



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2024

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 2 5

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2024

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

PËRMBAJTJA

1. Fjala e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore	13
2. Fjala hyrëse e Guvernatorit	15
3. Përmbledhje ekzekutive	17
4. Misioni, Vizioni dhe Vlerat e BQK-së	19
5. Plani Strategjik 2024-2028	20
6. Struktura organizative e BQK-së më, efektive nga 31 dhjetor 2024.....	21
I. Ekonomia e Kosovës në vitin 2024	23
1. Përmbledhje Makroekonomike	23
1.1. Eurozona	23
1.2. Ballkani Perëndimor	25
1.3. Sektori real	26
1.4. Sektori fiskal	30
1.5. Sektori i jashtëm.....	31
II. Aktiviteti i BQK-së në vitin 2024	34
1. Stabiliteti Financiar	34
1.1. Sektori financiar	34
1.2. Aktivitetet në fushën stabilitetit financiar	34
2. Mbikëqyrja Financiare	36
2.1. Aktivitetet Mbikëqyrëse të sektorit bankar	36
2.2. Aktivitetet mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve	46
2.3. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sektorit të Pensioneve	52
2.4. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sektorit të Tregjeve, IMF, IFJB, IP dhe IPE	55
2.5. Aktivitetet Mbikëqyrëse për Parandalimin i pastrimit të parave dhe LFT	58
2.6. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sistemeve të TI të Institucioneve Financiare	60
2.7. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare	60
2.8. Regjistri Kreditor.....	61
3. Licencimi dhe rregullimi i Institucioneve Financiare	64
3.1. Licencimi	64
3.2. Rregullimi i Institucioneve Financiare	71
4. Sistemi i Pagesave.....	84
4.1. Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare	85
4.2. Regjistri i Llogarive Bankare	87
4.3. Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave	88
4.4. Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave	88
4.5. Roli i BQK-së si katalizator i sistemit të pagesave	91
4.6. Bashkëpunimi me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare në fushën e pagesave	92

5. Edukimi Financiar dhe Mbrojtja e Konsumatorit	94
5.1. Edukimi Financiar dhe promovimi i qasjes në financa	94
5.2. Mbrojtja e konsumatorit	96
6. Aktivitetet në fushën e Statistikave	99
7. Menaxhimi i Rezervave dhe Operacionet Bankare	101
7.1. Menaxhimi i Mjeteve dhe Rezervave	101
7.2. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme	106
III. Qeverisja dhe zhvillimet e brendshme të BQK-së	119
1. Bordi i Bankës Qendrore dhe komitetet e tij	119
1.1. Komiteti i Auditimit (KA)	121
1.2. Komiteti për qeverisje, etikë dhe burime njerëzore	122
2. Bordi Ekzekutiv	124
3. Auditimi i Brendshëm	125
4. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut	126
4.1. Menaxhimi i Rrezikut Operacional	127
4.2. Menaxhimi i Rrezikut Financiar	129
5. Burimet Njerëzore	131
6. Teknologjia Informativë dhe siguria	132
7. Komunikimi me Publikun	133
7.1. Bashkëpunimi me institucionet tjera vendore	135
7.2. Konferenca Ndërkombëtare për shënimin e 25-vjetorit të BQK-së	135
7.3. Konferenca e fundvitit me media (26 dhjetor 2024)	136
8. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Integrimet Evropiane	136
8.1. Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare dhe Asistencat Teknike	137
8.2. Aktiviteti lidhur me Integrimet Evropiane	139
8.3. Konferencat ndërkombëtare dhe rajonale	140
8.4. Anëtarësimet në organizata ndërkombëtare	141
8.5. Vizitat Bilaterale në institucionet homologe	142
9. Qëndrueshmëria financiare	143
IV. Pasqyrat Financiare	144
V. Shtojca Statistikore	205

LISTA E SHKURTESAVE

AB	Auditimi i Brendshëm
ACH	Sistemi Automatik i Pagesave Individuale (Automated Clearing House)
AMIK	Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës
AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
APR	Asetet e Peshuara ndaj Riskut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambientit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BEK	Bordi Ekzekutiv i BQK-së
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe)
EACHA	Shoqata Evropiane e Shtëpive të Kliringut të Pagesave
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

EUROSTAT	Drejtoria Gjenerale për Statistika Evropiane
FKGK	Fondi Kosovare për Garanci Kreditore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBP	Funta Britanike (ang. Great Britain Pound)
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
ICAAP	Procesi i Brendshëm i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. the Internal Capital Adequacy Assessment Process)
IÇI	Indeksi i Çmimeve të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IHH	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IJSHEF	Institucione Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IFJB	Institucione Financiare Jobankare
IOPS	Organizata Ndërkombëtare për Mbikëqyrje të Pensioneve (angl. International Organisation of Pension Supervisors)
KA	Komiteti i Auditimit
KJP	Kreditë Joperformuese
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MTPL	Sigurimi i Autopërgjegjësive
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
NREK	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (angl. European System of Central Banks)

SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut ndër bankar
SEPA	Zona Unike e Pagesave në Euro (angl. Single Euro Payment Area)
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
SFR	Franga Zvicerane (Swiss Franc)
SRK	Sistemi i Regjistrit të Kontabilitetit
SWIFT	Shoqëria për Telekomunikim Financiar Ndërbankar Botëror (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunications)
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

LISTA E GRAFIKËVE

1.	Inflacioni në Eurozonë sipas kategorive kryesore	24
2.	Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor	25
3.	Norma e rritjes së BPV-së reale	26
4.	Inflacioni në Kosovë sipas kategorive kryesore	27
5.	Inflacioni bazë dhe i përgjithshëm	28
6.	Inflacioni i brendshëm dhe i importuar	28
7.	Regjistri i bizneseve	29
8.	Struktura e ndërmarrjeve të reja	29
9.	Eksportet, importet dhe bilanci tregtar i mallrave	31
10.	Eksporti i mallrave sipas kategorive	32
11.	Importi i mallrave sipas kategorive	32
12.	Remitencat	33
13.	Investimet e huaja direkte	33
14.	Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës	34
15.	Zërat kryesorë të aseteve të sektorit bankar	39
16.	Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	40
17.	Pjesëmarrja e kredive sipas sektorëve ekonomikë	40
18.	Stoku i kredive, sipas sektorëve ekonomikë	40
19.	Kreditë e reja, ndryshimi vjetor	41
20.	Struktura e depozitave	42
21.	Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita	43
22.	Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve	43
23.	Norma mesatare e interesit në depozita	43
24.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve	44
25.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare	44
26.	Stoku i kredive, sipas normave të interesit fikse apo variable	44
27.	Profiti neto i sektorit bankar	44
28.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar	45
29.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	45
30.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve	46
31.	Asetet e sektorit të sigurimeve	48
32.	Primet e shkruara dhe dëmet e paguara	50
33.	Asetet e sektorit pensional	53
34.	Performanca e FKPK-së	53
35.	Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale	53
36.	Investimet e FKPK-së	54
37.	Investimet e FSKP-së	54
38.	Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar	56

39.	Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive-----	56
40.	Rritja e kredive ndaj korporatave jofinanciare -----	56
41.	Lizingjet-----	57
42.	Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar -----	57
43.	Norma mesatare e interesit në kredi-----	57
44.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar-----	57
45.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar -----	58
46.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore-----	58
47.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së -----	62
48.	Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së -----	62
49.	Numri i kërkesave për raporte kreditore -----	63
50.	Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave-----	65
51.	Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve -----	67
52.	Rrjeti i siguruesve-----	68
53.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	85
54.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	85
55.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	85
56.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave-----	85
57.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në KIPS -----	86
58.	Mesatarja vjetore e vlerës së transaksioneve në KIPS -----	86
59.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	86
60.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	86
61.	Raporti i kredisë brenda ditore ndaj totalit së vlerës së shlyer në RTGS-----	87
62.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit -----	88
63.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit -----	88
64.	Numri i terminalave ATM-----	89
65.	Numri i terminaleve POS-----	89
66.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	89
67.	Vlera vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	89
68.	Numri i transferove të kreditit në formë elektronike në raport me transferet formë letër-----	89
69.	Numri i llogarive me qasje në internet në raport me numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse ---	90
70.	Portfolio e rezervave (EUR) të BQK-së -----	101
71.	Saldo përfundimtare e mjeteve në EUR të investuara sipas gjendjes së tyre, më 31 dhjetor të viteve përkatëse -----	102
72.	Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në USD -----	103
73.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit në EUR të BQK-së-----	103
74.	Raporti i shpërndarjes së portfolios investuese në EUR të BQK-së -----	103
75.	Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit -----	104
76.	Struktura e Letrave me Vlerë sipas afatit të maturimit -----	105

77.	Struktura e investitorëve nën Ankandet e Letrave me Vlerë-----	105
78.	Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2023 dhe 2024 -----	106
79.	Ankandet e letrave me vlerë gjatë vitit 2024 -----	106
80.	Furnizimi me para të gatshme-vlera -----	107
81.	Pranimi i parave të gatshme-vlera-----	107
82.	Furnizimi i parave të gatshme-vëllimi-----	108
83.	Pranimi i parave të gatshme-vëllimi-----	108
84.	Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve -----	109
85.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve -----	109
86.	Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve-----	109
87.	Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve -----	109
88.	Eksporti i parave të gatshme-vlera -----	110
89.	Importi i parave të gatshme-vlera-----	110
90.	Eksporti i parave të gatshme-vëllimi -----	110
91.	Importi i parave të gatshme-vëllimi-----	110
92.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi-vëllimi -----	111
93.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	111
94.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi-numri i copëve -----	111
95.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	111
96.	Kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim-vëllimi -----	111
97.	Kartëmonedha të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara-vëllimi-----	111
98.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim -----	112
99.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara -----	112
100.	Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim -----	112
101.	Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim -----	112
102.	Monedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim -----	113
103.	Monedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim -----	113
104.	Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse-----	116
105.	Vlera e transaksioneve vendore dalëse-----	116
106.	Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse-----	117
107.	Vlera e transaksioneve vendore hyrëse -----	117
108.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse -----	117
109.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse -----	117
110.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse -----	118
111.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse -----	118
112.	Burimet e rreziqeve-----	127
113.	Struktura e rezervave të BQK-së, me 31 dhjetor 2024-----	129
114.	Struktura e rezervave të BQK-së, me 31 dhjetor 2023-----	129
115.	Klasifikimi kreditor i rezervave të BQK-së, 31 dhjetor 2024-----	129

116.	Klasifikimi kreditor i rezervave të BQK-së, 31 dhjetor 2023-----	129
117.	Humbja e pritur kreditore sipas llojit të ekspozimeve -----	130
118.	Humbja e pritur kreditore në raport me vlerën e ekspozuar sipas llojit të ekspozimeve ECL/EAD	130
119.	Rezervat sipas maturitetit-----	131
120.	Struktura sipas edukimit-----	131
121.	Numri i publikimeve në rrjete sociale -----	133

LISTA E TABELAVE

1.	Indikatorët bazë makroekonomikë në Eurozonë-----	24
2.	Indikatorët bazë makroekonomik në BP -----	26
3.	Numri i ekzaminimeve në banka-----	36
4.	Struktura e asetëve të sektorit bankar-----	39
5.	Struktura e detyrimeve të sektorit bankar-----	42
6.	Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve-----	47
7.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	49
8.	Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	49
9.	Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	50
10.	Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit -----	51
11.	Rezultatet financiare -----	51
12.	Numri i ekzaminimeve të sektorit të pensioneve-----	52
13.	Numri i ekzaminimeve të sektorit të IMF, IFJB, IP dhe IPE -----	55
14.	Numri i ekzaminimeve për pastrimin e parave -----	59
15.	Numri i institucioneve financiare -----	65
16.	Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave -----	67
17.	Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve-----	68
18.	Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	68
19.	Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike -----	69
20.	Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK -----	69
21.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SPN-----	87
22.	Rastet e procesuara në regjistrin e llogarive bankare -----	87
23.	Numri i llogarive -----	90
24.	Numri i llogarive të parasë elektronike -----	90
25.	Numri dhe vlera e pagesave të parave elektronike -----	90
26.	Numri i ankesave ndër vite -----	97
27.	Numri i ankesave sipas kanalit të pranimit -----	97
28.	Numri i ankesave sipas statusit -----	98
29.	Shuma dhe vëllimi i aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve me para të gatshme-----	107
30.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	116
31.	Niveli i depozitave klientëve kryesor -----	118

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

1. Fjala e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore

Kam kënaqësinë t'ju drejtohem në kuadër të Raportit Vjetor për vitin 2024 në emër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Viti që lamë pas ishte një periudhë konsolidimi dhe avancimi të mëtejshëm për institucionin tonë, me progres të vazhdueshëm në drejtim të harmonizimit rregullativ dhe operacional me standardet më të larta të Bashkimit Evropian (BE).

Gjatë vitit 2024, Bordi i Bankës Qendrore vazhdoi miratimin dhe implementimin e një sërë rregulloresh kyçe të cilat kontribuuan drejtpërdrejt në forcimin e stabilitetit, transparencës dhe efikasitetit të sektorit financiar. Fokusi ynë mbeti tek avancimi i kornizës rregullative për sektorin bankar, sektorin e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare, dhe institucionet financiare jobankare, duke synuar krijimin e një sistemi financiar të besueshëm që i përgjigjet nevojave të ekonomisë së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Në vitin 2024, një nga prioritetet tona kryesore ka qenë forcimi i angazhimit në ruajtjen dhe konsolidimin e stabilitetit financiar në Kosovë. Përmes mbikëqyrjes aktive dhe masave proaktive, kemi siguruar që sektori financiar të ruajë qëndrueshmërinë, duke minimizuar rreziqet sistemike dhe duke promovuar një mjedis financiar të besueshëm dhe rezistent ndaj sfidave potenciale të tregut global.

Një tjetër sfidë kyçe gjatë vitit 2024 ishte menaxhimi i inflacionit, i cili ka shënuar një tendencë rritëse të moderuar, në linjë me zhvillimet globale. Në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante, BQK-ja ka vazhduar të monitorojë nga afër trendet inflacioniste, duke ndërmarrë veprime të koordinuara për zbutjen e efekteve negative në ekonominë vendore dhe për të mbështetur fuqinë blerëse të qytetarëve.

Duke shikuar drejt së ardhmes, BQK-ja është e përkushtuar të avancojë në përshtatjen me zhvillimet globale ekonomike dhe teknologjike. Objektivat tanë strategjike për vitin 2025 dhe më tej do të jenë orientuar në avancimin e mëtejshëm të sistemeve të pagesave të menjëhershme në bashkëpunim me partnerët tanë në Eurozonë, përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë kibernetike, zgjerimin e edukimit financiar dhe integrimin gjithnjë e më shumë të elementeve të ekonomisë së gjelbër në aktivitetet e sektorit financiar.

Në fund, dëshiroj të falënderoj anëtarët e Bordit, Guvernatorin, Bordin Ekzekutiv, dhe të gjithë stafin e BQK-së për punën e tyre të palodhshme, si dhe qytetarët për besimin dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme. Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë një të ardhme financiare më të qëndrueshme dhe prosperuese për Kosovën.

Me respekt,

Bashkim Nurboja, Dr. Sc.,



Kryetar i Bordit
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

2. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Të nderuar lexues, qytetarë, drejtues e përfaqësues institucionalë, partnerë ndërkombëtarë,

Me respekt dhe përkushtim të thellë profesional dhe ndjenjë të lartë të përgjegjësisë publike, kam kënaqësinë të paraqes Raportin Vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2024, një përmbledhje e angazhimeve dhe aktiviteteve institucionale për të garantuar stabilitetin financiar, ruajtjen e besimit publik, forcimin e integritetit dhe sovranitetit monetar të vendit tonë.

Viti 2024 ishte vit i progresit të qëndrueshëm, sfidave të menaxhuara me maturi dhe reformave të rëndësishme të zbatuara me përkushtim. Në këtë periudhë, ekonomia e Kosovës shënoi rritje reale prej 4.4 përqind, ndërsa inflacioni u ngadalësua në 1.6 përqind, duke reflektuar një përmirësim të kushteve makroekonomike dhe një menaxhim të kujdesshëm monetar dhe fiskal. Gjithashtu, sektori financiar pati një performancë të mirë, duke vazhduar të jetë i qëndrueshëm dhe brenda parametrave të caktuar të shëndetit financiar, që konfirmojnë stabilitetin financiar dhe zgjerimin e qasjes në financa të sigurta.

BQK ishte në qendër të përpjekjeve për të garantuar integritetin e sistemit financiar, mbrojtjen e euros si mjet i vetëm ligjor pagese, si dhe ligjshmërinë në operimin e institucioneve, përballë çdo praktike që cenon stabilitetin monetar dhe praktikave jo të ligjshme apo të pashëndetshme. Në këtë drejtim, janë ndërmarrë veprime të vendosura për luftën kundër parasë së falsifikuar, parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ligjshmërisë, si dhe për ruajtjen e besueshmërisë së parasë në qarkullim dhe mbrojtjen e konsumatorit të shërbimeve financiare.

Stabiliteti i sistemit financiar është ruajtur dhe konsoliduar më tej, siç dëshmohet nga qëndrueshmëria e treguesve të sektorëve bankar, të sigurimeve, pensione dhe institucioneve jo bankare dhe mikrofinanciare. Janë marrë masa konkrete me instrumente rregullatore për të kapitalizuar sektorin bankar dhe për të rritur qëndrueshmërinë e sektorit, të cilat masa kontribuojnë në arritjen e qëllimit parësor të BQK-së.

Në aspektin ligjor dhe rregullativ, kemi përmbyllur me sukses procesin e finalizimit të një sërë ligjesh dhe rregulloresh kyçe, të cilat forcojnë kornizën institucionale të BQK-së dhe përgatisin vendin për integrim të mëtejshëm në arkitekturën evropiane financiare. Para-plikimi në SEPA (Zona Unike e Pagesave në Euro), krahas përgatitjeve të kryera në një afat të shkurtër, përbën një hap të rëndësishëm drejt këtij qëllimi strategjik, duke krijuar bazën për një sistem pagesash të harmonizuar dhe integruar sigurt në hapësirën evropiane, si një përkushtim i të gjitha organeve drejtuese të BQK-së.

Në funksion të rritjes së përfshirjes financiare, efektet dha zbatimi i plotë i rregullores për llogaritë bazike, duke arritur numrin në 390 mijë llogari të tilla, ndërsa është zgjeruar rrjeti i institucioneve dhe shërbimeve financiare, ku gati u trefishua numri i institucioneve financiare të licencuara nga BQK në pjesën veriore të vendit, krahas sigurimit të ligjshmërisë në operimin e operatorëve vetëm me licencë të BQK-së, me qëllim ofrimin e shërbimeve të sigurta për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Një tjetër aktivitet i ndërmarrë në rritjen e transparencës, konkurrencës dhe fuqizimit të konsumatorit ishte lansimi testues i platformës për krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare, e cila vazhdon të avancohet për të arritur qëllimin e plotë dhe mbulimin e sektorit.

Në aspektin e brendshëm institucional, janë avancuar më tej reformat institucionale, përmes fuqizimit të qeverisjes së brendshme, auditimit të brendshëm, kontrollit të rrezikut dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit profesional dhe politikave që ruajnë, tërheqin dhe mbështesin kuadrot profesionale. Angazhimi ndaj zhvillimit teknologjik është rritur, me qasje strategjike në avancimin e sigurisë kibernetike dhe digjitalizimin e proceseve të brendshme. Këto arritje janë njohur gjërisht edhe nga institucionet partnere ndërkombëtare, si kontribuuese në këto procese.

BQK ka vazhduar të sigurojë qëndrueshmërinë financiare dhe buxhetore të duhur që, përveç tjerash, ia garanton pavarësinë kushtetuese, duke arritur që të mbërrijë kuotat ligjore të rezervave të kapitalit nga fitimet e qëndrueshme, si dhe të arrijë të ndajë për të dytin vit radhazi fitimet e ndashme me buxhetin e shtetit, krahas kontributit të interesit në depozitat e Buxhetit të Shtetit.

Gjithashtu, BQK ka dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në përmbylljen e suksesshme të procesit të vlerësimit për marrjen e një vlerësimi kreditor sovran të Kosovës, hap që reflekton maturimin e institucioneve ekonomike dhe financiare dhe hap rrugë të reja për financim ndërkombëtar. Sektori financiar ishte ndër fushat kyçe që u konsiderua lart me kontribut në marrjen e këtij vlerësimi.

Gjatë vitit, BQK ka realizuar të gjitha detyrat që rrjedhin nga programet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, të cilat u përmbyllën me sukses, duke forcuar kredibilitetin institucional dhe përkushtimin ndaj objektivave të zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes nga goditjet e jashtme, si dhe duke krijuar hapësirë shtesë financuese, në rast të nevojës së shfrytëzimit të tyre.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal është forcuar më tej, si në aspektin e zgjerimit të rrjetit të Bankave Qendrore homologe për menaxhim të rezervave ndërkombëtare, pjesëmarrjes në forume e konferenca për shkëmbim të përvojave dhe avancim të kapaciteteve, e deri tek përfaqësimi institucional në nivelet më të larta. Konferenca Ndërkombëtare për shënimin e 25-vjetorit të themelimit të BQK-së ishte ndër ngjarjet më madhore të organizuara me profesionalizëm dhe përkushtim, duke siguruar pjesëmarrje të nivelit më të lartë ndërkombëtar që ndonjëherë ka marrë pjesë në këto ngjarje, dhe përbën një moment kulmor të promovimit të Bankës Qendrore dhe Republikës së Kosovës, si vend që aspirojnë dhe punon për integrim të plotë në sistemin financiar evropian dhe ndërkombëtar. Kjo ngjarje më pas u pasqyrua gjerësisht edhe nga institucionet pjesëmarrëse ndërkombëtare në rrjetet e tyre zyrtare të komunikimit publik.

Në përmbyllje, dëshiroj të falënderoj të gjithë stafin e BQK-së për angazhimin dhe përkushtimin e treguar, Bordin e Bankës Qendrore për vizionin dhe mbështetjen, institucionet e Republikës së Kosovës, partnerët tanë vendas dhe ndërkombëtarë për bashkëpunimin e frytshëm, si dhe publikun e gjerë, duke përfshirë mediat, organizatat jo-qeveritare dhe akademinë. Së bashku kemi ndërtuar një themel të fuqishëm për të ardhmen e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.

Me përkushtim të vazhdueshëm për transparencë, besueshmëri dhe zhvillim gjithëpërfshirës, BQK do të mbetet institucion plotësisht i pavarur, siç kushtetuta e vendit ia përcakton, që garanton stabilitetin dhe sigurinë e sistemit financiar, mbështetjen e ekonomisë, avancimin e integriteteve financiare evropiane me qasje gjithëpërfshirëse në shërbim të qytetarëve dhe zhvillimit të vendit.

Me respekt,

Ahmet Ismaili,



Guvernator

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

3. Përmbledhje ekzekutive

Viti 2024 shënoi një periudhë të rëndësishme për ekonominë dhe sistemin financiar të Republikës së Kosovës, duke reflektuar përmirësim të ndjeshëm të kushteve makroekonomike dhe avancim të mëtejshëm të stabilitetit financiar. Rritja reale ekonomike arriti në 4.4%, që ishte më larta në rajon (mesatarja rajonale 3.4%), ndërsa inflacioni u ngadalësua ndjeshëm në 1.6%, që ishte norma më e ulët në rajon (mesatarja 3.2%).

Asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 12.75 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.8%, krahasuar me vitin 2023, të dominuara nga asetet e sektorit bankar në vlerë prej 8.6 miliardë euro ose 67% e aseteve të sektorit financiar. Kreditë dhe produktet kreditore, arritën vlerën prej 5.8 miliardë euro, duke përfaqësuar 45.5% të aseteve të sektorit financiar.

Sektori bankar vazhdoi të jetë i qëndrueshëm, likuid dhe i mirë kapitalizuar. Kreditimi u rrit me 18.3% ndërsa depozitat u rritën me 13% dhe si rezultat raporti midis kredive dhe depozitave arriti në 84%, duke dëshmuar besim të lartë të publikut në sistemin bankar dhe nivel të kënaqshëm të mbështetjes ndaj ekonomisë reale. Raporti i kapitalizimit të bankave arriti në 17.4% ndërsa norma e kredive joperformuese mbeti në nivel të ultë historik prej 1.9%. Normat e interesit në kredi ranë në 5.9%, dhe margjina kredi-depozita u ngushtua në 2.5 pikë përqindje.

Sektori pensional arriti në 3.2 miliardë euro, me kthim nga investimet në vlerë 247 milionë euro, ndërsa sektori i sigurimeve shënoi rritje të primeve në 168 milionë euro, krahas rritjes së dëmeve të paguara. Sektori Mikrofinanciar shënoi rritje të kreditimit për 24.6%, kurse kreditimi në bujqësi dhe për ndërmarrje u mbështet edhe nga skemat e garancive kreditore.

BQK intensifikoi mbikëqyrjen në të gjithë sektorët financiarë, duke realizuar 30 ekzaminime në vend dhe duke përgatitur për kalimin në standardet evropiane si SREP, IFRS 17 dhe Solvenca II. U krijua Departamenti i Rimëkëmbjes dhe Përmbjlljes, ndërsa mbikëqyrja e rreziqeve sistemike dhe analizat makroprudenciale u avancuan në bashkëpunim me FMN. Në mbështetje të FMN-së, u krijua Komiteti i Riskut si dhe u miratua deklarata e apetitit të rrezikut. Gjithashtu, u funksionalizua Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili trajoi 927 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, krahas me shqyrtimin e praktikave mbikëqyrëse, si dhe u lancua platforma për krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare. BQK ndërmori masa korrigjuese dhe administrative në pajtim me mandatin ligjor dhe me qëllim të pajtueshmërisë me kornizën ligjore dhe rregullative.

Legjislacioni i BQK-së është avancuar dhe harmonizuar me kornizën ligjore të BE-së përmes miratimit të tre ligjeve kyçe: Ligji për Bankat, Ligji për Shërbimet e Pagesave dhe Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Po ashtu, janë miratuar 39 rregullore, udhëzime dhe instrumente tjera rregullatore, duke përfshirë 20 rregullore të veçanta që hapin rrugë për anëtarësimin në SEPA, ndërsa është realizur edhe para-aplikimi për anëtarësim në SEPA tek institucionet përkatëse të BE-së.

Sa i përket sistemit të pagesave, viti 2024 shënoi rritje të ndjeshme në përdorimin e instrumenteve elektronike, ku numri i transaksioneve u rrit me 9.6% dhe në vlerë prej 16.3%. Kështu, Sistemi Ndërbankar i Pagesave (KIPS) procesoi afër 21 milionë transaksione me vlerë mbi 25.3 miliardë euro. Sa i përket llogarive, nga 2.53 milionë llogari bankare të hapura, mbi 1 milion llogari kanë qasje në shërbime online, ndërsa numri i llogarive bazike në 390 mijë llogari, të cilat BQK i mbështeti përmes rregullores për llogaritë bazike dhe fushatave të edukimit financiar.

Qasja në financa u përmirësua ndjeshëm, veçanërisht pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme, që ndikoi në trefishimin e pranisë së institucioneve financiare në komunat veriore të Kosovës, duke fuqizuar gjithpërfshirjen dhe qasjen në financa. Gjithashtu, si

rezultat u tërhoqën nga qarkullimi kartëmonedha të dyshuara, përfshirë mbi 400 mijë copë kartëmonedha të denominimit 500 Euro, duke forcuar edhe me tej integritetin monetar.

Në aspektin e operacioneve dhe menaxhimit të parasë së gatshme, BQK vazhdoi zbatimin e masave në adresimin e sfidave në fushën e parave të falsifikuara në koordinim të ngushtë institucional. Në këtë drejtim, BQK nisi krijimin e sistemit kombëtar kundër falsifikimit të parasë, të mbështetur nga BE dhe Banka Qendrore e Kroacisë.

Në fushën ndërkombëtare, u arritën marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e rezervave me tri banka qendrore të BE-së, ndërsa vazhdoi edhe qasja në linjën kreditore të Eurosistemit, të cilën në emër të Bankës Qendrore Evropiane e operon Banka Qendrore e Gjermanisë (Deutsche Bundesbank).

BQK e ka avancuar ndjeshëm komunikimin institucional përmes lansimit të webfaqes së re, platformës për krahasimin e produkteve financiare, aktiviteteve të edukimit financiar dhe rritjes së ndjeshme të pranisë digjitale. Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare me rastin e 25-vjetorit të themelimit dhe komunikimi transparent me mediat, dëshmuar angazhimin për edukim financiar, transparencë dhe besim publik.

Sfidat aktuale dhe pasiguritë globale kërkojnë qasje të kujdesshme, vlerësime të bazuara dhe vendimmarrje të balancuar, të adaptueshme në rrethana dinamike, të cilat, BQK përmes strukturave drejtuese dhe stafit profesional, bashkëpunimit ndër-institucional dhe mbështetjes së partnerëve të saj strategjik do të arrij t'i menaxhoj me sukses, në pajtim me kornizën ligjore të aplikueshme.

4. Misioni, Vizioni dhe Vlerat e BQK-së

Misioni

Misioni i BQK-së është të sigurojë dhe të ruajë stabilitetin financiar dhe të çmimeve, të ofrojë sistem efektiv të pagesave, si dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Republikën e Kosovës.

Vizioni

BQK synon të vazhdojë të jetë një institucion i pavarur, i besueshëm dhe transparent, që vepron me përgjegjësi ndaj publikut, si dhe të jetë sinonim i profesionalizmit, inovacionit dhe gjithëpërfshirjes.

Vlerat

BQK mbështetet në vlerat e mëposhtme:

- **Integriteti dhe etika** – Staf i BQK-së është i përkushtuar të punojë me ndershmëri sipas standardeve më të larta të integritetit dhe sjelljes profesionale në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.
- **Pavarësia, kompetenca dhe profesionalizmi** - Për t'i përmbushur objektivat e saj, BQK sigurohet që veprimtarinë e saj ta udhëheqë përmes qasjes së pavarur, ekspertizës dhe profesionalizmit
- **Puna në grup dhe inovacioni** - BQK nxit bashkëpunimin dhe promovimin e ideve të reja për të përballuar sfidat me zgjidhje të qëndrueshme
- **Promovimi i interesit publik** - BQK vepron me transparencë në vendimmarrje dhe në interes të së mirës së përbashkët
- **Efektiviteti dhe efikasiteti** - Arritja e objektivave përmes përdorimit efikas të burimeve me rezultate të matshme
- **Cilësia dhe përkushtimi** - BQK punëson staf të kualifikuar që ofron punë të lartë cilësore dhe përkushtim të vazhdueshëm.

5. Plani Strategjik 2024-2028

Plani Strategjik 2024-2028 është bazuar në Politikën për Planifikim Strategjik në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Ai është një shprehje e vizionit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe një kornizë dinamike që pasqyron dedikimin tonë ndaj qëndrueshmërisë së sistemit financiar, inovacionit në funksion të rritjes së efikasitetit të shërbimeve financiare dhe mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ky Plan Strategjik është hartuar me kontribut dhe gjithë-përfshirje të personelit të BQK-së. Ai merr parasysh të gjitha kërkesat e nevojshme të kohës dhe shërben si udhërrëfyes për të adresuar çështjet që lidhen me: (a) qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar, (b) modernizimin e infrastrukturës së tregut financiar, (c) edukimin dhe përfshirjen financiare, (ç) avancimin e mbrojtjes së konsumatorit, si dhe (d) zgjerimin e bashkëpunimit dhe ndikimit në fushat e përgjegjësisë.

Më poshtë janë listuar pesë qëllimet strategjike të planit:

Qëllimi 1: Forcimi i qëndrueshmërisë dhe stabilitetit financiar

Avancimi i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse për të identifikuar dhe reaguar me kohë ndaj rreziqeve të institucioneve financiare në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar.

Qëllimi 2: Ngritja e kapaciteteve, përkushtimi ndaj personelit, digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve

Modernizimi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në funksion të ngritjes së nivelit të qeverisjes korporative, kapaciteteve njerëzore, kontrollës së brendshme, menaxhimit të riskut, transparencës, proceseve dhe operacioneve të punës.

Qëllimi 3: Modernizimi i infrastrukturës së tregut financiar dhe konkurrueshmëria

Avancimi i infrastrukturës për shlyerjen e pagesave dhe Letrave me Vlerë dhe për digjitalizimin e shërbimeve të pagesave në funksion të nxitjes së konkurrencës dhe zhvillimit të tregut.

Qëllimi 4: Avancimi i mbrojtjes së konsumatorit, edukimi financiar dhe përfshirjes financiare


Promovimi i edukimit financiar, qasjes në financa dhe gjithë-përfshirjes financiare si dhe praktikave më të mira të ofrimit të shërbimeve nga institucionet financiare.

Qëllimi 5: Zgjerimi i bashkëpunimit, përfshirjes dhe ndikimit në fushat e përgjegjësisë

Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me akterët e jashtëm, institucionet financiare, autoritetet rregullatore, institucionet financiare ndërkombëtare dhe institucionet tjera përkatëse me interes të përbashkët.

Dokumentin e plotë e gjeni në vegzën e faqes zyrtare të BQK-së: <https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2024/09/PlaniStrategjik2024-2028.pdf>

6. Struktura organizative e BQK-së, efektive nga 31 dhjetor 2024



*vetëm Funksion

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

I. Ekonomia e Kosovës në vitin 2024

1. Përmbledhje Makroekonomike

Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të qëndrueshme prej 4.4 përqind të BPV-së në vitin 2024, mbështetur nga konsumi, investimet dhe eksportet, ndërsa importet vazhduan të jenë të larta duke ndikuar si komponentë negativisht në kalkulimin e BPV-së. Kontributi i konsumit në rritjen vjetore të BPV-së rezultoi më i lartë kundrejt vitit paraprak, atribuar rritjes së besimit të konsumatorëve dhe ngadalësimit të inflacionit. Investimet publike dhe rritja e eksportit të shërbimeve ishin gjithashtu faktorë mbështetës. Megjithatë, importet e mallrave dhe shërbimeve e rritën deficitin tregtar dhe për pasojë, ndikuan negativisht rritjen reale. Për vitin 2025, BQK parashikon rritje reale të BPV-së prej 4.1 përqind, rritje e mbështetur nga kërkesa e brendshme dhe eksportet. Pasiguritë e rritura gjeopolitike dhe implikimet tek partnerët kryesor ekonomik mund të ndikojnë negativisht rritjen e projektuar. Shkalla mesatare e inflacionit u ngadalësua në 1.6 përqind në vitin 2024, kryesisht si rezultat i dinamikave në çmimet e karburanteve dhe ushqimit. Ndërkohë, presionet e rritura inflacioniste gjatë vitit 2025 janë përkthyer në shkallë më të lartë të inflacionit të pritur. BQK parashikon një normë inflacioni prej 3.3 përqind, dinamikë e ndikuar nga presionet e rritura në çmimet e ushqimit dhe energjisë elektrike përgjatë vitit 2025.

Sektori i ndërmarrjeve u karakterizua me rritje të qarkullimit dhe shkallë me të lartë të ndërmarrjeve të reja të regjistruara, me sektorin e tregtisë dhe industrisë përpunuese si dominues. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore u rrit, megjithëse mbetet ende relativisht e ulët, veçanërisht për gratë.

Në sektorin fiskal, të hyrat u rritën me 11.0 përqind, si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik dhe përmirësimit të mbledhjes së të hyrave, ndërsa shpenzimet u rritën me 8.3 përqind. Borxhi publik shënoi një rritje prej 4.6 përqind, por mbetet në nivele të ulëta. Në sektorin e jashtëm, u thellua bilanci tregtar i mallrave, duke rritur deficitin në llogarinë rrjedhëse dhe neutralizuar efektin pozitiv të rritjes së burimeve tjera, kryesisht të shërbimeve dhe të ardhurave parësore.

1.1. Eurozona

Ekonomia e Eurozonës u rrit me një ritëm modest në vitin 2024, pas një periudhe stagnimi përgjatë vitit 2023. Sipas të dhënave preliminare nga Eurostat, rritja ekonomike ishte 0.9 përqind në vitin 2024, kundrejt 0.4 përqind në vitin paraprak. Kjo rritje u diktua kryesisht nga ecuria pozitive e konsumit privat, e mbështetur nga rritja e të ardhurave reale dhe ngadalësimi i inflacionit, si dhe përmirësimi i besimit të konsumatorëve. Në anën tjetër, investimet e dobëta reflektojnë pjesërisht koston e lartë të financimit, rënien e marzhave të fitimit, krahas produktivitetit më të ulët dhe rritjen e pasigurive. Konkurrueshmëria e ulët e mallrave evropiane ndikoi negativisht në eksporte dhe në industrinë prodhuese, dukë bërë që rritja ekonomike të gjenerohet kryesisht nga sektori i shërbimeve.

Dinamikat e rritjes ekonomike ishin të përziara, me dallime të dukshme mes ekonomive të mëdha të Eurozonës. BPV vijoi të tkurret për -0.2 përqind në Gjermani dhe -1.2 përqind në Austri, ndërsa u evidentua rritje në Spanjë, Francë dhe Itali (shih Tabelën 1). Këto dallime pasqyrojnë dallimet në modele ekonomike sektoriale, politikën fiskale e monetare dhe dinamika të tregut të patundshmërive. Ekonomitë në zhvillim shënuan rritje më të fortë, kryesisht për shkak të rritjes së turizmit dhe konvergencës me ekonomitë e zhvilluara.

Projeksionet e BQE-së sugjerojnë për rritje ekonomike prej 0.9 përqind në vitin 2025, bazuar mbi pritjet për rritje të konsumit privat, si rezultat i rritjes së të ardhurave reale të ekonomive familjare, lehtësimit të kushteve të financimit si dhe rimëkëmbjes graduale të investimeve dhe

eksporteve, për shkak të përmirësimit të tregtisë globale. Megjithatë, projeksionet mbeten të ndjeshme ndaj rreziqeve, si përkeqësimi i marrëdhënieve tregtare me SHBA-të dhe implikimet në eksport dhe investime, tensionet e vazhdueshme gjeopolitike, zbehja e ngadalshme e efektit shtrëngues të politikës monetare pas lehtësimit, e të tjera.

Tregu i punës vazhdoi të karakterizohet nga zhvillime pozitive gjatë vitit 2024. Norma e papunësisë ra në 6.4 përqind nga 6.6 përqind në 2023, duke qëndruar në nivele historikisht të ulëta. Rritja e punësimit e bazuar mbi pritshmëritë për rikuperim të aktivitetit ekonomik dhe rritjen e pagave reale, u ngadalësua në 0.4 përqind në vitin 2024 nga 0.6 përqind në vitin e mëparshëm. Ky zhvillim sinjalizon për stabilizim në tregun e punës pas një periudhe me rritje të fortë të punësimit, pasi dinamikat ciklike që nxitën punësimin pritet të zbehen gradualisht.

Tabela 1. Indikatorët bazë makroekonomik në Eurozonë

Përshkrimi	BPV reale (%)				Inflacioni (%)				Papunësia (%)			
	2022	2023	2024	2025p	2022	2023	2024	2025p	2022	2023	2024	2025p
Eurozona	3.5	0.4	0.9	0.9*	8.4	5.4	2.4	2.3*	6.8	6.6	6.4	6.3
Austria	5.3	-1.0	-1.2	-0.3	8.6	7.7	2.9	2.9	4.8	5.1	5.2	5.3
Franca	2.6	0.9	1.2	0.6	5.9	5.7	2.3	0.9	7.3	7.3	7.4	7.9
Gjermania	1.4	-0.3	-0.2	0.0	8.7	6.0	2.5	2.4	3.2	3.1	3.4	3.6
Greqia	5.7	2.3	2.3	2.3	9.3	4.2	3.0	2.8	12.5	11.1	10.1	9.3
Italia	4.8	0.7	0.7	0.7	8.7	5.9	1.1	1.8	8.1	7.7	6.5	5.9
Spanja	6.2	2.7	3.2	2.6	8.3	3.4	2.9	2.3	13.0	12.2	11.4	10.4


Burimi: Eurostat (Qershor, 2025), BQE (Mars 2025), dhe Komisioni Evropian (Maj 2025).

*Të dhënat janë sipas vlerësimeve dhe parashikimeve të BQE-së dhe Komisionit Evropian.

Inflacioni në Eurozonë në vitin 2024 u ngadalësua në 2.4 përqind, nga 5.4 përqind në vitin paraprak. Rënia e çmimeve të energjisë dhe stabilizimi i zinxhirëve të furnizimit ndihmuan në këtë ngadalësim, së bashku me kushtet e shtrënguara të financimit. Çmimet e ushqimit dhe mallrave poashtu u ngadalësuan, të ndihmuara nga përmirësimi i ofertës dhe aktiviteti relativisht i dobët ekonomik. Në anën tjetër, përkundër ngadalësimit, inflacioni mbeti i lartë në sektorin e shërbimeve si një ndër kontribuuesit kryesor në rritjen e çmimeve, i nxitur kryesisht nga rritja e pagave në këtë sektor (shih Grafikonin 1). Këto dinamika u reflektuan edhe në inflacionin bazë që rezultoi për 0.4 pikë përqindje më i lartë sesa ai i përgjithshëm, duke sinjalizuar për vazhdimësi të presioneve të brendshme inflacioniste.

Projeksionet e BQE-së sugjerojnë për vazhdim të ngadalësimit të inflacionit, me normën mesatare vjetore që pritet të sillet rreth 2.3 përqind në 2025 dhe 1.9 përqind në 2026. Ecuria rënëse e inflacionit pritet të udhëhiqet nga komponenta bazë, përkatësisht nga shërbimet si rrjedhojë e rënies së presioneve inflacioniste në paga dhe vazhdimin të ndikimit të kushteve të shtrënguara të financimit. Ngjashëm, parashikimet sugjerojnë për ngadalësim edhe të inflacionit bazë, që pritet të shënojë rritje prej 2.2 dhe 2.0 përqind në vitin 2025 dhe 2026 respektivisht. Rreziqet kryesore anojnë nga kahu i lartë dhe përfshijnë ndër të tjera, rritjen e tensioneve tregtare dhe implikimet në kursin e këmbimit, tensionet gjeopolitike dhe kushtet klimatike.

Grafik 1. Inflacioni në Eurozonë sipas kategorive kryesore



Burimi: Eurostat (2025)

Në vitin 2024, BQE ndërmoi hapa për të lehtësuar politikën monetare, duke ulur gradualisht normat e interesit. Nga qershori deri në dhjetor 2024, norma e interesit të depozitave u ul për 1.0 pikë përqindje, ndërsa norma e rifinancimit të operacioneve dhe ajo e huazimit marginal u ul për 1.35 pikë përqindje. Këto veprime synonin të mbështesnin rritjen ekonomike, ndërkohë që inflacioni kishte shfaqur një tendencë rënëse.


Sipas Anketave të Kreditimit Bankar të BQE-së, përgjatë vitit 2024, standardet e kreditimit vazhduan të shtrëngohen përgjithësisht, me disa tendenca lehtësuese në sektorë specifikë. Standardet e kreditimit ndaj ndërmarrjeve dhe ato të kredive konsumuese ndaj ekonomive familjare u shtrënguan, si pasojë e rritjes së rrezikut të perceptuar nga bankat dhe zvogëlimit të tolerancës ndaj rrezikut. Kurse, standardet e kreditimit ndaj ekonomive familjare për kredi hipotekare u lehtësuan, si rezultat i rritjes së konkurrencës në sektorin bankar. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet ra ndjeshëm në fillim të vitit, si pasojë e normave të larta të interesit dhe dobësimit të investimeve, por u përmirësua në pjesën e dytë të vitit me rënie të normave të interesit. Ngjashëm, kërkesa e ekonomive familjare për kredi hipotekare u rrit dukshëm nga gjysma e dytë e vitit e nxitur nga normat më të ulëta të interesit dhe përmirësimi i perspektivës së tregut të patundshmërive, ndërsa kërkesa për kredi konsumuese shënoi rritje modeste.

1.2. Ballkani Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) në vitin 2024 shënoi rritje mesatare prej 3.4 përqind (3.7 përqind në 2023). Rritja më e lartë, krahasuar me vendet tjera të rajonit, u shënuar në Kosovë (4.4 përqind), ndërsa rritja më e ulët u shënuar në Bosnjë dhe Hercegovinë (2.5 përqind). Aktiviteti ekonomik në rajon, përfshirë Kosovën, u mbështet kryesisht nga ulja e presioneve inflacioniste dhe rritja e kreditimit, faktor që u përkthye në rritje të konsumit dhe investimeve. Konsumi vazhdon të jetë faktori kryesor i rritjes ekonomike në rajon, i nxitur nga rritja e pagave, shpenzimeve publike dhe përmirësimi i tregut të punës. Megjithatë, kërkesa e jashtme mbetet e dobët si pasojë e ngadalësimit ekonomik në partnerët kryesorë evropianë, duke pasur ndikim negativ në rritjen e tregtisë. Projektionet e FMN-së për vitin 2025 sugjerojnë për rritje mesatare prej 3.4 përqind në rajonin e BP (shih Grafikon 2). Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë, që është partneri kryesor tregtar i rajonit dhe burim i rëndësishëm për investime, pritet të jetë faktor përcaktues në dinamikën e përgjithshme ekonomike të vendeve të BP. Për më tepër, sfida si dinamikën e ekonomisë globale, presionet inflacioniste dhe pasiguria gjeopolitike mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në rajon.

Norma mesatare e inflacionit në vendet e BP në vitin 2024 u ngadalësua në 3.2 përqind, nga 7.7 përqind sa ishte në vitin 2023. Norma më e lartë e inflacionit ishte në Serbi (4.8 përqind), ndërsa Kosova kishte normën më të ulët prej 1.6 përqind (shih Tabelën 2). Faktorët që pritet të ndikojnë në ngadalësimin e inflacionit në BP në vitet e ardhshme përfshijnë vazhdimin e lehtësimeve në zingjirët e furnizimit dhe stabilizimin e çmimeve të energjisë, së bashku me masat e politikës monetare që synojnë mbajtjen e inflacionit në nivele të kontrolluara.

Grafik 2. Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Eurostat, dhe Agjencitë Statistike të vendeve të Ballkanit Perëndimor (2025).

*Projektionet e FMN-së (WEO Prill 2025).

Aktiviteti kredidhënës në vendet e rajonit, përfshirë Kosovën, ka shënuar rritje të përshpejtuar krahasuar me vitin paraprak. Norma më e lartë e rritjes së kreditimit u shënuar në Kosovë, me

18.3 përqind, ndjekur nga Mali i Zi me 13.3 përqind dhe Shqipëria me 12.8 përqind (shih Tabelën 2). Po ashtu, kreditë jo-performuese shënuan rënie në të gjitha vendet e rajonit. Megjithatë, dallimet ndërmjet vendeve mbeten të dukshme: Mali i Zi vazhdon të ketë nivelin më të lartë të kredive jo-performuese, ndjekur nga Shqipëria, ndërkohë që Kosova vijon të ketë shkallën më të ulët të kredive jo-performuese (shih Tabelën 2).

Tabela 2. Indikatorët bazë makroekonomik në BP

Përshkrimi	Inflacioni (%)				Balanci i llogarisë rrjedhëse (% e BPV)				Rritja e kreditimit (%)				Kreditë jo-performuese (%)				Papunësia (%)			
	2021	2022	2023	2024	2021	2022	2023	2024	2021	2022	2023	2024	2021	2022	2023	2024	2021	2022	2023	2024
Kosova	3.4	11.6	4.9	1.6	(9.4)	(10.3)	(7.6)	(9.0)	15.5	16.0	13.0	18.3	2.3	2.0	2.0	1.9	20.8	12.6	10.9	n/a
Maqedonia e Veriut	3.4	14.0	9.0	4.2	(2.8)	(6.1)	0.4	(2.3)	8.9	6.4	2.8	10.8	3.1	2.8	2.7	2.6	15.4	14.4	13.1	13.0
Mali i Zi	2.5	11.9	8.7	3.6	(9.2)	(12.9)	(11.4)	(17.4)	3.6	4.7	6.6	13.3	6.8	6.3	5.8	4.1	n/a	n/a	n/a	n/a
Shqipëria	2.3	6.6	5.3	2.6	(7.6)	(5.8)	(1.2)	(2.4)	6.4	8.9	11.9	12.8	5.4	4.8	4.6	4.0	11.5	10.8	9.5	8.8
Bosnja dhe Hercegovina	2.0	14.0	6.1	2.2	(1.8)	(4.4)	(2.3)	(3.6)	8.4	10.0	4.8	9.8	5.8	4.5	3.8	3.2	17.4	15.4	13.2	13.2
Serbia	4.0	11.7	12.1	4.8	(4.1)	(6.5)	(2.3)	(6.3)	9.7	7.1	1.1	8.8	3.6	3.0	3.2	2.5	11.1	9.5	9.4	8.6

Burimi: Eurostat, FMN, Agjencitë Statistikore, dhe Bankat Qendrore të vendeve të BP (2025).

Në vitin 2024, tregu i këmbimit valutor kishte luhatje, ku valuta euro ka pësuar ndryshime në raport me monedhat kryesore të rajonit dhe më gjerë. Euro u vlerësua kundrejt lirës turke, duke reflektuar zhvillimet makroekonomike dhe presionet inflacioniste në Turqi, të cilat ndikuan në dobësimin e monedhës së saj. Ndërsa, euro është zhvlerësuar ndaj lekut shqiptar, sterlinës britaneze dhe frangut zviceran. Ndërkohë, euro ka mbetur pothuajse e pandryshuar ndaj denarit maqedonas dhe dollarit amerikan, duke sugjeruar ekuilibër më të qëndrueshëm në këto tregje, si rezultat i politikave monetare të kujdesshme.

1.3. Sektori real


1.3.1 Bruto Prodhimi Vendor

Ekonomia e Kosovës ka vazhduar me rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të kushteve makroekonomike në vitin 2024. Sipas vlerësimeve tremujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV reale shënoi rritje prej 4.4 përqind në vitin 2024 (shih Grafikon 3), rritje e mbështetur nga konsumi, investimet dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve pati një ndikim të theksuar negativ në aktivitetin ekonomik.

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, kontribuoi me 4.8 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së, krahasuar me 3.4 pikë përqindje në vitin 2023. Rritja e konsumit rezultoi të jetë mbështetur nga rritja e burimeve kryesore të financimit, ngadalësimi i rritjes së çmimeve si dhe përmirësimi i besimit të konsumatorëve. Investimet kontribuan me 2.0 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së, krahasuar me 1.2 pikë përqindje në vitin 2023, kryesisht si pasojë e rritjes së investimeve publike.

Në kuadër të komponentëve të BPV, ndryshimi në eksportet neto kontribuoi dhe korigjoi negativisht me 2.4 pikë përqindje rezultatin e BPV-së, ku eksporti i mallrave dhe shërbimeve kontribuoi me 3.8 pikë përqindje, ndërsa importi kontribuoi negativisht me 6.2 pikë përqindje. Rritja e deficitit tregtar ishte rezultat i rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve për 8.9

Grafik 3. Norma e rritjes së BPV-së reale



Burimi: ASK (2025)

përqind (importi i mallrave shënoi rritje reale për 7.0 përqind dhe importi i shërbimeve shënoi rritje për 16.4 përqind). Ndërsa, rritja e vizitave të diasporës në Kosovë rezultoi në rritje reale të eksportit të shërbimeve për 10.8 përqind si dhe eksporti i mallrave shënoi rritje reale prej 5.7 përqind.

Për vitin 2025, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje prej 4.1 përqind. Në përgjithësi, aktiviteti ekonomik do të mbetet i mbështetur nga konsumi, investimet dhe eksportet, ndërsa sfidat e tregtisë ndërkombëtare dhe pasiguria globale mund të kenë ndikim të vazhdueshëm negativ në ritmin e rritjes ekonomike. Faktorët që pritet të ndikojnë në këtë rritje janë të ardhurat nga diaspora dhe stabilizimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare, që mund të ndikojnë në rritjen e besimit të konsumatorëve dhe investitorëve. Kërkesa e brendshme pritet të kontribuojë me 5.7 pikë përqindje në rritjen e BPV-së, ndërsa eksportet neto pritet të kontribuojnë negativisht me 1.7 pikë përqindje. Konsumi pritet të kontribuojë me 3.3 pikë përqindje, i mbështetur nga rritja e remitencave, kompensimi i punëtorëve dhe kredive personale. Investimet pritet të kontribuojnë me 2.4 pikë përqindje, kryesisht nga investimet private. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të ndikojë pozitivisht me 2.7 pikë përqindje, veçanërisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të diasporës, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve do të kontribuojë negativisht me 4.4 pikë përqindje.


Megjithatë, perspektiva ekonomike përballet me rreziqe dhe pasiguri që mund të ndikojnë negativisht në aktivitetin ekonomik. Tensionet gjeopolitike mund të ndikojnë në çmimet e energjisë dhe zinxhirët e furnizimit, duke pasur efekte negative në tregti dhe investime. Ngadalësimi i mundshëm i aktivitetit ekonomik në BE paraqet një rrezik për rritjen ekonomike të Kosovës.

1.3.2 Çmimet

Çmimet në Kosovë vijuan të ndjekin ecuri rënese përgjatë vitit 2024, falë zbutjes së presioneve të jashtme inflacioniste, si rrjedhojë e stabilizimit të ofertës dhe rënies së çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare. Shkalla e inflacionit në vitin 2024 rezultoi 1.6 përqind kundrejt 4.9 përqind në vitin 2023 (shih Grafikonin 4). Ky ngadalësim u mbështet nga rënia e çmimeve të karburanteve dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare që u pasqyrua në rënie të çmimeve të karburanteve dhe ngadalësim të rritjes së çmimeve të ushqimit në vend. Për më shumë, u evidentua rritje e ngadalësuar edhe në çmimet e mallrave tjera dhe shërbimeve. Përkundër rritjes së përshpejtuar ekonomike në vitin 2024, nuk u evidentuan presione inflacioniste në çmimet e konsumit nga kërkesa e brendshme, kryesisht si rezultat i varshmërisë së ekonomisë nga mallrat e importuara të cilat shënuan rritje të ngadalësuar të çmimeve.

Kontributi kryesor në shkallën e inflacionit u gjenerua nga kategoria e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, me 0.8 pikë përqindje. Rritje e ngadalësuar e çmimeve u evidentua në të gjitha nënkategoritë e ushqimit, me përjashtim të çmimeve të bulmetit dhe perimeve, të cilat shënuan rënie vjetore, dhe çmimeve të vajrave dhe yndyrnave, të cilat shënuan rënie më të lehtë në vitin 2024. Në anën tjetër, u evidentuan presione të forta inflacioniste në çmimet e kafesë, çajit, dhe

Grafik 4. Inflacioni në Kosovë sipas kategorive kryesore




Burimi: ASK (2025) dhe kalkulimet e BQK-së

kakaos si pasojë e çmimeve më të larta të importit të këtyre mallrave për shkak të goditjeve në ofertë nga kushtet e pafavorshme klimatike.

Ndërkohë, kontributi nga çmimet e energjisë mbeti negativ, ndonëse u tkurr nga -0.4 pikë përqindje në vitin 2023 në -0.1 pikë përqindje në vitin 2024. Përkundër që çmimet e naftës ndoqën ecuri rënëse përgjatë vitit 2024, efekti i bazës më të ulët në vitin paraprak ndikoi në tkurrjen e kontributit negativ nga kjo kategori. Rritje e ngadalësuar u evidentua në çmimet e energjisë elektrike, të cilat janë të rregulluara, si dhe në çmimet e lëndëve të ngurta, që mund t'i atribuohet rritjes së përdorimit të pajisjeve më efçente për ngrohje.

Zbutja e presioneve inflacioniste u reflektua edhe në ngadalësimin e inflacionit bazë që rezultoi në normë mesatare vjetore prej 2.6 përqind në 2024 në krahasim me 4.4 përqind sa ishte në vitin 2023. Megjithëkëtë, ritmi i rënies së inflacionit bazë ishte më i ngadalshëm sesa ai i inflacionit të përgjithshëm, me inflacionin bazë që mbeti më i lartë se sa ai i përgjithshëm përgjatë tërë vitit 2024 (shih Grafikon 5). Kontributi kryesor në inflacionin bazë u shënuar nga rritja e çmimeve të transportit, orendive, mallrave dhe shërbimeve të ndryshme, dhe rekreacionit dhe kulturës. Rritje e ngadalësuar u evidentua në të gjitha nënkategoritë me përjashtim të çmimeve të rekreacionit dhe kulturës me presione të rritura inflacioniste në gjysmën e parë të vitit 2024.


Grafik 5. Inflacioni bazë dhe i përgjithshëm



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2025)

Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe pesha e lartë e këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që norma e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara (shih Grafikon 6). Në vitin 2024, 1.2 pikë përqindje nga shkalla e inflacionit në Kosovë ishte nga mallrat e importuara, ndërsa 0.4 pikë përqindjeje u gjenerua brenda vendit. Përgjatë vitit 2024, u evidentua ngadalësim në presionet inflacioniste të gjeneruara brenda vendit, që përkon kryesisht me rritjen e ngadalësuar të çmimeve të energjisë elektrike, mallrave dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e shtëpisë, shërbimeve hoteliere dhe disa shërbimeve tjera të gjeneruara brenda vendit.

Grafik 6. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2025)

Sipas indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) të ASK-së, çmimet e mallrave të importuara në Kosovë shënuan rritje të ngadalësuar prej 0.8 përqind në vitin 2024 nga 4.2 përqind në vitin 2023. Ngadalësimi u mbështet nga çmimet e produkteve minerale dhe metaleve bazë, që përbëjnë rreth 25 përqind të mallrave të importuara dhe të cilat shënuan rënie prej 3.9 dhe 1.8 përqind respektivisht. Për më shumë, rritja e ngadalësuar e çmimeve të artikujve ushqimorë, pijeve dhe duhanit, pajisjeve të makinerisë dhe atyre elektrike, si dhe mjeteve të transportit kontriboi në ecurinë e këtij indeksi.

Ndërsa, u evidentua përshejtim i rritjes së indekseve që sinjalizojnë për koston e prodhimit të brendshëm, si indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) dhe indeksi i kostos së ndërtimit (IKN). IÇP rezultoi me rritje prej 4.6 përqind kundrejt rënies prej 3.1 përqind në vitin 2023. Kontributin kryesor në këtë rritje e shënuan rritja e çmimeve të prodhimit të energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar prej 10.2 përqind, përpunimit të produkteve ushqimore prej 5.2 përqind, prodhimit të letrës prej 11.3 përqind, prodhimit të drurit prej 7.4 përqind, e të tjera. Po ashtu, IKN shënoi rritje prej 3.4 përqind, që paraqet rritje të përshejtuara kundrejt 0.6 përqind në vitin paraprak. Rritja e këtij indeksi u diktua kryesisht nga rritja e pagave në ndërtimtari prej 14.1 përqind, rritja e çmimeve të transportit dhe energjisë prej 7.2 dhe 10.2 përqind, respektivisht, si dhe nga rritje e çmimeve të materialeve prej 1.8 përqind. Ndërsa, vetëm çmimet e makinerive shënuan rënie prej 0.2 përqind.


Parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma e përgjithshme e inflacionit në vend pritet të jetë rreth 3.3 përqind në vitin 2025. Rënia e çmimeve të ushqimit dhe naftës në tregjet ndërkombëtare mund të zbusë presionet inflacioniste. Megjithatë, plotësimi i nevojave shtesë me energji elektrike, tensionet gjeopolitike, kufizimet tregtare dhe kushtet klimatike, mund të ndikojnë në rritjen më të lartë të inflacionit.

1.3.3 Ndërmarrjet

Qarkullimi i ndërmarrjeve, sipas të dhënave të ATK-së, ka shënuar rritje prej 4.6 përqind në vitin 2024. Sektori i tregtisë, bashkë me sektorin e industrisë përpunuese, përbëjnë dy sektorët ekonomikë me pjesëmarrjen më të lartë në qarkullimin e gjithsej ndërmarrjeve (48.8 përqind dhe 13.0 përqind, përkatësisht). Gjatë vitit 2024, qarkullimi në këta dy sektorë ka shënuar rritje. Në sektorin e tregtisë, rritja mesatare ishte 6.2 përqind, ndërsa në sektorin e industrisë përpunuese ishte më e ulët, me një rritje prej 3.3 përqind.


Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve, në vitin 2024 u regjistruan dhe u shuan më shumë ndërmarrje krahasuar me vitin 2023. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 12,051, që paraqet një rritje prej 5.6 përqind krahasuar me vitin 2023, ndërsa u mbyllën 1,637 ndërmarrje, apo 2.2 përqind më shumë sesa në vitin 2022 (shih Grafikon 7). Sektori i tregtisë mbetet sektori me numrin më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara, duke përfaqësuar 24.7 përqind të gjithsej ndërmarrjeve të reja të regjistruara, ndjekur nga sektori i prodhimit me 11.2 përqind, sektori i ndërtimtarisë 11.0 përqind, aktiviteteve profesionale 9.9 përqind, hotelerisë 8.5 përqind, etj. (shih Grafikon 8). Krahasuar me vitin 2023, në sektorin e tregtisë u regjistruan 222 ndërmarrje më shumë, në sektorin e prodhimit 187 dhe në sektorin e

Grafik 7. Regjistri i bizneseve



Burimi: ASK (2025)

Grafik 8. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2025)

ndërtimtarisë 161. Sektorët me numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në krahasim me vitin 2023 ishin sektori i hotelerisë me 37 ndërmarrje më pak, sektori i arsimit me 28, sektori i furnizimit me energji elektrike me 25, dhe ai i patundshmërisë me 21 ndërmarrje më pak.

1.3.4. Tregu i punës

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2024 ishte 43.2 përqind, duke shënuar rritje prej 2.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, ky nivel vlerësohet si relativisht i ulët, për shkak të një pjese të konsiderueshme të popullsisë në moshë relativisht të re (nxënës, studentë), si dhe punonjësve të dekurajuar dhe personave që nuk janë aktiv në kërkim të punës.

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të ASK-së, shkalla mesatare e punësimit në vitin 2024 ishte 38.6 përqind, që paraqet një rritje vjetore prej 2.3 pikë përqindje. Shkalla e punësimit ishte më e lartë se meshkujt, me 55.9 përqind, që tregon një rritje vjetore prej 2.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Ndërkohë, përqindja e femrave të punësuarra ishte 21.2 përqind, duke shënuar rritje vjetore prej 1.4 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023.

Gjithashtu, sipas të dhënave nga anketa e lartpërmendur, popullsia e moshës 35-44 vjeç ka normën më të lartë të punësimit (51.1 përqind), ndërsa grup-mosha 15-24 vjeç (sipas kategorizimit të ASK-së) ka normën më të ulët të punësimit (19.4 përqind). Sipas nivelit arsimor, shkalla më e lartë e punësimit rezulton të jetë në mesin e fuqisë punëtore me arsim të lartë, pasuar nga ata me arsim të mesëm.

Diktuar edhe nga struktura e ekonomisë, shkalla e punësimit ishte më e lartë në sektorin e tregtisë (19.5 përqind e të punësuarve), pasuar nga sektori i ndërtimtarisë (12.6 përqind), sektori i prodhimit (10.6 përqind), sektori i arsimit (8.8 përqind), etj. Krahasuar me vitin 2023, të dhënat tregojnë për një rritje në pjesëmarrjen e të punësuarve në sektorët e ndërtimtarisë dhe prodhimit ndërsa pjesëmarrja e të punësuarëve në sektorin e tregtisë ishte më e ulët.

Statistikat zyrtare të tregut të punës tregojnë se shkalla mesatare e papunësisë në vitin 2024 ishte 10.8 përqind, një nivel pak më i ulët sesa në vitin paraprak (10.9 përqind). Në baza gjinore, tregu i punës në Kosovë karakterizohet nga një shkallë më e lartë e papunësisë tek femrat (18.0 përqind) sesa tek meshkujt (7.7 përqind). Sidoqoftë, edukimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës në Kosovë, ku shkalla e papunësisë më e lartë është për personat pa shkollim (rreth 55.9 përqind), ndërsa më e ulëta për ata me arsimim terciar (6.5 përqind).

1.4. Sektori fiskal

Gjatë vitit 2024, sektori fiskal u karakterizua me rritje të konsiderueshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Të hyrat buxhetore¹ arritën vlerën neto prej 3.1 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.0 përqind. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, përmirësimit të procesit të mbledhjes së të hyrave si dhe forcimit të aktiviteteve kundër evazionit tatimor, duke kontribuar në një deficit primar buxhetor shumë të ulët (-0.1 përqind si përqindje e BPV-së).

Në kategorinë e të hyrave tatimore, pothuajse të gjitha komponentët shënuan rritje. Rritja më e lartë është shënuar tek të hyrat tatimore indirekte, të cilat arritën vlerën prej 2.3 miliardë euro, që përbënë rritje prej 10.6 përqind krahasuar me vitin 2023. Të hyrat tatimore direkte shënuan rritje prej 5.5 përqind, duke arritur vlerën prej 517.2 milionë euro. Ndërkohë, të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 26.5 përqind, duke arritur vlerën 337.7 milionë euro.

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga huazimet shtetërore.

Shpenzimet buxhetore² shënuan rritje prej 8.3 përqind, duke arritur vlerën prej 3.1 miliardë euro. Kategoria që shënoi rritjen më të lartë ishte ajo e shpenzimeve kapitale me 16.7 përqind apo në vlerë prej 654.7 milionë euro. Shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 6.3 përqind, duke arritur vlerën prej 2.5 miliardë euro. Në kategorinë e shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet për paga shënuan rritje për 10.0 përqind, duke arritur vlerën prej 843.7 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshirë ato komunale) shënuan rritje për 7.8 përqind, duke arritur vlerën prej 491.0 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje prej 3.3 përqind, duke arritur vlerën prej 1.1 miliardë euro.

Borxhi publik në vitin 2024 arrit vlerën prej 1.74 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 4.6 përqind krahasuar me vitin paraprak. Pavarësisht kësaj, përqindja e borxhit publik në raport me BPV-në u ul në 16.5 përqind, nga 17.5 përqind që ishte vitin 2023. Për shkak të rritjes së likuiditetit të Qeverisë, borxhi i brendshëm publik shënoi rënie prej 0.8 përqind, duke arritur në 962.2 milionë euro, ndërsa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 12.2 përqind, duke arritur në 777.2 milionë euro, apo 44.7 përqind e gjithsej borxhit publik.


Shuma e shpallur në ankande gjatë vitit 2024 arriti vlerën prej 270 milionë euro apo 86.2 përqind më shumë krahasuar me vitin 2023. Shuma e pranuar ishte 253.6 milionë euro, ose 137.3 përqind më shumë sesa në vitin 2023. Kërkesa për investime në bono dhe obligacione qeveritare gjithashtu ishte më e lartë për 165.3 përqind krahasuar me vitin 2023. Norma mesatare e interesit në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës shënoi rritje, duke arritur në 3.86 përqind, krahasuar me 3.35 përqind në vitin 2023. Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës në vitin 2024 ishte kryesisht e dominuar nga letrat me vlerë me afat maturimi pesëvjeçar, të cilat përbënin 35.8 përqind të gjithsej letrave me vlerë. Ky është një ndryshim i rëndësishëm nga struktura e vitit të kaluar, kur letrat me vlerë me afat tre vjeçar përbënin 51.5 përqind të gjithsej letrave me vlerë.

1.5. Sektori i jashtëm

Bilanci i pagesave në vitin 2024 u karakterizua me rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe financiare kundrejt vitit paraprak, ndërsa bilanci i llogarisë kapitale shënoi rënie të bilancit pozitiv. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse u ndikua nga përkeqësimi i bilancit tregtar të mallrave, si një nga kategoritë përcaktuese, dhe pjesërisht nga rënia e bilancit pozitiv e të ardhurave dytësore. Në anën tjetër, sektori i shërbimeve dhe të ardhurave parësore ndikuan pozitivisht në deficitin e përgjithshëm të llogarisë rrjedhëse, por ky ndikim ishte i pamjaftueshme për të shmangur rritjen e tij.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse arriti në 914.8 milionë euro, ose 8.9 përqind e BPV-së, duke shënuar rritje vjetore prej 25.4 përqind. Ky zgjerim u ndikua kryesisht nga rritja e deficitit tregtar të mallrave që shënoi rritje prej 7.1 përqind, duke arritur vlerën prej 4.9 miliardë euro, si dhe nga rënia e lehtë prej 1.9 përqind e të ardhurave dytësore, të cilat u tkurrën në 2.0 miliardë euro. Megjithatë, ky thellim i deficitit u amortizua pjesërisht nga rritja e bilancit pozitiv të shërbimeve, që u zgjerua me 9.9 përqind dhe arriti në 1.8 miliardë euro, si dhe nga përmirësimi i bilancit të të ardhurave parësore me 9.7 përqind, duke arritur në 218.2 milionë euro.

Grafik 9. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar i mallrave



² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

Eksporti i mallrave arriti në 943.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.3 përqind (shih Grafikon 9). Kjo rritje u mbështet kryesisht nga performanca pozitive në disa sektorë, me eksportin e metaleve bazë, si kategoria më e rëndësishme, që shënoi rritje prej 22.6 përqind, duke arritur në 220.9 milionë euro, e ndikuar nga rritja e kërkesës për metale në tregjet ndërkombëtare. Pas metaleve, eksporti i mallrave shënoi rritje edhe në produktet e plastikës dhe gomës, duke arritur në


119.8 milionë euro apo 2.9 përqind rritje vjetore. Eksporti i artikujve ushqimor shënoi rritje prej 13.9 përqind dhe arriti vlerën prej 105.6 milionë euro (shih Grafikon 10). Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor i Kosovës, me 45.4 përqind të gjithëj eksporteve, me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si destinacionet kryesore. Ndërsa vendet e BE-së përbëjnë 33.1 përqind e eksportit të përgjithshëm, me Gjermaninë si destinacionin kryesor. Ndërkohë që struktura e mallrave të eksportuara mbeti e koncentruar gjeografikisht, Kosova rezulton të ketë ruajtur shtrirjen gjeografike të eksportit të mallrave në gjithëj 148 shtete.

Vlera e gjithëj mallrave të importuara gjatë vitit 2024 arriti në 6.4 miliardë euro apo 61.8 përqind e BPV-së, duke shënuar rritje vjetore prej 7.8 përqind. Kjo rritje kryesisht i atribuohet rritjes së kërkesës në vend, që u reflektua në rritjen e sasisë dhe peshës së mallrave të importuara, të cilat shënuan rritje për 6.7 respektivisht 6.8 përqind. Struktura e mallrave të importuara mbeti e pa ndryshuar, e dominuar nga produktet minerale, makineritë dhe artikujt ushqimorë (shih Grafikon 11). Pjesa më e madhe e mallrave të importuara ishin mallra të ndërmjetme, me 45.1 përqind të gjithëj importeve, ndërsa mallrat konsumuese kanë një pjesëmarrje më të ulët, 33.8 përqind. Pjesëmarrja e mallrave kapitale mbetet ende e ulët, 11.1 përqind, por ka shënuar rritje vjetore prej 17.2 përqind. Importi i mallrave vazhdon të ruajë strukturën gjeografike të njëjtë, me 44.7 përqind të mallrave të importuara nga vendet e BE-së, 14.4 përqind nga Turqia, 13.4 përqind nga vendet e rajonit, dhe 11.9 përqind nga Kina.

Bilanci i shërbimeve arriti në 1.8 miliardë euro (17.4 përqind e BPV-së), duke shënuar rritje vjetore prej 9.9 përqind. Megjithatë, kjo rritje ishte më e ngadalësuar kundrejt rritjes prej 18.7 përqind në vitin 2023, e ndikuar kryesisht nga rritja e importit të shërbimeve. Eksporti i shërbimeve shënoi rritje prej 13.4 përqind, duke arritur vlerën prej 3.4 miliardë euro, me kontributin kryesor nga shërbimet e udhëtimit, që shënuan rritje prej 9.9 përqind dhe arritën në 2.4 miliardë euro.


Dinamikat në këtë kategori kryesisht reflektojnë shpenzimet e diasporës në Kosovë, por edhe rritjen e numrit të udhëtarëve dhe të fluturimeve krahasuar me vitin paraprak. Rritja e eksportit të shërbimeve u ndikua edhe nga shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit, me 21.8 përqind, duke arritur vlerën 348.4 milionë euro. Po ashtu, shërbimet e tjera të biznesit kanë kontribuar me rritje të theksuar prej 32.9 përqind, duke arritur vlerën prej 261.2 milionë

Grafik 10. Eksporti i mallrave sipas kategorive



Burimi: BQK (2025)

Grafik 11. Importi i mallrave sipas kategorive



Burimi: BQK (2025)

euro. Nga ana tjetër, importi i shërbimeve shënoi rritje prej 17.7 përqind, kryesisht nga shërbimet e udhëtimit, të cilat u rritën me 18.7 përqind, duke arritur në 742.8 milionë euro, ose 47.2 përqind e gjithëj importit të shërbimeve. Ky trend është ndikuar nga liberalizimi i vizave me vendet e BE-së, që ka stimuluar rritjen e udhëtimeve jashtë vendit. Po ashtu, importi i shërbimeve të transportit shënoi rritje të konsiderueshme prej 25.8 përqind, duke arritur në 339.8 milionë euro. Rritja e eksportit të shërbimeve të IT-së dhe shërbimeve të tjera të biznesit është një tregues i rëndësishëm i transformimit të sektorit të shërbimeve dhe diversifikimit të eksportit. Megjithatë, rritja e ndjeshme e importeve mund të ndikojë negativisht në bilancin e përgjithshëm të shërbimeve.

Bilanci i të ardhurave parësore në vitin 2024 arriti vlerën prej 215.4 milionë euro, duke shënuar rritje prej 8.3 përqind. Kompensimi i punëtorëve ka kontribuar ndjeshëm në këtë përmirësim, me rritje vjetore prej 22.1 përqind, duke arritur në 412.9 milionë euro. Nga ana tjetër, bilanci i të ardhurave nga investimet ka vazhduar trendin negativ, duke shënuar bilanc negativ prej 201.4 milionë euro, si pasojë e rritjes së bilancit negativ të investimeve direkte, ndikuar kryesisht nga fitimet e ri investuara.

Remitencat, si një nga burimet kryesore të të hyrave dytësore, arritën vlerën prej 1.35 miliardë euro, apo 13.1 përqind e BPV-së, duke shënuar rritje të ngadalësuar prej 1.4 përqind krahasuar me rritjen prej 9.2 përqind në vitin 2023 (shih Grafikon 12). Ky ngadalësim mund të jetë pasojë e pasigurisë ekonomike dhe inflacionit ende të lartë në vendet ku jeton dhe punon diaspora kosovare, duke reduktuar mundësinë e tyre për të dërguar remitencë. Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet kryesore të remitencave, të cilat përbëjnë 56.2 përqind të gjithëj remitencave, e ndjekur nga SHBA-të dhe vendet tjera të BE-së. Remitencat përmes kanaleve formale, si bankat dhe agjencitë për transferim të parave, shënuan rritje vjetore prej 2.0 përqind, ndërsa remitencat përmes kanaleve joformale qëndruan në nivelin e njëjtë me vitin e kaluar.

Grafik 12. Remitencat



Burimi: BQK (2025)

Në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të arritën në 847.4 milionë euro (8.2 përqind e BPV-së) dhe shënuan rritje të ngadalësuar prej 0.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 14.8 përqind në vitin 2023 (shih Grafikon 13). Sektori i patundshmërisë vazhdon të dominoj, me 76.5 përqind të gjithëj IHD-ve, duke shënuar rritje prej 25.4 përqind dhe arriti vlerën prej 648.6 milion euro, e ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe kërkesës së lartë për patundshmëri. Tri shtetet kryesore prej nga vijnë IHD-të janë Gjermania me 23.7 përqind të gjithëj IHD-ve, Zvicra me 22.2 përqind dhe SHBA-të me 10.4 përqind. Në anën tjetër, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit shënuan rritje të dukshme, duke arritur në 224.3 milionë euro, rritje vjetore prej 18.1 përqind. Këto investime ishin kryesisht të orientuara në sektorin e patundshmërisë në vendet e rajonit, duke reflektuar diversifikim të kapitalit dhe kërkesën në rritje për investime jashtë Kosovës.

Grafik 13. Investimet e huaja direkte



II. Aktiviteti i BQK-së në vitin 2024

1. Stabiliteti Financiar

1.1. Sektori financiar

Sistemi financiar në vend ka vazhduar të zgjerohet tutje gjatë vitit 2024, duke shënuar rritje vjetore të përsheptuar të asetëve (shih Grafikon 14)³. Asetet e sistemit financiar në dhjetor 2024 arritën vlerën 12.75 miliardë euro, apo rritje vjetore prej 14.8 përqind nga 12.4 përqind në vitin paraprak. Kontributin kryesor në zgjerimin e sistemit financiar vazhdon ta ketë rritja e përsheptuar e sektorit bankar, i cili përfaqëson sektorin më peshën më të madhe në kuadër të sistemit financiar, me një pjesëmarrje prej 67.1 përqind në dhjetor 2024. Po ashtu, me rritje të përsheptuar u karakterizuan fondet pensionale dhe ndihmësit financiar, ndërsa sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar krahasuar me vitin e kaluar.

Numri i institucioneve financiare deri në fund të vitit 2024 arriti në 139 nga 136 sa ishte një vit më parë. Gjatë këtij viti u shtuan katër ndihmës financiar, ndërsa një bankë me kapital të huaj nën udhëheqjen e BQK-së ka përfunduar vullnetarisht veprimtarinë bankare dhe të cilës i është revokuar licenca.


1.2. Aktivitetet në fushën e stabilitetit financiar

Në funksion të objektivit të saj parësor, ruajtjes së stabilitetit financiar, BQK ka intensifikuar monitorimin dhe vlerësimin e rreziqeve sistematike përmes një qasjeje të strukturuar dhe të vazhdueshme. Ky proces përfshiu identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në intervale të rregullta mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, duke u mbështetur në analiza të thelluara cilësore dhe sasiore, ndërtimin e skenarëve makroekonomikë dhe financiarë, si dhe kalibrimin e modeleve që adresojnë dimensionet ciklike, strukturore dhe ndërsektoriale të rrezikut sistematik.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse, e orientuar nga rreziku (risk-based) dhe e bazuar në të dhëna, e cila kombinon modelet analitike dhe përvojën praktike për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet që mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin financiar të Kosovës, ka ndihmuar në informimin e publikut mbi gjendjen e sistemit financiar, rritjen e transparencës dhe nxitjen e debatit profesional mbi sfidat dhe perspektivat e sektorit financiar në vend.

Në përpjekje të vazhdueshme për të avancuar këto kapacite analitike në hap me zhvillimet globale në këtë fushë, BQK ka përmirësuar modelet për parashikimet makroekonomike dhe stres-testin makroprudencial. Në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), në vitin 2024 është finalizuar rishikimi i Modelit të Stres-Testit Makroprudencial, i cili do të fuqizojë procesin e

Grafik 14. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK (2025)

³ Disa nga të dhënat për sektorin financiar të paraqitura në këtë raport përfshijnë të dhëna të paaudituar të cilat mund të ndryshohen pas korrigjimeve eventuale dhe do të reflektohen në publikimet periodike të BQK-së.

politikëbërjes institucionale përmes forcimit të kapaciteteve analitike për vlerësimin e rreziqeve si dhe testimin e qëndrueshmërisë së sektorit ndaj rreziqeve potenciale ndaj stabilitetit financiar.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, BQK ka bërë progres në transformimin e modelit të saj makroekonomik në një model makroekonometrik më të integruar. Ky model do të shërbejë si bazë për projeksionet makroekonomike dhe për skenarët e rënduar të Stres-Testit, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit makrofinanciar.

Në funksion të transparencës dhe informimit të shpejtë të publikut, BQK ka vazhduar publikimin e raporteve të saj të rregullta. Raporti i Stabilitetit Financiar mbetet publikimi kyç që pasqyron qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe analizën e zhvillimeve makroekonomike dhe financiare në vend. Vlerësimet Tremujore të Ekonomisë ofrojnë një pasqyrë të zhvillimeve kryesore makroekonomike dhe të sektorit financiar. Gjithashtu, Raporti i Informatave Mujore të Sistemit Financiar përmbledh indikatorët kyç të sektorit financiar dhe publikohet çdo muaj.

BQK vazhdon të realizojë Anketën e Kreditimit Bankar të Kosovës (AKBK) në baza tremujore, e cila ndihmon në kuptimin e zhvillimeve në sektorin bankar dhe shërben si një input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe indikatorëve makroekonomikë dhe financiar. Për më tepër, në përputhje me objektivin e saj mandator, AKBK përfshin edhe seksionin mbi pritjet e bankave për çmimet në vend, ndërsa të dhënat mbi pritjet për inflacionin publikohen në faqen zyrtare të BQK-së, së bashku me Serinë Kohore të Inflacionit Bazë.

1.2.1. Zbatimi i Masave Makroprudenciale

Komiteti i Makroprudencës, si organ këshillues i BQK-së i mandatuar për të monitoruar, modeluar dhe analizuar dinamikën e rreziqeve sistemike për politik-bërje makroprudenciale, është takuar përkitazi me Politikën për Makroprudencë katër herë gjatë vitit 2024. Në linjë me rekomandimet e KKM-së, në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator 2024, Bordi Ekzekutiv i BQK-së ka miratuar zbatimin e dy instrumenteve makroprudenciale:

1. Shtesës Pozitive Neutrale Kundërciklike të Kapitalit në nivel prej 2.0% të aseteve të peshuara me rrezik të bankave. Vendimi ka hyrë në fuqi më datë 1 tetor 2024, me afat përshtatjeje të plotë deri më 30 qershor 2025.

2. Shtesën e Kapitalit për Institucionet e Tjera me Rëndësi Sistemike (O-SII) në nivel deri në 1.5% të aseteve të peshuara me rrezik të bankave, në varësi të nivelit të rëndësisë sistemike të secilës bankë. Vendimi ka hyrë në fuqi më datë 1 tetor 2024, me afat përshtatjeje të plotë deri më 30 qershor 2025.

Këto shtesa të kapitalit janë të aplikueshme mbi nivelet minimale të kapitalit të përcaktuara me Rregulloren mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe duhet të përmbushen me kapital bazë të klasit të parë (CET1). Zbatimi i këtyre masave është paraprirë nga një analizë e hollësishme mbi nevojën për masa të tilla dhe vlerësimin e efekteve të tyre të mundshme mbi sektorin bankar dhe ekonominë në tërësi. Në kuadër të operacionalizimit të kornizës makroprudenciale, BQK gjithashtu ka iniciuar plotësimin/amandamentimin e Rregullores mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit, për të përfshirë kapitujt specifikë mbi shtresat makroprudenciale të kapitalit.

Masat e ndërmarra përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në përforcimin e qëndrueshmërisë së sektorit për menaxhimin e rreziqeve ciklike dhe strukturore në ekonomi.

2. Mbikëqyrja Financiare

2.1. Aktivitetet Mbikëqyrëse të sektorit bankar

Gjatë vitit 2024, aktivitetet e mbikëqyrjes së sektorit bankar janë zhvilluar në përputhje me mandatin për të ruajtur stabilitetin financiar dhe për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të sistemit bankar. Në këtë drejtim, BQK ka vazhduar zbatimin e qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, e cila fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve më të rëndësishme që mund të ndikojnë në shëndetin financiar të bankave individuale dhe të sistemit në tërësi.

Kjo qasje është zbatuar në përputhje me Manualin e Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Banka, i cili përshkruan metodologjinë për planifikimin, realizimin dhe dokumentimin e ekzaminimeve, si dhe për përcaktimin e masave mbikëqyrëse të nevojshme.

Janë realizuar 3 ekzaminime të plota në vend në banka, përmes të cilave janë vlerësuar komponentët kyç të profilit të rrezikut të secilës bankë përfshirë Rrezikun kreditor, Rrezikun e likuiditetit, Rrezikun e tregut dhe Rrezikun operacional.

Tabela 3. Numri i ekzaminimeve në banka, gjatë vitit 2024

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka	3 ekzaminime të plota

Burimi: BQK (2025)

Gjatë ekzaminimeve të plota në vend, të bankave, është vlerësuar profili i rrezikut të bankave, mënyra e qeverisjes së brendshme, apetitet e bankave për të marrë rreziqe, praktikatat e tyre për të menaxhuar rreziqet, si dhe është bërë përcjellja e përbushjes së rekomandimeve të dala nga ekzaminimet paraprake të BQK-së.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar praktikave të menaxhimit të rrezikut kreditor, rrezikut të koncentrimin, duke marrë parasysh faktin se ky rrezik përbën komponentin kryesor ndaj të cilit janë të ekspozuara bankat që operojnë në tregun financiar të Kosovës. Ekspozimi i lartë ndaj rrezikut kreditor buron nga vetë natyra e aktivitetit bankar, ku kredidhënia përbën pjesën më të madhe të portofolit të aseteve të bankave. Në këtë kontekst, BQK ka vlerësuar me prioritet kapacitetin e bankave për të identifikuar, matur, monitoruar dhe menaxhuar rrezikun kreditor në mënyrë efektive, duke u fokusuar në politikatat e aprovimit të kredive dhe menaxhimit të mëtutjeshëm të kredive.

Gjatë ekzaminimeve në vend, është analizuar në detaje profili i portofolit kreditor, struktura sektoriale dhe ekspozimet ndaj individëve dhe bizneseve, për të identifikuar sektorët më të ndjeshëm dhe për të vlerësuar përgatitjen e bankave për t'iu përgjigjur ndryshimeve të mundshme në mjedisin ekonomik.

Gjatë vitit janë adresuar çështjet lidhur me rrezikun e koncentrimin në kuadër të rrezikut kreditor, duke siguruar pajtueshmëri me kornizën ligjore me kontribut pozitiv në stabilitetin financiar të vendit.

Në mënyrë shtesë, zhvillimet makroekonomike me burim të jashtëm si lufta në Ukrainë, si dhe faktorët e brendshëm dhe rajonalë si rritja e inflacionit, rritja e çmimeve në sektorin e ndërtimitarisë dhe energjisë, do të përcillen me kujdes nga BQK, për shkak të impaktit të mundshëm që këto mund të kenë në cilësinë e aseteve të sektorit bankar. Këta faktorë mund të ndikojnë në aftësinë e huamarrësve për të përbushur obligimet e tyre financiare, të cilët do të

monitorohen me kujdes në kuadër të mbikëqyrjes makroprudenciale, krahas asaj mikroprudenciale.

Rreziku i likuiditetit ka qenë një tjetër komponent thelbësor i vlerësimit mbikëqyrës, për shkak të rritjes më të shpejtë të volumit të kredive në sektorin bankar në krahasim me rritjen e depozitave. Kjo dinamikë është pasuar nga një rritje e dukshme e konkurrencës ndërmjet bankave për të tërhequr depozita, përmes ofrimit të normave më të larta të interesit, veçanërisht në depozitat me afat.

Kjo qasje ekspansive në rritjen e bazës së fondeve me burim nga depozitat mund të ketë pasoja afatmesme për koston e financimit, si dhe për strukturën dhe stabilitetin e burimeve të likuiditetit. Në këtë drejtim, BQK ka vlerësuar me kujdes pozicionin e likuiditetit afatshkurtër dhe afatgjatë të bankave, përmes treguesve si LCR (Liquidity Coverage Ratio) dhe NSFR (Net Stable Funding Ratio), dhe ka analizuar skenarë të mundshëm të tensioneve në treg për të vlerësuar aftësinë e bankave për të përballuar tronditje të papritura në burimet e tyre të financimit.

BQK do të vazhdojë të thellojë vlerësimet mbi këto dy rreziqe edhe gjatë vitit 2025, me një fokus të posaçëm në bankat sistemike, në ato që shfaqin ritme të përshpejtuara të rritjes, apo që tregojnë shenja të përkeqësimit të profilit të rrezikut në cilësinë e portofolit apo në strukturën e financimit.

Ky fokus i dyfishtë është në përputhje me përpjekjet e BQK-së për të ruajtur një sistem bankar të qëndrueshëm, të mirë-kapitalizuar dhe të mbrojtur nga tronditjet e papritura, në linjë me standardet ndërkombëtare mbikëqyrëse dhe rregullative.

Përveç ekzaminimeve në vend, gjatë gjithë vitit 2024 është realizuar një monitorim i rregullt dhe sistematik i performancës financiare të bankave, përmes analizës së raporteve të rregullta të dorëzuara në BQK. Ky proces ka shërbyer si një instrument kyç për identifikimin e hershëm të zhvillimeve potencialisht rrezikuese, duke ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve të mbikëqyrjes dhe në hartimin e planeve vjetore të ekzaminimeve.

Në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të kuadrit mbikëqyrës dhe në funksion të përafrimit të tij me praktikën më të mira ndërkombëtare, Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare, me përkrahjen teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ka filluar procesin e tranzicionit nga modeli CAMELS në modelin SREP (Procesi i Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës). Ky ndryshim përfaqëson një hap strategjik në drejtim të forcimit të kapaciteteve analitike të mbikëqyrjes dhe integritimit të qasjes së bazuar në rrezik në të gjitha komponentët e vlerësimit të bankave.

Modeli SREP ofron një kornizë më të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, e cila përfshin vlerësimin e modeleve të biznesit, sistemeve të qeverisjes së brendshme, rreziqeve kryesore (p.sh., kreditor, operacional, tregu, dhe likuiditet), si dhe adekuatshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit të secilës bankë në raport me profilin e tyre të rrezikut. Aktualisht janë në zhvillim udhëzime të detajuara dhe metodologji që do të sigurojnë zbatim të plotë dhe të harmonizuar të këtij modeli në përputhje me praktikën e Autoritetit Bankar Evropian (EBA) dhe Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare.

Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim me FINSAC (qendër e asistencës teknike e mbështetur nga Banka Botërore), BQK ka nisur projektin për zgjerimin e kornizës raportuese përmes zbatimit të FINREP (Financial Reporting) dhe COREP (Common Reporting). Ky projekt ka për synim harmonizimin e standardeve të raportimit financiar dhe rregullator me ato të Bashkimit Evropian, duke përmirësuar cilësinë, përmbajtjen dhe krahasueshmërinë e të dhënave ndërmjet institucioneve financiare dhe autoriteteve mbikëqyrëse.

Përmes zbatimit të kornizës FINREP / COREP, BQK do të ketë në dispozicion të dhëna më të detajuara dhe të standardizuara për të gjitha bankat në vend, duke mundësuar analiza më të thelluara të rreziqeve dhe tendencave të tregut. Kjo do të përforcojë ndjeshëm kapacitetin për

paralajmërim të hershëm, si dhe do të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme efikasitetin e mbikëqyrjes.

Këto reforma përfaqësojnë shtylla kyçe të transformimit të kuadrit mbikëqyrës të BQK-së dhe të përgatitjes së tij për sfidat dhe standardet e një tregu gjithnjë e më të ndërlidhur me sistemin financiar evropian. Në këtë mënyrë, BQK po ndërton një sistem mbikëqyrës më të fuqishëm, më reagues dhe të harmonizuar me kërkesat moderne të mbikëqyrjes.

Si rezultat i qasjes prudente të mbikëqyrjes, së bashku me kuadrin rregullativ gjithnjë në përmirësim dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, sektori bankar në Kosovë vazhdon të tregojë stabilitet të lartë, duke qenë mirë i kapitalizuar dhe likuid, me kualitet të lartë të aseteve dhe indikatorë financiarë që dëshmojnë qëndrueshmëri të vazhdueshme në një ambient sfidues makroekonomik.

2.1.1 Përmbyllja e Institucioneve Financiare

Në vitin 2024, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka krijuar Departamentin e Rimëkëmbjes dhe Përmbylljes i cili do të veprojë si Autoriteti i Përmbylljes për bankat dhe degët e bankave të huaja që operojnë në Republikën e Kosovës. Si Autoritet i Përmbylljes, BQK-ja ka kompetencën për të ndërmarrë masa të hershme dhe të shpejta të ndërhyrjes kur një bankë konsiderohet se ka dështuar ose ka gjasa të dështojë, me synimin për të siguruar vazhdimësinë e funksioneve kritike, minimizimin e ndikimit të dështimit të bankës në stabilitetin financiar dhe mbrojtjen e fondeve publike.

Si Autoritet i Përmbylljes, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, gjatë zbatimit të instrumenteve të përmbylljes dhe ushtrimit të kompetencave të përmbylljes, ndjek objektivat e mëposhtme:

- Sigurimi i vazhdimësisë së funksioneve kritike të bankës;
- Parandalimi i ndikimeve të konsiderueshme negative në stabilitetin financiar, veçanërisht duke parandaluar përhapjen e rreziqeve, mbrojtjen e infrastrukturës së tregut dhe ruajtjen e disiplinës së tregut;
- Mbrojtja e fondeve publike duke minimizuar mbështetjen financiare të jashtëzakonshme nga shteti;
- Mbrojtja e depozitorëve të siguruar, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-2016 (i ndryshuar dhe plotësuar herë pas here); dhe
- Mbrojtja e fondeve dhe aseteve të klientëve.

Departamenti i Përmbylljes si funksion i veçantë brenda BQK-se, është operacionalisht i pavarur dhe i ndarë qartë nga funksionet tjera të mbikëqyrjes. Si i tillë ky Departament, ka linjë të ndarë të raportimit të drejtpërdrejtë nga Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare dhe funksionet tjera mbikëqyrëse të BQK-së.


2.1.2 Sektori Bankar

Asetet

Në fund të vitit 2024, asetet e sektorit bankar arritën vlerën 8.56 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 13.5 përqind nga 11.5 përqind një vit më parë (shih Grafikon 15). Aktiviteti kreditues shënoi përshpejtim të trendit të rritjes dhe ishte zëri kryesor që ndikoi në zgjerimin e asetëve të sektorit bankar në vend (Tabela 4). Zëri i parasë së gatshme dhe bilanci me BQK-në, si kategoria e dytë më pjesëmarrjen më të madhe në kuadër të asetëve të sektorit, ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar. Ndërsa, si rezultat i ngadalësimit të rritjes së investimeve në tregjet e jashtme, kategoria e letrave me vlerë ka shënuar rritje vjetore më të ngadalësuar. Konkretisht, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rritje vjetore prej 13.4 përqind nga 3.9 përqind në vitin paraprak. Kurse, investimet në letra me vlerë shënuan ngadalësim të rritjes, në 10.8 përqind nga 19.0 përqind në vitin paraprak (shih Grafikon 15).

Shkalla e koncentrimit në tregun bankar edhe këtë vit mbeti në nivel të ngjashëm, me tendencë të lehtë të rritjes në disa nga treguesit e koncentrimit. Asetet e pesë bankave më të mëdha rritën lehtë peshën e tyre në 79.5 përqind të gjithsej asetëve të sektorit nga 78.7 përqind sa ishte në vitin paraprak. Po ashtu, tri bankat më të mëdha kanë rritur lehtësisht koncentrimin e tyre në treg, në 52.7 përqind nga 52.3 përqind një vit më parë. Likuidimi vullnetar i një banke me kapital të huaj nën udhëheqjen e BQK-së dhe të cilës i është revokuar licenca, ka ndikuar në rënie të pjesëmarrjes së bankave të huaja për 0.7 pikë përqindje, duke zbritur në 83.6 përqind në fund të vitit 2024. Indeksi Herfindal-Hirschman(HHI)⁴ për asetet e sektorit bankar arriti në 1,412.5 pikë nga 1,391.6 pikë në vitin e kaluar.

Grafik 15. Zërat kryesorë të asetëve të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2025)

Tabela 4. Struktura e asetëve të sektorit bankar

Përshkrimi	2020		2021		2022		2023		2024	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në	790.6	14.8%	839.9	14.1%	877.4	13.0%	911.8	12.1%	1,034.3	12.1%
Bilanci me bankat komerciale	562.2	10.5%	496.1	8.3%	575.2	8.5%	600.0	8.0%	493.2	5.8%
Letrat me vlerë	584.3	10.9%	685.0	11.5%	752.1	11.1%	895.0	11.9%	991.8	11.6%
Kreditë bruto	3,246.6	60.6%	3,748.6	62.9%	4,348.5	64.3%	4,913.8	65.2%	5,813.4	67.9%
Asetet Fikse	116.4	2.2%	127.4	2.1%	136.1	2.0%	149.5	2.0%	161.4	1.9%
Asetet Tjera	53.2	1.0%	62.7	1.1%	71.4	1.1%	71.0	0.9%	62.2	0.7%
Gjithsej	5,353.4	100%	5,959.6	100%	6,760.6	100.0%	7,541.1	100.0%	8,556.3	100.0%

Burimi: BQK (2025)

⁴ Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) është një numër që tregon sa i përqendruar është një treg: sa më i lartë numri, aq më pak kompani e kontrollojnë atë treg, dhe aq më pak konkurrencë ka.


Kreditë

Në fund të vitit 2024, gjithsej stoku i kredive arriti në 5.81 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.3 përqind, të përshpejtuar për 5.3 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Trendi i përshpejtuar i rritjes është nxitur nga zgjerimi i ndjeshëm i kreditimit si për ekonomitë familjare ashtu edhe për korporatat jofinanciare (shih Grafikonin 16). Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar (AKBK), tregojnë se dinamikat e kreditimit gjatë vitit 2024 u ndikuan kryesisht nga kërkesa e rritur kreditore, shoqëruar edhe me lehtësim deri në një masë të kushteve të kreditimit.

Kontributin kryesor në zgjerimin e kreditimit e kishte segmenti i korporatave jo-financiare, i cili vazhdon të dominoj strukturën e përgjithshme të kreditimit. Për të dytin vit me radhë, ky sektor është shoqëruar me një rritje më të lartë të stokut të kredive me maturitet afatshkurtër kundrejt atyre me maturitet afatgjatë. Megjithatë, segmenti i ekonomive familjare po rritet me një normë më të lartë, duke zgjeruar më shpejt pjesëmarrjen e tij në kreditimin e përgjithshëm të sektorit, dhe kjo rritje po shoqërohet me zgjerim më të madh të stokut të kredive me maturitet afatgjatë. Krahas rritjes së përgjithshme të kreditimit, gjatë vitit 2024 ka pasur gjithashtu një rritje të përfshirjes financiare, veçanërisht të numrit të kredimarrësve të rinj. Sipas të dhënave nga Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK), numri i kredimarrësve të rinj në vitin 2024 arriti në 23 mijë, duke shënuar një rritje vjetore prej 6.8 përqind krahasuar me 2.0 përqind rritje vjetore të kredimarrësve të rinj në vitin 2023.


Kreditë ndaj korporatave jo-financiare shënuan rritje vjetore prej 15.3 përqind, për 5.2 pikë përqindje më e lartë se në vitin paraprak, duke arritur vlerën prej 3.41 miliardë euro. Kjo dinamikë në kuadër të kreditimit ndaj KJF-ve u ndikua nga rritja e lartë e kredive të reja investive, veçanërisht në pjesën e dytë të vitit. Aktiviteti kreditues ndaj KJF-ve, sipas sektorëve ekonomik, u karakterizua me përshpejtim të rritjes në sektorë të caktuar si tregtia me shumicë, shërbimet financiare dhe prodhimi, përkundër që aktiviteti ekonomik i këtyre sektorëve ka shënuar ngadalësim të rritjes reale. Ndërsa, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë ka shënuar rënie, përkundër rritjes së aktivitetit ekonomik të këtij sektori. Më konkretisht, sektori i tregtisë me

Grafik 16. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2025)

Grafik 17. Pjesëmarrja e kredive sipas sektorëve ekonomikë, 2024



Burimi: BQK (2025)

Grafik 18. Stoku i kredive sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2025)


shumicë ka shënuar një rritje vjetore të stokut të kredive prej 16.0 përqind dhe vazhdon të mbetet kategoria me kontributin më të madh në dinamikën e kredive ndaj ndërmarrjeve, për shkak të peshës dominuese prej 42.0 përqind (shih Grafikon 17). Po ashtu, sektori i shërbimeve financiare dhe ai i prodhimit kanë shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 26.7 përqind dhe 11.9 përqind, përkatësisht. Kurse, sektori i ndërtimtarisë dhe bujqësisë u karakterizuan me ngadalësim të rritjes në 10.6 përqind nga 15.9 përqind, respektivisht me rënie vjetore prej 9.2 përqind krahasuar me rritjen prej 25.8 përqind në vitin paraprak (shih Grafikon 18).

Kreditë e reja për korporatat jo-financiare gjatë vitit 2024 shënuan rritje vjetore të lartë prej 18.3 përqind nga 7.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur vlerën prej 1.43 miliardë euro (shih Grafikon 19). Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga rritja e kredive të reja investive, të cilat shënuan rritje prej 42.2 përqind nga 3.6 përqind një vit më parë. Në kuadër të këtyre kredive, me rritje u karakterizuan kreditë për sektorin e shërbimeve dhe industrisë, prej 51.4 përqind dhe 50.5 përqind, përkatësisht. Ndërsa, kreditë për qëllime jo-investive shënuan rënie prej 10.5 përqind nga rritja prej 15.6 përqind një vit më parë, dhe si rezultat kishin kontribut negativ në rritjen e gjithsej kredive të reja për korporatat jo-financiare.

Stoku i kredive për ekonomitë familjare në vitin 2024 shënoi rritje vjetore prej 22.0 përqind nga 17.3 përqind në vitin paraprak, ndikuar nga zgjerimi i kredive konsumuese dhe atyre hipotekare. Kontributin kryesor në këtë rritje e kishin kreditë e reja konsumuese, të cilat përshpejtuan ritmin e rritjes në 27.1 përqind nga 23.2 përqind një vit më parë. Po ashtu, kreditë e reja hipotekare shënuan kthesë pozitive për dallim nga viti i kaluar, duke regjistruar rritje vjetore prej 37.9 përqind nga rënia prej 11.3 përqind në vitin paraprak. Krahas zgjerimit të stokut të kredive të ekonomive familjare, struktura e maturimit të tyre ka pësuar ndryshim gradual, duke u orientuar gjithnjë më shumë drejt kredive me afat më të gjatë maturimi si dhe shuma më të larta. Konkretisht, kategoria ‘mbi 10 vite’ ka zgjeruar pjesëmarrjen në 36.7 përqind, për 2.3 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë, dhe krahasuar me pesë vite më parë është rritur për 20.6 pikë përqindje. Gjithsesi, kategoria dominuese vazhdoi të jetë ajo e maturitetit ‘5 deri në 10 vite’, me pjesëmarrje prej 42.9 përqind.

Sipas të dhënave nga databaza e RKK, kreditë e reja të disbursuara për ekonomitë familjare gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 kishin një vlerë mesatare prej 10.3 mijë euro dhe afat mesatar maturimi prej 4.9 vitesh. Më konkretisht, në aspekt të vlerës së kredive të reja të lëshuara në këtë periudhë, 34.5 përqind e tyre ishin në intervalin prej 10-30 mijë euro, duke u pozicionuar si kategoria dominuese për ekonomitë familjare. Ndërsa, në aspekt të numrit të kredive të disbursuara, kjo kategori kishte pjesëmarrje prej 18.5 përqind. Kreditë në intervalin 30-60 mijë euro kishin pjesëmarrje 22.7 përqind në vlerë të gjithsej kredive dhe 5.7 përqind në numër. Kreditë me vlerë të barabartë apo mbi 60 mijë euro, të cilat kryesisht përfshijnë kreditë hipotekare dhe lizingjet që përfaqësuan vetëm 1.9 përqind të numrit të kredive por në kuadër të vlerës kishin pjesëmarrje prej 22.1 përqind. Në aspektin e maturitetit, kreditë me kohëzgjatje 3-5 vite ishin dominuese sipas numrit, me pjesëmarrje prej 44.1 përqind. Ndërkohë, kreditë me maturitet 5-10 vite përfaqësuan 37.8 përqind të vlerës totale të kredive të reja të disbursuara për ekonomi familjare, duke konfirmuar tendencën e një zhvendosje drejt financimeve me afate më të gjata dhe vlera më të larta.

Grafik 19. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Detyrimet dhe burimet vetanake

Financimi i aktivitetit të sektorit bankar mbeshtetet pothuajse në tërësi nga depozitat e klientëve dhe kapitali vetanak. Në dhjetor 2024, depozitat kishin pjesëmarrje prej 80.9 përqind në gjithë strukturën e detyrimeve dhe kapitalit vetanak të sektorit, për 0.4 pikë përqindje më ulët se viti paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së bilancit nga bankat komerciale (Tabela 5). Mjetet vetanake që përbëjnë komponentën e radhës me pjesëmarrjen më të lartë, shënuan rritje të lehtë të pjesëmarrjes në 11.6 përqind apo 0.2 pikë përqindje më e lartë se në vitin paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së fitimit të mbajtur.

Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2020		2021		2022		2023		2024	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	90.4	1.7%	113.2	1.9%	199.9	3.0%	183.8	2.4%	273.6	3.2%
Depozitat	4,360.7	81.5%	4,901.8	82.2%	5,553.3	82.1%	6,129.0	81.3%	6,923.5	80.9%
Huatë tjera	43.1	0.8%	39.1	0.7%	31.6	0.5%	33.3	0.4%	42.3	0.5%
Detyrimet tjera	202.2	3.8%	220.1	3.7%	252.0	3.7%	287.5	3.8%	267.5	3.1%
Borxhi i ndërvarur	46.9	0.9%	42.3	0.7%	23.0	0.3%	45.0	0.6%	59.1	0.7%
Mjetet vetanake	610.2	11.4%	643.1	10.8%	701.3	10.4%	862.4	11.4%	990.3	11.6%
Gjithsej detyrimet dhe burimeve vetanake	5,353.4	100.0%	5,959.6	100.0%	6,760.6	100.0%	7,541.1	100.0%	8,556.2	100.0%

Burimi: BQK (2025)


Depozitat

Në dhjetor 2024, vlera e gjithë depozitave arriti në 6.92 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 13.0 përqind nga 10.4 përqind në vitin paraprak. Rritja e theksuar e depozitave, veçanërisht gjatë pjesës së dytë të vitit, ka ndikuar në kthimin e trendit pozitiv të rritjes për dallim nga viti paraprak ku shënuan ngadalësim të rritjes. Depozitat e ekonomive familjare dominojnë strukturën e gjithë depozitave, me pjesëmarrje prej 65.1 përqind të gjithë portfolios në dhjetor 2024 (shih Grafikon 20).

Këto depozita kanë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel të rritjes nga viti i kaluar, apo rritje prej 11.1 përqind nga 11.3 përqind në vitin paraprak. Depozitat e korporatave jo-financiare shënuan rritje vjetore prej 12.3 përqind nga 12.9 përqind. Ndërsa, depozitat e korporatave të tjera financiare dhe korporatave publike shënuan një rritje vjetore të përshpejtuar prej 34.2 përqind dhe 20.6 përqind, apo rritje nga viti paraprak për 28.4 dhe 32.4 pikë përqindje, respektivisht. Ky zhvillim është ndikuar kryesisht nga depozitorët e mëdhenj, të cilët përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të rritjes në këto kategori, veçanërisht nga sektori i fondeve pensionale, kompanive të sigurimit dhe sektori i energjisë.

Sa i përket strukturës së depozitave sipas maturitetit, rritja e normave të interesit nga viti paraprak ka ndikuar që depozitat e afatizuara të rrisin pjesëmarrjen në kaudër të gjithë depozitave për 3.7 pikë përqindje, ndërsa ato të transferueshme dhe të kursimit të zvogëlojnë pjesëmarrjen për 1.9 dhe 1.8 pikë përqindje respektivisht. Vlera e gjithë depozitave të reja arriti në 1.17 miliardë euro në fund të dhjetorit 2024, duke shënuar rritje vjetore prej 34.8 përqind nga 11.3 përqind një vit më parë. Segmenti i ekonomive familjare ka shënuar rritje vjetore prej 42.0 përqind nga 36.4 përqind në vitin paraprak. Depozitat e reja të korporatave jo-financiare,

Grafik 20. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2025)

gjithashtu shënuan rritje të lartë prej 20.7 përqind pas një rënie të ndjeshme prej 18.4 përqind në vitin e kaluar.


Normat e interesit

Normat e interesit në kreditë e sektorit bankar në vend kanë pësuar rënie graduale, ndikuar nga zhvillimet në nivel global, ku pjesa më e madhe e bankave qendrore ndërmorën masa lehtësuese në politikën e tyre monetare gjatë vitit 2024. Në anën tjetër, nevoja për likuiditet e dhe financim të aktivitetit të rritur në rrethana të konkurrencës së rritur ndërbankare, ka kontribuar në rritjen e normave të interesit në depozita. Në dhjetor të vitit 2024, norma e interesit në kredi zbriti në 5.9 përqind nga 6.3 përqind sa ishte një vit më parë.

Ndërkohë, norma e interesit në depozita arriti në 3.4 përqind nga 3.1 përqind në vitin paraprak. Si rezultat i uljes së normave të interesit në kredi dhe rritjes së normës së interesit në depozita, margjina e interesit kredi-depozitë ka arritur nivelin më të ulët ndër vite, duke zbritur në 2.5 pikë përqindje në dhjetor 2024 nga 3.2 pikë përqindje në dhjetorin e vitit paraprak (shih Grafikon 21).

Norma mesatare e interesit si për kreditë për korporatat jofinanciare ashtu edhe për ekonomitë familjare zbriti për 0.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Konkretisht, norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare zbriti në 6.0 përqind, ndërsa për ekonomitë familjare në 5.7 përqind (shih Grafikon 22).


Grafik 21. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita



— Norma e interesit në depozita — Dallimi kredi-depozita — Norma e interesit në kredi


Burimi: BQK (2025)

Grafik 22. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2025)


Grafik 23. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2025)


Në kuadër të KJF-ve, normat më të favorshme të interesit u ofruan për sektorin e industrisë dhe shërbimeve, me një mesatare prej 5.9 përqind. Ndërkaq, për ekonomitë familjare, normat më të favorshme të interesit u aplikuan për kreditë hipotekare me një mesatare prej 4.9 përqind, ndërsa kreditë konsumuese kishin një normë mesatare interesi prej 6.0 përqind.

Grafik 24. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2025)

Grafik 25. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2025)

Normat e interesit në depozita arritën në 3.4 përqind, duke shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Në dhjetor 2024, norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jo-financiare ka shënuar rritje vjetore për 0.4 pikë përqindje, duke arritur në 4.1 përqind. Po ashtu, për ekonomitë familjare norma mesatare e interesit ka shënuar rritje vjetore për 0.5 pikë përqindje, duke arritur në 2.9 përqind (shih Grafikët 24 dhe 25).

Trendi rënës i normës së Euribor-it ka ndikuar strukturën e kredive sipas llojit të normave të interesit, duke e bërë më pak atraktive për bankat ofrimin e kredive me normë

variabile. Si rezultat, në fund të vitit 2024, pjesëmarrja e kredive me normë variabile të interesit zbriti në 29.6 përqind, nga 33.9 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (shih Grafikun 26).

Figura 26. Stoku i kredive, sipas normave të interesit fikse apo variabile (në përqindje)




Burimi: BQK (2025)

Performanca e sektorit bankar

Në fund të vitit 2024, profiti neto i gjithsej sektorit arriti në 182.1 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të përsheptuar prej 17.3 përqind nga 10.7 përqind në vitin paraprak (shih Grafikun 27). Ky rezultat reflekton rritjen më të lartë të të hyrave kundrejt rritjes më të ngadalësuar të shpenzimeve (shih Grafikun 28).

Të hyrat e sektorit shënuan rritje prej 15.7 përqind, duke arritur në 503.3 milionë euro. Kontributin kryesor në rritjen e të hyrave kishin të hyrat nga interesi të cilat u rritën për 18.1 përqind dhe përfaqësuan 76.0 përqind të gjithsej të hyrave të sektorit. Përkundër rritjes së përsheptuar të kreditimit, rënia e normës mesatare të interesit në kredi gjatë kësaj periudhe ka ndikuar në rritje vjetore më të ngadalësuar të të hyrave nga interesi nga kreditë apo rritje prej 17.4 përqind nga 24.0 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, si rezultat i rritjes së ngadalësuar të investimeve në letra me vlerë, të hyrat nga interesi në këtë kategori u ngadalësuan në 36.6 përqind nga 48.5 përqind.

Grafik 27. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2025)

Kategoria e të hyrave nga jo interesi, e që janë kryesisht të hyra nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje prej 8.4 përqind nga 3.2 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 103.7 milionë euro në fund të dhjetorit 2024. Mirëpo, përkundër rritjes vjetore të përsheptuar, të hyrat nga jo-interesi shënuan rënie vjetore të pjesëmarrjes në kuadër të gjithsej të hyrave të sektorit në 20.6 përqind nga 22.0 përqind. Kjo si rezultat i rritjes më të lartë së të hyrave nga interesi në raport me të hyrat nga jo-interesi.


Shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën 321.2 milionë euro, duke shënuar ngadalësim të rritjes vjetore në 14.9 përqind nga 21.5 përqind një vit më parë (shih Grafikon 28). Kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej shpenzimeve e kishin shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, dhe ato të interesit. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, me pjesëmarrje prej 57.1 përqind, shënuan rritje vjetore prej 16.9 përqind, për 0.9 pikë përqindje më lartë se viti paraprak. Ndërsa, shpenzimet e interesit shënuan rritje vjetore të lartë prej 42.2 përqind, por që ishte për 13.2 pikë përqindje më ulët se viti paraprak. Rritja më e lartë e gjithsej të hyrave krahasuar me rritjen e gjithsej shpenzimeve ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit të jetë më i ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (shih Grafikon 28). Treguesit e profitabilitetit të sektorit poashtu shënuan rritje të lehtë: Kthimi në Kapital, arriti në 19.9 përqind nga 19.7 përqind një vit më parë, si dhe Kthimi në asete arriti në 2.6 përqind nga 2.5 përqind (shih Grafikon 29).

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar në vend ka vazhduar të demonstrojë stabilitet dhe qëndrueshmëri. Treguesit e shëndetit financiar u karakterizuan me qëndrueshmëri, përkatësisht ulje të kredive jo-performuese dhe mbajtje të kapitalit dhe likuiditetit mbi nivelet minimale rregullatore.


Në kuadër të treguesve të shëndetit financiar, raporti i kredive jo-performuese zbriti në 1.9 përqind, apo rënie për 0.1 pikë përqindje nga viti paraprak (shih Grafikon 30). Rënia e këtij treguesi pasqyron ritmin më të lartë të rritjes së gjithsej portofolit të kredive në krahasim me rritjen e vlerës së kredive jo-performuese. Ndërsa, mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë shënoi rënie në 124.4 përqind nga 145.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si rezultat i rënies së vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive dhe rritjes më të shpejtë të së vlerës së kredive jo-performuese.

Grafik 28. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2025)


Grafik 29. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2025)

Norma e kredive jo-performuese për segmentin e korporatave jofinanciare shënoi rënie për 0.2 pikë përqindje, ndërsa për segmentin e ekonomive familjare shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje nga viti parapak. Më saktësisht, raporti i kredive jo-performuese për korporatat jo-financiare zbriti në 2.2 përqind, ndërsa për ekonomitë familjare arriti në 1.5 përqind. Ekonomitë familjare u karakterizuan me një rritje të lartë të ekspozimeve jo-performuese për të dytin vit me radhë duke shënuar rritje prej 34.4 përqind nga 36.1 përqind një vit më parë. Poashtu, për segmentin e korporatave jo-financiare, ekspozimet jo-performuese përshpejtuan ritmin e rritjes në 6.5 përqind nga 5.0 përqind rritje në vitin e kaluar. Sektori i shërbimeve dhe tregtisë kishin rënie vjetore të raportit të KJP-ve ndaj kredive për 1.3, dhe 0.4 pikë përqindje respektivisht, duke rezultuar në normë të KJP-ve prej 2.7 përqind për sektorin e shërbimeve dhe 1.5 përqind për tregtinë. Në anën tjetër, sektorët që shënuan rritje vjetore të vlerës së KJP-ve ishin prodhimtaria dhe bujqësia. Norma e KJP-ve arriti në 2.9 përqind nga 2.2 përqind për sektorin e prodhimtarisë dhe 6.6 përqind nga 4.8 përqind për atë të bujqësisë.

Grafik 30. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2025)

Pozicioni i kapitalit në fund të vitit 2024 ka mbetur i pandryshuar në 17.4 përqind, nivel ky i qëndrueshëm për dy vite me radhë. Ky zhvillim në normën e kapitalizimit u ndikua nga rritja vjetore pothuajse e njëjtë e mjeteve të peshuara me rrezik në raport me atë të kapitalit rregullativ. Konkretisht, kapitali rregullativ i sektorit në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024 shënoi rritje vjetore prej 15.1 përqind nga 27.3 përqind një vit më parë. Kurse mjetet e peshuara me rrezik kanë shënuar përshpejtim të rritjes në 15.2 përqind nga 13.5 përqind në dhjetor 2023, kryesisht si rezultat i aktivitetit kreditues: rritjes së lartë të ekspozimeve ndaj individëve dhe NVM-ve, si dhe kredive hipotekare me pronë të paluajtshme.

Treguesit e likuiditetit dhe financimit, përkundër trendit rënës, qëndruan mbi nivelet minimale rregullatore. Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR) qëndroi lartë mbi minimumin prej 100 përqind të kërkuar me rregullore, përkatësisht në 210.9 përqind në dhjetor 2024, mirëpo krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit parapak shënoi rënie për 68.9 pikë përqindje. Niveli i lartë i LCR dëshmon se bankat mbajnë mjaftueshëm mjete likuide për të plotësuar nevojat dalëse (rrjedhjes së parasë) për një periudhë 30 ditore. Po ashtu, edhe treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) shënoi rënie në 136.0 përqind nga 150.3 përqind në dhjetor 2023, por mbetet mbi minimumin rregullativ prej 100 përqind duke sugjeruar se bankat disponojnë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për të mbuluar kërkesat më afatgjata të financimit/likuiditetit. Tutje, raporti i likuiditetit - i shprehur si raport i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra - shënoi rënie vjetore për 2.0 pikë përqindje, duke zbritur në 32.7 përqind. Kjo si rezultat i rritjes vjetore më të theksuar të detyrimeve afatshkurtra prej 14.4 përqind në raport me rritjen e mjeteve likuide prej 7.8 përqind. Gjithashtu, rritja më e lartë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar në rritjen e raportit kredi-depozitë për 3.8 pikë përqindje, duke arritur në 84.0 përqind.

2.2. Aktivitetet mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve

Për vitin 2024, BQK ka vazhduar aktivitetin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive në funksion të mbikëqyrjes prudente për sektorin e sigurimeve. Aktiviteti i mbikëqyrjes është realizuar përmes

mbikëqyrjes në vend – ekzaminimeve dhe mbikëqyrjes nga jashtë, respektivisht sistemit të monitorimit dhe analizimit të raporteve financiare. BQK është angazhuar me kapacitet të plotë në realizimin e ekzaminimeve të plota dhe të fokusuara. Qëllimi i ekzaminimeve në vend ka qenë vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të institucioneve siguruese në raport me pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, profilin e rrezikut, gjithnjë në funksion të mbrojtjes së policë mbajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të institucioneve.

Klasifikimi i siguruesve për të qenë subjekt i ekzaminimeve është bazuar në disa faktorë, duke filluar nga analizat e pasqyrave dhe treguesve financiarë, profilin e rrezikut të siguruesve duke marr parasysh edhe ekzaminimet paraprake të realizuara, numrin e gjetjeve dhe rekomandimeve, ankesat e policëmbajtësve në BQK, opinionin e pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, si dhe faktorëve tjerë relevant. Këta faktorë kanë ndikuar në prioritizimin e institucioneve më me rrezik për të qenë subjekt i ekzaminimeve të radhës nga BQK dhe si rrjedhojë, në ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes së vazhdueshme efektive.

Tabela 6. Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve për vitin 2024

Institucioni	Lloji i ekzaminimit
Sigurues	3 ekzaminime të plota 2 të fokusuara
Ndërmjetësues	2 ekzaminime të plota 1 i fokusuar

Burimi: BQK (2025)

Gjatë vitit 2024, BQK ka vazhduar me implementimin e Manualit të Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Siguruesit, i cili përbën një kornizë konceptuale të avancuar lidhur me mbikëqyrjen. Kjo në funksion të harmonizimit me parimet bashkëkohore të mbikëqyrjes së sigurimeve, të zgjerimit dhe nxitjes së identifikimit të hershëm të rreziqeve ndaj të cilave siguruesit ekspozohen, si dhe hartimin e rekomandimeve mbikëqyrëse prudente në funksion të ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar të siguruesve.

Në fillim të vitit 2024, është realizuar një mision i Asistencës Teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar me qëllim të avancimit të mëtejshëm të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Gjatë vitit 2024, BQK ka bërë ndryshimet/plotësimet e nevojshme në Manualin e Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për siguruesit bazuar në rekomandimet e Asistencës Teknike, si dhe mbështetur në praktikën më të mirë mbikëqyrëse, të cilat mund të implementohen në sisteme financiare të madhësisë dhe kompleksitetit të ngjashëm me sistemin tonë. Krahas ndryshimeve/plotësimeve të bëra në Manual, dhe me qëllim të avancimit dhe rritjes së fokusit drejt qasjes së bazuar në rrezik, gjatë vitit 2024 janë përgatitur edhe udhëzuesit e vlerësimit të rreziqeve dhe funksioneve të kontrollit së bashku me Shkallët e Ndërhyrjes bazuar në vlerësimin e rrezikut, duke plotësuar dhe forcuar tutje mbikëqyrjen e bazuar në rrezik.

Gjatë periudhës raportuese, janë ndërmarrë një sërë veprimesh mbikëqyrëse të cilat kanë pasur për qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit të sigurimeve dhe përmirësimin e mekanizmave të menaxhimit të rrezikut. Këto aktivitete janë realizuar përmes analizës së rregullt të treguesve financiarë, vizitave mbikëqyrëse në vend, vlerësimit të funksioneve kyçe dhe shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës nga kompanitë e sigurimeve.

Nga ky proces, janë identifikuar fushat të cilat kanë nevojë për përmirësim në lidhje me qeverisjen korporatave, funksionimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe avancim të praktikave të menaxhimit të rrezikut. Në këtë kontekst, veprimet mbikëqyrëse janë fokusuar në ofrimin e rekomandimeve praktike dhe të zbatueshme, me qëllim rritjen e efektivitetit në fushat kyçe të


cilat synojnë jo vetëm të adresojnë sfidat aktuale, por edhe të krijojnë një mjedis të qëndrueshëm për rritje të shëndetshme dhe afatgjatë të sektorit.

BQK me përkrahjen nga Banka Botërore, është duke punuar intensivisht për të mundësuar transformimin më të lehtë dhe efikas nga IFRS 4 në IFRS 17, si dhe adaptimin e Solvences II në pajtim me udhërrëfyeset e pranuar nga Banka Botërore. Zbatimi i këtij standardi, nuk shihet thjesht si një detyrim për përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, por si një shtyllë thelbësore për forcimin e transparencës, qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë në raportimin financiar të sektorit të sigurimeve.

2.2.1. Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve vazhdoi të rritet gjatë vitit 2024, por me një ritëm më të ngadalësuar krahasur me vitin paraprak. Vlera e përgjithshme e primeve të shkruara shënoi rritje vjetore të theksuar, mbështetur kryesisht nga sigurimet jo-jetë. Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, shkalla e ndërmjetësimit të sektorit arriti në 1.64 përqind nga 1.51 përqind në vitin 2023. Ngjashëm, niveli i densitetit, i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori, arriti në 104.9 euro nga 92.3 euro në 2023.

Grafik 31. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2025)

Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me shkallë më të ulët të koncentrimit krahasuar me atë bankar dhe mikrofinanciar. Krahasuar me një vit më parë, Indeksi Herfindahl⁵ për primet e shkruara bruto (PShB) në 2024 shënoi rritje në 1000 pikë nga 992. Po i njëjti indeks, i kalkuluar duke marrë për bazë asetet e tregut të sigurimeve, shënoi rritje në 957 pikë nga 954 pikë në fund të vitit 2023. Në të njëjtën kohë, indeksi CR5⁶ për vitin 2024, i llogaritur në raport me PShB për sektorin e sigurimeve, rezulton 59.1 përqind nga 59.6 përqind në vitin 2023, ndërsa, i llogaritur në raport me asetet, rezulton 56.1 përqind nga 55.5 përqind në vitin 2023.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.6 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar në fund të vitit 2024, krahasuar me 2.7 në vitin paraprak. Vlera e tyre arriti në 334.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 10.0 përqind, për 2.7 pikë përqindje më ulët se shkalla e rritjes vjetore një vit më parë (shih Grafikun 31). Sigurimet “jo-jetë” shënuan rritje vjetore prej 9.9 përqind dhe përfaqësuan 91.6 përqind të gjithsej asetëve të sektorit në fund të vitit 2024. Ndërsa sigurimet “jetë”, që përbëjnë pjesën e mbetur të asetëve, shënuan rritje vjetore prej 10.6 përqind.

Në kuadër të gjithsej asetëve, depozitat e mbajtura në bankat komerciale shënuan rritjen më të theksuar, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në totalin e asetëve. Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, si kategoria e dytë me peshën më të madhe, shënoi gjithashtu rritje vjetore. Të gjithë zërat e tjerë bilancor shënuan rritje, me përjashtim të kategorisë ‘investimet në prona dhe ‘asetet tjera’ që shënuan rënie (shih Tabelën 7).

⁵ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n (s_i)^2$, ku S paraqet pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto) e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

⁶ Indeksi CR5 (Concentration Ratio of the top 5 firms (Shqip: Raporti i koncentrimit të top 5 kompanive) kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 siguruesve me vlerat më të larta të asetëve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

Sa i përket detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën dominuese me gjithsej 66.7 përqind, pasuar nga ekuiteti me 24.7 përqind dhe zërat tjerë bilancor me peshë më të ulët (shih Tabelën 8). Vlera e kapitalit të sigurimeve ka shënuar rritje dukshëm më të lartë krahasuar me një vit më parë, si rrjedhojë e fitimit të lartë të realizuar në vitin 2024. Për më tepër, operimi me fitim për të pestin vit me radhë ka ndikuar në zvogëlim gradual të humbjeve të trashëguara nga vitet e kaluara. Si rrjedhojë, vlera e humbjeve të akumuluar ndër vite nga sektori u zvogëluara në 34.7 milionë euro nga 43.6 milionë euro sa ishin në vitin 2020.

Tabela 7. Asetet e sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2023	2024	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2023	Pjesëmarrja 2024
Paraja dhe depozitat në BQK	4.4	4.7	8.3%	1.4%	1.4%
Depozitat në bankat komerciale	140.9	163.4	16.0%	46.3%	48.8%
Letrat me vlerë	50.9	53.0	4.2%	16.7%	15.8%
Huatë dhe të arkëtueshmet	18.8	20.8	10.5%	6.2%	6.2%
Pjesa e risiguruesit për rezerva teknike	42.9	49.8	16.3%	14.1%	14.9%
Investimet në prona	6.2	4.8	-23.0%	2.0%	1.4%
Asetet tjera	40.2	38.0	-5.4%	13.2%	11.4%
Gjithsej tregu	304.1	334.5	10.0%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2025)

Vlera e përgjithshme e primeve të shkruara shënoi rritje vjetore të theksuar prej 14.7 përqind nga 9.4 përqind një vit më parë, dhe arriti në 168.1 milionë euro. Struktura e primeve të shkruara vazhdon të dominohet nga primet e sigurimit “jo-jetë” të cilat në dhjetor 2024 përfaqësuan 95.5 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e tyre arriti në 160.4 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 14.7 nga 9.5 përqind një vit më parë. Rritja e vlerës së primeve rezultoi nga rritja e volumit të policave të shitura në vitin 2024, të cilat arritën në 1.97 milionë polica, një rritje vjetore prej 33.1 përqind.

Tabela 8. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2023	2024	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2023	Pjesëmarrja 2024
Rezervat teknike	201.3	223.2	10.9%	66.2%	66.7%
Llogarite tjera të pagueshme	23.2	23.5	1.1%	7.6%	7.0%
Detyrimet tjera	4.6	5.3	15.2%	1.5%	1.6%
Gjithsej kapitali i aksionarit	75.1	82.5	9.9%	24.7%	24.7%
Gjithsej tregu	304.1	334.5	10.0%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2025)

Bruto primet e shkruara “jojetë” vazhdojnë të dominohen nga primet e detyrueshme, me një pjesëmarrje prej 55.5 përqind, ndërsa pjesa tjetër përfshinë primet vullnetare. Produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 7.7 përqind, ndikuar kryesisht nga produktet “MTPL” (Tabela 9). Kurse, në kuadër të sigurimit vullnetar, kategoria “aksident dhe shëndet”, me pjesëmarrje më të madhe në treg prej 23.0 përqind, shënoi rritje vjetore prej 27.6 përqind. Kategoria “përgjegjësi civile të përgjithshme” shënoi rritjen më të lartë vjetore prej 43.9 përqind, por ka pjesëmarrje të ulët prej vetëm 1.1 përqind (Tabela 9).

Vlera e primeve të shkruara nga siguresit “jetë” në vitin 2024 arriti në 7.6 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 15.7 përqind krahasuar me vitin 2023. Këto prime përfaqësojnë 4.5 përqind të gjithsej vlerës së primeve bruto të shkruara nga siguresit.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje vjetore prej 7.8 përqind nga 11.1 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën në 77.0 milionë euro në fund të vitit 2024. Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 69.4 milionë euro ishin dëme të paguara nga siguruesit, ndërsa 7.6 milionë euro dëme të paguara nga BKS.

Tabela 9. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në milionë euro).


Aktiviteti	2023	2024	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2023	Pjesëmarrja: 2024
<i>Gjithsejtë Jo-jetë</i>	139.9	160.4	14.7%	95.5%	95.5%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	69.2	75.6	9.2%	47.3%	45.0%
TPL+	4.1	4.7	14.6%	2.8%	2.8%
Sigurime kufitare	9.2	8.6	-7.0%	6.3%	5.1%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	30.3	38.7	27.6%	20.7%	23.0%
Kasko	10.4	11.4	10.4%	7.1%	6.8%
Kredi dhe garancione	8.7	11.0	27.1%	5.9%	6.6%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	6.6	8.3	26.0%	4.5%	5.0%
Përgjegjësi civile të përgjithshme	1.3	1.9	43.9%	0.9%	1.1%
<i>Gjithsej jetë</i>	6.6	7.6	15.7%	4.5%	4.5%
Gjithsej tregu	146.5	168.1	14.7%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2025)

Kurse, dëmet e paguara nga risiguruesit arritën në 8.3 milionë euro, duke marrë pjesë me 12.1 përqind në gjithsej shumën e dëmeve të paguara nga siguruesit.

Dëmet për sigurimet jo-jetë mbeten dominante, me një rritje të pjesëmarrjes nga 97.9 përqind në 98.2 përqind. Sigurimi i detyrueshëm (MTPL) vazhdon të ketë pjesën më të madhe të tregut, me pjesëmarrje prej 48.3 përqindje. Kategoria ‘aksident dhe shëndet’ ka një rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes nga 21.9 përqind në 25.6 përqind, duke reflektuar rritjen e rëndësisë së këtij segmenti. Sigurimi në pronë, pavarësisht rritjes së madhe vitin e kaluar, ka rënë ndjeshëm, duke zbritur pjesëmarrjen nga 9.1 përqind në 3.0 përqindje (Tabela 10).

Grafik 32. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit ‘jetë’ në vitin 2024 ka rënë në 1.4 milionë nga 1.5 milionë euro një vit më parë, që paraqet rënie vjetore prej 5.6 përqind nga një rritje prej 29.5 përqind në vitin 2023. Kjo rënie i artibuhet rënies së dëmeve të paguara për nënkategoritë, ‘jeta e debitorit’ (shlyerje të detyrimeve në rast të vdekjes së policëmbajtësit, që aplikohet kryesisht nga bankat për sigurim të kredive), kategoria ‘jeta me kursim’ dhe ‘jeta e kombinuar’ (kombinim i sigurimit ‘jetë’ për periudhë të caktuar kohore me mundësi vazhdimi).

Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara në vitin 2024 u përmissua për 3.0 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke zbritur në 45.8 përqind (shih Grafikun 32). Kjo erdhi si rezultat i rritjes më të lartë të primeve të shkruara krahasuar me dëmet e paguara (Tabelat 10 dhe 11).

Tabela 10. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në milionë euro)

Aktiviteti	2023	2024	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2023	Pjesëmarrja: 2024
<i>Gjithsejtë Jojetë</i>	70.0	75.6	8.1%	97.9%	98.2%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTP	34.4	37.2	8.3%	48.1%	48.3%
TPL+	0.3	0.3	7.3%	0.4%	0.4%
Sigurime kufitare, FG, MoU	5.8	7.6	32.3%	8.1%	9.9%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	15.7	19.7	26.0%	21.9%	25.6%
Kasko	6.3	6.9	8.4%	8.9%	8.9%
Kredi dhe garancione	0.9	1.4	57.0%	1.3%	1.9%
Sigurime në pronë	6.5	2.3	-64.1%	9.1%	3.0%
Sigurimi mallit në tranzit	0.0	0.0	-100.0%	0.0%	0.0%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.0	0.0	190.4%	0.0%	0.0%
<i>Gjithsej jetë</i>	1.5	1.4	-5.6%	2.1%	1.8%
Gjithsej tregu	71.4	77.0	7.8%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2025)

2.2.2 Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve vitin 2024 e përmbylli me fitim neto prej 14.7 milionë euro, krahasur me 11.0 milionë euro në vitin paraprak (Tabela 11).

Tabela 11. Rezultati financiar (në milionë euro)

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Sigurimet Jojetë	-5.1	2.0	5.8	2.5	10.0	13.5
Sigurimet Jetë	0.5	0.3	0.5	-0.4	1.0	1.2
Gjithsej tregu	-4.7	2.3	6.3	2.1	11.0	14.7

Burimi: BQK (2025)

Fitimi i realizuar në vitin 2024 është rrjedhojë e rritjes më të lartë të arkëtimit nga primet e shkruara në raport me rritjen më të ngadalësuar të shpenzimeve, përkatësisht 'dëmeve të ndodhura' dhe shpenzimeve operacionale (që përfshijnë shpenzimet për personelin dhe ato administrative).

2.2.3 Ndhmësit financiar

Sektori i ndihmësve financiar përfaqëson vetëm 0.1 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, por, përbën numrin më të madh të institucioneve financiare në vend. Në dhjetor 2024, sektori u përfaqësua nga gjithsej 65 zyra të këmbimeve valutore dhe agjencioneve për transferim të parave krahasuar me 61 sosh në vitin paraprak.

Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në fund të vitit 2024 arriti në 15.0 milionë euro nga 13.3 milionë euro një vit më parë. Struktura e aseteve të ndihmësve financiar përbëhet nga asetet fikse dhe tjera me pjesëmarrje prej 62.1 përqind., Ndërsa 33.1 përqind e mjeteve të sektorit janë të mbajtura në bankat komerciale, pjesa e mbetur përfshinë paranë e gatshme. Sektori ka nivel të ulët të borxhit, me vetëm 30.6 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit të financuar nga produkte të ndryshme të borxhit si kredi, llogari të pagueshme, dhe detyrime tjera. Ndërsa, kapitali vetanak përbën rreth 65.4 përqind të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit.

Sektori i ndihmësve financiar në vitin 2024 shënoi fitim neto në vlerë prej 0.3 milionë euro, që afërsisht paraqet përgjysmim të profitit në krahasim me vitin paraprak. Kjo dinamikë u ndikua nga rritja më e lartë e shpenzimeve në raport me të hyrat të cilat gjithashtu shënuan rritje.

Specifikisht, të hyrat shënuan rritje vjetore prej 7.9 përqind dhe arritën vlerën 8.0 milionë euro, kryesisht si kontribut i të hyrave nga shërbimet. Kurse, vlera e shpenzimeve shënoi rritje vjetore prej 13.2 përqind dhe arriti në 7.5 milionë euro, ndikuar nga rritja në dy komponentët kryesore të shpenzimeve (shpenzimet e personelit të ciula shënuan rritje prej 48.0 përqind rritje vjetore dhe ato operative me rritje vjetore prej 14.6 përqind).

2.3. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sektorit të Pensioneve

Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit pensional në vend, në vitin 2024 janë zhvilluar aktivitetet në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të mbikëqyrjes së fondeve pensionale. Aktiviteti i mbikëqyrjes është realizuar përmes mbikëqyrjes në vend - ekzaminimeve të plota dhe të fokusuara, dhe sistemit të mbikëqyrjes nga jashtë përmes monitorimit dhe analizimit të raporteve financiare periodike të fondeve pensionale. Mbikëqyrja e pensioneve ka zbatuar qasjen e mbikëqyrjes bazuar në rrezik, ku vëmendje e theksuar i është kushtuar rrezikut investues, menaxhimit të fondeve, strategjisë së investimeve, ruajtjes së likuiditetit adekuat, rrezikut operacional dhe rreziqeve tjera.

Sa i përket mbikëqyrjes së fondeve pensionale, gjatë vitit 2024, janë realizuar ekzaminimet në fonde pensionale dhe banka komerciale sipas planit vjetor. Gjatë vitit 2024 janë realizuar 3 ekzaminime, 1 ekzaminim i plotë i fondit pensional dhe 2 ekzaminime të fokusuara në bankat komerciale për shërbimet bankare të tërheqjes në faza të pensioneve të administruara nga bankat.

Gjatë ekzaminimeve është vlerësuar pajtueshmëria e fondeve pensionale me kërkesat ligjore dhe rregullative të BQK-së, duke përfshirë mënyrën e menaxhimit të asetëve, kontrollin e rreziqeve, funksionimin e organeve drejtuese dhe efektivitetin e sistemit të kontrollave të brendshme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar vlerësimit të profileve të rrezikut të fondeve pensionale, përfshirë rrezikun investues, rrezikun operacional dhe atë të qeverisjes.

Në kuadër të ekzaminimeve është rishikuar edhe zbatimi i rekomandimeve të ngritura në raportet e ekzaminimit të BQK-së, me qëllim të mbrojtjes së mjeteve pensionale të kursyera nga kontribuesit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të fondeve. Për më tepër, tek ekzaminimet e fokusuara fushëveprim i ekzaminimeve ishte vlerësimi i zbatimit të tërheqjes në faza të kursimeve të kontribuuesve që bëhet përmes bankave që e ofrojnë këtë shërbim dhe me të cilat FKPK hyn në marrëdhënie kontraktuale.

Tabela 12. Numri i ekzaminimeve të sektorit të pensioneve

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Fondet Pensionale	1 ekzaminim i plotë
Banka	2 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2025)

Nga vlerësimi i rreziqeve në sektorin e fondeve pensionale është konstatuar se sfidat kryesore lidhen me rrezikun investues, i cili ndikon drejtpërdrejt në kthimin e mjeteve të kontribuara nga kontribuesit dhe që mund të ndikohet nga luhatjet e mundshme në tregjet financiare. BQK, në kuadër të mandatit të saj mbikëqyrës, në vazhdimësi jep rekomandime të qarta dhe të strukturuar me afate të përcaktuara për zbatim, të cilat synojnë forcimin e qeverisjes, përmirësimin e menaxhimit të rreziqeve dhe ruajtjen e integritetit e transparencës në sistemin pensional.

Këto veprime përfaqësojnë një qasje proaktive të BQK-së drejt sigurimit të një funksionimi të qëndrueshëm të fondeve pensionale, në përputhje me interesat afatgjata të kontribuuesve. Në këtë mënyrë sigurohet që fondet të operojnë në mënyrë të qëndrueshme, transparente dhe në linjë me objektivat e tyre për ruajtjen dhe rritjen e vlerës së mjeteve të investuara.

2.3.1. Sektori pensional


Asetet e sektorit pensional u rritën me ritëm të përsheptuar prej 17.7 përqind në vitin 2024 nga 12.1 përqind në vitin paraprak, duke arritur vlerën prej 3.2 miliardë euro (shih Grafikin 33). Të dy fondet pensionale realizuan kthim të lartë nga investimet në tregjet ndërkombëtare, të ndikuar nga përmirësimi i treguesve makroekonomikë globalë si pasojë e rënies së inflacionit, politikës monetare lehtësuese të bankave qendrore si dhe avancimeve në sektorin e teknologjisë (inteligjencës artificiale). Ndërkohë, arkëtimet nga kontributet shënuan një rritje të lehtë, duke arritur në 316.5 milionë euro nga 286.8 milionë euro një vit më parë.

Sektori pensional i Kosovës dominohet nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), me pjesëmarrje prej 99.7 përqind në dhjetor 2024. Vlera e aseteve të këtij fondi arriti në 3.2 miliardë euro, duke shënuar rritje të ndjeshme vjetore prej 17.8 përqind nga 12.1 përqind në vitin paraprak.

Kthimi bruto nga investimet arriti në 247.2 milionë euro, një vlerë shumëfishë më e lartë krahasuar me 87.7 milionë euro të realizuara në vitin 2023. Rritja e çmimit të aksioneve në tregjet ndërkombëtare, e nxitur nga pritjet për ngadalësimin e normave bazë të interesit nga bankat qendrore, pati një ndikim të rëndësishëm në performancën e investimeve gjatë vitit. Tremujori i parë dha kontributin kryesor në këtë rritje, pasuar nga tremujori i tretë.


Arkëtimet nga kontributdhënësit kanë vazhduar trendin rritës, megjithatë, me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Dinamika e rritjes së ngadalësuar i atribuohet efektit të bazës së rritur në vitin paraprak, që u ndikua nga rritja e pagave të sektorit publik (Zbatimi i

Grafik 33. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro




Burimi: BQK (2025)

Grafik 34. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2025)

Grafik 35. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP (2025)

Ligjit për Pagat në Sektorin Publik), si dhe nga presionet për rritjen e pagave në sektorin privat për shkak të inflacionit të lartë.

Si rrjedhojë, vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja arrit në 315.8 milionë euro në vitin 2024, duke shënuar një ngadalësim të ritmit të rritjes vjetore në 10.4 përqind nga 18.5 përqind një vit më parë.


Çmimi i aksioneve të FKPK-së u rrit në 1.82 euro nga 1.67 euro për njësi, duke pasqyruar një menaxhim të suksesshëm të mjeteve, me fokus në rritjen e vlerës së kursimeve të kontribuuesve (shih Grafikon 35).

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP), që përbën 0.3 përqind të gjithsej asetëve pensionale, gjithashtu shënoi një rritje të ndjeshme vjetore prej 13.6 përqind, nga 9.9 përqind një vit më parë dhe arriti vlerën e asetëve në 10.7 milionë euro. Kthimi në investime gjithashtu shënoi rritje të lartë vjetore prej 51.4 përqind duke ngritur vlerën e kthimit në 1.2 milionë euro nga 817.0 mijë euro në dhjetor 2023. Tremujori i parë dha kontributin më të madh në këtë rritje, duke përfaqësuar 41.9 përqind të totalit të kthimit, i ndjekur nga TM4 me 27.3 përqind. Çmimi i aksioneve të FSKP-së u rrit në 2.15 euro për njësi nga 1.96 një vit më parë.


Struktura e investimeve të dy fondeve dominohet nga investimet në tregun e jashtëm të cilat vazhduan zgjerimin (shih Grafikon 36). Vlera totale e investimeve të FKPK-së në tregun e jashtëm arriti 2.5 miliardë euro, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në portofol në 79.2 përqind nga 74.5 përqind një vit më parë. Investimet janë fokusuar kryesisht në fondet e përbashkëta - duke zënë 99.9 përqind të totalit - ndërsa 1.2 milionë euro janë mbajtur në formën e parasë së gatshme (shih Grafikon 37). Në kuadër të investimeve në tregun e brendshëm, paraja e gatshme dhe depozitat në BQK shënuan rënie të ndjeshme, përkatësisht 45.2 përqind dhe 92.8 përqind, si rezultat i orientimit të investimeve drejt alternativave më fitimprurëse si letrat me vlerë dhe certifikatat e depozitave. Megjithëse investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u rritën me 11.4 përqind në vitin 2024, duke përmbysur rënien prej 19.3 përqind një vit më parë, pesha e tyre në totalin e investimeve zbriti në 15.7 përqind nga 16.5 përqind. Ndërkohë, investimet në certifikatat e depozitave në bankat vendore shënuan një rritje të përshpejtuar prej 68.8 përqind në vitin 2024, pas rënies prej 34.2 përqind një vit më parë. Pavarësisht kësaj rritje të ndjeshme, pesha e tyre në totalin e investimeve u rrit vetëm lehtësisht, në 4.8 përqind nga 3.3 përqind, pa ndikuar ndjeshëm në strukturën e përgjithshme të portofolit investues.

Struktura e portfolios investuese të FSKP-së është ngjashëm e diversifikuar me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm, më konkretisht në aksione që përbëjnë 96.7 përqind të portfolios investuese dhe pjesa tjetër në para të gatshme, që përbëjnë 3.3 përqind të gjithsej investimeve (shih Grafikon 37). Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të

Grafik 36. Investimet e FKPK-së



Grafik 37. Investimet e FSKP-së



fokusuara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës që përfaqësojnë 15.3 përqind të gjithsej portfolios investuese. Pjesa tjetër e mjeteve të mbajtura në vend, që përbëhet nga paraaja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale, përbëjnë 2.7 përqind të portfolios investuese.

2.4. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sektorit të Tregjeve, IMF, IFJB, IP dhe IPE

Institucionet mikrofinanciare dhe jo-bankare, gjatë vitit 2024 vazhduan të shtojnë peshë në zhvillimin e industrisë financiare të vendit dhe si të tilla mbeten gjithnjë e më aktivë në ndërmjetësimin financiar, në kreditimin kryesisht të shtresave me të ardhura të vogla, ekonomive familjare dhe bizneseve individuale që jo lehtësisht gjejnë qasje në burime të financimit. Gjithsej kreditë në fund të vitit 2024 arritën shumën prej 449.4 milionë euro euro, duke marrë pjesë mbi 4.0% në gjithësej kreditë e sektorit financiar. Po ashtu, edhe institucionet financiare jobankare me aktivitet të këmbimit të valutave, por edhe të faktoringut pasuan rritje të ofrimit të produkteve të tyre në ekonomi.

Fokus të rëndësishëm në tregun financiar kanë pasur institucionet e pagesave, me theks institucionet e pagesave elektronike (institucionet e emetimit të parasë elektronike.) Si rezultat i zgjerimit të vazhdueshëm të pikave të shërbimit të pagesave si dhe kostove të pranueshme dhe mjaft konkurruese në ofrimin e shërbimit të tilla, institucionet e pagesave me aktivitet shërbimin e pagesave dhe emetimit të parasë elektronike karakterizohen me zhvillime të vazhdueshme, si në aspekt të rritjes, e po ashtu dhe në aspekt të lansimit të produkteve të reja.

Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare gjatë gjithë vitit ka përcjellë performancën financiare të institucioneve mikrofinanciare, institucioneve financiare jobankare, institucioneve të pagesave dhe institucioneve të pagesave elektronike përmes raporteve mujore që ato kanë dorëzuar në BQK, si dhe realizimit të ekzaminimeve në vend në institucionet respektive, e me ç'rast në varësi të nevojave janë ndërmarrë veprime të nevojshme, pasuar me rekomandime konkrete për t'u zbatuar nga këto institucione.

Gjatë ekzaminimeve në vend, fokusi i BQK-së ka qenë vlerësimi gjithëpërfshirës i profileve të rrezikut të institucioneve, me theks në praktikën e kreditimit, klasifikimit dhe provizionimit të kredive, për të vlerësuar cilësinë e portfolit dhe menaxhimin e rrezikut kreditor në tërësi. Po ashtu, është vlerësuar struktura dhe përbërja e aseteve dhe detyrimeve, menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe aspektet e qeverisjes korporative, përfshirë rolin mbikëqyrës të bordit, auditimin dhe kontrollet e brendshme. Pjesë kyçe ka qenë edhe analiza e strukturës dhe cilësisë së kapitalit, si dhe planifikimi i tij në raport me kërkesat rregullative. Gjendja dhe performanca financiare janë shqyrtuar në funksion të qëndrueshmërisë së institucionit, ndërsa është vlerësuar edhe përputhshmëria me standardet e mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës ndaj klientëve.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar katër ekzaminime të plota, dy në institucione financiare jobankare dhe dy në institucione të pagesave elektronike ku konform objektivave përkatëse, mbikëqyrja e realizuar në vend në këto institucione gjatë vitit 2024 është fokusuar në vlerësimin e menaxhimit të rrezikut, pajtueshmërisë me legjislacionin e BQK-së, politikën e brendshme të tyre dhe vlerësimin e përgjithshëm të qeverisjes kooperative institucionale si dhe funksionimin e emetimit të parasë elektronike.

Tabela 13. Numri i ekzaminimeve të sektorit të IMF, IFJB, IP dhe IPE

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
IFJB	2 ekzaminime të plota
IPE	2 ekzaminime të plota

Burimi: BQK (2025)

Rrjedhimisht, reflektimet e këtyre institucioneve konform zhvillimeve pozitive në këtë sektor tregojnë për hapat e sukseseve karshi qasjes adekuate dhe mbikëqyrjes efektive të BQK-së, ku nëpërmjet mbikëqyrjes nga jashtë si dhe ekzaminimeve përkatëse dhe rekomandimeve konkrete për implementim është arritur të reflektohet avancim në menaxhimin e riskut, kontrollave të brendshme si dhe përmirësimin e infrastrukturës rregulluese dhe raportuese të sektorit mikrofinanciar, sektorit financiar jobankar, sektorit të institucioneve të pagesave dhe sektorit të pagesave elektronike.

2.4.1 Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar


Sektori mikrofinanciar dhe ai financiar jobankar vazhdoi rritjen e lartë edhe gjatë vitit 2024. Vlera e aseteve të sektorit arriti në 650.7 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 20.5 përqind, për 14.3 përqind më ulët se viti paraprak (shih Grafikon 38). Kreditë vazhdojnë të dominojnë strukturën e aseteve të këtij sektori me pjesëmarrje prej 69.1 përqind, pasuar nga lizingjet me 15.8 përqind. Paraja e mbajtur në sektorin bankar përbënë 9.1 përqind të aseteve dhe zërat e tjerë përbëjnë pjesën e mbetur prej 6.0 përqind.

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar dhe atij financiar jobankar vazhdoi trendin rritës të kredive duke arritur në 449.4 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 24.6 përqind (shih Grafikon 39).

Të dy segmentet e sektorit privat, korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjar shënuan rritje të lartë. Kreditë ndaj ekonomive familjare u rritën për 20.1 përqind nga 21.1 përqind në vitin 2023, duke arritur vlerën 264.7 milionë euro. Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore prej 31.7 përqind, nga 34.2 përqind në vitin 2023, duke arritur vlerën prej 184.6 milionë euro.


Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare ka ndjekur trendin rritës në të gjithë sektorët ekonomik (shih Grafikon 40). Kreditë bujqësore kanë peshë më të madhe (24.4 përqind), duke dhënë kështu kontributin më të lartë në rritjen e kreditimit ndaj korporatave jofinanciare. Vlera e kredive ndaj sektorit të bujqësisë arriti në 45.0 milionë euro që përkon me rritje vjetore

Grafik 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2025)


Grafik 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2025)

duke arritur në 449.4 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 24.6 përqind (shih Grafikon 39).

Grafik 40. Rritja e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK (2025)

prej 28.6 përqind. Rritja e theksuar e kredive për sektorin e bujqësisë është mbështetur edhe nga garancionet kreditore nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).

Lizingjet janë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar, me pjesëmarrje prej 15.8 përqind. Aktiviteti i lizingjeve shënoi ngadalësim të theksuar të rritjes vjetore në 6.9 përqing prej 30.8 përqind në dhjetor 2023, kurse vlera e tyre arriti në 103.1 milionë euro (shih Grafikonin 41). Në rritjen e lizingjeve kontributin kryesor vazhdojnë ta kenë korporatat jofinanciare të cilat kanë dhe peshën më të madhe prej 73.1 përqind në gjithsej lizingjet, përdërisa, kontributi i ekonomive familjare në lizingje ishte më i ulët.


Grafik 41. Lizingjet



Burimi: BQK (2025)


Në dhjetor 2024, norma mesatare e interesit në kreditë nga institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare ishte 18.7 përqind, duke u rritur me 0.1 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (shih Grafikonin 42). Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare shënoi rritje për 0.6 pikë përqindje duke arritur në 21.7 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese po ashtu është rritur për 0.5 pikë përqindje dhe ajo e kredive hipotekare është rritur për 1.3 pikë përqindje në fund të vitit 2024.

Grafik 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2025)


Grafik 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2025)

Për korporatat jofinanciare, norma mesatare e interesit në kredi zbriti për 0.3 pikë përqindje, në 15.6 përqind në fund të vitit 2024. Norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë dhe bujqësisë zbriti për 1.8 dhe 0.7 pikë përqindje respektivisht, duke rezultuar në 16.1 and 16.3 përqind në dhjetor 2024. Kurse norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve u rrit për 0.2 pikë përqindje duke arritur në 15.3 përqind (shih Grafikonin 43).

Grafik 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2025)

Në vitin 2024, sektori mikrofinanciar dhe jobankar realizoi rritje të përsheptuar të fitimit neto prej 12.5 përqind nga 6.4 përqind në vitin paraprak. Vlera e fitimit neto arriti në 20.3 milionë euro, ndikuar nga rritja më e lartë në vlerë e të hyrave në raport me rritjen e shpenzimeve

(shih Grafikët 44 dhe 45). Të hyrat e sektorit janë rritur për 19.9 milionë euro apo për 28.2 përqind, kurse shpenzimet për 17.7 milionë euro apo për 33.6 përqind.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi përfaqësojnë kategorinë kryesore me 83.6 përqind, të cilat shënuan rritje vjetore prej 23.1 përqind në vitin 2024 nga 22.2 përqind në vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit. Kategoria e të hyrave nga jointerеси, që përbën 16.4 përqind të gjithsej të hyrave, shënoi rritje vjetore prej 62.1 përqind nga 60.7 përqind një vit më parë, kjo si rezultat i rritjes së të hyrave tjera operative në 8.8 milionë euro nga 3.9 milionë euro në vitin e kaluar.

Në kuadër të shpenzimeve, pagesat e interesit të cilat kanë pjesëmarrje prej 33.5 përqind, shënuan rritje vjetore të lartë prej 63.0 përqind, por që megjithatë ishte më e ulët se rritja prej 69.2 përqind e shënuar në 2023. Kategoria që ka peshën më të madhe në gjithsej shpenzimet e sektorit, ajo e shpenzimeve për jointerеси me pjesëmarrje prej 50.2 përqind, shënoi rritje vjetore prej 25.3 përqind nga 20.5 përqind një vit më parë, si rezultat i rritjes së shpenzimeve për personelin dhe provizione.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave është rritur me 3.1 pikë përqindje dhe arriti në 77.6 përqind në dhjetor 2024, duke reflektuar rritjen relative më të lartë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat. Indikatorët kryesorë të profitabilitetit shënuan rënie në dhjetor 2024, me kthimin në mesataren e aseteve duke rënë me 0.6 pikë përqindje dhe kthimin në mesataren e kapitalit duke rënë me 1.5 pikë përqindje.


Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive të sektorit në fund të vitit 2024 zbriti në 1.6 përqind nga 1.8 përqind. Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione vazhdon të jetë e qëndrueshme, ndonëse zbriti lehtësisht në 148.4 përqind nga 149.7 përqind një vit më parë (shih Grafikun 46).

2.5. Aktivitetet Mbikëqyrëse për Parandalimin i pastrimit të parave dhe LFT

BQK-ja bazuar në paragrafin 4 të nenit 34 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (PPP/FT), zbaton kompetencat mbikëqyrëse në institucionet financiare për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj dhe me rregulloret përkatëse.


BQK-ja ka vazhduar me realizimin e funksionit mbikëqyrës në institucionet financiare sa i përket sigurimit të pajtueshmërisë PPP/FT. Fushëveprimi i mbikëqyrjes ka mbuluar institucionet financiare të licencuara, duke përfshirë bankat, kompanitë e sigurimeve, shërbimet e transferimit të vlerës monetare, institucionet financiare jobankare.

Grafik 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2025)

Grafik 46. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



*Përfshihen kreditë dhe lizingjet

Burimi: BQK (2025)

Gjatë vitit 2024, BQK ka realizuar 8 ekzaminime të plotë në vend, duke reflektuar një qasje mbikëqyrëse të bazuar në rrezik e cila i jep përparësi institucioneve dhe sektorëve me rrezik më të lartë të PP/FT. Qëllimi i ekzaminimeve të realizuara ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së programit me legjisllacionin në fuqi si dhe vlerësimi i efektivitetit të sistemeve dhe kontrolleve të brendshme të fushës. Tabela në vazhdim paraqet numrin e ekzaminimeve të realizuara për vitin 2024.

Fushat e ekzaminuara përfshijnë komponentët kryesorë të programit duke përfshirë qeverisjen dhe kulturën e pajtueshmërisë, funksionin e pajtueshmërisë për PPP/LFT, zbatimin e masave të kujdesit të duhur ndaj klientit dhe kujdesit të duhur të shtuar ndaj klientëve me rrezik të lartë, efektivitetin e vlerësimeve të rrezikut të PP/FT, monitorimi dhe raportimi si dhe trajnimi dhe ndërgjegjësimi i punonjësve.

Tabela 14. Numri i ekzaminimeve për pastrimin e parisë

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka, IMFJB, Sigurues	8 ekzaminime të plota

Burimi: BQK (2025)

Për zbatim sa më efektiv në praktikë të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit është e nevojshme nxjerrja e akteve udhëzuese. Ndërlidhur me këtë, është miratuar “Manuali i Mbikëqyrjes të Bazuar në Rrezik për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT)”. Ky Manual është përgatitur me asistencën teknike nga projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës kundër krimit ekonomik (PECK III). Qëllimi i këtij Manuali është ngritja e kapaciteteve mbikëqyrëse drejt qasjes së bazuar në rrezik e cila mundëson identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit si dhe përshtatjen e strategjisë mbikëqyrëse në përputhje me rrezikun e paraqitur.

Gjatë vitit 2024, BQK gjithashtu ka miratuar “Udhëzimin mbi Politikën dhe Procedurat për Menaxhimin Efektiv të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (PPFT) gjatë ofrimit të shërbimeve financiare, i aplikueshëm për të gjitha institucionet financiare”. Institucionet financiare sipas këtij udhëzimi duhet të sigurojnë që zbatimi i këtyre politikave dhe procedurave nuk mund të rezultojë me refuzime apo ndërprerje grupore të marrëdhënieve kontraktuale/biznesore për kategori të caktuara të klientëve të cilët i vlerësojnë me rrezik të lartë për PPFT. BQK njihë përgjegjësinë dhe obligimin e institucioneve financiare në vlerësimin e rrezikut të klientëve të tyre, vlerësim që sipas këtij udhëzimi duhet të bëhet individualisht për profilin e secilit aplikues ose pranues të produkteve/shërbimeve financiare individualisht. Gjithashtu, udhëzimi eviton praktikën e pashëndetshme të institucioneve financiare të cilat pamundësojnë qasjen e kategorive dhe subjekteve të caktuara në shërbime financiare pa një vlerësim adekuat të rrezikut të tyre individualisht dhe të mirë argumentuar, ndërsa promovon mbrojtjen e konsumatorëve dhe zgjerimin e përfshirjes financiare, për një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të sektorit financiar konkurrues.

Në aspekt të përgatitjes për aplikimin në SEPA, me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare të FATF dhe Direktivat e BE-së, si dhe duke u bazuar në rekomandimet e raportit të vitit 2018 të vlerësimit të pajtueshmërisë së vendit me standardet ndërkombëtare të PPPLFT të realizuar në projektin e përbashkët të Këshillit të Evropës dhe BE-së – PECK II, është miratuar plotësimi ndryshimi i Rregullores aktuale të BQK-së për PPP/LFT si dhe është miratuar Rregullorja mbi informacionet që duhet të shoqërojë transferet e fondeve e cila transponon

Rregulloren e BE-së 2015/847 dhe 2023/1113 si dhe implementon në plotësi kërkesat e Rekomandimit 16 të FATF për transferet elektronike.

Në aspektin e fuqizimit të bashkëpunimit dhe rritjes së kujdesit për sektorin financiar janë zhvilluar takime me Komitetin për Pajtueshmëri brenda Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe me bankat komerciale, në të cilat takime janë shqyrtuar kërkesat lidhur me kornizën ligjore dhe operacionale të fushës. Ndërsa, në kuadër të projektit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III), BQK ka vazhduar me pjesëmarrje aktive në takimet e Këshillit Drejtues dhe aktivitetet tjera të projektit.

2.6. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sistemeve të TI të Institucioneve Financiare

Viti 2024 shënoi themelimin e Divizionit të Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së (DMSI), me mandatin për të mbikëqyrur sistemet e informacionit dhe menaxhimin e rrezikut kibernetik në të gjitha segmentet e sektorit financiar të mbikëqyrur, përfshirë bankat, institucionet financiare jo-bankare (IFJB/IMFB), kompanitë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve. Përgjegjësitë që më parë ishin të shpërndara në disa departamente, janë bartur dhe konsoliduar brenda DMSI, duke mundësuar një qasje më të koordinuar dhe efektive ndaj rreziqeve teknologjike dhe kibernetike, por edhe aplikimin e praktikave të mira të menaxhimit të tyre.

Gjatë vitit të parë të funksionimit, është hartuar Draft Rregullorja për Sistemet e Informacionit dhe Menaxhimin e Rrezikut Kibernetik, e cila është bashkërenditur me kërkesat dhe praktikat më të fundit ndërkombëtare, duke synuar harmonizimin e qasjes mbikëqyrëse me zhvillimet globale në fushën e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike, por edhe gatishmërinë e reagimit ndaj sulmeve të mundshme.

Paralelisht, janë ndërmarrë veprime për sigurimin dhe plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, analizimit të metodologjisë së mbikëqyrjes dhe përgatitjes së mjeteve mbështetëse për vlerësim dhe analizë.

Në aspektin operativ, janë realizuar katër (4) ekzaminime të institucioneve financiare, me fokus në vlerësimin e sistemeve të TI-së dhe masave të zbatuara të sigurisë kibernetike, duke përfshirë edhe qeverisjen dhe vendimmarrjen lidhur me sistemet dhe praktikat e zbatuara. Po ashtu, është realizuar vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë së informacionit në industrinë financiare, përfshirë nivelin e pjekurisë së masave të vendosura. Ky raport, i cili do të publikohet gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, do të shërbejë si bazë për identifikimin e masave korrigjuese dhe prioriteteve për adresim të mëtutjeshëm.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të njohurive, në këtë fushë janë realizuar takime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, përfshirë bashkëpunime me organizata si IFC, IMF, CEF, MasterCard, si dhe me shoqata vendore dhe partnerë vendorë e ndërkombëtarë. Këto angazhime kanë ndihmuar në përvetësimin e praktikave më të mira dhe në forcimin e bashkëpunimit për ngritjen e kapaciteteve institucionale.

BQK mbetet e përkushtuar në avancimin e mëtejshëm të kornizës rregullative, ngritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet teknologjike, komunikimit të vazhdueshëm dhe transparent, si dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit financiar ndaj sfidave të sigurisë kibernetike.

2.7. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave mbikëqyrëse, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) vepron në pajtueshmëri me nenin 67, pika 4 të Ligjit Nr.03/L-209 për BQK-në, gjatë procesit të shqiptimit të ndëshkimeve administrative ndaj subjekteve/personave të mbikëqyrur. Kjo dispozitë përcakton që, përpara shqiptimit të ndëshkimeve administrative, Bordi Ekzekutiv i BQK-së i ofron subjektit/personit një deklaratë të detajuar, ku përshkruhen faktet dhe baza ligjore

mbi të cilat mbështetet ekzistenca e shkeljes, si dhe duke i dhënë subjektit/personit mundësi për të paraqitur fakte dhe argumente për mos ndëshkim.

Në deklaratën/Njoftimin paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative, të dërguar nga BQK-ja, përfshihet edhe këshilla juridike, ku subjekti (institucioni financiar) informohet për të drejtën e tij që, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e pranimit të deklaratës, mund të parashtrijë kërkesë për rishqyrtim në Divizionin e Rishqyrtimit të BQK-së. Nëse subjekti (institucioni financiar) i mbikëqyrur nga BQK-ja vendos të ankohet, atëherë ai dërgon kërkesën për rishqyrtim në Divizionin e Rishqyrtimit.

Divizioni i Rishqyrtimit është koordinuar me mbikëqyrjen financiare lidhur me dërgimin e Njoftimit paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative nga BQK tek subjekti (institucioni financiar), si përgatitje paraprake të nevojshme, për trajtimin e rasteve eventuale të parashtrimit të kërkesave për rishqyrtim nga institucionet financiare.

Gjatë vitit 2024 janë pranuar 11 kërkesa për rishqyrtim nga institucionet financiare, prej të cilave 10 kërkesa janë shqyrtuar me kujdes dhe në përputhje me kornizën ligjore, si dhe janë hartuar raporte me rekomandime përkatëse për vendimmarrje në Bordin Ekzekutiv, ndërsa një kërkesë është pranuar jashtë afatit rregullativ dhe nuk ka pasur elemente të kërkesës për rishqyrtim sipas kërkesës së Rregullores për Procedurat e Shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative, prandaj nuk është trajtuar nga Divizioni për Rishqyrtim. Rrjedhimisht, gjatë këtij procesi, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me institucionet financiare që kanë parashtruar kërkesat për rishqyrtim, si dhe me departamentet përkatëse të BQK, duke siguruar dokumentacionin dhe sqarimet e nevojshëm për një shqyrtim të plotë dhe të drejtë brenda afatit ligjor.

Në përputhje me planin vjetor 2024, është bërë rishikimi i Rregullores për Procedurat e Shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative, me qëllim të plotësimit dhe ndryshimi të saj. Pas finalizimit të rishikimit, më 17 dhjetor 2024, rregullorja është miratuar nga Bordi i BQK-së.

Mbi bazën e shqyrtimeve të tilla, në funksion të arritjes së objektivave parësore dhe duke u bazuar në detyrat përkatëse të realizuara nga njësitë organizative përgjegjëse, mbi bazën e autorizimeve ligjore, Bordi Ekzekutiv në 18 raste ka shqiptuar masa mbikëqyrëse të veçanta administrative dhe korrigjuese ndaj institucioneve financiare dhe strukturave përgjegjëse institucionale.

2.8. Regjistri Kreditor

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja mund të operojë, të rregullojë, të licencojë, të regjistrojë dhe të mbikëqyrë sistemet e informacionit të kredive me qëllim të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të kredive mes institucioneve kredidhënëse si dhe mund të nxjerrë rregullore për zbatimin përkatës.

Bazuar në këtë objektiv që nga viti 2006, BQK-ja ka nën menaxhim të saj sistemin e Regjistrimit të Kredive (RKK), i cili funksionon si një aplikacion i bazuar në internet dhe ka për qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave pozitive dhe negative të personave fizikë dhe juridikë, me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të klientëve kreditorë si dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të BQK-së.

Nga një perspektivë e përgjithshme ekonomike, Regjistri i Kredive lehtëson kredidhënien sa i përket vëllimit dhe kostove, si dhe kontribuon në stabilitetin financiar në përgjithësi duke ndihmuar kredidhënësit për një vendimmarrje të drejtë, brenda një kohe më të shkurtër në mënyrë më të saktë dhe më objektive.

Në bazë të rregullores së Regjistrimit të Kredive, anëtar në sistemin e RKK-së janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga BQK për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat komerciale dhe institucionet mikro-financiare të licencuara si dhe ato institucione

financiare jo-bankare dhe kompani të sigurimeve të licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore.

Banka Qendrore e Kosovës ka miratuar Udhëzuesin e ri Metodologjik për raportimin e të dhënave në Regjistrin e Kredive (RKK), me qëllim të avancimit të cilësisë dhe përmbajtjes së të dhënave të raportuara nga institucionet kredidhënëse. Ky udhëzim mundëson mbledhjen e informatave më të detajuara për huamarrësit, përfshirë aftësinë paguese, qëllimin e kredisë, vlerësimin e kolateralit dhe të dhënat në bazë të gjinisë së huamarrësve si një element i rëndësishëm për qasjen e grave në financa. Udhëzimi poashtu ndihmon BQK-në në formulimin e politikave më të sakta dhe i mbështet institucionet financiare në vlerësimin më të mirë të rrezikut kreditor.

Avansimi i udhëzimit me informacione të reja është zhvilluar në konsultim me institucionet financiare dhe me mbështetjen e Korporatës Financiare ndërkombëtare (IFC).

Poashtu Banka Qendrore e Kosovës ka bërë të mundur përmes nënshkrimit të Memomrandumit të Bashkëpunimit me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) shtimin në platformën shtetërore eKosova edhe shërbimin e Regjistrin të Kredive të Kosovës (RKK), ku qytetarët pa kosto kanë mundësi të nxjerrin Raportin Kreditor individual direkt nga platforma shtetërore eKosova, pa pasur nevojë ta kërkojnë në mënyrë fizike nga BQK.


Bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së aktualisht janë të regjistruar 2,769 përdorues aktiv të institucioneve kredidhënëse, ku dominon numri i përdoruesve nga e institucionet bankare me 1,887 përdorues aktiv, institucionet mikro-financiare dhe ato jo bankare vijojnë me 855 përdorues dhe në fund kompanitë e sigurimeve me 27 përdorues aktiv të sistemit të RKK-së. Gjatë vitit 2024, Regjistri i Kredive ka regjistruar 609 përdorues të ri.

Sistemi i Regjistrin të Kredive është i dizajnuar që të sigurojë një infrastrukturë të avancuar për funksionimin e tregut të kredive duke paraqitur një mjet të rëndësishëm për institucionet kredidhënëse në vlerësimin e riskut kreditor.

Ky sistem është një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga stafi i institucioneve kredidhënëse i cili hulumton mbi historitë kreditore të aplikantëve kreditor, ku gjatë vitit 2024 kap shifrën prej 1,687,799 hulumtime. (shih Grafikon 47)


Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në RKK, të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga BQK.

Grafik 47. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2025)

Grafik 48. Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së




Burimi: BQK (2025)

Gjatë vitit 2024, në RKK janë raportuar 302,570 kredi ku përfshihen huat, kredit kartelat, mbitërheqjet, kreditë hipotekare rezidenciale, linjat kreditore, garancionet, lizingu, faktoringu dhe asetet tjera kreditore. Në raportimin për kredi të aprovuara për vitin 2024 prijnë bankat me 169,826 kredi, ndjekur nga institucionet mikrofinanciare dhe ato jobankare me 120,309 dhe kompanitë e sigurimeve me 12,435 kredi të aprovuara (shih Grafikon 48).

Ndërsa numri i kërkesave për raportin individual kreditor të kredimarrësve në vitin 2024 ka shënuar ngritje nga një vit më parë, si për personat fizik dhe për juridik (shih Grafikon 49).

Grafik 49. Numri i kërkesave për raporte kreditore



Burimi: BQK (2025)

3. Licencimi dhe rregullimi i Institucioneve Financiare

Bazuar në Ligjin për BQK-në, objektivi parësor i saj është nxitja dhe mbajtja e një sistemi financiar stabil. BQK-ja angazhohet në arritjen e këtij objektivi përmes përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive si autoritet përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës.

BQK-ja, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoritet licencues, rregullues, dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare në vend, angazhohet në:

Rregullimin e hyrjes në treg të investitorëve potencialë, duke përcaktuar kritere për licencimin e institucioneve financiare dhe të atyre institucioneve, që posedojnë kapital të mjaftueshëm për mbështetjen e aktiviteteve të parapara, që prezantojnë përgatitjet e duhura për vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut, plane biznesore të qëndrueshme me synim ndikimin dhe konkurrencën në sektor, politika dhe procedura adekuate për kontrollin e tij, si dhe administratorë me nivel të lartë kualifikimi, profesionalizmi dhe etike, qasje të lehtë dhe të mirëbesimit dhe komunikimit me institucionet përkatëse shtetërore të vendit të investitorit;

Hartimin dhe mirëmbajtjen e kornizës rregullatore të përbërë nga një tërësi kriteresh minimale dhe kërkesash rregullative të aplikueshme ndaj institucioneve financiare, në harmoni me legjislacionin primar, Direktivat Evropiane, si dhe standardet ndërkombëtare;

Zhvillimin e një procesi mbikëqyrës efektiv, duke zbatuar parimet e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, nëpërmjet ekzaminimeve në vend, si dhe analizimin, vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave të institucioneve financiare, vlerësimin e trendëve të ardhshëm financiar, si dhe mundësinë e ndërmarrjes së masave përmirësuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;

Bashkëpunimin me institucionet financiare të licencuara dhe mbikëqyrura nga BQK-ja, si dhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse për bankat ose autoritetet rregullatorë përkatëse për institucionet jo-bankare që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.


Me qëllim të kryerjes së funksioneve të saj mbikëqyrëse, BQK-ja synon nivelet më të larta të integritetit, profesionalizmit, efikasitetit, transparencës dhe zhvillimit të përhershëm të kapaciteteve të saj mbikëqyrëse.

3.1. Licencimi

Sipas Ligjit për BQK-në, autoriteti i vetëm përgjegjës për rregullimin, licencimin/regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK-ja ka për qëllim që të sigurojë një proces meritator, transparent dhe gjithëpërfshirës të licencimit, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues financiar të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm, megjithatë shërbejnë për të siguruar që vetëm institucionet që plotësojnë kërkesat ligjore në nivelin e kërkuar, nuk ekspozojnë vendin ndaj rreziqeve dhe sjellin vlerë të shtuar hyjnë në treg. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore, ndërsa praktika në disa raste, ka dëshmuar nevojën për rishikimin dhe avancimin e tyre, konform praktikave të kaluara dhe sfidave aktuale.

Figura 1. Struktura e Institucioneve Financiare që operojnë në tregun financiar në Kosovë



Burimi: BQK (2025)

Tabela 15. Numri i institucioneve financiare


Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024
Bankat komerciale	11	11	12	12	11
Siguruesit	13	12	12	12	12
Fondet pensionale	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	57	53	59	61	65
Ndërmjetësuesit në sigurime	18	19	16	17	17
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jobankare	29	30	30	32	32

Burimi: BQK (2025)

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2024, sipas llojit të institucioneve financiare të licencuara dhe regjistruara që ofrojnë shërbime financiare në Kosovë, bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të renditura sipas peshës së tyre në sistem është paraqitur në figurën 47.

Në tregun financiar të Kosovës operojnë 139 institucione financiare të licencuara dhe regjistruara, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vend bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe kornizën rregullatore në fuqi të BQK-së.

Grafik 50. Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave



Burimi: BQK (2025)

Sa i përket qasjes në financa në komunat në veri të vendit, pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme më 1 shkurt 2024, numri i institucioneve financiare të licencuara për të operuar në katër komunat veriore është pothuajse trefishuar. Kjo rritje është rezultat i masave të planifikuara nga BQK për të mbështetur zgjerimin e qasjes në financa dhe aktivitetete të përbashkëta me sektorin financiar. Edukimi financiar ka qenë gjithashtu një fokus i këtyre përpjekjeve, duke dhënë rezultate pozitive.

Deri në gusht të vitit 2023 (para rregullores së re për operacione me para të gatshme), në veri të vendit operonin gjithsej 17 zyra të institucioneve financiare, prej të cilave 4 ishin degë bankare, dy nga to të vendosura në pikat kufitare. Sipas të dhënave aktuale, ky numër është rritur në 38 zyra të institucioneve financiare, duke shënuar një rritje prej 21 zyrash. Nga to, 9 janë degë bankare, duke e rritur për pesë numrin e degëve bankare dhe duke forcuar prezencën e sektorit bankar në këtë rajon të vendit. Kjo rritje përfshin si banka vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare.

Numri i institucioneve në veri të vendit deri më 31 dhjetor 2024 paraqitet në tabelën vijuese.

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare të hapura në pjesën Veriore të Kosovës deri më 31 dhjetor 2024

Zyra të Institucioneve Financiare	Deri më Gusht 2023	Deri më dhjetor 2024	Ndryshimi (numër)	Ndryshimi (%)
Banka	4	9	5	125%
Mikrofinanciare	2	4	2	100%
Zyra dhe agjent në IFJB	3	5	2	67%
Zyra të IFJB	7	16	9	129%
Sigurues	1	4	3	300%
Gjithsejt	17	38	21	124%

Burimi: BQK (2025)

Banka: Numri i bankave që kanë hapur zyra në veri të Kosovës është rritur nga 4 në gusht 2023 në 9 në dhjetor 2024, duke shënuar një shtim prej 5 zyrash ose 125%. Kjo rritje reflekton një përfshirje më të gjerë dhe një prani të shtuar të sektorit bankar në rajon.

Institucione Mikrofinanciare: Numri i institucioneve mikrofinanciare është dyfishuar, duke kaluar nga 2 në 4, që përfaqëson një rritje prej 100%. Ky zhvillim tregon një rritje të kërkesës për shërbime financiare alternative nga qytetarët.

Zyra dhe Agjentë në IFJB: Numri i zyrave dhe agjentëve të institucioneve financiare jo-bankare (IFJB) është rritur nga 3 në 5, duke shënuar një shtim prej 2 njësisish ose 67%. Kjo rritje pasqyron një zgjerim të moderuar të këtij segmenti në rajon.

Zyra të IFJB-së: Numri i zyrave të IFJB-së është rritur nga 7 në 16, duke përfaqësuar një rritje prej 9 zyrash ose 129%. Ky zhvillim tregon një fokus të shtuar në ofrimin e shërbimeve financiare jo-bankare.

Sigurues: Numri i zyrave të institucioneve të sigurimit është rritur nga 1 në 4, duke shënuar një rritje prej 300%. Ky zgjerim i ndjeshëm pasqyron përpjekje për të përmbushur më mirë nevojat për sigurime në këtë zonë.

Gjithsejt: Numri total i institucioneve financiare është rritur nga 17 në 38, me një shtim prej 21 njësisish ose 124%. Ky zhvillim dëshmon për një dinamizëm të konsiderueshëm në zgjerimin e sektorit financiar në veri të Kosovës.


Përmes qasjes së re mbikëqyrëse dhe dialogut mbikëqyrës në shkurt 2024, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, është revokuar licenca bankare dhe është miratuar procesi i likuidimit vullnetar për një degë të një banke të huaja që operonte në Republikën e Kosovës. Ky vendim është ndërmarrë mbi bazën e një dakordimi paraprak të arritur në kuadër të dialogut mbikëqyrës dhe rregullator ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe institucionit përkatës. Prosesi i mbylljes është realizuar në përputhje me planin vullnetar të paraqitur nga banka, i cili ka paraparë ndërprerjen e aktivitetit përkatës në mënyrë të rregullt dhe të kontrolluar.

3.1.2 Rrjeti i sistemit financiar

Në fund të vitit 2024, bankat e ushtruan veprimtarinë e tyre në gjithsej 58 degë dhe 166 zyra brenda territorit të vendit (shih Grafikon 50). Gjatë këtij viti, me miratim të BQK-së është rritur numri i degëve bankat e reja për një, ndërsa, numri i degëve të bankave tjera pothuajse ka mbetur i njëjtë me vitin paraprak.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit bankar përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit dhe ishte pothuajse e njëjtë me vitin paraprak në raport me numrin e degëve dhe zyrave (shih Tabelën 16). Megjithatë, vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe zyrave në rajonin e Prishtinës me 36.0 përqind, ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh 28.8 përqind (shih Grafikon 51).

Grafik 51. Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve



Burimi: ASK (2025)

Trendi pesëvjeçar sugjeron strategji konsistente të bankave sa i përket fokusimit gjeografik. Pra, gjatë kësaj periudhe nuk ka ndryshim të theksuar në rajonet tjera në raport me përqindjen e degëve dhe zyrave bankare dhe trendi vazhdon pothuajse në mënyrë proporcionale në të gjitha rajonet. Megjithatë, përfshirja financiare mund të rezultojë në konsiderim të kësaj shtirjeje.

Tabela 16. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave


Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjiilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	95	36%	38	15%	42	16%	52	20%	35	13%	262
2017	83	35%	37	16%	39	16%	47	20%	32	13%	238
2018	74	33%	35	16%	38	17%	44	20%	31	14%	222
2019	71	33%	35	16%	37	17%	44	20%	30	14%	217
2020	70	33%	34	16%	32	15%	41	19%	34	16%	211
2021	67	33%	34	17%	28	14%	38	19%	34	17%	201
2022	67	33%	35	17%	29	14%	39	19%	33	16%	203
2023	73	33%	37	17%	33	15%	41	19%	35	16%	219
2024	79	34%	39	17%	35	15%	41	17%	41	17%	235

Burimi: BQK (2025)

Siguruesit, gjatë vitit 2024 veprimtarinë e tyre e ushtruan përmes 60 degëve, njëjtë si në vitin paraprak, 415 zyrave dhe 50 agjentëve dhe brokerëve brenda territorit të vendit (shih Grafikon 52), ku vërehet një zgjerim i lehtë i rrjetit të përgjithshëm të zyrave të siguruesve në vend.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit të siguruesve përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit, por, nuk përputhet me shpërndarjen gjeografike të popullsisë si në rastin e bankave. Përqendrimi i rrjetit të siguruesve, me theks ai i degëve të siguruesve, në vitin 2024 ka përfaqësuar më të lartë në rajonin e Pejës me 26.7%, i pasuar nga rajoni i Gjilanit, që si rajone nuk reflektojnë shpërndarjen gjeografike të popullsisë dhe kjo strukturë është konsistente gjatë gjashtë viteve të fundit (shih Tabelën 17).

Grafik 52. Rrjeti i siguruesve



Burimi: BQK (2025)

Tabela 17. Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve

Vitet	Rajoni i Prishtinës		Rajoni i Prizrenit		Rajoni i Pejës		Rajoni i Gjilanit		Rajoni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	11	15.3%	11	15.3%	21	29.2%	18	25.0%	11	15.3%	72
2017	13	17.8%	11	15.1%	20	27.4%	19	26.0%	10	13.7%	73
2018	14	18.9%	11	14.9%	20	27.0%	19	25.7%	10	13.5%	74
2019	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2020	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2021	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2022	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2023	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2024	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60

Burimi: BQK (2025)

Fondet pensionale aktivitetin e tyre e zhvillojnë vetëm përmes zyrave qendrore me lokacion në Prishtinë.

Institucionet mikrofinanciare në fund të vitit 2024, aktivitetin e tyre e ushtruan përmes 149 zyrave të shpërndara brenda territorit të vendit. Gjatë vitit 2024 është aprovuar hapja e njëmbëdhjetë (11) zyrave, si dhe zhvendosja e katër (4) zyrave të tjera të IMF-ve. Shpërndarja gjeografike e zyrave të institucioneve mikrofinanciare vazhdon të jetë e përqendruar kryesisht në dy rajone të territorit të vendit, në rajonin e Prishtinës dhe atë të Prizrenit (shih Tabelën 18).

Tabela 18. Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	27	26%	24	23%	23	22%	19	18%	12	11%	105
2017	29	26%	26	23%	24	21%	20	18%	14	12%	113
2018	32	27%	28	23%	24	20%	22	18%	14	12%	120
2019	37	29%	30	23%	24	19%	23	18%	14	11%	128
2020	38	29%	30	23%	25	19%	23	18%	14	11%	130
2021	12	14%	30	36%	5	6%	23	27%	14	17%	84
2022	39	29%	33	24%	26	19%	24	18%	14	10%	136
2023	41	30%	32	23%	27	20%	24	17%	14	10%	138
2024	45	30%	33	22%	29	19%	26	17%	16	11%	149

Burimi: BQK (2025)

Institucionet financiare jobankare në fund të vitit 2024, aktivitetin e tyre e ushtruan në gjithsej 998 zyra dhe agjentë të shpërndarë brenda territorit të vendit. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të rrjetit të institucioneve financiare jobankare është i përqendruar pothuajse në gjithë territorin e vendit, ku prinë rajoni i Prishtinës me 37 përqind, pasuar nga rajoni i Gjilanit me 22 përqind, dhe me rajonin e Mitrovicës që ka pjesëmarrjen më të ultë në vend (shih Tabelën 19).

Këtij trendi të rritjes së zyrave dhe agentëve të rinj i ka kontribuar hyrja në treg dhe regjistrimi i institucioneve të reja financiare që merren me shërbimin e pagesave, emetimit të parasë elektronike dhe këmbimit valutor.

Tabela 19. Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agent) sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjiçanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	132	29%	85	18%	101	22%	103	22%	41	9%	462
2017	154	29%	96	18%	109	21%	115	22%	52	10%	526
2018	177	30%	111	19%	122	21%	130	22%	53	9%	593
2019	219	31%	126	18%	139	20%	160	23%	65	9%	709
2020	286	33%	150	17%	165	19%	192	22%	82	9%	875
2021	340	36%	163	17%	170	18%	197	21%	80	8%	950
2022	360	36%	177	18%	174	17%	212	21%	81	8%	1004
2023	384	37%	174	17%	177	17%	228	22%	75	7%	1038
2024	369	37%	168	17%	172	17%	223	22%	66	7%	998

Burimi: BQK (2025)

3.1.3 Aktiviteti i licencimit

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të licencimit dhe sigurimit të funksionimit të rregullt të veprimtarive financiare, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka vazhduar të jetë aktive në shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave për licencim gjatë vitit 2024. Në këtë periudhë, BQK-ja ka shqyrtuar gjithsej 354 kërkesa, detajet e të cilave janë pasqyruar në Tabelën 20 të raportit. Vlen të theksohet se në këtë numër nuk përfshihen: (i) Kërkesat e bartura nga viti 2023 që janë shqyrtuar për vendimmarrje gjatë vitit 2024, (ii) Shprehjet e interesimit për licencim apo regjistrim që janë paraqitur pranë BQK-së, por nuk kanë kaluar në fazën formale të shqyrtimit, (iii) Kërkesat që janë trajtuar nga BQK-ja, por nuk kërkojnë miratim formal sipas kuartrit rregullativ në fuqi,

(iv) Pyetjet, njoftimet dhe vlerësimet e tjera që kanë qenë objekt i trajtimit gjatë periudhës raportuese.

Gjatë vitit 2024, BQK-ja ka pranuar kryesisht kërkesa për regjistrimin e Institucioneve Financiare Jobankare (IFJB), një trend i ngjashëm me atë të vitit të kaluar. Po ashtu, është vërejtur një rritje e kërkesave të paraqitura nga sektori bankar, duke reflektuar zhvillimet dhe dinamikën e këtij sektori në tregun financiar të Kosovës. Në tërësi, struktura e kërkesave për licencim ka mbetur e qëndrueshme, ndonëse me një rënie të lehtë në numrin e përgjithshëm të aplikimeve krahasuar me vitet paraprake.

Kjo analizë ofron një pasqyrë të qartë të trendeve dhe dinamikës në procesin e licencimit, duke nënvizuar përkushtimin e BQK-së për të mbështetur një sistem financiar të qëndrueshëm dhe të mbrojtur nga rreziqet operacionale.

Tabela 20. Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK

Transaksionet	2024					
	Bankë	Fonde pensionale	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërrmjet në sigurime/tjeter	Gjithsej
Aplikacionet				0	1	1
Aksionarët kryesor dhe ndryshime në kapital	1	3	3	1	2	10
Drejtorë dhe menaxherë të lartë dhe delegim funksioneve	22	0	40	23	5	90
Auditori i jashtëm	16		48	19	10	93
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit/ emrit	9	0	12	1	2	24
Përvetësimet e interesit të kapitalit dhe transferimi i portofolit	0	0	0	0	0	0
Zgjerim i veprimtarive financiare	1		0	0	0	1
Hapja, zhvendosja dhe mbyllja e degëve dhe zyrave brenda dhe jashtë vendit	1		11	0	0	12
Licencimi dhe regjistrimi i agentëve/brokerëve	59		0	4	12	75
Tërheqja e licencimit/regjistrimit	35		1	10	8	54
Tjetër	2		2	0	0	4
Gjithsej	146	3	117	58	40	364

Burimi: BQK (2025)

Në procesin licencues, përveç kërkesave ligjore dhe rregullatorë, BQK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit të planit të biznesit dhe vlerës së shtuar, si dhe zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për qeverisje të përgjegjshme dhe efektive duke vlerësuar strukturat e tyre organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjësive.

Gjatë vitit 2024 janë marrë vendime dhe proceduar kërkesat për miratim/refuzim paraprak, si dhe ka pasur kërkesa të tërhequra në mënyrë vullnetare nga vetë institucionet financiare. Gjithsej ka pasur 354 kërkesa,. Natyra e kërkesave të miratuara/refuzuara në vitin 2024 ishte si në vijim:

- Aplikacioni për licencim ka përfshirë një kërkesë që lidhet me ndërmjetësues në sigurime (broker), të cilët sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë miratim paraprak nga BQK-ja;
- Miratimi i 10 kërkesave për ndryshim në aksionarin kryesor dhe në kapital është kryer në përputhje me rregulloret në fuqi dhe procedurat standarde të licencimit, duke përfshirë vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ligjore dhe rregullative. Procesi ka përfshirë shqyrtimin e dokumentacionit të plotë dhe të saktë të dorëzuar nga aplikantët, analizën e ndikimit në strukturën e kapitalit dhe qëndrueshmërinë financiare të institucioneve. Në këtë kategori janë shqyrtuar një kërkesë për banka, tri për fondet pensionale, tri për IMF&IFJB, një për sigurues dhe dy për ndërmjetësues në sigurime;
- Miratimi i 90 kërkesave për ndryshime në drejtorë dhe menaxherë të lartë, si dhe delegim të funksioneve, është realizuar në përputhje me rregulloret në fuqi, duke siguruar që të gjitha aplikimet përmbushin kriteret ligjore dhe standardet profesionale të kërkuara. Ky proces përfshiu: njëzet e dy kërkesa për banka, dyzet kërkesa për IMF&IFJB, njëzet e tri kërkesa për ndërmjetësues, kërkesa për sigurues dhe pesë kërkesa për ndërmjetësues në sigurime;
- Miratimi i 24 kërkesave për ndryshime në aktet themeluese dhe statutin e institucioneve financiare është kryer në përputhje me rregulloret në fuqi, duke siguruar përputhshmërinë me kuadrin ligjor të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Procesi përfshiu shqyrtimin e dokumentacionit, vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, verifikimin e ndikimit në funksionimin e institucioneve dhe garantimin që strukturat dhe qëllimet e tyre të reflektojnë qeverisjen e mirë. Kjo kategori përfshiu: nëntë banka, dymbëdhjetë IMF&IFJB, një sigurues dhe dy ndërmjetësues në sigurime;
- Miratimi i një kërkesë për zgjerimin e veprimtarisë financiare përfshin vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, analizën e përshtatshmërisë së planit të propozuar dhe sigurinë që aktivitetet e reja janë në përputhje me kuadrin rregullativ dhe ligjor në fuqi;
- Miratimi i 75 kërkesave për licencim dhe regjistrim të agjentëve dhe brokerëve përfshinë shqyrtimin e dokumentacionit të nevojshëm, verifikimin e plotësimin të kriterëve ligjore dhe rregullatore, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale dhe integritetit të aplikantëve për të siguruar përmbushjen e standardeve të përcaktuara. Në këtë kategori janë shqyrtuar pesëdhjetë e nëntë kërkesa për banka, katër për sigurues dhe dymbëdhjetë për ndërmjetësues në sigurime;
- Miratimi i 54 kërkesave për tërheqjen e licencimit/regjistrimit të agjentëve është kryer pas një procesi të detajuar vlerësimi dhe verifikimi të plotë të dokumentacionit. Nga ky numër, për banka janë miratuar tridhjetë e pesë kërkesa, një për IMF&IFJB, dhjetë për sigurues dhe tetë për ndërmjetësues në sigurime;
- Miratimi i 4 kërkesave në kategorinë "Të tjera" është kryer sipas procedurave përkatëse të Divizionit të Licencimit.

Gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar dhe mbajtur edhe takime informuese me palë të interesuara për licencim/regjistrim si institucione financiare nga Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit.

Aplikacionet dhe kërkesat e vitit 2024 që ende nuk janë konkretizuar me aplikacion dhe që janë në proces të shqyrtimit janë 1 aplikacione/kërkesa tjera për licencim/regjistrim si institucione financiare me veprimtrine si ndërmjetësues ne sigurime dhe risigurime.

Gjithashtu, gjate vitit 2024 është përfunduar një për regjistrim vullnetar të një IFJB që aktualisht ushtron aktivitetin e shërbimit të pagesave.

3.2. Rregullimi i Institucioneve Financiare

Hartimi i akteve të reja nënligjore dhe rishikimi i kuadrit rregullativ në fuqi synon plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij, në funksion të realizimit të një mbikëqyrjeje më efektive dhe në zbatim të kërkesave ligjore për institucionet financiare të licencuara/regjistruara dhe të mbikëqyrura nga BQK, nëpërmjet përafrimit me aktet rregullative të Bashkimit Evropian dhe me parimet bazë për mbikëqyrjen efektive të institucioneve tjera relevante ndërkombëtare.

Deri më tani, BQK-ja ka ndërtuar një kornizë rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, e mbështetur në vazhdimësi nga institucione të njohura ndërkombëtare, si Grupi i Bankës Botërore (BB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), USAID, FED, Thesari Amerikan, BQE, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), KfW, GIZ dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Korniza rregullative është hartuar në pajtueshmëri me direktivat evropiane që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Gjithashtu, BQK-ja ka vazhduar me procesin gradual drejt përafrimit me parimet bazë për mbikëqyrjen e bankave, të nxjerra nga Bank for International Settlements (BIS), si dhe parimet bazë për mbikëqyrjen e siguresve të nxjerra nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Siguruimeve (International Association for Insurance Supervision - IAIS). Meqenëse, direktivat, standardet ndërkombëtare, dhe parimet e lartëcekura lidhur me rregullimin e institucioneve financiare dhe fushën e veprimtarisë së tyre janë të natyrës dinamike, kjo ndikon që hartimi i kornizës rregullative të jetë një proces i vazhdueshëm dhe kompleks pasi që kërkon plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe rregullative, si dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim adekuat të këtyre instrumenteve juridike ndërkombëtare në funksion të nevojave të sektorit financiar në Kosovë.

Në shtesë të kësaj, BQK ka nisur dhe ka kryesuar grupin për hartimin e ligjit për bankat, ligjin për shërbimin e pagesave, ndërsa po vazhdon aktivitetin për ligjin për institucionet mikrofinanciare (jo bankare). Gjithashtu, është në proces të shqyrtimit të ndryshimeve ligjore në fushën e siguruimeve - ligjin për autopërgjegjesinë, si dhe ka marrë pjesë në grupin punues për koncept dokumentin për tregjet e kapitalit i cili u miratua më 18 dhjetor 2024, nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

3.2.1 Korniza ligjore e zbatueshme për institucionet financiare⁷

3.2.1.1 Ligji i ri për Banka

BQK-ja ka nisur dhe kryesuar grupin punues për hartimin e projektligjit për bankat. Ky projektligji u miratua në Kuvendin e Kosovës më 5 dhjetor 2024. Ligji nr. 08/L-304 për bankat ka për qëllim të rregullojë aktivitetin bankar dhe financiar të bankave në Republikën e Kosovës, në funksion të nxitjes dhe mbarëvajtjes së një sistemi të qëndrueshëm financiar, duke siguruar një nivel të duhur të mbrojtjes së interesave të depozitorëve, përmes rregullimit të kritereve për themelimin dhe licencimin e bankave, organizimin dhe menaxhimin e shëndoshë të bankave,

⁷ Ligji i ri për bankat (Ligji nr. 08/L-304), Ligji për shërbimet e pagesave (Ligji nr. 08/L-328) dhe ligji i ri për PPP/FT (Ligji nr. 08/L-333) të miratuar nga Parlamenti ende nuk janë në zbatim dhe nuk janë publikuar në gazetën zyrtare, për arsye të shqyrtimit kushtetues.

mbikëqyrjes prudenciale të bankave, mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe rimëkëmbjen, përmbylljen dhe likuidimin e bankave.

Ky Ligj përbëhet nga 150 nene, të ndarë në katër kapituj dhe harmonizon kornizën ligjore për bankat në Kosovë me aktet Acquis të Bashkimit Evropian, si në vijim:

Rregullorja mbi kërkesat prudenciale për institucionet kreditore dhe shoqëritë investuese (Rregullore 575/2013/EU, duke ndryshuar dhe plotësuar Rregulloren 648/2012/EU).

Direktiva për qasje në veprimtarinë e institucionit kreditor dhe mbikëqyrja prudenciale e institucionit kreditor dhe shoqërisë investuese.⁸

Direktiva për themelimin e kornizës së rimëkëmbjes dhe përmbylljes së institucioneve kreditore dhe shoqërive investuese.⁹

Ky Ligj do të zbatohet për të gjitha bankat, përfshirë degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, aksionarët e tyre, bordin e drejtorëve, menaxherët e lartë, punonjësit, agjentët dhe filialet e tyre, si dhe zbatohet për aspektet e kontabilitetit dhe sistemit të raportimit financiar të bankave, përfshirë kërkesat e auditimit.

3.2.1.2 Ligji i ri për Shërbimet e Pagesave

Ligji nr.08/L-328 për Shërbimet e Pagesave u miratua në Kuvendi e Republikës, më 5 dhjetor 2024. Ky ligj ofron një kornizë të përgjithshme për shërbimet e pagesave dhe aktivitetet e ndërlidhura brenda Kosovës, për ta harmonizuar kornizën ligjore kombëtare me direktivat dhe rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian, bazuar në zotimet ndërkombëtare të Kosovës nën Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit të nënshkruar me Bashkimin Evropian. Në përmbushje të këtyre zotimeve, Ligji për Shërbimet e Pagesave, ka për qëllim transpozimin e direktivave të rëndësishme për fushën e pagesave, si në vijim:

4.1. Direktiva (BE) 2015/2366 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 nëntor 2015 “për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”;

4.2. Direktiva (BE) 2009/110/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shtator 2009 “për marrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen prudenciale të punës së institucioneve të parasë elektronike”;

4.3. Direktiva (BE) 2014/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 korrik 2014 “për krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, ndërrimin e llogarisë së pagesës dhe qasjen në llogarinë e pagesës”;

4.4. Rregullorja (BE) 2015/751 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datës 29 prill 2015 “Për tarifën e shkëmbimit për transaksionet e bazuara në kartela”; dhe

4.5. Rregullorja (BE) 2024/886 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 Mars 2024, që amandamenton Rregulloren (BE) 260/2012 dhe (BE) 2021/1230 dhe Direktivën (BE) 98/26/EC dhe (BE) 2015/2366 lidhur me transferet e menjëhershme kreditore në euro.

Ligji për Shërbimet e Pagesave synon të rregullojë ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe emetimin e parasë elektronike në Kosovë, duke krijuar një kornizë të integruar dhe të qartë ligjore për sektorin financiar. Nëpërmjet këtij Ligji, përcaktohen subjektet e autorizuara për të ofruar këto shërbime. Ligji vendos kriteret e detajuara për autorizim dhe mbikëqyrje për institucionet financiare që ofrojnë shërbime të pagesave, duke caktuar se roli mbikëqyrës i takon BQK-së, e cila

⁸ Direktiva 2013/16/EU, duke ndryshuar dhe plotësuar Direktivën 2002/87/EC, dhe duke shfuqizuar Direktivën 2006/48/EC dhe 2006/49/EC

⁹ Direktiva 2014/59/EU, duke ndryshuar dhe plotësuar Direktivën 82/891/EEC, 2001/24/EC, 2002/47/EC, 2004/25/EC, 2005/56/EC, 2007/36/EC, 2011/35/EU, 2012/30/EU dhe 2013/36/EU, si dhe Rregulloren 1093/2010/EU dhe 648/2012/EU

ka të drejtë të mbikëqyrë aktivitetet e institucioneve përkatëse në mënyrë të vazhdueshme. Ligji thekson rëndësinë e transparencës në mënyrën e ekzekutimit të transaksioneve, të cilat kryhen në një ambient të sigurt dhe të besueshëm, duke vendosur rregulla të qarta për procedurat e pagesave, menaxhimin e rreziqeve dhe ruajtjen e të dhënave. Gjithashtu, ligji përcakton mekanizmat për zgjidhjen e ankesave dhe parandalimin e shkeljeve, duke përfshirë masat administrative që zbatohen në rast të mosrespektimit të normave të vendosura.

3.2.1.3 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit

Ligji Nr. 08/L-333 plotëson dhe ndryshon Ligjin Nr. 05/L-096, u miratua në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 5 dhjetor 2024, me qëllim që të përafrojë më tej kuadrin ligjor të Kosovës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me Direktivat e BE-së për PPF dhe me standardet FATF. Ky akt normativ përbën pjesë thelbësore të një kuadri juridik gjithëpërfshirës, i krijuar për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Sipas dispozitave të tij, subjektet raportuese janë të detyruara të aplikojnë masa të forta të dilijencës së klientit, duke përfshirë verifikimin e identitetit dhe përcaktimin e pronarit përfitues. Në varësi të vlerësimit të rrezikut, për skenarët me rrezik të ulët mund të zbatohet një dilijencë e thjeshtuar, ndërsa rastet me rrezik të lartë kërkojnë monitorim të vazhdueshëm dhe azhurnim të informacionit. Gjithashtu, çdo transaksion i dyshimtë duhet të raportohet brenda 24 orëve, ndërsa çdo transaksion me para që arrin ose tejkalon pragun prej dhjetë mijë euro (ose ekuivalenti) duhet të raportohet menjëherë. Gjithashtu ky Ligj përfshin dispozitë mbrojtëse që mbron subjektet raportuese, drejtorët, menaxhertë e lartë dhe punonjësit nga përgjegjësia civile ose penale kur raportojnë në mirëbesim. Në këtë mënyrë, amendamentimi sipas Ligjit Nr. 08/L-333 forcon angazhimin e Republikës së Kosovës në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke krijuar një mjedis rregullator më të fortë, të bazuar në një qasje të vlerësimit të rrezikut, dhe duke përafuar kuadrin juridik me standardet ndërkombëtare. Ky ligj transpozon Direktivën (BE) 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018 që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, si dhe ndryshimin e Direktivave 2009/138/KE dhe 2013/36/BE.

3.2.1.4 Koncept-Dokumentit për Zhvillimin e Tregut të Kapitalit

Me datën 18 dhjetor 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Koncept-Dokumenti për Zhvillimin e Kornizës Rregullatore për Tregjet e Kapitalit. Ky dokument konceptual synon të zhvillojë një kornizë rregullatore gjithëpërfshirëse për tregjet kapitale në Kosovë, me qëllim të rritjes së qasjes në financim afatgjatë për bizneset si dhe nxitjen e investimeve. Dokumenti identifikon mangësitë aktuale në legjislacionin ekzistues, veçanërisht në fushën e emetimit, regjistrimit dhe transferimit të letrave me vlerë, si dhe mungesën e rregullave për mbrojtjen e investitorëve dhe parandalimin e abuzimeve në treg.

Në këtë kontekst, janë propozuar tri opsione; ndër të cilat opsioni 3 – adoptimi i një kornize gjithëpërfshirëse rregullatorë, rekomandohet për të mbuluar:

- Zhvillimin e një tregu të obligacioneve korporative,
- Krijimin e një legjislacioni të ri për tregjet kapitale që të përcaktojë aktivitetet financiare dhe të sigurojë transparencë,
- Krijimin e një kornize për fondet investuese bazuar në standardet e BE-së (si UCITS dhe AIFMD).

Procesi konsultativ përfshiu institucione kyçe, përfshirë BQK-në, Kryeministrinë dhe Ministrinë e Financave, si dhe pjesëmarrës publikë, duke garantuar një reflektim të gjerë të interesave. BQK

ka marrë pjesë aktive në hartimin e këtij dokumenti, duke deleguar një anëtar në grupin punues, në përputhje me rolin e saj kushtetues e ligjor në rregullimin dhe standardizimin e kornizës ligjore financiare.

Implementimi i kësaj kornize pritet të sjellë përfitime ekonomike dhe sociale, duke rritur konkurrueshmërinë, inovacionin dhe krijimin e vendeve të punës, si dhe do të forcojë bazën për zhvillimin e infrastrukturës së tregjeve kapitale në Republikën e Kosovës.

3.2.1.5 Draft Ligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Jobankare

Gjatë vitit 2024 ka vazhduar aktiviteti i draftimit të Ligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Jobankare si dhe Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

3.2.2 Korniza rregulative për mbikëqyrjen e bankave

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregulative për rregullimin e bankave, gjatë vitit 2024 janë realizuar aktivitetet si në vijim:

3.2.2.1 Rregullorja për rrezikun e vendit dhe rrezikun e transferit

Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2024, ka miratuar këtë rregullore që synon të krijojë një kornizë të unifikuar për menaxhimin e rreziqeve të vendit dhe transferit. Qëllimi i saj është të sigurojë që bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara në Republikën e Kosovës të operojnë në bazë të standardeve të përcaktuara, duke përfshirë përcaktimin e rrezikut të vendit që i referohet mundësisë ose rrezikut që një huamarrës i huaj (shtetëror ose tjetër) të mos jetë në gjendje ose mos të dëshirojë të përmbushë obligimet për shkak të kushteve specifike të vendit, që mund të jenë ekonomike, politike, sociale, natyrore ose ngjarje tjera, si dhe rrezikun e transferit që është një nga rreziqet e vendit.

3.2.2.2 Rregullorja për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave

Kjo rregullore përcakton kriterin "i/e përshtatshëm dhe i/e duhur" për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave, duke kërkuar miratimin paraprak të Bankës Qendrore (BQK) gjatë procesit të licencimit dhe riemërimit, me qëllim që të ruhet integriteti, gjykimi i shëndoshë, udhëheqja, kompetenca dhe qëndrueshmëria financiare e tyre.

3.2.2.3 Aktet nënligjore në proces të draftimit për bankat

Derisa është hartuar një letër këshilluese për menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore në kuadër të projektit me Bankën Botërore (FinSAC), gjatë vitit 2024, ka vazhduar aktiviteti i draftimit të rregulloreve në fushën e bankave lidhur me auditimin dhe kontrillin e brendshëm, likuiditetin, qeverisjen korporative, sistemet e informacionit dhe menaxhimin të rrezikut, dhe legjislacionin tjetër i nevojshëm për avancimin e sektorit.

3.2.3 Korniza rregulative për siguresit

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregulative të siguresve dhe ndërmjetësuesve në sigurime, gjatë vitit 2024 janë hartuar aktet ligjore dhe nënligjore, si më poshtë:

3.2.3.1. Rregullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të siguresve

Rregullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të siguresve përcakton standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga siguresit në Republikën e Kosovës, në mënyrë që të sigurohet mbajtja e aseteve likuide të cilësisë së lartë, të cilat mund të shndërrohen lehtë në para të gatshme për përmbushjen e detyrimeve financiare afatshkurtra.

3.2.3.2. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Aktuarët e Sigurimeve

Kjo rregullore, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 29 mars 2024, ka për qëllim të plotësojë, ndryshojë dhe harmonizojë Rregulloren për Aktuarët e Sigurimeve (rregullorja bazë), e miratuar më 31 mars 2016. Ky plotësim dhe ndryshim synon të përmirësojë cilësinë e praktikave

aktuariale në sektorin e sigurimeve. Ndryshimi kryesor përfshin shtimin në nenin 14 të rregullores bazë të një dispozite që ndalon angazhimin e një aktuari për të kryer veprime aktuariale tek më shumë se dy sigurues njëkohësisht.

3.2.3.3. Rregullore për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit

Rregullore për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit u miratuar më 30 prill 2024 nga Bordi i Bankës Qendrore. Rregullorja e miratuar përcakton kërkesat që siguruesit duhet të ndjekin për mbajtjen e rrezikut dhe mbulimin përmes risigurimit, në rast se rreziku i siguruar tejkalon kufirin maksimal prej 10% të kapitalit të tyre themeltar.

3.2.3.4. Rregullore për transaksionet me personat e ndërlidhur të siguruesve

Kjo rregullore e cila u miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 17 dhjetor 2024, përcakton parimet dhe kërkesat që siguruesit e licencuar duhet të zbatojnë në transaksionet me personat e ndërlidhur me ta.

3.2.3.5 Aktet nënligjore në proces të draftimit për siguruesit

Gjatë vitit 2024, ka vazhduar aktiviteti i draftimit të rregulloreve në fushën e sigurimeve lidhur me menaxhimin e rrezikut operacional të siguruesve, auditimin e brendshëm të siguruesve, qeverisjen korporative të siguruesve, licencimin e siguruesëve dhe degëve siguruesëve të jashtëm dhe akte tjera të nevojshme për sektorin.

3.2.4 Korniza Rregullative për Fondet Pensionale

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës ligjore dhe rregullative të fondeve pensionale gjatë vitit 2024 janë hartuar aktet nënligjore, si në vijim:

3.2.4.1 Rregullore për Sistemet dhe Sigurinë e Informacionit për Fondet Pensionale

Me datë 28 shkurt 2024, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren për Sistemet dhe Sigurinë e Informacionit për Fondet Pensionale. Kjo rregullore për Sistemet dhe Sigurinë e Informacionit për Fondet Pensionale përcakton kriteret dhe kushtet minimale që fondet duhet të plotësojnë për organizimin dhe funksionimin e sistemeve të tyre të teknologjisë së informacionit. Qëllimi kryesor është të ulë rrezikun operacional që mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i sistemeve të TI-së, duke garantuar besueshmërinë dhe vazhdimësinë e operacioneve të fondit.

3.2.4.2 Aktet nënligjore në proces të draftimit

Gjatë vitit 2024, ka vazhduar aktiviteti i draftimit të rregulloreve në fushën e pensioneve lidhur me kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm për Fondet Pensionale dhe Qeverisjen Korporative të Fondeve Pensionale.

3.2.5 Korniza rregullative për Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e institucioneve mikrofinanciare dhe jo bankare, gjatë vitit 2024 janë hartuar draft aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë, miratimi i të cilave do varet nga përputhshmëria me ligjin e ri, aty ku do të ketë ndryshime.

3.2.5.1 Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Auditimin e Jashtëm të Institucioneve Mikrofinanciare

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për auditimin e jashtëm të IMF synon të azhurnojë rregulloren bazë të miratuar më 29 gusht 2013. Ndryshimet kryesore përcaktojnë që punësimi i njëjtë i auditorit të jashtëm të jetë i kufizuar në pesë vite të njëpasnjëshme, me mundësi rinovimi vetëm pas një ndërprerjeje prej dy vjetësh, ndërsa auditorët aktualisht të angazhuar nga BQK nuk mund të tejkalojnë periudhën pesëvjeçare që fillon me datën e angazhimit të tyre të parë. Gjithashtu, auditorët duhet të përmbushin kërkesat ligjore për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, duke siguruar kështu pavarësinë e tyre, ndërsa të gjitha dispozitat e tjera të

rregullores bazë mbeten të vlefshme. Kjo rregullore konsiderohet pjesë përbërëse e rregullores bazë dhe ka hyrë në fuqi më 30 gusht 2024.

3.2.5.2 Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Kontrollin e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Institucioneve Mikrofinanciare

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për Kontrollin e Brendshme dhe Funksionimin e Auditimit të Brendshëm të Institucioneve Mikrofinanciare, ka përqëllim azhurnimin e rregullores bazë të miratuar më 29 gusht 2013. Ky akt rregullativ përcakton se udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në nenin 12 të rregullores për Regjistrimin e Institucioneve Mikrofinanciare, të jetë i certifikuar në fushën e auditimit nga një institucion i akredituar në Kosovë, i njohur ndërkombëtarisht, ose nga një institucion i akredituar nga organi kompetent në vendin e themelimit të shërbimeve të certifikimit, të ketë reputacion të lartë etik dhe profesional si dhe përvojë adekuate në auditim. Institucionet mikrofinanciare janë të detyruara të përmbushin këto kërkesa brenda një afati prej dy vjetësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore, ndërsa të gjitha dispozitat e tjera të rregullores bazë mbeten në fuqi, me efekt nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore më 1 mars 2025, duke u konsideruar pjesë integrale e saj.

3.2.5.3 Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Auditimin e Jashtëm të Institucioneve Financiare Jobankare

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për auditimin e jashtëm të IFJB-ve synon të azhurnojë rregulloren bazë të miratuar më 27 dhjetor 2018. Ndryshimet kryesore përcaktojnë që punësimi i njëjtë i auditorit të jashtëm të jetë i kufizuar në pesë vite të njëpasnjëshme, me mundësi rinovimi vetëm pas një ndërprerjeje prej dy vjetësh, ndërsa auditorët aktualisht të angazhuar nga BQK nuk mund të tejkalojnë periudhën pesëvjeçare që fillon me datën e angazhimit të tyre të parë. Gjithashtu, auditorët duhet të përmbushin kërkesat ligjore për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, duke siguruar kështu pavarësinë e tyre, ndërsa të gjitha dispozitat e tjera të rregullores bazë mbeten të vlefshme. Kjo rregullore konsiderohet pjesë përbërëse e rregullores bazë dhe ka hyrë në fuqi më 30 gusht 2024.

3.2.5.4 Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Kontrollin e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Institucioneve Financiare Jobankare

Kjo rregullore, që plotëson dhe ndryshon rregulloren bazë të miratuar më 27 dhjetor 2018, përcakton se udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet të plotësojë kërkesat e nenit 12 të rregullores për regjistrimin e institucioneve financiare jobankare, të jetë i certifikuar ai auditor nga institucione të akredituara në Kosovë, i njohur ndërkombëtarisht, ose nga institucione të akredituara nga organet kompetente, dhe të ketë një reputacion të lartë etik dhe profesional, si dhe kualifikime dhe përvojë adekuate në fushën e auditimit. Gjithashtu, në këtë rregullore përcaktohet se institucionet financiare jobankare duhet të përmbushin kërkesat e kësaj rregullore brenda një afati prej dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi, ndërsa të gjitha dispozitat e tjera të rregullores bazë mbeten në fuqi.

3.2.5.5 Aktet nënligjore në proces të draftimit për Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare

Gjatë vitit 2024, ka vazhduar aktiviteti i draftimit të rregulloreve në fushën e institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare që lidhen me qeverisjen korporative, menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, dhe rregullartivë tjetër relevante për sektorin e institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare.

3.2.6 Rregulloret sipas Ligjit të ri për Shërbimet e Pagesave, të domosdoshme për aplikim për anëtarësim në SEPA

Republika e Kosovës, nëpërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), ka paraqitur aplikimin e saj paraprak për përfshirje brenda fushës gjeografike të Zonës së Vetme të Pagesave

në Euro (SEPA). Ky aplikim paraprak përfaqëson një pikë kthese të rëndësishme në udhëtimin e integritimit evropian të Kosovës, duke reflektuar përkushtimin e Republikës së Kosovës të vazhdueshëm për të përputhur kornizën financiare dhe rregullatore me standardet e Bashkimit Evropian (BE). Për këtë qëllim Republika e Kosovës e në veçanti BQK ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmirësuar kornizën ligjore, institucionale dhe rregullatore për shërbimet e pagesave përmes reformave gjithëpërfshirëse.

BQK ka demonstruar vazhdimisht përkushtimin e saj për të përputhur legjislacionin me standardet dhe rregulloret e BE-së, dhe ndryshimet e fundit legjislative në fushat e shërbimeve të pagesave, parandalimit të pastrimit të parave (PPP), luftimit të financimit të terrorizmit (LFT), mbrojtjes së konsumatorit dhe të të dhënave. Me rregullativën e përgatitur nga BQK është siguruar që sistemi ynë financiar të jetë në përputhje me direktivat kryesore të BE-së, përfshirë Direktivat për Shërbimet e Pagesave (PSD2), Direktivat dhe Rregulloret për Kërkesat e Kapitalit (CRD IV, CRR), Direktivat për Paratë Elektronike (EMD2), Direktivat për Llogaritë e Pagesave (PAD), Rregulloret e BE-së për Tarifatat e Shkëmbimit (IFR) dhe kornizën më të gjerë të PPP/LFT të BE-së. Rregulloret e hartuara për këtë qëllim janë të listuara si më poshtë dhe do të hynë në fuqi në momentin që Ligji nr. 08/L-328 për shërbimet e pagesave hynë në fuqi.

3.2.6.1 Rregullore për administrimin zyrtar dhe likuidimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë procedurat e administrimit zyrtar dhe likuidimit të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha institucionet e pagesave (IP) dhe institucionet e parasë elektronike (IPE) të autorizuara, në pajtim me Ligjin për Shërbimet e Pagesave, për të operuar në Republikën e Kosovës.

Rregullorja për administrimin zyrtar dhe likuidimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike përmban 24 nene dhe rregullojnë çështjet si në vijim:

- Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit Zyrtar
- Kompetencat dhe detyrat e Administratorit Zyrtar
- Procedurat e administrimit zyrtar nga marrja e kontrollit e deri te përfundimi i procesit të administrimit
- Llojet e likuidimit (Likuidimi vullnetar dhe i detyruar)
- Bazat për fillimin e likuidimit të detyruar, kompetencat e likuidatorit dhe afatet kohore

3.2.6.2 Rregullore për agjentët e ofruesve të shërbimeve të pagesave

Qëllimi i kësaj draft-rregullore është të përcaktojë kërkesat dhe rregullojë përdorimin e agjentëve të ofruesve të shërbimeve të pagesave. Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të autorizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe agjentët e tyre në Republikën e Kosovës.

Sipas nenit 2 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të kësaj draft-rregullore, ofrues i shërbimeve të pagesave nënkupton institucionet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 1 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave ose personin fizik ose juridik që përfiton nga përjashtimi sipas neneve 24 ose 25 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave (bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike).

Rregullorja për agjentët e ofruesve të shërbimeve të pagesave është i ndarë në tre kapituj dhe 18 nene dhe rregullon çështjet si në vijim:

- Dispozitat e përgjithshme;

- Regjistrimin e agjentëve, revokimin e regjistrimit të agjentëve, regjistrimin publik të agjentëve si dhe miratimet paraprake; dhe
- Kërkesat për përdorimin e agjentëve nga ofruesit e shërbimit të pagesave.

16.2.6.3 Rregullore për autorizimin, miratimin paraprak dhe qeverisjen e institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike si dhe regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë

Qëllimi i rregullores për autorizimin, miratimin paraprak dhe qeverisjen e institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike si dhe regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet kohore që duhen respektuar për:

- autorizimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike;
- regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë;
- informacionet që duhet t'i ofrohen Bankës Qendrore të Kosovës me rastin e aplikimit për autorizim si institucion pagesash ose institucion i parasë elektronike dhe për regjistrim si ofrues i shërbimeve të informacionit të llogarisë në pajtim me nenin 12 paragrafi 1, nenin 25 paragrafi 1 dhe nenin 29 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
- dhënien e miratimeve paraprake për transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK-ja për kryerjen e aktivitetit të institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë;
- obligimet e institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë për të njoftuar BQK-në gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre.
- organizimin, menaxhimin dhe administrimin e institucionit të pagesave, institucionit të parasë elektronike dhe ofruesit të shërbimeve të informacionit të llogarisë.

3.2.6.4 Rregullore për kapitalin fillestar dhe kapitalin rregullativ të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë kërkesat e kapitalit të zbatueshme për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, në përputhje me nenin 9, nenin 10, pikat 1 dhe 3, nenin 30 dhe nenin 31, paragrafët 1, 2 dhe 7 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave. Kjo rregullore do të zbatohet për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të autorizuar nga BQK sipas Projektligjit për Shërbimet e Pagesave.

Përmbajtja:

- Rregullore për kapitalin fillestar dhe kapitalin rregullativ të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike është i ndarë në 8 nene dhe rregullon çështjet si në vijim:
- Kapitalin fillestar të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike;
- Kapitalin rregullativ (own funds) të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike si dhe metodat për kalkulimin e tyre;

3.2.6.5 Rregullore për kontabilitet dhe auditim të jashtëm të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kornizën rregullative që ka të bëjë me kontabilitetin dhe auditorët e jashtëm të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike dhe të përcaktojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga auditorët e jashtëm në raport me rreziqet specifike të këtyre institucioneve dhe të sektorit financiar në përgjithësi.

Kjo rregullore përcakton kushtet për raportimin financiar dhe auditimin e Institucioneve të Pagesave dhe Institucioneve të Parasë Elektronike.

3.2.6.6 Rregullore për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë parimet bazë për organizimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme dhe funksionin e auditimit të brendshëm brenda institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike. Kjo rregullore për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike është i ndarë në dy pjesë kryesore, kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm, dhe në 12 nene të cilat rregullojnë çështjet si në vijim:

- Kërkesat për sistemin e kontrolleve të brendshme;
- Aktivitetet e kontrollit dhe ndarja e detyrave;
- Monitorimi i aktiviteteve dhe korrigjimi i mangësive;
- Funksioni i auditimit të brendshëm;
- Nënkontraktimi i jashtëm i auditimit të brendshëm.

3.2.6.7 Rregullore për kërkesat e mbrojtjes së fondeve të aplikueshme për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike

Rregullore për kërkesat e mbrojtjes së fondeve të aplikueshme për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike ka për qëllim të përcaktojë kërkesat për mbrojtje të fondeve nga institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike në përputhje me nenin 11 nënparagrafin 1.1, nenin 33 paragrafin 3, nenin 29 paragrafin 3, dhe nenin 124 nënparagrafi 8.4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

Rregullorja për kërkesat e mbrojtjes së fondeve të aplikueshme për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike është i ndarë në 8 nene dhe rregullon çështjet si në vijim:

Kjo rregullore përcakton kërkesat për ruajtjen e fondeve nga Institucionet e Pagesave dhe Institucionet e Parasë Elektronike në Kosovë. Ajo siguron që Institucionet e Pagesave dhe Institucionet e Parasë Elektronike në Kosovë të mbrojnë fondet e përdoruesve duke i mbajtur në llogari të ndara ose përmes polisës së sigurimeve, duke parandaluar përzierjen e tyre me fondet e institucionit.

Rregullorja synon të rrisë sigurinë dhe besueshmërinë e transaksioneve financiare duke siguruar që fondet e përdoruesve të jenë gjithmonë të mbrojtura në mënyrë adekuate.

3.2.6.8 Rregullore për nënkontraktimin e aktiviteteve

Kjo rregullore rregullon nënkontraktimet e aktiviteteve, duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të rrezikut, në lidhje me funksionet e nënkontaktuara, në veçanti për nënkontraktimin e funksioneve kritike ose të rëndësishme.

Rregullore për nënkontraktimin e aktiviteteve është e ndarë në 6 kapituj dhe 30 nene të cilat rregullojnë çështjet si në vijim:

- Dispozitat e përgjithshme;
- Proporcionaliteti, aplikimi në grup dhe skemat e mbrojtjes institucionale;
- Menaxhimi i nënkontraktimit të aktiviteteve;
- Rregullimi i procesit të nënkontraktimit të aktiviteteve;

- Detyrimin për miratim paraprak të nënkontraktimit të aktiviteteve; si dhe
- Dispozitat përfundimtare në të cilat është paraparë edhe periudha kalimtare prej 24 muajve;

3.2.6.9 Rregullore për regjistrin publik të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike

Qëllimi i kësaj rregullore është krijimi i regjistrit publik të institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike dhe agentëve të këtyre institucioneve në përputhje me nenin 18 të Projektligjit për Shërbimet e Pagesave.

Rregullore për regjistrin publik të institucioneve të pagesave dhe parasë elektronike është e ndarë në 4 kapituj dhe 11 nene të cilat rregullojnë çështjet si në vijim:

- Dispozitat e përgjithshme;
- Përmbajtjen e regjistrit publik, institucionet/personat që duhet përfshirë në të;
- Institucionet që vetëm duhet të regjistrohen në këtë regjistër; si dhe
- Dispozitat përfundimtare.

3.2.6.10 Rregullore për periudhën kalimtare për zbatimin e ligjit për shërbimet e pagesave

Rregullorja për periudhën kalimtare për zbatimin e ligjit për shërbimet e pagesave përbëhet nga 6 nene që rregullojnë çështjen e periudhës kalimtare të zbatueshme për subjektet dhe personat që i nënshtrohen Ligjit për shërbimet e pagesave. Qëllimi kryesor është të sigurohet që këto entitete të përshtatin operacionet e tyre për të përmbushur kërkesat e ligjit të ri, veçanërisht duke pasur parasysh faktin që Kosova së shpejti pritet të bashkohet me Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) dhe t'u mundësojë ofruesve kombëtar të marrin pjesë në skemat SEPA. Rregullorja kërkon që të gjithë ofruesit e autorizuar ose të regjistruar të shërbimeve të pagesave, përfshirë bankat dhe institucionet e parasë elektronike, të përshtatin aktivitetet e tyre me Kapitujt III dhe IV të Ligjit mbi Shërbimet e Pagesave.

3.2.6.11 Rregullore për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe transaksionet për debitimet direkte në euro

Kjo rregullore përcakton kërkesat për transaksionet e kreditit dhe të debitimit direkt të kryera në valutën Euro brenda Kosovës dhe ndërmjet Kosovës dhe zonës SEPA, ku si Ofruesi i Shërbimit të Pagesave (OSHP) e paguesit ashtu edhe OSHP-ja e përfituesit janë të vendosura në Kosovë ose një nga OSHP-të ndodhet në Kosovë dhe tjetri brenda zonës SEPA, ose ku i vetmi OSHP i përfshirë në transaksionin e pagesës ndodhet në Kosovë

Kjo rregullore përputhet me Rregulloren e BE-së SEPA, duke vendosur kërkesa uniforme teknike dhe afariste për transaksionet në euro në Kosovë

3.2.6.12 Rregullore për kriteret e përcaktimit të shumës minimale monetare të sigurimit të përgjegjësive profesionale ose garancive të tjera të ngjashme

Rregullorja për kriteret e përcaktimit të shumës minimale monetare të sigurimit të përgjegjësive profesionale ose garancive të tjera të ngjashme specifikon kriteret dhe treguesit se si të përcaktohet shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësive ose garancive të tjera të ngjashme për subjektet që aplikojnë për autorizim si ofrues të shërbimit të inicimit të pagesës (SHIP) ose regjistrim si ofrues të shërbimit të informacionit të llogarisë (SHILL).

Draft rregullorja jep udhëzime drejtuar autoriteteve kompetente për kriteret se si të përcaktohet minimumi i shumës monetare të sigurimit të dëmshpërblimit profesional (PII) ose garanci të tjera të krahasueshme për dy shërbime të reja të përcaktuara në LSHP: shërbimet e inicimit të pagesave (SHIP) dhe informacioni i llogarisë shërbimet (SHILL). Rregullorja përmban edhe Shtojcën I, për

llogaritjen e shumës minimale monetare të sigurimit të përgjegjësive profesionale ose garancive të ngjashme.

3.2.6.13 Rregullore për Teknologjinë e informacionit dhe komunikimit - menaxhimi i rrezikut të teknologjisë informative dhe sigurisë

Rregullore për Teknologjinë e informacionit dhe komunikimit - menaxhimi i rrezikut të teknologjisë informative dhe sigurisë, përmban përditësime gjithëpërfshirëse për kuadrin e menaxhimit të rrezikut të teknologjisë informative dhe sigurisë në institucionet financiare duke specifikuar proceset dhe kornizat që institucionet mund përdorin për të menaxhuar në mënyrë efektive sigurinë dhe rreziqet e privatësisë për operacionet organizative dhe asetet, individët dhe organizatat e tjera me theks të veçantë komunikimin ndërmjet udhëheqësve të lartë, menaxherët dhe personelit operacional.

3.2.6.14 Rregullore për ta njoftuar Bankën Qendrore të Kosovës për incidente madhore operacionale apo të sigurisë

Rregullorja sqaron se cilat incidente duhet të klasifikohen si incidente madhore nga OSHP-ë, rregullon procesin e njoftimit duket specifikuar përmbajtjen në raportin fillestar, të ndërmjetëm dhe përfundimtar, raportimin e deleguar dhe të konsoliduar dhe politikat operative dhe të sigurisë që OSHP-të duhet t'i sigurojnë lidhur me përgjegjësitë për raportimin e incidenteve. Rregullorja përmban edhe Shtojcën I, për raportimin për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe Shtojcën II - Udhëzimet drejtuar autoriteteve kompetente (BQK) për kriteret për vlerësimin e rëndësisë së incidentit dhe detajet e raporteve të incidentit që duhet të ndahen me autoritetet e tjera vendore.

3.2.6.15 Rregullore për standardet teknike për autentifikim të thelluar të klientit dhe standardet e hapura, të përbashkëta dhe të sigurta të komunikimit

Rregullorja për standardet teknike për autentifikim të thelluar të klientit dhe standardet e hapura, të përbashkëta dhe të sigurta të komunikimit, rregullon kërkesat e përgjithshme për autentifikimin që OSHP-të i përdorin si mekanizma funksionale të monitorimit të transaksioneve që u mundësojnë zbulimin e transaksioneve të pagesave të paautorizuara ose mashtruese me qëllim të zbatimit të masave të sigurisë.

Për më tepër kjo rregullore përfshin procesin e rishikimi të masave të sigurisë, kodin e autentifikimit, lidhjet dinamike, kërkesat e elementeve të kategorizuara si njohuri dhe posedim dhe aspektet tjera teknike lidhur me kërkesat rreth elementeve të autentifikimit.

Gjithashtu, rregullorja, sqaron edhe pjesën kur OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit, nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në nenin 3.

3.2.6.16 Rregullore për procesin e trajtimit të ankesave nga institucionet financiare

Kjo rregullore synon të përcaktojë kriteret dhe procedurat për themelimin e funksionit të brendshëm të trajtimit dhe menaxhimit të ankesave të klientëve nga institucionet financiare të licencuara, të cilat mbikëqyren nga BQK. Ai parashikon që çdo institucion financiar të krijojë një mekanizëm të pavarur dhe të paanshëm, në mënyrë që të trajtohen ankesat në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, duke siguruar zgjidhje në kohë për çështjet e paraqitura. Për këtë qëllim, rregullorja vendos udhëzime të hollësishme për parashtrimin e ankesave nëpërmjet mjetëve të ndryshme komunikimi (online, telefon, letër, e-mail, media sociale ose personalisht), për konfirmimin e pranimit të tyre, për regjistrimin në një bazë elektronike me numër unik identifikimi, si dhe për respektimin e afateve të caktuara që, në përgjithësi, përcaktojnë zgjidhjen e ankesave brenda 15 ditëve, me afate më të shpejta për disa raste specifike

3.2.6.17 Rregullore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Rregullore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit synon të përcaktojë kriteret dhe procedurat për menaxhimin e procesit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-096. Rregullorja zbatohet për të gjitha institucionet financiare, përfshirë bankat, degët e bankave të huaja, institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare, ofruesit e shërbimeve të pagesave, siguruesit dhe zyrat e këmbimit të valutave. Ajo përcakton përkufizimet kryesore, si menaxher i lartë, shërbimet financiare, NJIF-K, bankë guaskë, pagesë përmes llogarisë dhe rezidentin. Për më tepër, rregullorja thekson rëndësinë e trajnimit të rregullt të stafit dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

3.2.6.18 Rregullore për informacionet që duhet të shoqërojnë transferet e fondeve

Kjo rregullore e miratuar nga Bordi i BQK-së më 26 qershor 2024, përcakton rregullat për informacionet që duhet të shoqërojnë transferet e fondeve, për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Rregullorja synon të sigurojë që çdo transfer, në çfarëdo valute, të përfshijë informacion të plotë mbi paguesin dhe përfituesin, sipas kërkesave të përcaktuara në ligjet përkatëse. Në rast se transferi kryhet nga një llogari pagese, informacioni i nevojshëm përfshin emrin, numrin e llogarisë, adresën dhe të dhëna të tjera identifikuese, ose një identifikues unik të transaksionit. Për transfere që nuk kryhen nga llogaria pagese, ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të verifikojnë saktësinë e informacionit duke përdorur dokumente ose të dhëna nga burime të besueshme.

3.2.7 Aktivitete tjera rregullative

Aktivitete tjera që mund të veçohen gjatë vitit 2024 janë:

Aktivitetet rreth raporteve, pyetësorëve dhe dokumenteve tjera të ndryshme, të pranuar nga Komisioni Europian, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe organizatat tjera ndërkombëtare;

Analizimi dhe përgatitja e përgjigjeve lidhur me kërkesat për opinione të institucioneve financiare dhe njërive organizative brenda Mbikëqyrjes Financiare në BQK, sa i përket pajtueshmërisë së veprimeve të institucioneve financiare me kërkesat rregullative; etj.

3.3. Aktiviteti i BQK-së në fushën ligjore dhe të pajtueshmërisë

Në kuadër të përmbushjes së mandatit të saj për garantimin e stabilitetit financiar, si dhe për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka zhvilluar dhe miratuar kornizën ligjore përkatëse gjatë vitit 2024. Aktivitetet ligjore kanë përfshirë hartimin dhe zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe realizimin e një sërë veprimesh të tjera ligjore me qëllim forcimin e një sistemi financiar të qëndrueshëm dhe efikas.

Në këtë drejtim, BQK ka vijuar me avancimin e kornizës ligjore në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare, duke miratuar dhe zbatuar legjislacionin kyç për zhvillimin e sektorit financiar. Në këtë kontekst, janë hartuar dhe miratuar akte rregullatore sekondare të nevojshme për rregullimin e institucioneve financiare dhe ofrimin e shërbimeve të pagesave, duke siguruar harmonizimin me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe përgatitjen për integrimin e sektorit financiar të Kosovës në tregun financiar të BE-së.

Miratimi i tri ligjeve kyçe për zhvillimin e sektorit financiar në vend – Ligjit nr. 08/L-304 për Bankat, Ligjit nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave dhe Ligjit nr. 08/L-333 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit – ka krijuar bazën ligjore për hapat e mëtejshëm drejt anëtarësimit të Republikës

së Kosovës në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA). Këto ligje, të cilat janë plotësisht të harmonizuara me *acquis*-në e Bashkimit Evropian, u miratuan nga Kuvendi i Kosovës më 5 dhjetor 2024. Hyrja në fuqi e tyre mundëson integrimin e sektorit financiar të Kosovës në tregun financiar të Bashkimit Evropian, duke kontribuar në rritjen e transparencës, gjithë përfshirjes financiare dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Përveç kësaj, janë ndërmarrë hapa konkretë për përgatitjen e kornizës ligjore të nevojshme për zgjerimin e fushëveprimit gjeografik të SEPA-së, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentet përkatëse. Është hartuar dhe opinioni ligjor për aplikacionin SEPA, i cili konfirmon përparimet rregullatore të rëndësishme dhe gatishmërinë për pajtueshmërinë me kërkesat e SEPA-së.

Në këtë drejtim, BQK ka miratuar një sërë rregulloresh që rrjedhin nga këto ligje, të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar nga organet vendimmarrëse të saj si pjesë e paketës rregullatore për aplikacionin SEPA. Gjithashtu, në funksion të harmonizimit me kornizën ligjore për shërbimet e pagesave, sistemin bankar dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, janë realizuar ndryshime dhe plotësime edhe në disa rregullore ekzistuese.

Përveç kësaj, janë miratuar një sërë rregulloresh që rregullojnë veprimtarinë e sektorit të sigurimeve, fondeve pensionale, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, me synimin e forcimit të mbikëqyrjes dhe rritjes së qëndrueshmërisë së këtyre segmenteve të tregut financiar.

Së fundmi, ka hyrë në fuqi edhe Ligji nr. 08/L-295 për Kripto-Asetet, si iniciativë ligjore e Kuvendit të Kosovës, i cili ka ndikuar në kornizën ligjore të zbatueshme për BQK-në, me kërkesa ligjore dhe rregullative për t'u adresuar nga BQK përmes rregulloreve të saj. Ky ligj synon të rregullojë licencimin, autorizimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve që ushtrojnë veprimtari të lidhura me emetimin, shpërndarjen, tregtimin dhe ruajtjen e krypto-aseteve. Ky ligj përcakton gjithashtu kushtet e operimit dhe organizimit të operatorëve në këtë fushë, duke siguruar një kornizë të qartë rregullatore. Në bazë të këtij ligji, BQK është autorizuar si autoritet përgjegjës për lëshimin e licencave dhe autorizimeve për operimin e subjekteve në këtë sektor. Për zbatimin e plotë të ligjit, BQK është në proces të hartimit të akteve nënligjore përkatëse.

Në kuadër të realizimit të detyrave ligjore, BQK ka ndërmarrë gjithashtu hapa për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim forcimin e bashkëpunimit rregullator dhe shkëmbimin e përvojave.

Një aspekt tjetër kyç i aktivitetit ligjor ka qenë siguri i mbrojtjes efektive të interesave institucionale të BQK-së, përfshirë përfaqësimin në çështje administrative dhe të tjera që kërkojnë mbështetje ligjore. Po ashtu, janë ndërmarrë masa për menaxhimin e riskut ligjor dhe forcimin e mekanizmave të pajtueshmërisë, me synim garantimin e sigurisë juridike dhe integritetit institucional të Bankës.

Në vazhdimësi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për sigurimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së saj me legjislacionin në fuqi dhe Ligjin për BQK-në. Në përputhje me objektivat e saj strategjike, BQK do të vijojë të avancojë një kornizë rregullative efektive për mbikëqyrjen e sistemit financiar, duke kontribuar në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e tij, si dhe në funksionimin e sigurt të sistemit të pagesave në Kosovë.

4. Sistemi i Pagesave

Ofrimi i sistemeve të pagesave të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase është një ndër objektivat kryesore të BQK-së. Sistemi i pagesave ndërbankare, i zhvilluar, i mbikëqyrur dhe nën administrimin e BQK-së, gjatë vitit 2024 ka siguruar disponueshmëri maksimale, duke garantuar procesimin dhe shlyerjen e pagesave për të gjithë pjesëmarrësit ekonomikë në vend.

Në përmbushje të këtij objekti, BQK ka prioritet funksionin rregullativ, operacional, mbikëqyrës dhe katalizator për ruajtjen e sigurisë të infrastrukturës së pagesave dhe zhvillimit të mëtejshëm të tregut për shërbime të pagesave. Për këtë qëllim, BQK është duke punuar në implementimin e Planit Strategjik 2024-2028, në të cilin një ndër qëllimet kryesore është modernizimi i infrastrukturës së tregut financiar. Përveç kësaj, BQK ka vazhduar punën e saj në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlera të Vogla 2021-2026. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2024, në fushën e shërbimeve të pagesave ka pasur zhvillime dinamike si në aspektin rregullativ, operacional por edhe atë mbikëqyrës.

Në fillim të vitit 2024, BQK ri-inoj dhe organizoj takimin vjetor të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) me anëtarësi të zgjeruar. Në këtë kuadër, fokus iu dha përgatitjeve të nevojshme për plotësimin e kriterëve për anëtarësim në skemat e pagesave në zonën e BE-së (SEPA), marrjen e masave për zvogëlimin e përdorimit të parave të gatshme, si dhe implementimin e infrastrukturës së pagesave të shpejta, me fokus integrimin në sistemin e pagesave të shpejta të Bashkimit Evropian, të njohur si TIPS.

Gjithashtu, në fillim të vitit 2024, ka hyrë në fuqi Rregullorja për Strukturën dhe Përdorimin e Identifikuesit Unik të Llogarisë së Pagesës (IBAN) për Transaksionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare, e cila mundëson pajisjen me kodin e identifikimit të llogarive të pagesave (i njohur si KIO) edhe për institucionet financiare jobankare të autorizuar nga BQK për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe parave elektronike. Kjo rregullore që është miratuar në fund të vitit 2023, ka për qëllim përcaktimin e rregullave për përdorimin, strukturën dhe komunikimin e IBAN si identifikues unik i llogarisë së pagesës për transaksionet e transferit të kreditit dhe debitimet direkte në Republikën e Kosovës dhe ato ndërkombëtare.

Në funksion të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në dhe përfshirjes në projektin e Komisionit Evropian që ka për qëllim Modernizimin e Sistemeve të Pagesave të Vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili administrohet nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal dhe implementohet nga Grupi i Bankës Botërore, BQK në bashkëpunim me ekipin e Bankës Botërore ka përgatitur dhe finalizuar draftin e Ligjit për Shërbimet e Pagesave, i cili ka për qëllim transpozimin e direktivave të rëndësishme për fushën e pagesave. Në këtë drejtim, Bordi ekzekutiv i BQK-së themeloj grupin punues për harmonizimin e direktivave të BE-së për anëtarësim në SEPA. Në këtë proces, janë rishikuar / draftuar 20 rregullore të kornizës financiare të Kosovës me kërkesat e skemave të pagesave të SEPA-s. Pas miratimit të tre ligjeve të rëndësishme financiare nga Kuvendi i Kosovës më 5 dhjetor 2024 dhe miratimit të 20 rregulloreve përkatëse nga BQK më 17 dhjetor 2024, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) e nisi procesin e anëtarësimit në skemën e pagesave SEPA më 20 dhjetor 2024.


Si pjesë e strategjisë së gjithëpërfshirjes financiare në Kosovë, ka vazhduar zbatimi i Rregullores për Qasjen në Llogaritë e Pagesave me Shërbime Bazike, me fokus në sigurimin që të gjithë qytetarët, veçanërisht popullatat e pashërbyera dhe kategoritë e cenueshme, të kenë qasje në shërbimet bazike financiare. Deri në fund të vitit 2024, numri i llogarive në këtë kategori ka arritur në afërsisht 390 mijë llogari.

Në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe raportuese, sistemi i pagesave ndërbankare ka vazhduar të operojë me nivelin më të lartë të qëndrueshmërisë, sigurisë, dhe efikasitetit, që ka mundësuar kliringun dhe shlyerjen me kohë të të gjitha transaksioneve të pagesave dhe letrave me vlerë.

4.1. Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare


Sistemi i Pagesave Ndërbankare të Kosovës-KIPS, sistem i rëndësishëm sistemike, i cili mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë, ka vazhduar funksionimin normal dhe pa pengesa. Grafikët në vijim, paraqesin numrin dhe vlerën e transaksioneve të kryera përmes KIPS për periudhat përkatëse.

Grafik 53. Numri i transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2025)

Grafik 54. Vlera e transaksioneve në KIPS (në mijëra)




Burimi: BQK (2025)

Treguesit statistikor të aktiviteteve në KIPS gjatë vitit 2024, kanë shënuar rritje të theksuar të transaksioneve në vëllim për 9.6 përqind si dhe në vlerë për 16.3 përqind në krahasim me vitin paraprak, ku janë procesuar mbi 20.9 milionë transaksione me vlerë totale mbi 25.3 miliardë euro (shih Grafikët 53 dhe 54).


Në kuadër të KIPS realizohen pagesat përmes dy komponentëve: RTGS (Real-Time Gross Settlement) dhe ACH (Automated Clearing House). Në komponentën RTGS realizohen në kohë reale të gjitha pagesat me vlerë mbi 10 mijë euro, si dhe pagesat të urdhëruara me prioritet nga ana e klientëve. Ndërsa, në komponentin ACH realizohen të gjitha pagesat me vlerë nën 10 mijë euro ku përfshihen pagesat e rregullta-normale, pagesat masive, pagat dhe pensionet, pagesat Kos-Giro, dhe Debitimi Direkt. Krahasimi i trendëve rritës të vëllimit dhe vlerës së këtyre kategorive të pagesave për vitet e caktuara, është paraqitur në grafikët në vijim.

Grafik 55. Vëllimi vjetor i transaksioneve të KIPS-it sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2025)

Grafik 56. Vlera vjetore e transaksioneve të KIPS-it sipas llojeve të tyre (në mijëra)




Burimi: BQK (2025)

Këtë vit, pagesat e rregullta (normale dhe masive) përbënin rreth 47.9 përqind të vëllimit dhe 18.7 përqind të vlerës së transaksioneve të KIPS (shih Grafikun 55). Transaksionet RTGS procedohen

dhe shlyhen gjatë orarit të punës në kohë reale dhe në baza bruto. Gjatë vitit 2024, numri i tyre përbënte rreth 3.3 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve në KIPS (shih Grafikonun 55), ndërsa, vlera e tyre rreth 43.4 përqind të vlerës së transaksioneve përmes KIPS (shih Grafikonun 56).


Në kategorinë e pagesave për paga/pensione është shënuar rritje, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve. Në krahasim me vitin paraprak rritja në numër është 5.2 përqind, ndërsa në vlerë të transaksioneve 14.8 përqind. Krahas rritjes në vëllim dhe në vlerë të transaksioneve në krahasim me vitin paraprak, vërehet gjithashtu një rritje e mesatares ditore të transaksioneve të procesuara, si në vëllim ashtu edhe në vlerë, prej 8.3 përqind respektivisht 14.9 përqind (shih Grafikët 57 dhe 58).

Grafik 57. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2025)


Grafik 58. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2025)


Gjatë vitit 2024, pasqyrimi i pagesave të procesuara përmes komponentës ACH, sipas sesioneve, tregon një përqendrim më të theksuar në sesionin e parë dhe të dytë të kliringut, krahasuar me sesionin e fundit. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë sesionit të fundit të kliringut minimizon rreziqet shtesë në kuadër të funksionimit të sistemit të pagesave, prandaj, aplikohen tarifa më të ulëta për transaksionet e procesuara në dy sesionet e para (shih Grafikët 59 dhe 60).

Grafik 59. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në KIPS



Burimi: BQK (2025)

Figura 60. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në KIPS



Burimi: BQK (2025)

Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në KIPS gjatë vitit 2024 ka qenë afër 25.3 miliardë euro, ku janë përfshirë transaksionet e të gjithë pjesëmarrësve në KIPS, Bankat dhe Thesari. Nga vëllimi dhe vlera e transaksioneve të iniciuara nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse në sistem, tre pjesëmarrësit me numrin më të madh të transfereve të iniciuara zënë 63.4 përqind të vëllimit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë pjesëmarrësit tjerë zënë 36.6 përqind. Ndërsa, sa i përket vlerës të transfereve të iniciuara nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse, nga vlera e përgjithshme e tyre prej 25.3 miliard transaksione, tri institucionet e para pjesëmarrëse në

sistem me vlerën më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 41.8 përqind të vlerës të përgjithshëm, ndërsa, të gjitha institucionet tjera zënë 58.2 përqind (shih Tabelën 21).

Tabela 21. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SPN

Sistemi KIPS	Vëllimi	Vlera
3 pjesëmarres ne sistem	63.4%	41.8%
pjesëmarresit e tjerë	36.6%	58.2%
Gjithsejt	20,922,580	25,388,015,259

Burimi: BQK (2025)

Raporti i vlerës së Huasë brenda-ditore për likuiditet ndaj vlerës totale të aktivitetit të sistemit RTGS për vitin 2024 rezulton rreth 2.2 përqind (shih Grafikon 61), duke reflektuar një peshë të ulët të nevojës së financimit të aktivitetit të këtij sistemi me likuiditet nga BQK, rrjedhimisht, të ekspozimit të sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit.

4.2. Regjistri i Llogarive Bankare

Në kuadër të funksioneve operacionale të BQK-së, rol të rëndësishëm zë edhe Regjistri i Llogarive Bankare. Ky regjistër përfaqëson një infrastrukturë të bazës së të dhënave, e cila mundëson raportimin e të dhënave për llogaritë bankare nga ofruesit e të dhënave të llogarive (bankat komerciale), si dhe shfrytëzimin e këtyre të dhënave në funksion të zbatimit të vendimeve përmbarimore nga organet e përmbarimit dhe institucionet tjera kompetente sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Ky regjistër ka pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen e efikasitetit në procedimin e lëndëve përmbarimore nga organet e procedurës përmbarimore, sidomos pas zgjerimit të funksioneve për mundësimin e procedimit elektronik të vendimeve përmbarimore.


Në regjistër gjatë vitit raportues 2024, kanë pasur qasje 49 përmbarues privatë, 124 zyrtarë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe 14 zyrtarë nga Administrata Tatimore e Kosovës, përmes të cilit kanë shkëmbyer me bankat komerciale 24,598 raste të procedurës përmbarimore, prej të cilave 20,719 janë mbyllur (shih Tabelën 22).

Tabela 22. Rastet e procesuara në Regjistrin e Llogarive Bankare

Statusi i rasteve	2023	2024	Në ngritje/Në rënje (%)
Të hapura	23,159	24,598	6.21%
Të mbyllura	18,023	20,719	14.96%

Burimi: BQK (2025)

Grafik 61. Raporti i kredisë brenda ditore ndaj totalit së vlerës së shlyer ne RTGS



Burimi: BQK (2025)

4.3. Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave

Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve është një funksion i BQK-së, ku objektivat e sigurisë dhe efikasitetit promovohen duke monitoruar sistemet ekzistuese dhe të planifikuara, duke i vlerësuar ato kundrejt objektivave dhe sipas nevojës duke nxitur ndryshime.

Në funksion të mbikëqyrjes dhe zhvillimit të analizave të sistemeve të pagesave, gjatë vitit 2024 BQK ka vazhduar monitorimin e sistemit të pagesave përmes raportimeve periodike të pranuar nga bankat komerciale dhe IFJB-të që kryejnë shërbime të pagesave dhe parasë elektronike.


Këtë vit është rishikuar analiza vjetore për përdorimin e kartelave në Kosovë. Analiza përfshin informacione për shpërndarjen socio-demografike të kartelave të përdorura nga qytetarët e Kosovës dhe faktorët përkatës që kanë ndikuar në shpërndarjen e tillë. Gjithashtu, analiza pasqyron informacione për llojet e kartelave dhe përdorimin e kartelave në terminale të ndryshme, përfshirë ato online. Analiza vjetore publikohet në baza të rregullta vjetore në faqen zyrtare të BQK-së.

Në kuadër të përgatitjes së analizave dhe raporteve periodike për statistikën e pagesave janë përgatitur dhe publikuar raportet e rregullta vjetore dhe mujore lidhur me; numrin dhe vlerën e pagesave ndërbankare, depozitat e bankave komerciale dhe rezervat, instrumentet me para të gatshme dhe jo me para të gatshme, si dhe raporti krahasues mbi instrumentet e pagesave elektronike (Kosova në krahasim me vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore) të cilat gjithashtu publikohen në faqen zyrtare të internetit në BQK.

4.4. Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave


Raportimet e bankave për instrumente të pagesave tregojnë se deri në fund të dhjetorit të vitit 2024 numri i kartelave të debitit arriti afër 1.5 milionë, ndërsa, numri i kartelave të kreditit arriti në rreth 195 mijë. Krahasuar me një vit më parë, numri i kartelave të debitit është rritur për 5.61 përqind, ndërsa, numri i kartelave të kreditit është rritur për 8.17 përqind (shih Grafikët 62 dhe 63).

Grafik 62. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2025)

Grafik 63. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit




Burimi: BQK (2025)

Infrastruktura e terminaleve ka vazhduar të zgjerohet, ku evidentohet rritje e numrit të bankomatëve/ATM gjatë këtij viti në krahasim me vitin paraprak (shih Grafikun 64). Rritje e lehtë është shënuar edhe në numrin e terminaleve në pikat e shitjes/POS (shih Grafikun 65).


Krahas rritjes së numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave, në vitin 2024, nga të dhënat statistikore vërehet se ka pasur rritje të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike. Numri i pagesave të kryera përmes shërbimit të internetit/e-banking arriti në mbi 11.3 milionë transaksione, që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje për 16.6 përqind, me një vlerë që arriti në mbi 24.9 miliardë euro apo një rritje vjetore prej 16.3 përqind (shih Grafikët 66 dhe 67).

Grafik 64. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2025)


Grafik 65. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2025)


Viti 2024 u karakterizua me një trend në rritje të përdorimit të pagesave me kartelë. Numri i pagesave në pikat e shitjeve/POS është rritur për 39.4 përqind, ndërsa në vlerë është evidentuar rritje krahasuar me vitin paraprak për 31.8 përqind. Tërheqjet në bankomate/ATM gjithashtu tregojnë rritje në numër dhe vlerë krahasuar me vitin paraprak, me numrin e tërheqjeve në bankomate/ATM që është rritur për 3.1 përqind, ndërsa në vlerë për 5 përqind (shih Grafikët 66 dhe 67).

Grafik 66. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2025)

Grafik 67. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave




Burimi: BQK (2025)

Rritja e pagesave elektronike përgjatë viteve reflektohet edhe në mënyrën e realizimit të transfereve të kreditit. Transferet në formë letër vazhdimisht janë në rënie kundrejt atyre në formë elektronike.

Gjatë vitit 2024, transferet e iniciuara në formë letre përbënin 13 përqind, ndërsa ato në formë elektronike përbënin 87 përqind të gjithsej transfereve të iniciuara nëpërmjet bankave (shih Grafikun 68).

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve arriti rreth 2.53 milionë, që paraqet një rritje prej 1.1 përqind krahasuar me fundin e vitit 2023. Rreth 98.3 përqind e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.7 përqind të jorezidentëve (shih Tabelën 23).

Grafik 68. Numri i transfereve të kreditit në formë elektronike në raport me transferet formë letër



Burimi: BQK (2025)

Tabela 23. Numri i llogarive

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Llogaritë e Klientëve (1+2)	2,371,544	2,512,575	2,539,345	688,891	851,645	1,030,357
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.50%	98.53%	98.34%	98.29%	98.21%	97.93%
a-Indivuale (%)	91.73%	91.10%	92.34%	89.54%	90.31%	90.83%
b-afariste (%)	8.27%	7.43%	7.66%	10.46%	9.69%	9.17%
2-Llogari të jorezidentëve (c+d) (%)	1.50%	1.45%	1.66%	1.71%	1.79%	2.07%
c-Indivuale (%)	98.95%	99.20%	99.35%	91.55%	84.80%	81.27%
d-afariste (%)	1.05%	0.80%	0.65%	8.45%	15.20%	18.73%


Burimi: BQK (2025) Shënim: BQK, Raportimet e bankave sipas "Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve.

Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2024, mbi 1 milion llogari kishin qasje "online" nga interneti, që është një rritje prej 21 përqind e qasjes në llogari nga distanca.

Grafiku 69 tregon pjesëmarrjen e llogarive me qasje në internet, në numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse gjatë viteve të fundit. Bazuar në të dhënat statistikore, zhvillimi i infrastrukturës ka vazhduar trendin rritës dhe inkurajues mbetet edhe trendi i shpejtë i rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

IFJB-të të regjistruara për emetimin e parasë elektronike, në fund të vitit 2024 kanë raportuar 79,706 llogari të parasë elektronike, duke shënuar një rritje të shpejtë bazuar në faktin se ky është vetëm viti i pestë i operimit të tyre në treg (shih Tabelën 24). Këto institucione së bashku kanë kryer një volum prej 2.1 milion pagesa me para elektronike, me një vlerë prej rreth 860 milionë euro (Tabela 25).

Grafik 69. Numri i llogarive me qasje në internet në raport me numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse



Burimi: BQK (2025)

Tabela 24. Numri i llogarive të parasë elektronike

Përshkrimi i llogarisë	2022	2023	2024
Llogaritë e parave elektronike (E-money accounts)	25,164	45,310	79,706

Burimi: BQK (2025)

Tabela 25. Numri dhe vlera pagesave të parave elektronike

Përshkrimi	2022	2023	2024
Numri	293,097	1,620,139	2,188,448
Vlera	70,005,357	617,969,808	860,437,319

Burimi: BQK (2025)

Nxitja e përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike vlerësohet me ndikim edhe në zgjerimin e përfshirjes financiare të qytetarëve duke mundësuar qasjen në shërbimet e pagesave (hapjen e një llogarie paraje elektronike/llogarie pagese, dhe zotërimin e një karteje me parapagim) nga kategori të popullsisë pa qasje në shërbime bankare, si për kategoritë që nuk janë të punësuar. Realizimi i transaksioneve elektronike konsiderohet edhe si dritarja kryesore që mund t'u lehtësojë edhe qasjen në kredi dhe shërbime tjera financiare.

4.5. Roli i BQK-së si katalizator i sistemit të pagesave

BQK-ja, si një aktor kyç në sistemin e pagesave, ka demonstruar përkushtim të palëkundur për modernizimin dhe zgjerimin e tregut të pagesave. Ky angazhim dëshmohej nga zbatimi i iniciativave të shumta që synojnë përmirësimin dhe reformimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të pagesave.

Në fillimi të vitit, BQK ndërmorri disa nisma që përfshijnë riorganizimin dhe zgjerimin e Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) si një organ këshillues për të mbështetur reformat e sistemit të pagesave dhe për të rritur sigurinë. Takimi mblodhi një anëtarësi të zgjeruar të KKP-së, duke përfshirë drejtuesit kryesorë financiarë, së bashku me Guvernatorin e Bankës Qendrore dhe Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, përfaqësues nga institucione të ndryshme qeveritare (ATK, ARC, ASHI, MINT), organizata ndërkombëtare (Banka Botërore, FMN, USAID, Zyra e BE-së, SECO) dhe entitete financiare globale si Visa dhe MasterCard që kontribuan në diskutime, duke reflektuar natyrën bashkëpunuese dhe të nivelit të lartë të ngjarjes.

Në takimin e KKP-së, u vendos krijimi i Grupit Punues për Reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme dhe rritjen e përdorimit të pagesave elektronike. Gjithashtu, anëtarët e KKP-së u pajtuan me krijimin e grupeve tjera punuese për zhvillimet e infrastrukturës ligjore dhe teknike në fushën e pagesave, në funksion të proceseve integruese të vendit, avancimit të shërbimeve digjitale dhe rritjes së përfshirjes financiare.

Në funksion të realizimit të objektivave nga Plani Strategjik 2024-2028, të ndërlidhura me fushën e pagesave, gjatë këtij vit BQK ka ndërmarrur disa aktivitet të rëndësishme, si:

- Është hartuar dhe plotësuar kuadri ligjor i nevojshëm për sektorin e pagesave, duke mundësuar progres drejt anëtarësimit në SEPA. Si rezultat i kësaj, në dhjetor 2024, BQK-ja ka dorëzuar zyrtarisht para-aplikimin e saj në mekanizmin e parakualifikimit të Komisionit Evropian, DG FISMA. Në këtë aspekt, fillimisht pas një diskutimi të gjërë me akterët kryesor nga institucionet financiare dhe qeveritare, është finalizuar Ligji për Shërbimet e Pagesave, përmes të cilit janë transpozuar në legjislacionin vendor tri direktivat e BE-së të rëndësishme për shërbimet e pagesave: (i) Direktiva për Shërbimet e Pagesave (e njohur si PSD2), (ii) Direktiva për Llogaritë e Pagesave (e njohur si PAD), dhe (iii) Direktiva për Institucionet e Parave Elektronike (e njohur si EMD2). Adaptimi i këtyre direktivave në tregun vendor vlerësohet se do të kontribuojë në nxitjen e konkurrencës në tregun e shërbimeve të pagesave, në rritjen e transparencës dhe sigurisë në shërbimet e ofruara nga tregu, dhe në krijimin e një kuadri të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit. Përafrimi i praktikave të rregullimit të tregut të shërbimeve të pagesave me ato evropiane përbën edhe një hap themelor dhe substancial drejt integritimit dhe zbatimit të rekomandimeve që derivojnë në kuadër të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe shërbimeve për anëtarësimin në skemën e pagesave SEPA.
- Ligji për Shërbimet e Pagesave hapi rrugën për hartimin dhe rishikimin e 20 akteve nënligjore që rregullojnë fushat si: parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizimit; informacioneve që duhet të shoqërojnë transferet e fondeve; përcaktimin e kriterëve për transaksionet e kreditit dhe debitimit direkt; fondet vetanake dhe kapitalit, çështje të kontabilitetit dhe auditimit; mbrojtjen e fondeve të klientëve; agjentët nga subjektet e huaja; rreziqet operationale dhe të sigurisë; raportimin e incidenteve; rregullat dhe standardet për autentifikim; mekanizmat e ankesave; zgjidhjen e kontesteve, si dhe çështjet tjera të ndërlidhura me fushën e shërbimeve të pagesave.
- Në kuadër të zhvillimeve tjera rregullative, BQK ka implementuar Rregulloren për Strukturën dhe Përdorimin e Identifikuesit Unik të Llogarisë së Pagesës (IBAN) për Transaksionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare, e cila ka mundësuar pajisjen me kodin e identifikimit të

llogarive të pagesave (i njohur si KIO) edhe për institucionet financiare jobankare të autorizuar nga BQK për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe parave elektronike.

- BQK ka miratuar Udhëzimin për Standardizimin e QR Kodit, me qëllimin që të përcaktoj rregullat dhe kërkesat teknike për zhvillimin dhe funksionimin e strukturës së QR kodit në Republikën e Kosovës, që do të përdoret për pagesat e shpejta gjatë shitjeve me pakicë dhe për pagesat e faturave.
- Janë bërë analizat e nevojshme lidhur me mundësin për implementim të Sistemit të Pagesave të Shpejta, dhe si rezultat i kësaj, tashmë në kuadër të projektit të përbashkët rajonal bashkë me disa nga shtet e rajonit, BQK ka nënshkruar letrën e qëllimit me bankën e Italisë për implementim të Sistemit të Pagesave të Shpejta -TIPS clone, projekt i cili do të finalizohet në mesin e vitit 2026.
- Është rishikuar Rregullorja për Regjistrin e llogarive, që synon; të përmirësojë shërbimet financiare dhe krijimin e lehtësirave për qasje në llogarinë e pagesave me shërbime bazike, raportimin e llogarive të bazuar në IBAN edhe nga IFJB-të, si dhe dixhitalizimin e shërbimeve tjera financiare përmes ndërlidhjes me institucionet tjera shtetërore për të thjeshtuar procedurat për validimin e llogarive dhe shkëmbimin e raporteve mbi llogaritë, përmes platformës e-kosova.

4.6. Bashkëpunimi me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare në fushën e pagesave

Në kuadër të projektit për modernizim të sistemeve të pagesave të Ballkanit Perëndimor, nën udhëheqjen e Komisionit Evropian, në koordinim nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), dhe mbështetje teknike nga ekipi i Bankës Botërore, është ofruar një mbështetje shumë e rëndësishme për; finalizimin e Ligjit për Shërbimet e Pagesave, rishikimin e kornizës ligjore për AML/CFT, përgatitjen e akteve nën-ligjore dhe përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për plotësim të kriterëve për aplikim në SEPA, si dhe përzgjedhjen e opcionit për implementim të sistemit të pagesave të shpejta.

Përveç kësaj, nga Banka Botërore është ofruar edhe mbështetja mbi analizën për pranimin e pagesave elektronike (EPA) në vend, nga ku është zhvilluar një studim gjithëpërfshirës për të fituar njohuri më të thella se si individët, bizneset dhe palët e tjera kryesore të interesuara në Kosovë po përdorin sistemet e pagesave elektronike. Ky hulumtim synon të vlerësojë gjendjen aktuale të transaksioneve dixhitale, duke shqyrtuar tendencat në adaptim, modelet e përdorimit dhe depërtimin e përgjithshëm të zgjidhjeve të pagesave elektronike brenda ekonomisë. Më konkretisht, studimi synon të identifikojë dhe analizojë faktorët kryesorë që ndikojnë në pranimin e pagesave elektronike, si dhe barrierat që mund të kufizojnë përdorimin e gjerë të tyre. Kjo përfshin eksplorimin e faktorëve të tillë si preferencat e konsumatorëve, gatishmërinë e biznesit, edukimin financiar dhe dixhital, kornizat rregullatore dhe disponueshmërinë e infrastrukturës që mbështet transaksionet elektronike.

Për më tepër, studimi do të vlerësojë sfidat më të gjera me të cilat përballen pjesëmarrës të ndryshëm të tregut, duke përfshirë institucionet financiare, ofruesit e shërbimeve të pagesave, tregtarët dhe konsumatorët. Këto sfida mund të përfshijnë çështje që lidhen me kostot e transaksionit, shqetësimet e sigurisë, ndërveprueshmërinë ndërmjet sistemeve të pagesave dhe aksesin e shërbimeve financiare dixhitale, veçanërisht për popullsinë e pashërbyer.

Gjatë këti vit, përveç komunikimit dhe bashkëpunimit me shtete individuale për çështjet mbi fushat e pagesave, BQK është anëtarësuar në Shoqatë Evropiane të Shtëpive të Kliringut të Pagesave-EACHA.

Anëtarësimi në EACHA paraqet një hap të rëndësishëm, duke marrë parasysh projektet dhe reformat në proces lidhur me digjitalizimin e shërbimeve të pagesave. Ky anëtarësim ofron një mundësi për të mësuar nga përvojat dhe njohuritë e vendeve të tjera mbi procesin e anëtarësimit në infrastrukturë e sistemeve të pagesave në BE. Gjithashtu, do të lehtësojë procesin e identifikimit dhe adaptimit të një zgjidhje për procesimin e pagesave të shpejta në Republikën e Kosovës dhe do të lehtësojë qasjen e bankave dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave në shtëpitë e kliringut në Evropë, duke mbështetur qëllimin strategjik të BQK-së për modernizimin e sistemeve të pagesave dhe integrimin në SEPA. Kjo platformë do të ndihmojë BQK-në por edhe ofruesit e shërbimeve të pagesave në adaptimin e standardeve të BE-së dhe përgatitjen e tregut për integrim me skemat dhe sistemet e pagesave të BE-së. Gjithashtu, do t'i mundësojë BQK-së që të jetë e përfshirë për së afërmi në iniciativat dhe zhvillimet e reja në BE, për mbështetjen e avancimit të tregut të pagesave në Republikën e Kosovës.

Në nivel vendor, përveç tjerave një hapësirë e veçantë iu kushtua gjithashtu edhe rolit të edukimit financiar, në nxitjen e përfshirjes financiare si dhe bashkëpunimit të grupeve punuese në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësisive të Këshillit Kombëtar të Pagesave.

5. Edukimi Financiar dhe Mbrojtja e Konsumatorit

5.1. Edukimi Financiar dhe promovimi i qasjes në financa

Gjatë vitit 2024, BQK ka ndërmarrë një numër të konsiderueshëm iniciativash edukative dhe informuese, në përputhje me standardet ndërkombëtare të transparencës dhe objektivat strategjike të saj institucionale.

Edukimi financiar mbetet një ndër prioritetet kyçe të BQK-së, dhe fokusi kryesor i angazhimeve në kuadër të edukimit financiar gjatë vitit ka qenë, kontribuimi në ngritjen e njohurive rreth edukimit financiar, mbrojtjes së konsumatorit dhe përmirësimit të qasjes në financa.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre objektivave janë realizuar aktivitete ndërgjegjësuese, projekte edukative dhe janë përgatitur materiale informuese, krahas zbatimit të bashkëpunimeve me institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të iniciativave dhe aktiviteteve të edukimit, fokusi i BQK-se është i përqendruar në aspektet kryesore, si:

- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të rolit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, duke informuar publikun mbi funksionet, përgjegjësitë dhe ndikimin e saj në stabilitetin financiar të vendit, dhe
- Nxitjen dhe kontribuimi në krijimin, zhvillimin dhe avancimin e njohurive financiare, duke ndihmuar qytetarët të marrin vendime të informuara dhe të menaxhojnë më mirë financat e tyre personale.

Gjatë vitit 2024, BQK ka zhvilluar aktivitete edukative dhe informuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi funksionimin e sektorit ekonomik dhe financiar. Përmes iniciativave të ndryshme, janë shpërndarë informata, të dhëna, këshilla dhe udhëzime, duke kontribuar që qytetarët të avancojnë njohuritë e tyre financiare dhe përfitojnë njohuri të reja rreth kësaj fushe.

Ndër nismat kryesore të realizuara gjatë këtij viti janë:

- **Zhvillimi i Platformës për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare**- zhvilluar në kuadër të edukimit financiar, për t'u përdorur nga konsumatorët për informimin dhe krahasimin e tarifave dhe normave të produkteve dhe shërbimeve që ofrohen nga institucionet financiare. Platforma është një ueb aplikacion i zhvilluar për t'u përdorur nga konsumatorët me qëllim të informimit dhe krahasimit të normave të interesit dhe tarifave të produkteve dhe shërbimeve më të përdorura të cilat ofrohen nga institucionet financiare. Qëllimi i ndërtimit të Platformës është të kontribuojë në rritjen e transparencës, mbrojtjen e konsumatorit, edukimin financiar dhe avancimin e qasjes në financa. Platforma është e plotësuar me të dhëna nga institucionet bankare dhe është në proces të kompletimit me të dhëna nga institucionet tjera, si: Institucionet Mikrofinanciare, Institucionet Financiare Jobankare si dhe të dhënat nga Kompanitë e Sigurimeve dhe pritet që të finalizohet e gjatë vitit 2025.
- **Java Ndërkombëtare e Parasë 2024**, (18- 22 mars 2024) është një kampanjë ndërkombëtare ndërgjegjësuese që organizohet çdo vit nga OECD/INFE (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik / Rrjeti Ndërkombëtar për Edukimin Financiar) dhe për qëllim ka promovimin e edukimit financiar tek fëmijët dhe të rinjtë, duke i ndihmuar ata që në moshë të hershme të zhvillojnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe sjellje të duhura për marrjen e vendimeve të duhura financiare. Në këtë fushatë marrin pjesë mbi 170 shtete nga e gjithë bota, përmes aktiviteteve edukuese dhe ndërgjegjësuese. Si pjesë e përkushtimit të saj strategjik për

edukimin financiar, BQK shënon rregullisht këtë javë me aktivitete të dedikuara për nxënës, të rinj dhe palë relevante në nivel kombëtar.

Aktivitetet e organizuara këtë vit ishin:

- Nënshkrimi i MoU me SHBK, AMIK dhe BKS për themelimin e Komitetit për Edukimin Financiar;
- Nënshkrimin e MoU me Fakultetin Ekonomik për bashkëpunim në mes të dy institucioneve;
- Shpallja e çmimit vjetor “Ekonomisti i ri”, të cilin BQK e ndan çdo vit me qëllim promovimin e hulumtimeve shkencore, në fushën e ekonomisë e financave ku ftohen të gjithë hulumtuesit e rinj (studentët) që të aplikojnë me punimet e tyre shkencore;
- Aktivitet edukativ në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Ismail Qemali” në Prishtinë,
- Ligjëratë me Studentët e Kolegjit UBT;
- Ligjëratë në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional “Abdyl Ramaj” në Suharekë;
- Konferencë e bashkëorganizuar nga BQK dhe AMIK me temën “Qasja në financa për gratë ndërmarrëse”. Ngjarja u organizuar me qëllim të promovimit të përfshirjes financiare dhe fuqizimit ekonomik të grave, dhe mblodhi përfaqësues nga sektori publik dhe privat, institucione financiare, donatorë dhe gra ndërmarrëse, duke shërbyer si platformë për diskutimin e sfidave dhe mundësive në mbështetjen e bizneseve të udhëhequra nga gratë. Ndër temat kryesore të trajtuara ishin qasja në financim, trajnimet financiare dhe nevoja për rrjetëzim institucional. Në këtë ngjarje morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës.
- **1 Qershori Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve** – për shënimin e kësaj dite u organizuan aktivitete edukative me nxënës të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Xhemail Mustafa” në Prishtinë, dhe me nxënës të Shkollës së Mesme “Abdyl Ramaj ” në Suharekë, respektivisht nxënës të drejtimit Banka dhe Sigurime. Në këto aktivitete nxënësit u informuan se si funksionon sistemi financiar në Kosovë, si të njohin rëndësinë e menaxhimit të duhur të parasë, rëndësinë e kursimit e si të menaxhojnë buxhetin e financat personale.
- **Dita Botërore të Kursimeve (100 – vjetori)** –Në kuadër të shënimit të kësaj dite me 31 tetor 2024, u zhvilluan aktivitete me nxënës të Shkollës Filllore “Thimi Mitko” në Gjiilan, ku morën pjesë rreth 140 nxënës, me të cilët u mbajt aktivitet edukativ i përshtatur për fëmijët e ciklit të ulët. Aktivitetet e BQK-së në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Kursimeve vijuan në bashkëpunim me German Sparkassenstiftung for International Cooperation, me grupe tjera të rinjve, ku u realizuan aktivitete edukative e informuese me studentët e RIT Kosovo (A.U.K.) dhe studentët e Kolegjit AAB.
- **Materiale edukative** dhe informuese për publikun- në formë të broshurave, videove e infografikëve, të cilat janë shpërndarë në formë të broshurave gjatë aktiviteteve të ndryshme, si dhe janë promovuar përmes të gjitha kanaleve zyrtare të komunikimit të BQK-së, përfshirë rrjetet sociale.

Aktivitet edukative – gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithashtu një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve me nxënës të shkollave filllore, të mesme ku morën pjesë rreth 400 nxënës;

Ligjëratat me Studentët të Universiteteve dhe Kolegjeve private, UP, AAB, UBT, AUK ku morën pjesë rreth 300 studentë;

Janë shpërndarë 1180 materiale edukative, broshura e fletushka edukative e informuese.

5.2. Mbrojtja e konsumatorit

Në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorit si përgjegjësi e rëndësishme për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), kërkohet zhvillim i vazhdueshëm i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse të praktikave të tregut dhe trajtimi i vazhdueshëm i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare.

Mbikëqyrja e sjelljes së tregut luan një rol kyç në ruajtjen e stabilitetit dhe besueshmërisë së tregjeve financiare, forcimin e besimit midis pjesëmarrësve dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Është një proces i vazhdueshëm që kërkon vigjilencë, përshtatshmëri dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet autoriteteve rregullatore dhe pjesëmarrësve të tregut.

Institucionet financiare po integrojnë gjithnjë e më shumë inteligjencën artificiale dhe mësimin e makinerive në proceset e tyre të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve financiare. Për këtë arsye, mbikëqyrja e sjelljes së tregut luan një rol kyç në ruajtjen e stabilitetit dhe besueshmërisë së sistemit financiar, si dhe për të siguruar që konsumatorët të jenë të mbrojtur dhe të informuar në mënyrë të drejtë dhe transparente.

Mbrojtja e interesave të konsumatorit realizohet përmes zhvillimit të vazhdueshëm të kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, BQK-ja siguron që institucionet financiare të zbatojnë praktikën më të mira të tregut. Mbikëqyrja realizohet përmes ekzaminimeve në vend dhe monitorimeve nga distanca, me fokus të veçantë të transparencës dhe ofrimi i qartë i shërbimeve dhe produkteve financiare. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është trajtimi i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, të cilat janë bërë ndaj institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja.

Gjatë vitit 2024, është miratuar plotësimi i Rregullores për procesin e trajtimit të ankesave nga institucionet financiare. Kjo rregullore përcakton kriteret dhe procedurën të qarta për themelimin e një funksioni të brendshëm të trajtimit dhe menaxhimit të ankesave të klientëve nga institucionet financiare. Gjithashtu, rregullorja përfshinë kërkesat për raportimin e ankesave nga institucionet financiare dhe ofron mundësinë e përdorimit të mekanizmave alternativë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 është plotësuar Rregulla e brendshme për trajtimin e ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, e cila rregull përcakton kriteret për trajtimin e të gjitha ankesave të paraqitura në BQK nga ana e klientëve apo palëve të treta ndaj institucioneve financiare të licencuara, regjistruara dhe të mbikëqyrura nga BQK-ja.

Llojet e ankesave gjatë vitit

Gjatë vitit 2024, në BQK janë pranuar dhe trajtuar gjithsej 927 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizik e juridik). Përkatësisht, ankesat sipas kategorive të institucioneve financiare janë listuar si më poshtë:

- Bankat: Numri i ankesave të trajtuara ndaj bankave ka qenë 537 ankesa, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktet kreditore (kredi), menaxhimin e llogarisë bankare dhe produktin e kartelave debitore dhe kreditore.
- Institucione Mikrofinanciare (IMF): Numri i ankesave të trajtuara ndaj IMF-ve ka qenë 37 ankesa, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktin e kredisë.
- Institucione Financiare Jo Bankare (IFJB): Numri i ankesave të trajtuara ndaj IFJB-ve ka qenë 31 ankesa, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktin e kredisë dhe menaxhimin e shërbimeve digjitale përmes kartelave.
- Kompanitë e Sigurimeve/Ndërmjetësuesit e Sigurimeve: Numri i ankesave të trajtuara ndaj kompanive të sigurimeve ka qenë 322 ankesa, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur

me sigurimin shëndetësor, sigurimin e auto përgjegjësisë(përfshire sigurimin Kasko) dhe produktin e Letërkredisë/Garancionit.

Nga totali i ankesave të pranuar për vitin 2024, 847 ankesa janë parashtruar nga persona fizikë, ndërsa 80 ankesa nga persona juridikë.

Tabela 26. Numri i ankesave ndër vite

Institucionet financiare	Numri i ankesave ndër vite				
	2022	2023	% e ndryshimit	2024	% e ndryshimit
Bankat komerciale	518	448	-13.5%	537	19.9%
Institucionet Mikrofinanciare	54	54	0.0%	37	-31.5%
Institucionet Financiare jo Bankare	29	27	-6.9%	31	14.8%
Kompanitë e sigurimeve	262	246	-6.1%	321	30.5%
Ndërmjetësuesit e Sigurimeve	0	0	n.a	1	n/a
Fondet pensionale	0	1	n/a	0	n/a
Gjithsej	873	792	-9.3%	927	17.0%

Burimi: BQK (2025)

Në tabelën e mësipërme vërehet se numri i ankesave të trajtuara në vitin 2024 është rritur në krahasim me dy vitet paraprake. Edhe pse rritja është në një përqindje të vogël krahasuar me vitin paraprak, ajo pasqyron një rritje të vetëdijes së konsumatorëve për të adresuar shqetësimet e tyre, duke shfrytëzuar mekanizma të ndryshëm të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.

Ankesat sipas kanalit të pranimit

Sa i përket mënyrës së pranimit të ankesave, bazuar në kërkesat e Rregullës së Brendshme për Trajtimin e Ankesave, parashtrimi i ankesave në BQK bëhet kryesisht përmes platformës/sistemit për parashtrimin dhe menaxhimin e ankesave, linku i së cilës është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të BQK-së.

Tabela 27. Numri i ankesave sipas kanalit të pranimit

Kanali i pranimit të ankesave	Numri i ankesave	Pjesëmarrja në %
Sistemi online	661	71.3%
Personalisht në BQK	224	24.2%
MINT	33	3.6%
E-mail	9	1.0%
Gjithsej	927	100.0%

Burimi: BQK (2025)

Përveç kësaj, ankesat mund të dorëzohen edhe përmes:

- Postës Elektronike, duke e dërguar në adresën e postës elektronike zyrtare të BQK-së,
- Dorëzimi personal në zyrën e arkivit të BQK-së,
- Departamentit të Mbrojtjes së Konsumatorit, për ankesat e referuara sipas marrëveshjes mes BQK-së dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).

Numri i ankesave sipas statusit

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të trajtuara të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare gjatë vitit 2024, rreth 23% e tyre janë cilësuar si “të bazuara” dhe te njëjtat janë zgjidhur në favor të palëve ankuese. Ndërsa pjesa tjetër e ankesave ka përfshirë :

- Ankesat e pabazuara ose të pambështetura me dëshmi shtesë, si dhe
- Ankesa të cilat janë udhëzuar që fillimisht të shfrytëzojnë të drejtën e ankesës në institucionin financiar, në përputhje me rregullën përkatëse për trajtimin e ankesave.

Tabela 28. Numri i ankesave sipas statusit

Institucionet financiare	Gjithsej ankesa	Të Bazuara	Të Pabazuara
Bankat komerciale	537	115	422
Institucionet Mikrofinanciare	37	7	30
Institucionet Financiare jo Bankare	31	10	21
Kompanitë e sigurimeve	321	87	234
Ndërmjetësuesit e Sigurimeve	1	0	1
Fondet pensionale	0	0	0
Gjithsej	927	219	708

Burimi: BQK (2025)

6. Aktivitetet në fushën e Statistikave

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për BQK-në, BQK për përmbushjen e objektivave të saj mbledh, përpilon dhe publikon statistika dhe informacione tjera të nevojshme. BQK është prodhuese dhe përdoruese kryesore e statistikave financiare të Republikës së Kosovës dhe një nga burimet kryesore të statistikave në nivel kombëtar. Në kuadër të mandatit ligjor të saj, BQK përpilon dhe publikon statistikat e sektorit monetar, financiar, llogarive financiare dhe sektorit të jashtëm. Përpilimi i këtyre statistikave ndjekë metodologjinë e rekomanduar nga FMN, BQE, BB, Eurostat, dhe praktikat më të mira të vendeve tjera.

Për qëllime të përpilimit të statistikave, subjektet raportuese në BQK, në Departamentin e Statistikës (DS) janë personat fizik dhe juridik, përfshirë institucionet financiare (bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit, ndërmjetësit tjerë financiar, dhe ndihmësit financiar), ndërmarrjet në pronësi të huaj, Dogana e Kosovës, institucionet qeveritare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare dhe organizatat jofitimprurëse. Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK respekton konfidencialitetin në lidhje me të dhënat individuale që i siguron nga subjektet e ndryshme raportuese, të cilat i përdorë vetëm për qëllime të përpilimit të statistikave. Informatat e siguruara nga raportuesit janë të nevojshme për të përpiluar statistikat monetare dhe financiare, statistikat e sektorit të jashtëm dhe llogarive financiare në kuadër të përgjegjësive ligjore të BQK-së që burojnë nga Ligji nr. 03/L209 për BQK-në dhe Ligji nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Publikimi i statistikave bëhet sipas afatit të publikuar paraprakisht në faqen e internetit të BQK-së, dhe në formate të ndryshme, si: seritë kohore, Buletini Mujor Statistikor, Raporti Vjetor, Faqja Përmbledhëse e të Dhënave Kombëtare, FMN, Eurostat, BB, CEFTA, etj. Statistikat në përgjegjësinë e BQK-së sipas kërkesës, përgatiten dhe shpërndahen për nevoja të njëjësive organizative brenda BQK-së, si dhe për përdoruesit e jashtëm, si: institucionet qeveritare, mediat, organizata ndërkombëtare, universitetet dhe publiku i gjerë.

Gjatë vitit 2024, BQK ka vijuar përpilimin dhe publikimin e rregullt të statistikave brenda fushëveprimit të saj, në përputhje me kalendarin zyrtar të publikimeve. Statistikat monetare dhe financiare, që mbulojnë nënsektorët si banka qendrore, bankat komerciale, kompanitë e sigurimit, fondet pensionale, ndërmjetësit dhe ndihmësit financiarë, si dhe statistikat e sektorit të jashtëm, përfshirë bilancin e pagesave, pozicionin e investimeve ndërkombëtare dhe borxhin e jashtëm, janë publikuar rregullisht në faqen e internetit të BQK-së dhe në platformat e organizatave ndërkombëtare. Moduli i statistikave të llogarive financiare ka vazhduar të publikohet rregullisht në baza tremujore në seri kohore në faqen e internetit të BQK-së për sektorin financiar dhe sektorin e jashtëm. Megjithatë, janë edhe tre sektorë tjerë të ekonomisë të pambuluar, për të cilët burimet e të dhënave duhet të sigurohen në bashkëpunim me institucionet tjera relevante në vend. Në këtë drejtim, për të përcaktuar ndarjen e përgjegjësive institucionale, si edhe mekanizmat e bashkëpunimit për përgatitjen e llogarive financiare si dhe statistikave tjera ekonomike dhe financiare, në gusht 2024 është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet BQK-së, ASK-së, dhe MFPT-së.

BQK, në cilësinë e koordinatorit të vendit, në muajin gusht 2024 në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës ka dërguar në FMN zotimin për abonim në standardin SDDS. Aktualisht Kosova është anëtare në standardin e-GDDS. Kalimi nga e-GDDS (Enhanced General Data Dissemination System) në SDDS (Special Data Dissemination Standard) për Kosovën nënkupton një avancim të rëndësishëm në nivelin e transparencës dhe cilësisë së statistikave ekonomike dhe financiare që publikohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Republikës Kosovës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ky avancim nënkupton: rritje e standardeve të publikimit të të dhënave, zgjerimin e mbulimit të të dhënave, krijimi i një faqeje të

dedikuar për shpërndarjen e të dhënave (National Summary Data Page - NSDP), përmirësimin e besueshmërisë dhe transparencës, rritjen e mundësive për investime dhe integrim ekonomik ndërkombëtar, etj. Për shkak të rëndësisë së tij, kalimi nga e-GDDS në SDDS është një hap strategjik për Kosovën, që e pozicionon vendin më afër standardeve ndërkombëtare të tregut të lirë dhe transparencës financiare. Ky proces kërkon një angazhim të madh institucional të vendit, por përfitimet afatgjata do të jenë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Në qershor 2024, këtij hapi të rëndësishëm i ka paraprirë organizimi, për herë të parë në Prishtinë i një punëtorie rajonale nga FMN në bashkëpunim me BQK, e dedikuar posaçërisht për këtë qëllim, ku kanë marr pjesë Shqipëria dhe Mali i Zi. Deri në fund të vitit 2024, në kuadër të obligimeve shtesë për BQK që ngarkon ky standard janë përbushur një pjesë e konsiderueshme e tyre; DS ka përpiluar raportin e konsoliduar të rezervave ndërkombëtare dhe likuiditetit valutor, metodologjinë e këtij raporti, ka shkurtuar afatin e pranimit dhe përgatitjes së statistikave të BQK-së, etj.

Gjatë vitit 2024, BQK ka vazhduar përafrimin e mëtejshëm të statistikave nën përgjegjësinë e saj me standardet e Bashkimi Evropian të përcaktuara me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Regjionale (ESA 2010). Në baza të rregullta mujore janë raportuar statistikat mbi normat e interesit në depozita në Bankën Qendrore Evropiane (BQE), ndërsa në Eurostat në baza tremujore janë raportuar statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare dhe në baza vjetore statistikat e investimet direkte dhe tregtisë ndërkombëtare në shërbime.

Në kuadër të Programit IPA 2022, BQK këtë vit ka filluar implementimin e projektit “1.9 Investimet e Huaja Direkte”. Gjatë dy viteve të ardhshme, në kuadër të këtij projekti, DS pritet të rrisë gamën e publikimeve me katër dataset të reja në Eurostat. Si pjesë e këtij procesi, në shtator 2024, BQK ka përfituar një asistencë teknike treditore nga Eurostat. Në kuadër të marrëveshjeve me Qeverinë e Kosovës dhe FMN, atë të Stand-By Arrangement (SBA), dhe Marrëveshjes së Resilience and Sustainability Facility (RSF), DS ka vazhduar përgatitjen dhe dorëzimin në FMN të raporteve për indikatorët e shëndetit financiar dhe statistikave tjera të sektorit financiar.

Gjatë vitit 2024, DS ka organizuar projektin e rregullt të anketës me jo-rezidentët, të cilët vizitojnë Kosovën. Kjo anketë është realizuar për herë të parë dy herë brenda vitit, gjatë periudhës së pushimeve: një herë në sezonin e pushimeve të verës dhe për herë të parë në sezonin e dimrit. Anketa është realizuar duke përdorur një sistem të avancuar të huazuar nga Banka Botërore, i cili ka mundur rritje të efikasitetit të mbledhjes së të dhënave dhe përmirësim të kualitetit të tyre. Të dhënat e mbledhura janë përdorur për kalkulimin e vlerësimeve të shpenzimeve të emigrantëve në Kosovë, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në statistikat e shërbimeve të udhëtimit dhe disa kategori tjera që lidhen me impaktin e emigrantëve në Kosovë, siç janë remitencat, investimet direkte, etj. Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë, është punuar në zhvillimin e platformës online për raportimin e anketave për investimet direkte dhe investimet në letrat me vlerë. Kjo platformë do të ndihmojë në automatizimin e proceseve të punës, duke rritur efikasitetin dhe produktivitetin e realizimit të punëve të përditshme, sidomos në pranimin dhe validimin e raporteve. Me finalizimin e këtij programi, që pritet gjatë vitit 2025, synohet të rritet funksionaliteti, efektiviteti, dhe mbrojtja e të dhënave. Përveç kësaj, BQK këtë vit është angazhuar edhe në ngritjen e nivelit të cilësisë dhe konsistencës së të dhënave të prodhuara sipas standardeve dhe metodologjisë së rekomanduar nga Eurostat dhe FMN, përditësimin e metodikës së publikuar në faqen e internetit të BQK-së, publikimin e tabelave të reja, shkurtimin e frekuencës së publikimit të treguesve statistikor, avancimin e metodave të procesimit dhe validimit të raporteve statistikore, mirëmbajtjen e faqes “Ekonomia e Kosovës në një shikim”, përpilimin dhe publikimin e kamatëvonesës në transaksionet tregtare dhe instrumentet kreditore, përpilimin dhe raportimin e treguesve të shëndetit financiar, si dhe publikimin e sqarimeve të përmbledhura rreth zhvillimeve kryesore në treguesit ekonomik dhe financiarë të publikuar në faqen e internetit të BQK-së për transparencë dhe njoftim më të saktë të publikut.

7. Menaxhimi i Rezervave dhe Operacionet Bankare

7.1. Menaxhimi i Mjeteve dhe Rezervave

Banka Qendrore e Kosovës menaxhon asetet dhe rezervat e saj dhe është përgjegjëse për administrimin e Sistemit Qendror Depozitar, duke mundësuar realizimin e ankandeve dhe tregtimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Detyrat e menaxhimit të rezervave janë specifikuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht në Nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-209.

7.1.1. Menaxhimi i Investimeve

Banka Qendrore menaxhon rezervat e saj për të arritur objektivat e Politikës së Investimeve të miratuar nga Bordi Ekzekutiv, ku prioritet kanë siguria dhe likuiditeti i mjeteve, para kthimit nga investimet. Gjatë vitit 2024, janë finalizuar marrëveshjet e bashkëpunimit për menaxhimin e rezervave ndërkombëtare me tri banka qendrore partnere: Bankën e Italisë, Bankën Kombëtare të Belgjikës dhe Bankën e Kroacisë. Këto marrëveshje përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të rrjetit të partnerëve strategjikë dhe diversifikimit të mëtejshëm të portofolit të investimeve.

Në të njëjtën kohë, ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me Departamentin e Thesarit të Bankës Botërore (RAMP), me fokus në avancimin e mëtejshëm të politikave për investime. Ky bashkëpunim synon rritjen e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e rezervave në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe zhvillimin e mëtejshëm të kornizës së politikave dhe praktikave operacionale të investimeve.

7.1.2 Instrumentet


Rezervat në portfolion e BQK-së përbëhen nga instrumentet e portfolios të cilat klasifikohen si likuide dhe me gradë investuese. Kategoria e rezervave likuide përbëhet prej instrumenteve që mirëmbahen për të siguruar mjete të mjaftueshme për realizimin e pagesave dhe transfereve sipas nevojave të BQK-së dhe depozitorëve të saj. Ndërsa kategoria e mjeteve investuese përbëhet nga instrumentet financiare të sigurta, me vlerësim kreditor investiv që gjithashtu janë lehtësisht të tregtueshme.

Për të siguruar mjaftueshmëri të fondeve likuide për realizimin e transfereve ndërkombëtare të depozitarëve të BQK-së, mjetet në llogarinë rrjedhëse mirëmbahen për të realizuar obligimet afatshkurtëra të BQK-së të cilat për periudhën raportuese përbëjnë nivelin prej 11.1 përqind të portfolios.

Portfolio e rezervave në euro të BQK-së sipas instrumenteve është pasqyruar në grafikun 70, bazuar në gjendjen e datës 31 dhjetor 2024. Sipas këtij grafiku, 38.84 përqind e portofolit është i investuar në

Letra me Vlerë Ndërkombëtare, 2.41 përqind në Letra me Vlerë të gjelbra dhe të qëndrueshmërisë, si dhe 12.84 përqind në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Plasimi

Grafik 70. Portfolio e rezervave (EUR) të BQK-së, sipas gjendjes 31 dhjetor 2024



në depozita bankare në mënyrë që të sigurohet shpërndarje adekuate sipas instrumenteve afatshkurtra është prej 34.81 përqind.

Portfolion investuese të rezervës së BQK-së në të gjitha valutat e përbëjnë këto instrumente financiare:

- depozitat bankare me afat të plasura në bankat Evropiane me rangim adekuat investues, marrëveshjet afatshkurtëra të riblerjes të plasura me bankat vendore dhe Rezervën Federale të SHBA-së;
- Letrat me Vlerë Ndërkombëtare, respektivisht obligacione qeveritare, komunale, supranacionale, agjensive shtetërore apo institucioneve kreditore në euro dhe dollarë me afat maturimi deri në shtatë vite;
- obligacionet shtetërore të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës të tregtuara në tregun sekondar të Letrave me Vlerë me afat maturimi deri në shtatë vite.

Marrëveshjet afatshkurtëra të riblerjes (Repo) me bankat vendore të Republikës së Kosovës kanë vazhduar të plasohen përgjatë vitit 2024 dhe përbëjnë një instrument të rëndësishëm të tregut vendor të parasë. Përmes këtij instrumenti BQK u ofron likuiditet të shpejtë bankave vendore në rast nevojë për periudhë prej një deri në dhjetë ditë kundrejt kolateralit, respektivisht Letrave me Vlerë të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky instrument u ndihmon obligacioneve qeveritare të trajtohen si instrumente më likuide duke u ofruar mbajtësve të tyre qasje të lehtë në financim përmes kolateralit.

Gjatë vitit 2024, BQK ka vazhduar të jetë pjesë e linjës kreditore të ofruar nga Eurosistemi përmes Deutsche Bundesbank. Përmes kësaj linje kreditore, Banka Qendrore Evropiane i ka ofruar mundësinë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të marrë hua nga pakoja e likuiditetit të Eurosistemit kundrejt kolateralit adekuat në euro të përbërë nga Letra me Vlerë të tregtueshme të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të Eurozonës dhe institucionet supranacionale. Kjo linjë kreditore adreson nevojat e mundshme të likuiditetit në euro të BQK-së në rast të kërkesave eventuale, duke i mundësuar hua deri në 100 milion euro nga Banka Qendrore Evropiane. Linja kreditore do të qëndrojë në fuqi deri në datën 31 janar 2027, me mundësi të zgjatjes së afatit.


7.1.3 Valutat

Përbërja valutore e portfolios së rezervave të BQK-së konsiston në euro dhe dollar amerikan. Siç shihet në grafikun 71, euro rezervat në dispozicion në portfolion e BQK-së kanë shënuar zbritje marginale në 1,326 milionë euro në vitin 2024 nga 1,332 milionë euro në vitin paraprak, për shkak të lëvizjeve të fondeve të depozitarëve të BQK-së.

Prej rreth 4.5 përqind e portfolios së rezervave mbahet në dollar amerikan, të investuara në plasmane një-ditore me

normën e interesit të kuotuar nga marrëveshjet e riblerjes me Bankën e Rezervës Federale të ShBA-ve, depozita të afatizuara dhe letra me vlerë afatshkurtëra të emetuara dhe paguara nga thesari Amerikan me afat maturimi deri në një vit në kuadër të programit automatik të investimeve me Bankën e Rezervës Federale (Automatic Investment Programme). Në vitin 2024,

Grafik 71. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në EUR (mil) sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2025)

rezervat në dollar amerikan kanë shënuar një rritje të konsiderueshme, kryesisht si rezultat i rritjes së ekspozimit ndaj dollarit amerikan përmes blerjes shtesë të bonove të thesarit. Si rrjedhojë, grafiku 72 pasqyron një rritje nga 10.98 milionë dollar amerikan në vitin 2023 në 61.66 milionë dollar amerikan në vitin 2024. Shpërndarja e aseteve në dy valutat përkatëse bëhet në bazë të përmbajtjes së rezervave të BQK-së nga depozitarët e saj, të cilat kryesisht mbahen në valutën euro.

7.1.4 Shpërndarja


Në përputhje me objektivat e Politikës së Investimeve të BQK-së, plasmani i investimeve të rezervave është përqendruar në instrumentet financiare të sigurta dhe likuide, respektivisht në instrumente borxhi apo obligacione me maturitet maksimal deri në shtatë vite dhe rangim kreditor adekuat.

Gjatë vitit 2024 shpërndarja e portfolios është realizuar me fokus në kategorinë e aseteve likuide, lehtësisht të konvertueshme dhe me treg të zhvilluar siç janë letrat me vlerë sikurse bonot e thesarit dhe obligacionet. Rrjedhimisht, 41.3 përqind e portfoliut është investuar në letra me vlerë ndërkombëtare, të cilat përfaqësojnë instrumentet kryesore likuide me pjesëmarrjen më të lartë në portfolin e BQK-së. Letrat me Vlerë Kombëtare përbëjnë prej 12.8 përqind të portfolios, ndërsa depozitat bankare përbëjnë 34.8 përqind, dhe mjetet e mbajtura në llogari rrjedhëse prej 11.1 përqind, siç pasqyrohet në grafikun 73.

Në portfolion e letrave me vlerë rëndësi të veçantë i kushtohet shpërndarjes gjeografike, shpërndarjes sipas emetuesve dhe kushtit që këto letra të njihen si kolateral i pranueshëm nga Banka Qendrore Evropiane.


Ndryshimet e fundit në normat e interesit nga Banka Qendrore Evropiane dhe Rezerva Federale e ShBA-së kanë ndikuar në normat e tregut ndërbankar dhe tregut të borxheve. Këto zhvillime kanë mundësuar pozicionimin e portfolios në instrumente me kthime sipas normave të tregut të Eurosistemit dhe Bankës së Rezervës Federale në ShBA.

Grafik 72. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në USD (mil) sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse




Burimi: BQK (2025)

Grafik 73. Raporti i shpërndarjes së portfolios investuese në EUR të BQK-së (në përqindje)



Burimi: BQK (2025)

Grafik 74. Raporti i shpërndarjes së portfolios investuese në EUR të BQK-së (në përqindje)




Burimi: BQK (2025)

Sikurse në vitin paraprak, shpërndarja e portfolios së BQK-së në Letra me Vlerë është realizuar nga kushtet e tregut dhe çmimet për obligacionet qeveritare, supranacionale, agjensive dhe institucioneve kreditore të emetuara dhe paguara në euro.

Norma depozitare në tregun ndërbankar në euro bazohet në normën e vendosur nga Banka Qendrore Evropiane për depozita e cila gjatë vitit 2024 ka variuar nga 4 përqind në janar deri në uljen e fundit në 3 përqind në dhjetor 2024.¹⁰

Në vitin 2024 shpërndarja në Letra me Vlerë Ndërkombëtare ka shënuar ngritje krahasuar me vitin paraprak, siç shihet në grafikun 75. Ndryshimin kryesor në strukturën e shpërndarjes së portfolios e shohim tek depozitat bankare ku kjo kategori asetesh ka në fillim të vitit ka shënuar ngritje të konsiderueshme, si rezultat i ngritjes së normës depozitare nga Banka Qendrore Evropiane dhe mundësive për plasmane në tregun ndërbankar të bankave Qendrore dhe Komerciale të Eurosistemit. Kjo shpërndarje i mundëson BQK-së që të mbajë likuiditet të mjaftueshëm në portfolion e saj të rezervave, njëkohësisht duke kontribuar në ruajtjen e sigurisë së portfolios dhe realizimit të kthimit nga investimi nga kjo kategori e asetëve.

Grafik 75. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit (në milionë euro)



Burimi: BQK (2025)

7.1.5. Performanca e portfolios

Instrumentet në portfolion e BQK-së kanë treguar performancë të lartë duke realizuar 27.74 milionë euro të hyra neto nga të gjitha kategoritë e investimeve në të gjitha kategoritë e asetëve të portfolios, përfshirë diferencën në mes të hyrave dhe shpenzimeve nga normat e aplikuara ndaj llogarive depozitare. Kjo vlerë përfaqëson një rritje prej 8.4 përqind në të hyrat e fituara krahasuar me vitin e kaluar.

7.1.6. Menaxhimi i rrezikut në investimin e rezervave

Investimi i mjeteve bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet, agjencitë më kredibile të Eurozonës, dhe institucionet supranacionale me vlerësim kreditor investiv sipas vlerësimeve nga Agjencitë Kreditore ndërkombëtare: Standard & Poor's dhe Moody's si dhe në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës.

Rreziqet financiare gjatë investimit të mjeteve nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku likuiditetit, rreziku valutor dhe rreziku operacional.

Rreziku kreditor - Portofolio e investimeve është shpërndarë në mënyrë që të mbahet rreziku kreditor në nivel të ulët. Të gjitha investimet janë realizuar në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër dhe afatgjatë kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) për afat të shkurtër dhe Baa2/BBB (Moody's/S&P) për afat të gjatë, si dhe në rastet e jashtëzakonshme në treg, me P-3/A-3 për afat të shkurtër dhe Baa3/BBB- (Moody's/S&P) për afat të gjatë.

Rreziku i normës së interesit - menaxhimi i rrezikut të normave të interesit nga BQK kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve

¹⁰ https://www.ecb.europa.eu/stats/policy_and_exchange_rates/key_ecb_interest_rates/html/index.en.html

dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit.

Rreziku i likuiditetit - është rreziku në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve nga detyrimet e saj financiare. Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Rreziku valutor - paraqitet si pasojë e lëvizjeve të kursit këmbimor që implikojnë vlerën e valutave në tregun financiar ku mund të paraqitet kthimi apo humbja si rezultat i ndryshimeve të kursit këmbimor.

Rreziku operacional - është rreziku i përmbushjes që ka të bëjë me plasmanin e depozitave, tregtimin e letrave me vlerë dhe pagesën me kohë të tyre.

7.1.7 Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës

Në pajtim me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, BQK vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në procesin e emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke realizuar ankandet e organizuara.

Sipas kalendarit vjetor të emetimeve të Letrave me Vlerë të publikuar nga Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 16 ankande për emetimin e Letrave me Vlerë me afat maturimi nga 1 deri në 10 vite.

Grafiku 76 paraqet strukturën sipas maturimit të Letrave me Vlerë të emetuara në tregun primar, shprehur në përqindje, ku dominojnë emetimet me afat maturimi 5 dhe 3 vjeçar. Grafiku 77 paraqet fondet e investuara në tregun primar sipas kategorisë së investitorit.¹¹

Në grafikun 78 shihen normat mesatare vjetore të kthimit në investim sipas maturitetit, nga ku shihet rritje krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, në grafikun 79 janë paraqitur ankandet e realizuara me sukses, ku shihet se kërkesa më e madhe nga tregu ishte për Letra me Vlerë me afat maturimi nga 2 deri 5 vite.

Grafik 76. Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit





Figura 77. Struktura e investitorëve në ankandet e letrave me vlerë




¹¹ Pjesëmarrës në tregun primar të Letrave me Vlerë të Qeverisë janë bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit si dhe personat juridik dhe fizik duke vepruar përmes bankave komerciale.

Gjithsej vëllimi i shitblerjeve¹² të Letrave me Vlerë ndërmjet pjesëmarrësve në tregun sekondar gjatë vitit 2024 ishte 77.6 milionë euro, i cili krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 68.6 milionë euro, shënoi rritje prej 13.2 përqind.


Ndërsa, për qëllime të huadhënies afatshkurtër të mbështetur me kolateral Letra me Vlerë të Qeverisë, gjithsej vëllimi i transaksioneve të riblerjeve të Letrave me Vlerë gjatë vitit rezultoi me 64.0 milionë euro, krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 67.6 milionë euro, duke shënuar rënie prej 5.2 përqind.

Grafik 78. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2023 dhe 2024, në përqindje



Burimi: BQK (2025)

Grafik 79. Ankandet e Letrave me Vlerë gjatë vitit 2024



Burimi: BQK (2025)

Me qëllim të menaxhimit sa më efikas të ofrimit të likuiditetit nga BQK-ja për sektorin bankar bazuar në huadhënien brenda-ditore të mbështetur me kolateral Letra me Vlerë, vëllimi i kërkesave nga sektori bankar ishte gjithsej 358.3 milionë. Krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 592.5 milionë euro, shënoi rënie prej 39.5 përqind.

7.2. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

BQK në kuadër të operacioneve të menaxhimit të parave të gatshme siguron furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro. Për realizimin e këtij funksioni BQK mban dhe administron rezervat valutore, rregullon dhe përcakton standardet për Institucionet Financiare në fushën e operacioneve me para të gatshme që kanë të bëjnë me kontrollin dhe riqarkullimin e kartëmonedhave dhe monedhave si dhe obligimin për tërheqjen nga qarkullimi të parave të dyshuara si të falsifikuara dhe atyre të papërshtatshme për riqarkullim duke përfshirë kriteret për këmbimin e parave të dëmtuara.

Gjatë vitit 2024 BQK-ja përmbushi në mënyrë të suksesshme funksionin e furnizimit të ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro.


¹² Pjesëmarrës në tregun sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë ishin fondet pensionale, bankat komerciale, personat fizik duke vepruar përmes bankave komerciale dhe institucionet publike.

Tabela 29. Shuma dhe vëllimi i aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve me para të gatshme


Llojet e operacioneve	2020	2021	2022	2023	2024
Rritja vjetore e shumës së operacioneve me kartëmonedha	-12.17%	29.31%	28.18%	12.59%	2.64%
Shuma e operacioneve me kartëmonedha (në euro)	3,143,483,655	4,064,682,790	5,210,009,170	5,865,873,880	6,020,805,090
Pranimi i kartëmonedhave	1,449,545,855	2,087,439,200	2,499,965,400	2,735,521,340	2,988,237,500
Furnizimi me kartëmonedha	1,093,937,800	967,243,590	981,543,770	871,352,540	937,567,590
Eksporti i kartëmonedhave	475,000,000	950,000,000	1,700,000,000	2,215,000,000	2,075,000,000
Import i kartëmonedhave	125,000,000	60,000,000	28,500,000	44,000,000	20,000,000
Rritja vjetore e vëllimit të operacioneve me kartëmonedha	5.17%	18.98%	21.51%	12.76%	5.08%
Vëllimi i operacioneve me kartëmonedha (në copë)	68,618,553	81,643,508	99,201,043	111,862,413	117,541,912
Pranimi i kartëmonedhave	29,268,128	40,173,242	45,151,268	49,980,419	54,605,837
Furnizimi me kartëmonedha	25,258,425	19,627,266	19,016,775	19,159,994	20,669,075
Eksporti i kartëmonedhave	9,672,000	18,128,000	32,333,000	38,072,000	38,267,000
Import i kartëmonedhave	4,420,000	3,715,000	2,700,000	4,650,000	4,000,000
Rritja vjetore e shumës së operacioneve me monedha	-33.87%	-5.80%	28.59%	385.59%	52.27%
Shuma e operacioneve me monedha (në euro)	2,408,470	2,268,716	2,917,422	14,166,836	21,572,088
Pranimi i monedhave	0	290,000	180,362	20,000	7,993,818
Furnizimi me monedha	1,045,470	1,367,716	1,616,060	2,414,836	4,578,270
Eksporti i monedhave	0	0	0	0	9,000,000
Import i monedhave	1,363,000	611,000	1,121,000	11,732,000	0
Rritja vjetore e vëllimit të operacioneve me monedha	-46.71%	47.18%	58.47%	67.35%	-44.92%
Vëllimi i operacioneve me monedha (në copë)	9,379,000	13,803,957	21,874,635	36,606,123	20,162,029
Pranimi i monedhave	0	160,500	180,185	20,000	5,129,209
Furnizimi me monedha	5,379,000	7,743,457	10,544,450	12,786,123	10,132,820
Eksporti i monedhave	0	0	0	0	4,900,000
Import i monedhave	4,000,000	5,900,000	11,150,000	23,800,000	0

Burimi: BQK (2025)

Krahasuar me vitin e kaluar, gjatë vitit 2024 aktivitetet e përgjithshme të operacioneve me kartëmonedha shënuan një rritje grupore prej 2.64 përqind (shprehur në vlerë) dhe një rritje grupore prej 5.08 përqind (shprehur në vëllim) ndërsa aktivitetet e përgjithshme të operacioneve me monedha shënuan një rritje grupore prej 52.27 përqind (shprehur në vlerë) dhe një rënie grupore prej 44.92 përqind (shprehur në vëllim).

Grafik 80. Furnizimi me para të gatshme, (vlera) në milionë euro


Burimi: BQK (2025)

Grafik 81. Pranimi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro

Burimi: BQK (2025)


Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2024, shënoi një rritje prej 7.83 përqind krahasuar me vitin 2023.

Grafik 82. Furnizimi i parave të gatshme, (vëllimi) në milionë copë



Burimi: BQK (2025)

Grafik 83. Pranimi i parave të gatshme, (vëllimi) në milionë euro



Burimi: BQK (2025)

Gjatë vitit 2024, BQK-ja e furnizoi sektorin bankar me mbi 20.67 milionë copë kartëmonedha euro (në vlerë prej mbi 937.57 milionë euro) dhe me mbi 10.13 milionë copë monedha euro (në vlerë prej mbi 4.58 milionë euro). Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk pati ndonjë ndryshim nga viti 2023 në vitin 2024. Te kartëmonedhat euro vëllimet e kërkesave për furnizim gjatë vitit 2024 shënuan një rritje prej 7.88 përqind krahasuar me vitin 2023 dhe vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet me prerje prej 5, 20 dhe 100 euro te cilat përbenin rreth 85.73 përqind të kërkesës vëllimore për furnizim.


Gjatë vitit 2024 kërkesa për denominimet në vlerë prej 200, 100 dhe 50 euro shënoi një rritje grupore prej 4.10 përqind, përderisa kërkesa për denominimet në vlerë prej 20, 10 dhe 5 euro shënoi një rritje grupore prej 10.53 përqind krahasuar me vitin 2023.

Vëllimet e kërkesave për furnizim me monedha gjatë vitit 2024 shënuan një rënie prej rreth 20.75 përqind krahasuar me vitin 2023. Kjo rënie e kërkesës gjatë vitit 2024 kryesisht ka ndodhur për shkak të furnizimeve të shtuara me vëllime të monedhave në fund të dhjetorit 2023 si rezultat i masave kundër parave të falsifikuara dhe furnizimit të ekonomisë me monedha plotësisht të reja. Kërkesa për furnizim me monedha euro në vitin 2024 u dominua nga monedhat me vlerë të vogël prej 1, 2 dhe 5 euro cent të cilat përbenin rreth 52.04 përqind të kërkesës për furnizim.

Krahasuar me vitin paraprak kërkesat për denominimet prej 1, 2 dhe 5 euro cent kanë shënuar një rënie grupore prej 38.18 përqind, ndërsa kërkesat për furnizim me denominimet prej 2 dhe 1 euro kanë shënuar një rritje grupore prej 137.39 përqind në raport me vitin paraprak. Rritja e kërkesave për denominimet prej 2 dhe 1 euro erdhi kryesisht si rezultat i masave kundër parave të falsifikuara dhe furnizimit të ekonomisë me monedha plotësisht të reja.


Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje prej 9.53 përqind në vitin 2024 krahasuar me vitin paraprak. Të shprehura në vlerë, depozitat e parave të gatshme arritën shumat prej afër 2.99 miliardë kartëmonedha euro dhe mbi 7.99 milionë monedha euro përkatësisht. Për sa i përket vëllimit, BQK-ja pranoi nga sektori bankar afër 54.61 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 220,000 copë kartëmonedha në ditë), ndërsa depozitat e monedhave ishin 5.13 milionë copë. Vëllimet e kartëmonedhave të pranuar si depozita gjatë vitit 2024 shënuan një rritje prej rreth 9.25 përqind krahasuar me vitin 2023 ndërsa tek monedhat si rezultat i masave kundër parave të falsifikuara rritja ishte shumë e lartë.

Grafik 84. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2025)


Grafik 85. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2025)


Struktura e kartëmonedhave euro të pranuar si depozita gjatë vitit 2024 nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak kurse siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm depozitat e monedhave (sidomos tek denominimet prej 2 dhe 1 euro) ishin në një nivel më të lartë se në vitin 2023 si rezultat i masave kundër parave të falsifikuara (tërheqja prej ekonomisë të monedhave në qarkullim në njërën anë dhe furnizimi i i saj me monedha plotësisht të reja në anën tjetër).

Grafik 86. Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2025)

Grafik 87. Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2025)

Ngjashëm me vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2024 paratë e gatshme të pranuar si depozita ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, gjatë vitit 2024 paratë e gatshme neto¹³ (tepricat) ishin rreth 2.05 miliardë euro, shumë kjo që ishte dukshëm më e lartë se sa në vitin e kaluar kur paratë e gatshme neto ishin rreth 1.86 miliardë euro. Kjo rritje e parave të gatshme neto ishte kryesisht si rezultat i rritjes domethënëse të vëllimit të depozitave të parave të gatshme nga sektori bankar në njërën anë dhe rritjes së moderuar të kërkesës për para të gatshme krahasuar me vitin paraprak në anën tjetër.


BQK-ja mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, ndërsa tepricat dërgohen¹⁴ në Eurozonë, ku mëpastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat¹⁵ jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2024 arritën shumën prej 2.06 miliardë euro duke qenë më e ulët për 4.41 përqind se sa një vit më parë kur ishin 2.16 miliardë euro.

¹³ Depozitat minus Tërheqjet e parave të gatshme

¹⁴ Depozitohen në llogaritë e BQK-s të mbajtura në bankat korrespondente të Eurozonës


¹⁵ Importet minus Eksportet e parave të gatshme

Grafik 88. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2025)


Grafik 89. Importi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2025)


Përkundër rritjes së parave të gatshme neto, rënia neto e dërgesave në vitin 2024, është rezultat i zvogëlimit të gjendjes së rezervave valutore të mbajtura në BQK gjatë vitit 2023 në njërin anë dhe rritjes së moderuar të kërkesës për para të gatshme në vitin 2024 në anën tjetër.

Grafik 90. Eksporti i parave të gatshme (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2025)

Grafik 91. Importi i parave të gatshme (vëllimi), në milionë copë




Burimi: BQK (2025)

Gjatë vitit 2024 rreth 54.6 milionë copë kartëmonedha euro të pranuar si depozita nga sektori bankar u procesuan duke u kontrolluar për autenticitet dhe duke u klasifikuar sipas shkallës së përshtatshmërisë. Kontrolli për autenticitet dhe klasifikimi sipas shkallës së përshtatshmërisë i një vëllimi kaq të madh të kartëmonedhave ka kontribuar dukshëm në mbrojtjen e integritetit të kartëmonedhave euro në qarkullim si dhe mundësimin e detektimit të falsifikimit duke siguruar kështu që të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro të futura në qarkullim të kishin një gjendje të mirë kualitative (të përshtatshme për riqarkullim) në mënyrë që të sigurohej se këto të fundit mund të kontrollohen për vërtetësinë e tyre.


Rreth 18.72 milionë copë kartëmonedha euro (34.28 përqind e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2024 u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim (të vjetërsuara/dëmtuara) dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi vazhdoi të kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës si parakusht i mbrojtjes së integritetit të valutës zyrtare në qarkullim.

Grafik 92. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2025)


Grafik 93. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar, në përqindje



Burimi: BQK (2025)


Ngjashëm me vitet e kaluara, kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim, ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro. Ato përbënin rreth 87.74 përqind të vëllimit të kartëmonedhave të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi për shkak të përdorimit më të shpeshtë nga qytetarët.

Grafik 94. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2025)


Grafik 95. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar (në përqindje)



Burimi: BQK (2025)


Cilësia e parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës u përmirësua gjithashtu edhe përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2024, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 4.58 milionë copë kartëmonedha të reja euro (22.14 përqind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara gjatë vitit).

Grafik 96. Kartëmonedha të reja te futura ne qarkullimi (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2025)

Grafik 97. Kartëmonedha te reja te futura ne qarkullim (vëllimi) nga gjithsej të furnizuara, në përqindje




Burimi: BQK (2025)

Rreth 96.92 përqind e sasisë së kartëmonedhave të reja të furnizuara (futura në qarkullim) gjatë vitit 2024 ishin kartëmonedha të denominimeve me vlerë të ulët (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat u furnizuan bankat komerciale me qëllim të furnizimit dhe shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Për më tepër, edhe të gjitha kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim


euro me te cilat u furnizuan bankat komerciale ishin të një cilësie të lartë (të përshtatshme për riqarkullim).

Grafik 98. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: BQK (2025)

Grafik 99. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara (në përqindje)




Burimi: BQK (2025)

7.2.1 Lufta kundër parave të falsifikuara dhe aktivitetet në zbatim të masave rregullative

Me qëllim të ruajtjes së integritetit të euros në qarkullim saj, lufta kundër parave të falsifikuara ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2024.


Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, gjatë vitit 2024 janë analizuar/raportuar ¹⁶ një numër prej 1,346 kartëmonedhash dhe 41,072 monedhash të falsifikuara. Pjesa më e madhe e këtyre kartëmonedhave dhe monedhave janë konfiskuar nga institucionet financiare gjatë aktivitetit të tyre të rregullt.

Grafik 100. Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2025)

Grafik 101. Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2025)


Ngjashëm me vitin paraprak, në vitin 2024 kartëmonedhat më të falsifikuara kanë qenë ato të prerjes prej 100 dhe 50 euro të cilat përbënin rreth 74.9 përqind të të gjitha kartëmonedhave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi. Ndërsa, sa i përket monedhave në vitin 2024 ashtu sikurse edhe në vitin e kaluar monedha më e falsifikuar ishte ajo në prerje prej 2€ e cila përbënte rreth 98.6 përqind të gjithë numrit të monedhave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi.

Ndërlidhur me situatën e krijuar gjatë vitit 2023 me dukurinë e qarkullimit të monedhave 2 euro të falsifikuara, BQK, në kuadër të kompetencave të saj, gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2023 pati zhvilluar disa takime me institucionet përgjegjëse në luftën kundër parave të falsifikuara me qëllim të koordinimit ndër-institucional për luftimin e kësaj dukurie. Nga takimet ndër-institucionale, institucionet përgjegjëse ishin dakorduar për masa specifike afatshkurtëra të veprimit, masa këto që parashihnin ndërmarrjen e veprimeve parandaluese nga secili institucion sipas fushave të përgjegjësive me qëllim të luftimit dukurisë së parave të falsifikuara. Përpjekjet

¹⁶ Kartëmonedha dhe monedha të rezultuara si të falsifikuara pas analizave


e përbashkëta ndër-institucionale gjatë gjithë vitit 2024 rezultuan me një luftë të suksesshme ndaj parasë se falsifikuar në fushat e përgjegjesisë të secilit institucion pa përjashtim.

Grafik 102. Monedhat euro të falsifikuara te konfiskuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2025)

Grafik 103. Monedhat euro të falsifikuara te konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2025)

Më konkretisht, në zbatim të këtyre masave, gjithnjë në kuadër të kompetencave të saj, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me Bankat komerciale, në fillim të muajit dhjetor 2023 filloj me zbatimin e masave specifike të veprimit si:

1. Heqja e tarifës për depozitim të monedhave dhe stimulimit të depozitimit të monedhave
 - a. Heqja e tarifës për depozitim të monedhave në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, efektive prej datës 11 dhjetor 2023;
 - b. Udhëzimi i bankave komerciale që të njejtën praktikë të aplikojnë kundrejt klientëve të tyre;
 - c. Heqja e tarifës për depozitim të monedhave nga Bankat komerciale, efektive prej fundit të muajit dhjetor 2023;
2. Sigurimi i furnizimit të ekonomisë përmes Bankave komerciale me monedha plotësisht të reja të denominimeve prej 2 dhe 1 euro

Në zbatim të masës së heqjes së tarifës për depozitim të monedhave në sektorin bankar, dhe stimulimit të depozitimit të monedhave, gjatë vitit 2024 janë tërhequr nga qarkullimi dhe deponuar në BQK rreth 4.35 milionë copë monedha të denominimeve prej 2€ dhe 1€, prej të cilave 3.51 milionë copë monedha të denominimeve prej 2 euro dhe 835 mijë copë monedha të denominimeve prej 1 euro, monedha këto të deponuara nga bizneset dhe qytetarët në bankat komerciale pa asnjë tarifë të aplikuar. Përmes kësaj mase, BQK-ja dhe bankat komerciale kanë detektuar dhe tërhequr nga qarkullimi afër 84 mijë copë monedha të denominimeve prej 2 euro, të dyshuara si të falsifikuara të cilat janë dorëzuar tek autoritetet përgjegjëse për analizë të mëtutjeshme.

Në zbatim të masës së sigurimit të furnizimit të ekonomisë përmes Bankave komerciale me monedha plotësisht të reja, BQK-ja ka furnizuar ekonominë e Republikës së Kosovës përmes bankave komerciale me afër 10.13 milionë copë monedha euro plotësisht të reja të të gjitha denominimeve në shumë prej afër 4.58 milionë euro pa asnjë tarifë të aplikuar. Ky angazhim ka kontribuar në zvogëlimin e qarkullimit të monedhave false, ka lehtësuar identifikimin dhe ka ngritur ndërgjegjësimin e publikut për këtë çështje. Për më shumë, BQK-ja furnizoj ekonominë e Republikës së Kosovës përmes bankave komerciale me afër 20.7 milionë copë kartëmonedha euro plotësisht të reja dhe të përshtatshme për riqarkullim. Shuma e kartëmonedhave të lëshuara në qarkullim ishte afër 937.6 milionë euro.

Ne aspektin rregullativ, me qëllim të parandalimit të parave të falsifikuara dhe luftës kundër informalitetit dhe dukurive të ndërlydhura, në fillim të vitit 2024 gjegjësisht prej 1 shkurt 2024, përmes Rregullores për Operacione me Para të Gatshme ndër të tjera filluan të zbatohen masat rregullative si:

1. Rregullimi i transportit ndërkufitar të monedhave - Përmes këtij rregullimi synohet që në vazhdimësi të bëhet parandalimi i futjes së monedhave të falsifikuara në Republikën e Kosovës, përmes të cilit rregullim personat fizikë dhe personat juridikë që nuk ushtrojnë veprimtari financiare, do të jenë të obliguar që të bëjnë deklarin e monedhave nëse bartin më shumë se 100 copë/njësi, pavarësisht që vlera e tyre është nën kufirin e deklaramit prej 10,000 (dhjetëmijë) euro.
2. Ndalimi i ri-qarkullimit të kartëmonedhës prej 500 euro - Përmes këtij rregullimi është dhënë kontribut dhe ndihmë në aspektin e strategjisë përkatëse kundër shpëlarjes së parave, informalitetit dhe dukurive të ndërlidhura. Përmes këtij rregullimi u ndalua riqarkullimi i kartëmonedhës prej 500 euro nga institucionet financiare edhe pse rregullimi nuk e ndalon qarkullimit e kartëmonedhës prej 500 euro ndërmjet palëve si mjet i ligjshëm i pagesës.
3. Rregullimi i transportit ndërkufitar të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera - Përmes këtij rregullimi behet kontrolli i plotë i parave të gatshme që hyjnë dhe dalin nga Republika e Kosovës përmes institucioneve financiare për mundësimin e modelimit të vlerësimit të parasë në qarkullim. Përmes këtij rregullimi, importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës mund të bëhet vetëm për dhe nga institucionet financiare bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare bankare.
4. Rregullimi i procedurave dhe detyrimet për ofruesit e shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti - Përmes këtij rregullimi Institucionet financiare jo-bankare që janë të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, të cilat ofrojnë llogari të pagesave dhe parave elektronike, duhet të marrin licencën dhe autorizimin shtesë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e shërbimit të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme, apo blerjen dhe rikthimin e parave elektronike përmes makinave që përdoren nga klienti. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të ofrojë shërbime të depozitimit apo të tërheqjes së parave të gatshme përmes ndonjë lokacioni me shërbim fizik apo përmes ndonjë pajisje apo makine që përdoret nga klienti, në emër të ofrimit të shërbimeve financiare pa posedim të licencës dhe autorizimit nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
5. Rregullimi i importimit të pajisjeve ose makinave teknike-elektronike që ofrojnë shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave të gatshme - Përmes këtij rregullimi synohet të rregullohet importimi i pajisjeve ose makinave teknike-elektronike për shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave të gatshme ku ky aktivitet mund të bëhet vetëm nga institucionet e licencuara financiare për ofrim të aktiviteteve bankare apo institucionet financiare jo-bankare me shërbime të licencuara për para elektronike dhe shërbimet e pagesave. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të importojë dhe pajiset me makina teknike-elektronike për shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave nëse nuk është i licencuar si institucion financiar për ofrim të aktiviteteve bankare, apo institucion financiar jo-bankar me shërbime të licencuara për para elektronike dhe shërbimet e pagesave.

Në zbatim të masës rregullative të ndalimit të ri-qarkullimit të kartëmonedhës prej 500 euro, gjatë vitit 2024 numri i kartëmonedhave të denominimit prej 500 euro të tërhequra nga qarkullimi dhe deponuara në BQK arriti në 407.5 mijë copë apo 203.75 milionë euro. Ky veprim, ka ndikuar, kontribuar dhe ndihmuar në strategjinë përkatëse kundër informalitetit dhe dukurive të ndërlidhura.

Në zbatim të masës rregullative të rregullimit të transportit ndërkufitar të parave të gatshme, BQK-ja gjatë vitit 2024 ka licencuar 5 institucione financiare për importin dhe eksportin e parave të gatshme dhe për të njëjtat gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 264 autorizime për eksport (kryesisht të valutave jo-euro) në kundërvlerë të tërësishme prej 977.2 milionë euro. Valuta më eksportuar nga institucionet financiare ishte Franka Zvicerane e cila përbente rreth 83.32% të shumës së eksportuar në kundërvlerë euro, e përcjellur nga Funta Angleze me 8.13%, Dollari Amerikan me 7.02% dhe pjesa tjetër kishte të bënte me Krunen Suedeze, Dollarin Kanadez dhe Dollarin Australian dhe Euron që së bashku përbënin rreth 1.53% të shumës së eksportuar në kundërvlerë euro nga institucionet financiare gjatë vitit 2024. Në anën tjetër gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 3 autorizime për import të parave të gatshme në kundërvlerë të tërësishme prej 5.61 milionë euro. Valuta që më u importua nga institucionet financiare ishte Dollari Amerikan me i cili përbente rreth 100% të shumës së importuar dhe u importua për kryerjen e operacioneve të aktiviteteve këmbimore të bankave.

Në vazhden e masave strategjike dhe afatgjata të luftës dhe krijimit të sistemit për luftën kundër parave të falsifikuara, me mbështetje nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, BQK, ka aplikuar në TAIEX për financimin e projektit ‘Krijimi i sistemit për luftën kundër parave të falsifikuara në Republikën e Kosovës’. Kërkesa e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është aprovuar në fillim të shtatorit 2024 dhe do të jetë e ndare në 4 faza. Faza e parë dhe e dytë e projektit TAIEX kanë përfunduar gjatë vitit 2024 kurse fazat tre dhe katër që parashikohen të mbahen në gjysmën e parë të vitit 2025 që parashohin Draftimin e “Ligjit për luftën kundër parave të falsifikuara në Republikën e Kosovës”.

Përmes draftimit të Ligjit për luftën kundër parave të falsifikuara përmes programit TAIEX synohet:

1. Rishikimi i Rregullatave aktuale ligjore për luftën kundër parave të falsifikuara;
2. Draftimi i Ligjit specifik i cili do të specifikojë krijimin e Qendrave Kombëtare Kundër Falsifikimit si dhe do përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion përgjegjës në procesin e parandalimit dhe luftës kundër parave të falsifikuara, duke përfshirë dhe aspektet e funksionimit të sistemit, shkëmbimi i të dhënave dhe monitorimi;
3. Krijimi i Qendrave Kombëtare (NAC, CNAC, NCC dhe NCO)
 - a. Krijimi i Qendrës Kombëtare për Analizën e Kartëmonedhave (NAC) dhe Qendrës Kombëtare për Analizën e Monedhave (CNAC)
 - b. Krijimi Zyrës Qendrore Kombëtare (NCO)
 - c. Krijimi i Qendrës Kombëtare Kundër Falsifikimit (NCC);
4. Krijimi i Sistemit të Monitorimit të Falsifikimeve (KCMS);
5. Krijimi i rregullave/udhëzimeve dhe procedurave specifike nga secili institucion bazuar në Ligjin primar.

7.2.2 Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive të klientëve të BQK-së

BQK-ja ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe institucione të tjera siç janë bankat dhe institucionet të tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-së.

BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave dhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Edhe gjatë vitit 2024 sikurse në vitet paraprake, të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT kurse të gjitha pagesat vendore u realizuan përmes sistemit KIPS, duke shkurtuar kështu kohën dhe duke rritur efektivitetin e procesimit.


Tabela 30. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2020	2021	2022	2023	2024
Transaksionet me para te gatshme	+354,562	+1,119,117	+1,516,986	+1,861,774	+2,054,085
Depozita ne para te gatshme	1,449,546	2,087,729	2,500,146	2,735,541	2,996,231
Terheqje te parave te gatshme	1,094,984	968,612	983,160	873,767	942,146
Transferet vendor	+70,305	+30,021	+34,037	+5,532	+40,391
Transferet vendor ardhesh	110,763	76,421	92,164	95,370	105,957
Transferet vendor dales	40,458	46,400	58,127	89,838	65,566
Transferet nderkombetar	-424,086	-1,068,449	-1,444,209	-1,811,455	-2,094,613
Transferet nderkombetar ardhesh	1,794,963	1,727,337	1,728,325	1,471,546	1,825,009
Transferet nderkombetar dales	2,219,049	2,795,786	3,172,534	3,283,000	3,919,622

Burimi: BQK (2025)


Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së në vitin 2024 u kryen në emër të/dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e operacioneve të pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të/dhe për llogari të AKP-së.¹⁷

Grafik 104. Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse, numri



Burimi: BQK (2025)

Grafik 105. Vlera e transaksioneve vendore dalëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2025)

BQK-ja gjatë vitit 2024 ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 9.02 mijë urdhërpagesa dalëse vendore (një rritje prej 21.81 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 9.75 mijë urdhërpagesa hyrëse (një rritje prej 4.07 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse vendore arrinin shumën prej mbi 65.57 milionë euro (një rënie prej 27.02 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse vendore arrinin shumën prej afër 105.96 milionë euro (një rritje prej 11.10 përqind krahasuar me vitin paraprak). Numri dhe shuma më e madhe e transaksioneve vendore u kryen nga BQK-ja me urdhër dhe për AKP-në.


¹⁷ AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

Grafik 106. Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse, numri



Burimi: BQK (2025)

Grafik 107. Vlera e transaksioneve vendore hyrëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2025)

Sa i përket pagesave vendore dalëse, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato, kurse kompanitë e sigurimit të gjitha pagesat e tyre i kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.


Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për llogari të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kishte të bënte me transferët e fondeve të bankave komerciale dhe Trustit Pensional të Kosovës.

Grafik 108. Vëllimi i transaksioneve nderkombëtare dalëse, numri



Burimi: BQK (2025)

Grafik 109. Vlera e transaksioneve nderkombëtare dalëse, shuma




Burimi: BQK (2025)

BQK-ja gjatë vitit 2024 ka procesuar për dhe në emër të klientëve të saj afër 3,249 urdhërpagesa dalëse ndërkombëtare (një rënie e moderuar prej 1.63 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 1,328¹⁸ urdhërpagesa hyrëse ndërkombëtare (një rënie prej 24.72 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse ndërkombëtare kapnin shumën prej mbi 3.92 miliardë euro (një rritje prej 19.39 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse ndërkombëtare kapnin shumën mbi 1.83 miliardë euro (një rritje prej 24.02 përqind krahasuar me vitin paraprak).


¹⁸ Shumica e pagesave ardhese kanë të bëjnë me transferët e fondeve të bankave komerciale

Grafik 110. Vëllimi i transaksioneve nderkombëtare hyrëse, numri



Burimi: BQK (2025)

Grafik 111. Vlera e transaksioneve nderkombëtare hyrëse, shuma



Burimi: BQK (2025)

Më 31 dhjetor 2024, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës arritën shumën prej rreth 395.42 milionë euro ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej rreth 179.14 milionë euro. Së bashku, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe ato të AKP-së përbënin rreth 43.0 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2024.

Tabela 31. Niveli i depozitave klientëve kryesor (në mijëra euro)

Gjendja e llogarive	2020	2021	2022	2023	2023
Gjithsej gjendja	1,214,559	1,275,801	1,288,150	1,343,340	1,336,308
Institucionet Qeveritare	316,897	423,322	419,664	345,232	395,422
Agjencia Kosovare e Privatizimit	191,457	184,737	165,854	166,373	179,143
Bankat Komercale + Kompanitë e Sigurimeve	571,114	593,910	575,043	594,657	660,291
Të tjera	135,091	73,832	127,589	237,078	101,452

Burimi: BQK (2025)

Bankat komerciale dhe kompanitë e sigurimeve kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në nivelin e depozitave në BQK. Këto depozita kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat dhe obligimet ligjore dhe rregullatore të Bankave komerciale dhe kompanive të sigurimeve. Ato përbënin rreth 49.41 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2024. Më 31 dhjetor 2024, depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit ishin në shumën prej rreth 660.29 milionë euro.

III. Qeverisja dhe zhvillimet e brendshme të BQK-së

1. Bordi i Bankës Qendrore dhe komitetet e tij

Procesi i vendimmarrjes në Bordin e Bankës Qendrore udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës.

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë. Gjithashtu, Bordi i Bankës Qendrore, ka ushtruar mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe të aktiviteteve të Bankës Qendrore.

Gjatë vitit 2024, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur 13 mbledhje në të cilat janë marrë gjithsejtë 29 vendime. Në këtë kuadër, Bordi ka arritur të realizoj pothuajse në mënyrë të plotë Planin Vjetor të Punës për vitin 2024, të miratuar paraprakisht.

Bordi i Bankës Qendrore, si një nga organet vendimmarrëse të BQK-së, duke u bazuar në rekomandimet e Bordit Ekzekutiv ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar, si në vijim:

1. Rregullore për Sistemet dhe Sigurinë e Informacionit për Fondet Pensionale;
2. Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Aktuarët e Sigurimeve;
3. Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit të Siguruesve;
4. Rregullore për Kërkesat e Mbajtjes së Rrezikut dhe Mbulimit përmes Risigurimit;
5. Rregullore për Parimet e Menaxhimit të Rrezikut të Vendit dhe të Transferit;
6. Rregullore për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
7. Rregullore për Informacionet që Shoqërojnë Transferet e Fondeve;
8. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Auditorët e Jashtëm të Institucioneve Mikrofinanciare;
9. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Auditorët e Jashtëm të Institucioneve Financiare Jobankare;
10. Rregullore për Regjistrin e Llogarive;
11. Rregullore për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë;
12. Rregullore për Transaksionet me Personat e Ndërlidhur të Siguruesve;
13. Rregullore për Administrimin Zyrtar dhe Likuidimin e Institucioneve të Pagesave dhe Institucioneve të Parasë Elektronike;
14. Rregullore për Agjentët e Ofruesve të Shërbimeve të Pagesave;
15. Rregullore për Regjistrin Publik të Institucioneve të Pagesave dhe Parasë Elektronike;
16. Rregullore për Kapitalin Fillestar dhe Fondet Vetanake të Institucioneve të Pagesave dhe Institucioneve të Parasë Elektronike;
17. Rregullore për Aranzhmanet e Kontraktimit të Jashtëm;
18. Rregullore për Kërkesat e Mbrojtjes së Fondeve të Aplikueshme për Institucionet e Pagesave dhe Institucionet e Parasë Elektronike;
19. Rregullore për Periudhën Kalimtare për Zbatimin e Ligjit për Shërbimet e Pagesave;

20. Rregullore për Kontabilitet dhe Auditim të Jashtëm të Institucioneve të Pagesave dhe Parasë Elektronike;
21. Rregullore për Kontrollat e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Institucioneve të Pagesave dhe Parasë Elektronike;
22. Rregullore për Kriteret e Përcaktimit të Shumës Minimale Monetare të Sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale ose Garancive të Tjera të Ngjashme;
23. Rregullore për Caktimin e Kërkesave për Transferta dhe Kreditit dhe Transaksionet për Debitimet Direkte në Euro;
24. Rregullore për Autorizimin, Miratimin Paraprak dhe Qeverisjen e Institucioneve të Pagesave dhe Parasë Elektronike, si dhe Regjistrimin e Ofruesve të Shërbimeve të Informacionit të Llogarisë;
25. Rregullore për Standardet Teknike për Autentifikim të Thelluar të Klientit dhe Standardet e Hapura, të Përbashkëta dhe të Sigurta të Komunikimit;
26. Rregullore për Njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës për Incidente Madhore Operacionale apo të Sigurisë;
27. Rregullore për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit - Menaxhimi i Rrezikut të Teknologjisë Informative dhe Sigurisë;
28. Rregullore për Trajtimin e Ankesave nga Institucionet Financiare;
29. Rregullore për Procedurat e Shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative.

Bordi i Bankës Qendrore, gjithashtu ka miratuar:

- Raportin vjetor të BQK-së për vitin 2023;
- Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2023 dhe Raportin e Auditorit të Pavarur;
- Buxhetin Vjetor të BQK-së për vitin 2025;
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së;
- Strukturën Organizative të Bankës Qendrore;
- Planin Strategjik të Bankës Qendrore 2024-2028;
- Planin Vjetor (të punës) të Bordit të Bankës Qendrore për vitin 2025;
- Planin Vjetor (të punës) të Auditimit të Brendshëm për vitin 2025.

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar.

Gjithashtu, Bordi ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmoni me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2024, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Bashkim Nurboja, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore;

Nora Latifi Jashari, anëtare;

Nexhat Kryeziu, anëtar;

Arta Hoxha, anëtare; dhe

Ahmet Ismaili, Guvernator/anëtar.

1.1. Komiteti i Auditimit (KA)

Komiteti i Auditimit (KA) është organ këshillues i emëruar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) në përputhje me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Komiteti mbështet Bordin e Bankës Qendrore në përmbushjen e detyrimeve të tij mbikëqyrëse në fushat e kontrollit të brendshëm, menaxhimit të rrezikut, qeverisjes institucionale dhe raportimit financiar.

Misioni i Komitetit është të ofrojë mbikëqyrje të pavarur dhe këshilla mbi:

- Cilësinë dhe integritetin e pasqyrave vjetore financiare;
- Pajtueshmërinë me kornizën ligjore dhe rregullatorë, përfshirë Kodin e Etikës;
- Funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Proceset e menaxhimit të rrezikut;
- Pavarësinë dhe objektivitetin e funksionit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Marrëdhënien dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Auditimit të Brendshëm dhe Auditimit të Jashtëm.

Përbërja, mandati dhe detyrat e Komitetit janë të përcaktuara në Statutin përkatës të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore, ndërsa Komiteti raporton rregullisht mbi aktivitetet dhe vlerësimet e tij.

Përbërja:

Më 31 dhjetor 2024, Komiteti i Auditimit përbëhej nga:

- Nora Latifi-Jashari, Kryetare;
- Nexhat Kryeziu, Anëtar;
- Edona Perjuci-Uka, Anëtare e Jashtme.

Aktivitetet gjatë vitit 2024:

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, Komiteti i Auditimit zhvilloi gjithsej tetë (8) takime. Në përputhje me Planin Vjetor të Punës të miratuar, Komiteti ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara duke inkurajuar përmirësimin e zbatimit të politikave, procedurave dhe standardeve më të mira në të gjitha nivelet e Bankës.

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Këshillimin e Menaxhmentit lidhur me përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Shqyrtimin e raporteve të Auditimit të Brendshëm, përfshirë gjetjet dhe rekomandimet përkatëse;
- Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe vlerësimi i çështjeve që lidhen me opinionet e auditimit të jashtëm;

- Diskutimin mbi rezultatet e vlerësimit të jashtëm për funksionin e Auditimit të Brendshëm;
- Miratimin e Planit Vjetor të Komitetit të Auditimit për vitin 2025;
- Shqyrtimin e Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2025-2027;
- Miratimin e Planit Vjetor të Punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025;
- Shqyrtimi dhe përcjellja e çështjeve të ngritura nga Auditimi i Jashtëm;
- Vlerësimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet funksionit të Auditimit të Brendshëm dhe Auditorit të Jashtëm;
- Mbrojtjen e pavarësisë funksionale të Shefit të Auditimit të Brendshëm;
- Vlerësimin e përshtatshmërisë së burimeve njerëzore të Auditimit të Brendshëm;
- Këshillimin mbi përmirësimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm;
- Sigurimin e dokumentimit të plotë të takimeve dhe raporteve të trajtuara.

Rishikimi dhe përditësimi i kornizës rregullative:

Në bashkëpunim me Shefin e Auditimit të Brendshëm, Komiteti ka rishikuar dhe përditësuar Statutin e Komitetit dhe Statutin e Auditimit të Brendshëm. Të dy dokumentet janë miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore pas shqyrtimeve përkatëse. Gjithashtu, është rishikuar dhe përditësuar edhe Metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut të Auditimit të Brendshëm.

Shkëmbimi i Përvojave:

Në funksion të forcimit të kapaciteteve institucionale dhe shkëmbimit të përvojave, Komiteti zhvilloi një vizitë zyrtare në Bankën e Shqipërisë gjatë vitit 2024, ku u njoh me praktikat më të mira të mbikëqyrjes dhe auditimit.

1.2. Komiteti për qeverisje, etikë dhe burime njerëzore

Komiteti për Qeverisje, Etikë dhe Burime Njerëzore (KQEBNJ) është emëruar nga Bordi i Bankës Qendrore në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Rregullën për Procedurat e Punës së Bordit të Bankës Qendrore. Komiteti si organ këshillues ndihmon Bordin e Bankës Qendrore në mbikëqyrjen dhe implementimin e standardeve më të larta të qeverisjes, sjelljes etike dhe burimeve njerëzore brenda Bankës Qendrore.

KQEBNJ në rolin këshillëdhënës ndaj Bordit të BQK-së mbikëqyre:

- Zbatimin e strukturës së përgjithshme të qeverisjes së BQK-së;
- Politikat dhe praktikat e qeverisjes, duke përfshirë rolin e Bordit dhe komiteteve të tij, si dhe rolin e Bordit Ekzekutiv;
- Zbatimin e kornizës ligjore në të gjitha operacionet e BQK-së, sa i përket fushave të specifikuara në Statutin e KQEBNJ-së;
- Zbatimin e Strategjisë së BQK-së;
- Zbatimin e Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes të Bankës Qendrore;
- Politikat dhe mekanizmat për raportimin dhe trajtimin e çështjeve etike dhe konflikteve të interesit;
- Përshtatshmërinë dhe zbatimin e politikave të rekrutimit, trajnimit, vlerësimit të performancës, kompensimit të punonjësve të BQK-së, si dhe parimin e vazhdimësisë;

- Përshtatshmërinë dhe zbatimin e politikave të BQK-se për tërheqjen, zhvillimin dhe mbajtjen e talenteve të nevojshëm për të përmbushur misionin e saj.
- Përbërja, mandati dhe detyrat e Komitetit janë të përcaktuara në Statutin përkatës të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore, ndërsa Komiteti raporton rregullisht mbi aktivitetet dhe vlerësimet e tij.

Përbërja:

Më 31 dhjetor 2024, Komiteti për Qeverisje, Etikë dhe Burime Njerëzore përbëhej nga:

- Arta Hoxha, Kryetare;
- Bashkim Nurboja, Anëtar.

Aktivitetet gjatë vitit 2024:

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, Komiteti për Qeverisje, Etikë dhe Burime Njerëzore zhvilloi gjithsej gjashtë (6) takime. Në përputhje me Planin Vjetor të Punës të miratuar, Komiteti ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara duke inkurajuar përmirësimin dhe promovimin e politikave, procedurave dhe praktikave më të mira në të gjitha nivelet organizative të BQK-së që kanë të bëjnë me qeverisjen korporative, çështjet e etikës dhe burimeve njerëzore.

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Miratimin e planit vjetor të Punës së KQEENJ-së;
- Këshillimin në fushën e Qeverisjes korporative në BQK përmes takimeve me menaxhmentin;
- Dhënien e rekomandimeve për menaxhmentin, si dhe përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve;
- Shqyrtimin dhe dhënien e mbështetjes për plotësim/ndryshimin e Strukturës Organizative, e cila është miratuar në Bordin e Bankës Qendrore;
- Shqyrtimi i politikave të reja të Burimeve Njerëzore dhe dhënia e rekomandimeve të cilat janë adresuar nga menaxhmenti.
- Diskutimin dhe rekomandimin për hartimin e kornizës rregullative për sinjalizuesit në BQK;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të strukturës organizative, si dhe politikave të brendshme për qeverisjen e BQK-së;
- Rishikimin e politikave dhe praktikave të brendshme lidhur me qeverisjen;
- Rishikimin e politikave dhe mekanizmave për raportimin dhe trajtimin e çështjeve etike dhe konflikteve të interesit;
- Trajtimin e politikave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Sigurimin e dokumentimit të plotë të takimeve dhe raporteve të trajtuara.

Hartimi i kornizës rregullative:

Komiteti ka draftuar Statutin e Komitetit i cili është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore pas shqyrtimeve përkatëse.

2. Bordi Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv i BQK-së përbëhet nga Guvernatori, që është kryesues i Bordit Ekzekutiv, dhe Zëvendësguvernatorët. Më 31 dhjetor 2024, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Ahmet Ismaili, Guvernator, Dardan Fusha, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare, Milot Cakaj, Zëvendësguvernator për Mbikëqyrje Financiare, dhe Nesrin Shileku Shala, Zëvendësguvernatore për Funksione të Përgjithshme. Kompetencat e Bordit Ekzekutiv janë të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për politikëbërje, administrim dhe ushtrim të operacioneve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ndërsa aktiviteti i tij mbikëqyret nga Bordi i Bankës Qendrore.

Gjatë vitit 2024, Bordi Ekzekutiv ka mbajtur 40 mbledhje. Në kuadër të kompetencave të tij në relacion me Bordin e Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv gjatë vitit 2024 ka shqyrtuar dhe përgatitur për procedim rregullor të aplikueshme për sistemin financiar të vendit, raportin vjetor të BQK-së, si dhe raportet, pasqyrat dhe planet financiare të BQK-së. Në këtë aspekt, nga Bordi Ekzekutiv po ashtu janë përgatitur dhe komunikuar raporte dhe informata të rregullta dhe ad hoc mbi ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të dhëna.

Bordi Ekzekutiv në pajtim me legjislacionin në fuqi gjatë vitit 2024 ka miratuar gjashtë instrumente rregullatore në formë të udhëzimeve, si dhe dy manuale të mbikëqyrjes, një udhëzues dhe një udhërrëfyes të aplikueshëm për sistemin financiar të vendit. Në të njëjtën sferë të kompetencave, Bordi Ekzekutiv sa i përket sektorit bankar, një dege të bankës së huaj i është miratuar likuidimi vullnetar dhe një dege të bankës së huaj i është miratuar shndërrimin në bankë vendore. Sa i përket sektorit të institucioneve financiare jobankare, Bordi Ekzekutiv ka miratuar regjistrimin e dy institucioneve me aktivitet të këmbimit valutor dhe të një institucioni me aktivitet të kredidhënies, si dhe ka miratuar likuidimin vullnetar të një institucioni financiar jobankar. Në sektorin e sigurimeve, gjatë vitit 2024 është regjistruar një kompani e trajtimit dhe vlerësimit të dëmeve në sigurime. Në të njëjtën periudhë, në funksion të arritjes së objektivave parësore dhe duke u bazuar në detyrat përkatëse të realizuara nga njësitë organizative përgjegjëse, në 18 raste janë shqiptuar masa mbikëqyrëse të veçanta ndaj institucioneve financiare dhe palëve të lidhura.

Në vitin 2024, Bordi Ekzekutiv ka miratuar planin vjetor të punës, ndërsa në aspektin zhvillimor afatgjatë, ka themeluar Komitetin e Rrezikut dhe ka përgatitur strukturën e re organizative të BQK-së. Bordi Ekzekutiv gjatë vitit 2024 ka miratuar edhe nxjerrjen/ndryshimin dhe plotësimin e 26 politikave dhe rregullave të brendshme, si dhe ka mbikëqyrrur raportimet e komiteteve dhe organeve të tjera brendshme relevante për ushtrimin e kompetencave të tij. Bordi Ekzekutiv ka ushtruar edhe detyra të tjera në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Brenda kompetencave ekzekutive funksionojnë edhe Komitetet në vijim:

- Komiteti Këshillëdhënës për Makroprudencë
- Komiteti i Investimeve
- Komiteti i Riskut

3. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion shumë i rëndësishëm që ofron siguri të arsyeshme për Bordin e Bankës Qendrore, Komitetin e Auditimit dhe Bordin Ekzekutiv lidhur me efektivitetin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm. Auditimi i Brendshëm, së bashku me Auditimin e Jashtëm, plotësojnë zinxhirin e llogaridhënies në institucion.

Korniza ligjore e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) i siguron AB-së mandat të plotë dhe pavarësi në kryerjen e angazhimeve të auditimit. Këto angazhime synojnë ofrimin e rekomandimeve për rritjen e efikasitetit të kontrolleve të brendshme dhe shtimin e vlerës në institucion.

Gjatë vitit 2024, AB-ja ka realizuar auditimet sipas Planit Vjetor të hartuar në bazë të Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut sipas Qasjes së Bazuar në Rrezik. Auditimet e realizuara gjatë këtij viti përfshinë auditime financiare, të pajtueshmërisë, operationale dhe të teknologjisë informative. Aktivitetet audituese janë zhvilluar në pajtim me Ligjin nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nenin 61 të këtij ligji, dhe Planin Vjetor të AB-së.

Fokusi kryesor i AB-së ka vazhduar të jetë në avancimin dhe përmirësimin e sistemeve dhe proceseve që ndihmojnë Menaxhmentin në realizimin e objektivave institucionale. Përmes angazhimeve të kryera, AB-ja ka ofruar rekomandime specifike për përmirësimin e kontrolleve të brendshme dhe rritjen e vlerës në departamente dhe divizione të ndryshme të Bankës Qendrore.

Krahas aktiviteteve audituese të realizuara në vitin 2024, AB-ja ka hartuar edhe Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2025, paraprirë nga përgatitja e Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2025-2027. Ky plan u diskutua në nëntor 2024 nga Komiteti i Auditimit dhe u miratua në dhjetor 2024 nga Bordi i Bankës Qendrore.

Shefi i AB-së ka raportuar në mënyrë të rregullt pranë Komitetit të Auditimit dhe Bordit të Bankës Qendrore. Gjatë vitit 2024 janë mbajtur tetë (8) takime të Komitetit të Auditimit, në të cilat është diskutuar kryesisht progresi i realizimit të aktiviteteve audituese dhe zbatimi i rekomandimeve të AB-së.

Gjithashtu, AB-ja ka vazhduar angazhimin në zbatimin e rekomandimeve të dala nga vlerësimet e jashtme, përfshirë ato nga Banka Qendrore e Holandës, Fondit Monetar Ndërkombëtar (Vlerësimi i Masave Mbrojtëse - Safeguards Assessment) dhe Auditorëve të Jashtëm.

Në kuadër të ngritjes së vazhdueshme profesionale, stafi i AB-së ka marrë pjesë në disa trajnime, seminare dhe konferenca gjatë vitit 2024. Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me Auditorët e Jashtëm të BQK-së është realizuar gjithashtu në mënyrë sistematike.

4. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut

Menaxhimi i rrezikut (MR) në BQK është i orientuar drejt arritjes së objektivave të përcaktuara me ligj dhe monitorohet e mbikëqyret me një qasje të strukturuar sistematike, e përcaktuar nga kuadri i përgjithshëm i MR-së. Ky kuadër përcakton llojet kryesore të rrezikut (rrezikun strategjik, operacional dhe financiar) me të cilët BQK përballlet dhe menaxhon. Pjesë e kuadrit janë proceset për identifikim, analizim dhe vlerësim të rrezikut që përcillen me përgjigje adekuata ndaj rrezikut dhe monitorohet niveli i rrezikut sipas kuadrit rregullues në fuqi.

Zhvillimi i kuadrit të MR në BQK mbështetet mbi parimet të cilat mundësojnë menaxhimin efektiv dhe efikas të rrezikut në arritjen e objektivave të saj dhe nuk është proces i pavarur nga aktivitetet dhe proceset tjera të punës, por është pjesë integrale e qeverisjes dhe e të gjitha proceseve, përfshirë planifikimin strategjik dhe menaxhimin e projekteve.

BQK, në përputhje me praktikat më të mira, ka adoptuar modelin e tri linjave mbrojtëse për menaxhimin e rrezikut:

Figura 2. Njësitë organizative-bartësit e proceseve

- Linja e parë mbrojtëse - Njësitë organizative/bartësit e proceseve kanë përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e rrezikut, të cilët zbatojnë kontrolle të brendshme për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet që lidhen me aktivitetet e tyre.
- Linja e dytë mbrojtëse - Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut ka rol mbikëqyrës, duke siguruar që proceset e menaxhimit të rrezikut janë të përshtatshme dhe efektive, si dhe duke ofruar udhëzime dhe koordinim në zbatimin e politikave dhe strategjive të rrezikut, dhe
- Linja e tretë mbrojtëse – Auditimi i brendshëm kryen vlerësime të pavarura për të siguruar që masat e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollet e brendshme funksionojnë në mënyrë efektive dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator dhe objektivat strategjike të BQK-së.



Gjatë vitit 2024, në kuadër të përmirësimit të strukturës së menaxhimit të rrezikut, është themeluar Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut. Ky komitet ka për qëllim forcimin e qasjes së strukturuar ndaj menaxhimit të rrezikut, duke mbështetur monitorimin dhe mbikëqyrjen e politikave dhe strategjive të menaxhimit të rrezikut brenda institucionit. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut (DMR) raporton në baza periodike tek Bordi Ekzekutiv i BQK-së rreth aktiviteteve në shërbim të avancimit të proceseve dhe mbi profilin e përgjithshëm të rrezikut në BQK. DMR raporton gjithashtu edhe tek Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Komiteti i Auditimit.

Në vitin 2024 është aprovuar Deklarata e Appetitit të Rrezikut (DARr) që përcakton nivelin e rrezikut që BQK është e gatshme të marrë përsipër për të arritur objektivat e saj strategjike, financiare dhe operative. Kjo deklaratë artikulon rreziqet që mund të ndikojnë në burimet kryesore të BQK-së, duke përfshirë fitimin, kapitalin, likuiditetin dhe reputacionin. Ndryshimet në deklaratën e appetitit të rrezikut duhet të rekomandohen nga Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut, të miratohen nga Bordi Ekzekutiv dhe të marrin pëlqimin nga Bordi i Bankës Qendrore përmes Komitetit të Auditimit.

Deklarata e apetitit të rrezikut të BQK-së:

Banka Qendrore e Kosovës ka një tolerancë të ulët ndaj rreziqeve të pranueshme, që mund të pengojnë aftësinë e saj për të siguruar ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar dhe arritjen e objektivave të saj.

Ne menaxhojmë dhe zbusim në mënyrë aktive rreziqet operacionale, financiare dhe të tregut, si dhe rreziqeve tjera përmes kontrolleve rigorozë të brendshme dhe një kornize gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut, duke siguruar vazhdimësinë e funksioneve tona thelbësore si dhe realizimin e mandatit tonë në ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe financiar.

Në arritjen e objektivave të saj, BQK-ja është e ekspozuar ndaj këtyre kategorive kryesore të rreziqeve:

Rreziku strategjik

Rreziku strategjik është rreziku që ngjarjet e papritura të brendshme dhe të jashtme mund ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave dhe qëllimeve strategjike të BQK-së .

Rreziku financiar

BQK është e ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të rreziqeve financiare duke përfshirë; rreziku kreditor, rrezikun e tregut, rrezikun e valutës dhe rrezikun e likuiditetit.

Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes që rezulton nga procese, njerëz dhe sisteme të brendshme të pamjaftueshme ose të dështuara ose nga ngjarje të jashtme.

Rreziku i reputacionit

Rreziku i reputacionit i referohet mundësisë që një ngjarje apo veprim i caktuar të dëmtoj imazhin apo reputacionin publik të BQK-së. Si rrjedhojë të rrezikohet dhe të jetë e paaftë në arritjen e objektivave të politikës dhe përmbushjen e përgjegjësive të saj ndaj publikut, punonjësve, palëve të interesuara dhe mbarë ekonomisë.

Rreziku i jashtëm

Rreziku i jashtëm është rreziku që ngjarjet politike, gjeopolitike ose të akterëve të jashtëm të ndikojnë në arritjen e objektivave të BQK-së

Rreziku i mbikëqyrjes


Rreziku i mbikëqyrjes është rreziku që proceset mbikëqyrëse të BQK-së të mos identifikojnë dhe të zbusin rreziqe të rëndësishme për industrinë e shërbimeve financiare ose klientët dhe që kanë një efekt negativ në stabilitetin e tregut ose konkurrencën efektive.

Gjatë vitit 2024 me qëllim të rritjes së efikasitetit në fushën e menaxhimit të rrezikut DMR ka krijuar dy divizione, atë të menaxhimit të rrezikut operacional dhe të menaxhimit të rrezikut financiar.

4.1. Menaxhimi i Rrezikut Operacional

Divizioni i menaxhimit të rrezikut operacional në kuadër të Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut ka të zhvilluar Sistemin e

Grafiku 112. Burimet e rreziqeve



Burimi: BQK (2025)

Menaxhimit të Rrezikut, i cili mbështet proceset e identifikimit, vlerësimit, raportimit dhe monitorimit të rreziqeve brenda BQK-së. Ai siguron mbledhjen e të dhënave të nevojshme për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve dhe mundëson krijimin e raporteve të rregullta për monitorimin e tyre. Përmes këtij sistemi, BQK trajton në mënyrë efektive dhe të koordinuar çdo lloj rreziku, duke mundësuar që të merren masa proaktive dhe reaktive për të mbajtur nën kontroll ndikimet e mundshme të rreziqeve dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e operacioneve të saj.

Për secilin rrezik të identifikuar përcaktohet edhe burimi i rrezikut, i cili mund të ketë ndikim në arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale të bankës. Rreziqet operative mund të vijnë nga procese të brendshme joefektive, dështime të sistemeve, ngjarje të jashtme ose gabime njerëzore. Figura e mësipërme tregon burimet e rreziqeve të identifikuara në fund të vitit 2024 dhe ndikimi potencial i tyre.

BQK-ja është anëtare e IORWG-së (International Organization Risk Working Group), një grup punues ndërkombëtar i cili i mundëson bankave qendrore dhe autoriteteve monetare dhe mbikëqyrëse të ndajnë dhe zhvillojnë praktika më të mira për menaxhimin e rrezikut operacional. BQK, si anëtare e kësaj platforme, ka marrë pjesë në vlerësimin periodik të kryer nga kjo organizatë me mbi 124 institucione, duke përfshirë bankat qendrore, autoritetet mbikëqyrëse dhe autoritetet monetare (përfshirë FMN-në dhe BShN) nga 118 vende.

BQK, si anëtare e IORWG-së, ka marrë pjesë në vlerësimin periodik të kryer nga IORWG i cili rezultoi me 73.5% të nivelit të maturitetit, që tregon një progres të konsiderueshëm në përmirësimin e strukturës dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut në BQK. Ky vlerësim është rezultat i angazhimit të vazhdueshëm të BQK-së për të zbatuar praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe për të zhvilluar një kuadër të qëndrueshëm për menaxhimin e rrezikut operacional, si dhe për të rritur kapacitetet e brendshme për të identifikuar, analizuar dhe adresuar rreziqet.

Nivelet e maturitetit sipas IORWG-së

AD-HOCK	BAZIKE	I MENAXHUAR	I AVANSUAR	I MATURUAR
< 60.9%	≥ 60.9%	≥ 71.2%	≥ 86.6%	≥ 94.1%

Për të forcuar kulturën e rrezikut të BQK-së, në vitin 2024 janë zhvilluar programe vetëdijesimi lidhur me menaxhimin e rrezikut operacional të cilat programe janë ekzekutuar në mënyrë periodike. Për t'i kontribuar ngritjes së vetëdijesimit rreth raportimit të incidenteve, zhvillimit dhe raportimit të indikatorëve kyç të rrezikut dhe çështjeve tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut, janë zhvilluar udhëzues dhe procedura lehtë të qasshëm për stafin. Gjatë periudhave tremujore të raportimit të vetëvlerësimeve dhe indikatorëve të rrezikut, janë mbajtur takime me të gjitha njësitë raportuese me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për identifikim të rrezikut dhe vlerësim të kontroleve për zbutje të rrezikut. Gjithashtu, pas çdo zhvillimi dhe avancimi të proceseve dhe instrumenteve mbështetëse, janë organizuar takime me njësitë organizative në mënyrë që të ofrohen informacionet e nevojshme për zbatim të kërkesave të reja të nxjerra përmes këtyre akteve.

Proceset për identifikim, analizim dhe vlerësim të rrezikut të cilat përcillen me përgjigje ndaj rrezikut dhe monitorim të nivelit të tij, janë dizajnuar për të qenë në shërbim të arritjes së objektivave strategjike të BQK-së, duke vënë në pah mundësitë dhe rreziqet potenciale. Për të arritur këtë është bërë lidhja në mes qëllimeve strategjike, proceseve të punës që ndihmojnë arritjen e këtyre objektivave dhe rreziqeve që mund të rrezikojnë arritjen e tyre. Për secilën fazë të ciklit të menaxhimit të rrezikut janë zhvilluar procedura, forma dhe vegla për të mbështetur identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe monitorimin e nivelit të rrezikut në BQK.

Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut ka përgatitur raporte të konsoliduara me rezultatet e nxjerra pas analizave dhe vlerësimeve duke përdor instrumentet e zhvilluara për këtë qëllim. Raportet si produkte finale të dala pas ekzekutimit të proceseve të menaxhimit të rrezikut janë standardizuar dhe përshtatur për palët e interesit.

BQK i kushton rëndësi të veçantë vazhdimësisë së shërbimeve të saj. Banka planifikon, zbaton dhe monitoron vazhdimisht lloje të ndryshme aktiviteteve që kontribuojnë në ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve të saj kritike dhe rrisin qëndrueshmërinë e bankës në përgjithësi.


Procesi i Analizës së Ndikimit të Biznesit (BIA) është procesi i përcaktimit të burimeve të kërkuara për proceset e shërbimeve kritike të bankës dhe bën të mundur identifikimin e të gjitha burimeve teknike, njerëzore dhe logjistike të nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve. Ky proces gjithashtu bën identifikimin e palëve të treta të përfshira në ofrimin e shërbimeve kritike, vlerësimin e rreziqeve të mundshme që mund të çojnë në ndërprerjen ose ndërprerjen e ofrimit të shërbimeve, si dhe përcaktimin e kohës minimale që biznesi mund të tolerojë për ndërprerjen e shërbimit dhe afatin kohor të rikuperimit të këtij shërbimi.

Në vitin 2024 është testuar plani i vazhdimësisë së biznesit për të kryer shërbime përkatëse në situata të jashtëzakonshme.

4.2. Menaxhimi i Rrezikut Financiar


BQK menaxhon rezervat e saj bazuar në parimet e sigurisë, likuiditetit dhe kthimit nga investimet. Rreziku financiar i referohet mundësisë që banka të pësojë humbje financiare si pasojë e ndryshimeve të papritura apo të pakontrolluara në tregje financiare.

Grafiku 113. Struktura e rezervave të BQK-së me 31 dhjetor 2024, në % Gjithsej rezervat: € 1,618.5 milion




Burimi: BQK (2025)

Grafiku 114. Struktura e rezervave të BQK-së me 31 dhjetor 2023, në % Gjithsej rezervat: € 1,604.9 milion




Burimi: BQK (2025)

Grafiku 115. Klasifikimi kreditor i rezervave të BQK-së 31 dhjetor 2024



Burimi: BQK (2025)

Grafiku 116. Klasifikimi kreditor i rezervave të BQK-së 31 dhjetor 2023



Burimi: BQK (2025)

Rreziku financiar klasifikohet si më poshtë:


- **Rreziku kreditor** është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj dhe rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera;
- **Rreziku i tregut** është rreziku i humbjeve që rrjedhin nga lëvizjet e çmimeve të tregut si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit, normat e këmbimit valutor dhe çmimet e kapitalit dhe të mallrave;
- **Rreziku i likuiditetit** nënkupton mundësinë e humbjes financiare si rezultat i mos përmbushjes në kohë të duhur të obligimeve që rrjedhin nga detyrimet financiare;

Rreziqet që i përkasin menaxhimit të mjeteve nga ana e BQK-së përbëhen kryesisht nga rreziqe financiare si rreziku kreditor, rreziku i tregut dhe rreziku i likuiditetit.

Rreziku Kreditor


Investimi i mjeteve të BQK-së bëhet në letrat me vlerë të emtuara nga shtetet stabile dhe të zhvilluara, agjencitë më kredibile të Eurozonës, dhe institucionet supranacionale me vlerësim të lartë kreditor investiv nga agjencitë kreditore ndërkombëtare si Standard&Poor's, Moody's, Fitch si dhe në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës.

Grafiku 117. Humbja e pritur kreditore sipas llojit të ekspozimeve



Burimi: BQK (2025)

Grafiku 118. Humbja e pritur kreditore në raport me vlerë e ekspozuar sipas llojit të ekspozimeve ECL/EAD



Burimi: BQK (2025)

BQK menaxhon rrezikun kreditor duke investuar në instrumente financiare me vlerësim të lartë kreditor. Të gjitha investimet realizohen në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër dhe afatgjatë kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) ose më lartë për afat të shkurtër dhe Baa2/BBB (Moody's/S&P) ose më lartë për afat të gjatë, si dhe në rastet e jashtëzakonshme në treg, me P-3/A-3 ose më lartë për afat të shkurtër dhe Baa3/BBB (Moody's/S&P) ose më lartë për afat të gjatë. Po ashtu, për të realizuar diversifikim të investimet në instrumente financiare sipas Politikës së investimeve janë përcaktuar kufizime në nivel të llojit të investimit, emetuesit, shpërndarjes gjeografike, maturitetit.

Rreziku i tregut


BQK nuk është e ekspozuar ndaj ndryshimeve të çmimeve të letrave me vlerë të ekuitetit dhe mallrave. BQK ka ekspozime ndaj ndryshimit të normave të interesit dhe kursit të këmbimit.

Rreziku i normës së interesit është ekspozimi i fitimeve dhe ekuitetit aktual ose të ardhshëm të BQK-së ndaj ndryshimeve të pafavorshme në normat e interesit në treg. BQK me qëllim të menaxhimit efektiv të rrezikut të normës së interesit, monitoron në baza të rregullta se si ndryshimet në normat e interesit do të ndikojnë në vlerë ekonomike të ekuitetit si dhe në fitimet e saj. BQK e menaxhon ekspozimin ndaj ndryshimeve të normave të interesit në vlerën ekonomike

të ekuitetit duke investuar kryesisht në letra me vlerë apo depozita me afat të shkurtër deri në 1 vit.

Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku i humbjes nga ndryshimet në kursin e këmbimit. BQK në portfolio e saj ka instrumente financiare në valuta jo euro në një përqindje të ulët, si rrjedhojë ekspozimi ndaj rrezikut valutor vlerësohet të jetë i ulët. Ndryshimet e ndër-valutore ndikojnë në bilancet e llogarive të rivlerësimit në pasqyrën e pozitës financiare si dhe në fitim apo humbje në pasqyrën e të ardhurave. Me 31 dhjetor 2024 nga gjithsej € 1,618.48 milion rezerva rreth 87% janë në euro, ndërsa me 31 dhjetor 2023 nga gjithsej € 1,604.91 milion rezerva rreth 89% ishin në euro.

Grafiku 119. Rezervat sipas maturitetit




Rreziku i likuiditetit është rreziku në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve që rrjedhin nga detyrimet e saj financiare. Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së. Rrezikun e likuiditetit BQK e menaxhon duke investuar në instrumente financiare likuide si në llogaritë nostro në banka korrespondentë, depozita në tregun e parasë me maturitet jo më të gjatë se një vit. Me 31 dhjetor 2024, 67% e rezervës të BQK-s ka maturitet të mbetur deri në një vit ndërsa me 31 dhjetor 2023 79% e rezervës kishte maturitet të mbetur deri në një vit.

5. Burimet Njerëzore

Në përputhje me objektivat strategjike të BQK-së dhe politikat e administrimit të burimeve njerëzore, institucioni është i përkushtuar në avancimin e vazhdueshëm të praktikave moderne të menaxhimit të burimeve njerëzore. Ky përkushtim synon krijimin e një mjedisi pune të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke integruar standardet më të mira ndërkombëtare dhe duke ofruar mundësi të barabarta për zhvillim dhe avancim profesional për të gjithë punonjësit. Në këtë mënyrë, BQK synon të rrisë profesionalizmin, performancën dhe motivimin e stafit, duke siguruar që institucioni të mbetet konkurrues dhe i orientuar drejt inovacionit.

Grafiku 120. Struktura sipas edukimit



Në fund të vitit 2024, numri i të punësuarve në BQK ishte 237, me një moshë mesatare prej 42 vitesh. Struktura gjinore mbeti e balancuar, ku raporti i punonjëseve femra ndaj meshkujve ishte 53.8% - 46.2%, ndërsa në nivel drejtues ky raport ishte 41.0% - 59.0%.

Sa i përket kualifikimeve të stafit, BQK-ja vazhdon të ketë një strukturë të lartë akademike: 1.7% e stafit ka përfunduar studimet e doktoraturës, 42.6% ka ndjekur studime pasuniversitare, 47.3% ka përfunduar studimet universitare, 7.6% ka arsim të mesëm dhe 0.8% ka edukim bazik (shih Grafikon 120.)

Gjatë vitit 2024, BQK-ja ka hartuar për herë të parë Planin e Integritetit, një dokument kyç për forcimin e standardeve etike dhe profesionale brenda institucionit. Gjithashtu, janë zhvilluar disa pyetësorë për të gjithë stafin, me qëllim përfshirjen e tyre aktive në ndryshimet dhe përparimet e proceseve të Bankës.

Për më tepër, gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt avancimit të politikave të brendshme që mbështesin zhvillimin e kapaciteteve të stafit dhe forcimin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Janë rishikuar dhe harmonizuar dokumente të rëndësishme që lidhen me trajnimet, zhvillimin profesional, vlerësimin e performancës, me qëllim krijimin e një qasjeje më strategjike dhe të qëndrueshme për ndërtimin e kapaciteteve institucionale. Gjithashtu, është përditësuar politika për marrëdhëniet e punës, përfshirë rregullimin e procedurave të punësimit dhe rekrutimit, duke garantuar transparencë dhe objektivitet në këto procese. Përveç kësaj, është miratuar edhe politika për klasifikimin e vendimeve të punës, e cila ka kontribuar në unifikimin dhe standardizimin e pozitave brenda institucionit në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Këto përmirësime përforcojnë angazhimin e BQK-së për zhvillimin profesional të stafit dhe ndërtimin e një kulture organizative të bazuar në performancë, përfshirje dhe integritet. Nëpërmjet implementimit të praktikave bashkëkohore të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përkushtimit të vazhdueshëm për zhvillimin profesional të stafit, DBNjZh siguron që BQK-ja të mbetet një institucion modern dhe konkurrues, me fokus në cilësinë dhe përfshirjen profesionale. Banka Qendrore e Kosovës e konsideron kapitalin njerëzor si një nga asetet e saj më të rëndësishme dhe vazhdimisht zbaton politika që sigurojnë kushte pune në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në vitin 2024, gjithsej 177 punonjës të BQK-së morën pjesë në trajnime profesionale, seminare dhe konferenca, si dhe vizita studimore, në bashkëpunim me institucione prestigjioze si Banka Qendrore Evropiane, Banka Botërore, JVI, CEF, Bundesbank e Gjermanisë, Banka e Francës, Banka Kombëtare e Austrisë, Banka e Rezervave Federale e Nju Jorkut, FMN, Banka e Çekisë, Banka e Anglisë, Banka e Italisë, Banka e Shqipërisë, Banka e Holandës, Shoqata e Bankave të Kosovës dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

6. Teknologjia Informative dhe siguria

Gjatë vitit 2024, BQK ka vazhduar me avancimin e sistemeve teknologjike, forcimin e sigurisë së informacionit dhe përmirësimin e proceseve të punës. Fokusi kryesor ka qenë rritja e cilësisë dhe zgjerimi i shërbimeve të ofruara, si dhe garantimi i sigurisë së tyre. Një zhvillim i rëndësishëm në këtë drejtim ka qenë orientimi drejt shërbimeve në teknologjinë Cloud, me synim përsheptimin e transformimit teknologjik, forcimin e sigurisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së funksionimit të sistemeve të informacionit në raste krizash.

Në funksion të përputhjes me zhvillimet e reja teknologjike dhe kërkesat gjithnjë në rritje për shërbime efikase dhe të sigurta, është ndërmarrë një rishikim i strukturës së departamentit, janë shtuar kapacitetet dhe njëkohësisht janë përmirësuar kushtet e punës me qëllim tërheqjen dhe mbajtjen e stafit profesional të TI-së. Struktura e re është dizajnuar për të ofruar një përgjigje më efektive ndaj nevojave operative, zhvillimeve të reja dhe kërkesave në rritje për digjitalizim të shërbimeve, si dhe sfidave të sigurisë kibernetike. Kjo strukturë mbështet objektivat e Planit Strategjik të BQK-së, duke mundësuar një qasje më të qartë dhe të lehtë për biznesin dhe

përdoruesit e shërbimeve për adresimin efektiv të kërkesave, si dhe përmirësimin e kohës së reagimit ndaj tyre.

Për t'u përballur me sfidat në rritje në fushën e sigurisë kibernetike, BQK ka ndërmarrë një nismë strategjike për krijimin e Kornizës për Sigurinë Kibernetike. Kjo nismë udhëhiqet nga funksioni i Zyrtarit Kryesor për Sigurinë e Informacionit (CISO), i themeluar në kuadër të strukturës së re organizative të BQK-së. Si hap fillestar, është zhvilluar Strategjia për Sigurinë Kibernetike, e cila përcakton vizionin, objektivat dhe masat për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, sistemeve dhe informacionit të institucionit. Strategjia bazohet në një qasje të integruar që përfshin ndërtimin e kapaciteteve, menaxhimin e rrezikut, reagimin ndaj incidenteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave të kontrollit. Kjo strategji paraqet themelin për ndërtimin e një strukture të qëndrueshme dhe efektive për sigurinë e informacionit dhe atë kibernetike, duke siguruar përputhshmëri me standardet më të avancuara ndërkombëtare.


7. Komunikimi me Publikun

Viti 2024 është shoqëruar me zhvillime të rëndësishme për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në fushën e komunikimit me publikun dhe forcimit të transparencës institucionale. Gjatë këtij viti, BQK ka ndërmarrë hapa të qëndrueshëm për të transformuar mënyrën se si informon dhe angazhohet me qytetarët, mediat dhe palët e tjera të interesit.

BQK ka përmirësuar dhe zgjeruar ndjeshëm komunikimin me publikun përmes njoftimeve të publikuara në të gjitha kanalet zyrtare, me qëllim që të sigurohet një informim gjithëpërfshirës dhe transparent mbi aktivitetet dhe përgjegjësitë e institucionit. Ky komunikim është realizuar përmes:

- Publikimit të komunikatave dhe njoftimeve për media;
- Publikimit të të dhënave dhe statistikave të detajuara për institucionet bankare, sistemin e pagesave dhe institucionet tjera financiare;
- Raporteve periodike, buletineve dhe analizave mbi stabilitetin financiar;
- Shpërndarjes së materialeve informuese, si broshura, video, infografika dhe përmbajtje të tjera edukative për publikun.

Grafiku 121. Numri i publikimeve në rrjete sociale



Burimi: BQK (2025)

Përveç komunikimit tradicional me median, është zgjeruar edhe komunikimi digjital, duke përfshirë: 320 publikime në faqen zyrtare të BQK-së në Facebook, 93 publikime në profilin zyrtar të Guvernatorit në Facebook; 367 publikime në LinkedIn; 454 publikime në X (ish-Twitter); 36 publikime në profilin zyrtar të Guvernatorit në X dhe 2 publikime në platformën BIS. Gjatë periudhës është rritur ndjeshëm prania në rrjetet sociale zyrtare të BQK-së, përmes publikimit të materialeve vizuale dhe përmbajtjeve informuese, përfshirë video mesazhe dhe informacione në platformat LinkedIn, Facebook, X (ish-Twitter) dhe YouTube.

Një zhvillim shumë i rëndësishëm gjatë vitit 2024 ishte ridizajnimi dhe i faqes zyrtare dhe platformës për edukim financiar. Web-faqja e re ka një dizajn modern dhe është në përputhje me praktikatat ndërkombëtare për transparencë, siguri dhe gjithëpërfshirje, duke ofruar strukturë të

qartë, navigim të lehtë dhe përmbajtje të sistemuar. Ndër funksionet e reja të faqes përfshihen: kalendari dinamik i aktiviteteve, mundësia për kërkim të avancuar, filtrimi dhe renditja e informatave sipas nevojave të përdoruesit, si dhe një galeri multimediale me përmbajtje vizuale dhe video.

Sa i përket trajtimit të kërkesave për informim dhe komunikimit me publikun në funksion të përmbushjes së objektivit të saj për transparencë dhe informim të publikut, gjatë vitit 2024 BQK ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për informim nga qytetarët dhe palë të tjera të interesuara. Gjatë kësaj periudhe, BQK u është përgjegjës për të gjitha kërkesave zyrtare të adresuara institucionit, si dhe ka trajtuar mbi 420 korrespondenca me publikun, përfshirë kërkesa për informacione, pyetje që lidhen me sistemin financiar dhe fushat e përgjegjësisë së BQK-së. Numri i kërkesave të trajtuara për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2024 ka qenë 34 prej të cilave në 31 kërkesa është lejuar qasja e plotë apo e pjesshme ndërsa janë refuzuar 3 kërkesa të qasjes në dokumente konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Këto kërkesa janë administruar përmes adresës zyrtare të kontaktit info@bqk-kos.org, dhe media@bqk-kos.org dhe kontakteve të zyrtarëve përgjegjës për fushat specifike duke reflektuar përkushtimin e institucionit për një qasje të hapur, transparente dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve dhe të gjitha palëve të interesuara.

Gjatë vitit 2024, BQK ka vazhduar me angazhimin rreth komunikimit institucional dhe transparencën publike, me qëllim të ofrimit të një informimi të balancuar, profesional dhe në kohë për opinionin publik, si dhe bashkëpunimit me media si partnere në shpërndarjen e informatave tek qytetarët.

Në këtë kontekst, BQK ka zhvilluar një numër të gjerë aktiviteteve informuese dhe përfaqësuese. Komunikimi me përfaqësuesit e mediave është realizuar përmes konferencave për shtyp, deklaratave zyrtare, intervistave, prezantimeve publike, si dhe përmes pjesëmarrjes së Guvernatorit dhe menaxhmentit të lartë të BQK-së në intervista televizive, në panele diskutimi dhe ngjarje të rëndësishme publike.

Guvernatori ka qenë i pranishëm në mediat vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë platformat si: Bloomberg (intervistë e shkruar), Financial Times, Reuters, Associated Press, Euractiv, Politico dhe Frankfurter Allgemeine Zeitung. Janë realizuar gjithsej 22 intervista televizive dhe video, përfshirë mediat vendore, si RTK, Kosova Press, KTV, Kallxo, ATV dhe Ekonomia Online si dhe media tjera, si dhe janë zhvilluar takime me Komisionin e pavarur për Media.

Një aktivitet i veçantë ishte kampanja informuese që shoqëroi hyrjen në fuqi të Rregullores për Operacionet me Paratë e Gatshme. Në këtë drejtim, BQK organizoi një sërë aktiviteteve me qëllim të informimit të drejtë të qytetarëve rreth përmbajtjes dhe zbatimit të kësaj rregulloreje. Si pjesë e kësaj kampanje, u përgatitën, u shpërndanë dhe u publikuan materiale informuese si fletushka dhe broshura në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, si dhe dokumenti me “Pyetjet dhe përgjigjet më të shpeshta”.

Për të lehtësuar qasjen në informata dhe për të ofruar mbështetje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, gjatë vitit u vendos në funksion edhe linja pa pagesë (0800 222-55), e cila iu dedikua veçanërisht komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, me qëllim që të informohen në mënyrë të qartë dhe të drejtë mbi zbatimin e rregullores. Për të adresuar këto kërkesa BQK angazhoi ekip të veçantë me njohuri adekuate gjuhësore dhe të proceseve. Në të njëjtën kohë janë realizuar dhe publikuar 23 video sqaruese në tri gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës në lidhje me rregulloren, si dhe 9 publikime sqaruese të bazuara në pyetjet më të shpeshta të qytetarëve.

BQK ka mbajtur komunikim të hapur me të gjitha mediet dhe portalet online vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, ku gjatë vitit ka adresuar të gjitha kërkesat dhe është përgjegjës në 54 kërkesa për informacion.

Gjatë kësaj periudhe, BQK ka zhvilluar takime të rregullta me përfaqësues të misioneve diplomatike dhe institucioneve vendore e ndërkombëtare për të ofruar sqarime shitesë mbi qëllimin dhe efektet e pritura të Rregullores në fjalë.

7.1. Bashkëpunimi me institucionet tjera vendore

Gjatë periudhës raportuese, konform mandatit institucional dhe në përputhje me kërkesat ligjore, Guvernatori bashkë me ekipin teknik mori pjesë në dy mbledhje të Komisionit për Buxhet, Financa dhe Transfere të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke prezantuar rezultatet e punës dhe duke ofruar informacione të detajuara mbi zhvillimet në sistemin financiar dhe reformat institucionale. Në vijim të angazhimeve tjera, janë zhvilluar gjithsej 71 takime zyrtare, prej të cilave 35 janë mbajtur në ambientet e BQK-së, ku janë pritur përfaqësues të institucioneve financiare vendore e ndërkombëtare, përfshirë ambasadorë dhe diplomatë të akredituar në Kosovë.

Gjithashtu ka vazhduar bashkëpunimi i rregullt me institucione vendore si MFPT, NJIF, FKGK, SHBK, AMIK, BKS, oda ekonomike dhe universitete e institucione tjera vendore me ç' rast janë nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi:

- Memorandum i Mirëkuptimit me ASHI për shtimin në E-Kosova të dy shërbimeve: Regjistri i Llogarive dhe Regjistri i Kredive të Kosovës.
- Memorandum mirëkuptimi me ASK dhe MFPT– për definimin e rolit dhe përgjegjësi në fushën e statistikave makroekonomike dhe financiare.
- Memorandum mirëkuptimi me Fakultetin Ekonomik- për avancim të bashkëpunimit dhe aktiviteteve në fushën e ekonomisë, financave dhe edukimit financiar
- Memorandum bashkëpunimi me SHBK BKS dhe AMIK- për koordinimin e aktiviteteve në fushën e Edukimit Financiar

BQK ka realizuar bashkëpunim të rregullt me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, Agjencinë për parandalimin e Korrupsionit dhe autoritetet e zbatimit të ligjit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe mandatet përkatëse. Ky bashkëpunim është zhvilluar përmes shkëmbimit të informatave, raportimeve të rregullta, konsultimeve dhe trajtimit të çështjeve të ndjeshme institucionale. Veprimet janë mbështetur në memorandume bashkëpunimi dhe legjislacionin në fuqi.

BQK ka organizuar dhe bashkëorganizuar dhe një numër konferencash dhe ngjarjesh profesionale gjatë vitit 2024, me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe zhvillimin e sektorit financiar. Këto aktivitete kanë shërbyer si platforma të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe prezantimin e risive në sektorin financiar.

7.2. Konferenca Ndërkombëtare për shënimin e 25-vjetorit të BQK-së

Në kuadër të shënimit të 25-vjetorit të themelimit, BQK organizoi Konferencën Ndërkombëtare me temën: “Tejkalimi i kufijve, ndërtimi i së ardhmes: Integrimi në SEPA për përfshirjen financiare – Fuqizimi i rritjes dhe qëndrueshmërisë financiare”.

Përveç karakterit ceremonial kjo ngjarje shërbeu edhe si konferencë profesionale e nivelit të lartë, ku morën pjesë 24 folës, përfshirë guvernatorë dhe përfaqësues të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe të BQK-së, si dhe 250 pjesëmarrës, prej tyre 44 mysafirë ndërkombëtarë nga institucionet më të rëndësishme financiare ndërkombëtare. Konferencën me fjalë mirëseardhje e

hapi z. Ahmet Ismaili – Guvernator i BQK-së, ndërsa fjalë përshëndetëse për të pranishmëve ju drejtua Presidentja e Republikës së Kosovës Znj. Vjosa Osmani-Sadriu, e cila theksoi rolin e BQK-se në ruajtjen e stabilitetit ekonomik e financiar në vend. Kjo Konferencë Ndërkombëtare, e organizuar me rastin e 25-vjetorit të themelimit të BQK-së, u përshëndet edhe përmes një video-mesazhi nga znj. Kristalina Georgieva – Drejtoreshë Menaxhuese e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Fjalimin kryesor të konferencës e mbajti z. Robert Holzmann – Guvernator i Bankës Kombëtare të Austrisë, kurse fjalën përmbyllëse e dha Kryetari i Bordit të BQK-së Z. Bashkim Nurboja. Në kuadër të Konferencës u zhvilluan tri sesione që trajtuan tema si integrimi në SEPA, transformimi digjital dhe ndikimet e tyre në shërbimet financiare, duke theksuar lehtësimin e pagesave ndërkufitare dhe rritjen e efikasitetit të transaksioneve; përmirësimi i stabilitetit financiar në një mjedis global në ndryshim; si dhe roli i bankave të Ballkanit Perëndimor në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe avancimin e përfshirjes financiare në një treg konkurrues dhe digjitalizuar. Përveç paneleve, Konferenca u pasurua me një prezantim tematik mbi zhvillimet në pagesat pa para të gatshme në Ballkanin Perëndimor, duke ofruar pasqyrë krahasuese ndërmjet vendeve të rajonit në raport me tendencat evropiane.

Nga aspekti organizativ, Konferenca u realizua me angazhim të lartë protokollar dhe ceremonial, në bashkëpunim të ngushtë me Protokollin e Shtetit, Policinë e Kosovës, si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe partnere ndërkombëtarë. Ngjarja u mbulua gjerësisht nga mediat vendore dhe ndërkombëtare, duke reflektuar interesin dhe rëndësinë e temave të diskutuara si dhe nivelin e lartë të përfaqësimit. Organizimi i kësaj Konference vuri në pah kapacitetet e BQK-së për të krijuar ambient adekuat për dialog rajonal dhe ndërkombëtar mbi temat strategjike të zhvillimit financiar.

7.3. Konferenca e fundvitit me media (26 dhjetor 2024)

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta të komunikimit me publikun, në fund të dhjetorit 2024 u mbajt Konferenca e fundvitit me përfaqësues të mediave vendore. Kjo ngjarje tashmë tradicionale shërben për të shpalosur para opinionit publik arritjet institucionale përgjatë vitit, sfidat me të cilat është përballur dhe objektivat për vitet e ardhshme. Gjithashtu, kjo ngjarje shërben si një forum i hapur komunikimi, ku përfaqësues të të gjitha mediave vendore kanë mundësi të adresojnë çështje me interes dhe të marrin përgjigje të drejtpërdrejta. Në këtë mënyrë, BQK promovon transparencë të plotë dhe thëllon partneritetin me mediat, duke synuar një komunikim të rregullt, profesional dhe të balancuar mbi zhvillimet në sektorin financiar.

Në këtë konferencë u theksua roli i rëndësishëm i mediave në informimin e drejtë të publikut, si dhe falënderimi i BQK-së ndaj tyre për pasqyrimin korrekt të ngjarjeve dhe arritjeve të institucionit gjatë vitit 2024.

8. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Integrimet Evropiane

Viti 2024 u karakterizua me një dinamikë të lartë në marrëdhëniet ndërkombëtare të Bankës Qendrore të Kosovës, në përputhje me qëllimin strategjik për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjen aktive në organizata financiare ndërkombëtare. Aktivitetet intensive në këtë drejtim kanë kontribuar në rritjen e besueshmërisë ndërkombëtare të BQK-së dhe në thellimin e integritit të Kosovës në sistemin financiar evropian dhe global.

8.1. Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare dhe Asistencat Teknike

BQK ka mbajtur dhe intensifikuar bashkëpunimin me institucione kyçe ndërkombëtare si Banka Qendrore Evropiane (ECB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), OECD, Ekipi Ekonomik Gjerman (ang. GET) dhe banka qendrore të rajonit dhe më gjerë.

Gjatë vitit 2024, një delegacion i lartë i BQK-së i kryesuar nga Guvernatori Ismaili, mori pjesë në takimet pranverore dhe vjetore të FMN dhe BB në Washington D.C. Përmes mbi 30 takimeve bilaterale dhe shumëpalëshe me përfaqësues të lartë të FMN-së, BB-së, Bankës së Rezervës Federale të SHBA-së, BERZH-it, Bankës së Francës, Bankës së Italisë, EuroClear, IFC dhe institucioneve të tjera relevante, delegacioni i BQK-së diskutoi për një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi strategjike. Delagacioni mori pjesë aktive në diskutimet për perspektivat ekonomike rajonale dhe globale, duke përfaqësuar Kosovën në nivelet më të larta të dialogut ndërkombëtar financiar.

Gjatë vitit 2024, FMN ka vazhduar përkrahjen e BQK-së me asistencë teknike në fusha të ndryshme, si:

1. Menaxhimi të rezervave dhe investimeve- për avancimim e praktikave të menaxhimit të rezervave dhe rrezikut,
2. Mbikëqyrja Bankare – për rishikimin e manualit aktual të SREP-së dhe zbatimin e tij në procedurat operative
3. Mbikëqyrja e Sigurimeve – për avancimin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik,
4. Statistikave- përmirësimi i plotësisë së statistikave të financave qeveritare (GFS) për vendimmarrje
5. Stabiliteti financiar- për modelimin e Stres Testeve dhe
6. Rreziku operacional- për rishikimin e kornizës së rrezikut operacional dhe themelimin e Komitetit të Riskut
7. Mbikëqyrja e Sistemeve të TI-së për institucionet financiare – Korniza për menaxhimin e rreziqeve kibernetike dhe instrumentet e nevojshme.

Një proces i rëndësishëm që ka filluar gjatë vitit është rishikimi i Ligjit për BQK që poashtu po bëhet me asistencë teknike nga FMN. Rishikimi efektiv do të ndihmojë në adresimin e boshllëqeve në Ligjin aktual të BQK-së, largimin e mospërputhjeve në kompetencat mbikëqyrëse dhe forcimin e kuadrit ligjor në funksion të përmirësimit të qeverisjes.

Një zhvillimi tjetër i rëndësishëm është përfundimi i të gjitha detyrave me sukses në kuadër të Marrëveshjes Stand-By (SBA) dhe Programit për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri (RSF), duke reflektuar përkushtimin Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për stabilitet financiar, qëndrueshmëri ekonomike dhe reforma institucionale. Në kuadër të kësaj marrëveshje është finalizuar drafti i Ligjit për Banka në përputhje me rekomandimet e vlerësimit të FSSR dhe është dërguar në

Kuvend, është përfunduar dokumenti mbi “Rregullat e Procedurës” që sqarojnë rolet dhe përgjegjësitë e Bordit Mbikëqyrës në raport me Bordin Ekzekutiv sipas kornizës ligjore, është përgatitur udhërrëfyesi për miratimin e SREP (Procesi i Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës), si dhe është miratuar udhëzuesi për përcaktimin e praktikave që bankat duhet të ndjekin për të monitoruar dhe raportuar të dhënat për kompanitë eksportuese që mund të ekspozohen ndaj kostove të tranzicionit në kontekstin e zbatimit të Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit për Karbonin (CBAM). Këto përmbyshje përforcojnë kapacitetin mbikëqyrës të BQK-së dhe tregojnë angazhimin e saj për të avancuar më tej në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në.

Në të njëjtën kohë, BQK ka përfituar në mënyrë të vazhdueshme nga asistenca teknike e Bankës Botërore. Gjatë vitit 2024, kjo mbështetje është përqendruar në disa fusha kyçe, me qëllim forcimin e zhvillimit institucional dhe përmirësimin e funksioneve mbikëqyrëse të BQK-së:

1. Sistemi i Pagesave: për përgatitjen e anëtarësimit në SEPA, përmes përafrimit të kornizës rregullative me standardet përkatëse evropiane.
2. Mbikëqyrja e Sigurimeve: për zbatimin e standardeve IFRS 17 dhe Solvency II, me qëllim forcimin e mbikëqyrjes së sektorit të sigurimeve.
3. Mbikëqyrja Bankare: për Strategjinë e Menaxhimit dhe Mbikëqyrjes së Rreziqeve Klimatike në sektorin financiar (2024–2026), si dhe për përmirësimin e kornizës së rezolutës bankare dhe raportimit mbikëqyrës (FINREP/COREP).
4. Mbikëqyrje Bankare dhe Stabilitet Financiar – për Studimin për Qëndrueshmërinë e Korporatave si vlerësim gjithëpërfshirës i sektorit korporativ në Kosovë, për të ndihmuar mbikëqyrësit në vlerësimin efektiv të modeleve të vlerësimit të rrezikut të kredisë nga ana e bankave.

Në fushën e bashkëpunimit teknik, BQK ka nënshkruar me IFC Marrëveshjen për avancimin e Shërbimeve Financiare Digjitale. Kjo marrëveshje ka për qëllim promovimin dhe rritjen e përdorimit të teknologjive digjitale në sektorin financiar, duke kontribuar në rritjen e përfshirjes financiare dhe zhvillimin e një sistemi financiar më efikas dhe të qëndrueshëm në Kosovë. Bashkëpunimi mbështet fuqizimin e kapaciteteve teknike dhe rregullatore të Bankës Qendrore, duke adresuar sfidat dhe mundësitë që sjell transformimi digjital në sektorin financiar dhe duke përshpejtuar inovacionin për përfitimin e qytetarëve dhe biznesit. Një bashkëpunim tjetër shumë i rëndësishëm është asistenca teknike që IFC ka ofruar në hartimin e Ligjit për Institucione Mikrofinanciare dhe IFJB që pritet të finalizohet gjatë vitit 2025.

Sa i përket bashkëpunimit me BERZh, gjatë pjesëmarrjes në takimet pranverore të FMN-së dhe BB-së në Washington D.C., u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi lidhur me zbatimin e iniciativës “WE Finance Code” në Kosovë. Përmes këtij Memorandumi BQK merr rolin udhëheqës në promovimin e standardeve për barazi gjinore në qasje në financa, duke u angazhuar për të koordinuar dhe lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve financiare dhe aktorëve tjerë të rëndësishëm vendor. Ky zhvillim e vendos Kosovën në mesin e ekonomive të para në rajon që angazhohet në mënyrë të strukturuar për avancimin e qasjes gjinore në financa, dhe është në përputhje me prioritetet strategjike të BQK-së për gjithëpërfshirje financiare dhe zhvillim të sektorit financiar në përputhje me standardet më të avancuara ndërkombëtare.

Një tjetër bashkëpunim i rëndësishëm me BERZh është Studimi Rajonal të MREL për Kosovën, si një iniciativë kyçe për forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Ky studim, i mbështetur nga BERZH, synon të ndihmojë në përafrimin e sistemit financiar të Kosovës me standardet evropiane për menaxhimin e krizave bankare, përmes përcaktimit të kërkesave për kapital dhe detyrime të pranueshme. Zbatimi i këtij kuadri do të ndihmojë bankat në ndërtimin e planeve të

rikuperimit dhe zgjidhjes, duke rritur sigurinë financiare dhe përgatitjen për përballimin e goditjeve potenciale në tregjet financiare.

Gjatë vitit 2024, BQK-ja vazhdoi të marrë pjesë si institucion përfitues në Fazën II të Programit për Forcimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor me Synim të Integritimit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Faza II e këtij programi, që u lancua në shtator 2022, gjatë vitit 2024 përfshiu zhvillimin e 7 trajnimeve dhe 2 punëtorish politikash të nivelit të lartë, në të cilat BQK-ja mori pjesë bashkë me institucionet e tjera përfituese dhe të cilat trajtuan fusha dhe tema me interes për bankat qendrore të regjionit. Po ashtu, gjatë vitit 2024 u përfunduan edhe 3 masa bilaterale të bashkëpunimit me banka qendrore individuale të SEBQ-së, të nisura në vitin 2023: 1) bashkëpunimi me bankën qendrore të Austrisë në fushën e menaxhimit të rrezikut, 2) bashkëpunimi me bankën qendrore të Italisë në fushën e operacioneve me kartëmonedha dhe monedha metalike, si dhe 3) bashkëpunimi me bankën qendrore të Lituanisë në fushën e sigurisë së teknologjisë së informacionit. Njëherësh, gjatë vitit 2024, u dakordua masa e bashkëpunimit bilateral me bankën qendrore të Sllovenisë në fushën e kornizës makroprudenciale, që realizohet gjatë vitit 2025. Gjatë vitit 2024, u realizua edhe 1 praktikë e stafit të BQK-së në bankën qendrore të Sllovenisë brenda funksionit të shërbimeve ligjore, si dhe u dakorduan 1 praktikë në bankën qendrore të Holandës brenda funksionit të qeverisjes së bordeve dhe 1 praktikë në autoritetin kroat të mbikëqyrjes së shërbimeve financiare brenda funksionit të mbikëqyrjes së sigurimeve, që realizohen gjatë vitit 2025. Ky program është i financuar nga BE-ja dhe zbatohet nga BQE dhe 20 banka qendrore të SEBQ, duke përfshirë edhe bankën qendrore të Gjermanisë, e cila e koordinon dhe administron atë.

8.2. Aktiviteti lidhur me Integritet Evropian

Me qëllim të realizimit të perspektivës së vendit për anëtarësim në BE, BQK edhe këtë vit, ka vazhduar t'i përmbushë obligimet e saj në kuadër të procesit të integritet evropian duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme përmes raporteve të rregullta dhe pjesëmarrjes aktive në takime me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e integritet. Në këtë mënyrë, ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZKM), si koordinatorë kryesore e procesit të integritet, si dhe me ministritë përkatëse përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe Zyrën e BE-së në Prishtinë.

Gjatë vitit raportues, BQK ka dhënë kontributin e rregullt në përgatitjen e Raportit të Vendit, duke ofruar të dhëna dhe analiza të detajuara nga kapitujt që mbulon, për të reflektuar progresin e reformave strukturore dhe përputhjen me standardet evropiane. Po ashtu, BQK ka marrë pjesë aktive në hartimin e Marrëveshjeve në kuadër të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, duke siguruar integritimin e komponentëve financiarë dhe mbikëqyrës që ndërlidhen me mandatin e institucionit. BQK ka qenë pjesë aktive edhe në ekipin negociator të Marrëveshjes për Tregti të Lirë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve Anëtare të EFTA-s (Zvicra, Norvegjia, Islanda dhe Lihtenshtajni). Përfaqësuesit e BQK-së kanë kontribuar në kapitujt që lidhen me shërbimet financiare, duke siguruar që dispozitat e marrëveshjes të jenë në përputhje me kornizën ligjore dhe praktikat e tregut financiar të Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare. Angazhimi i BQK-së në këtë proces ka qenë kyç për të garantuar një hapje graduale dhe të qëndrueshme të tregut të shërbimeve financiare, duke mbrojtur stabilitetin financiar dhe duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e sektorit financiar në përputhje me objektivat strategjike të institucionit.

Në kuadër të Programit për Reforma në Ekonomi (PRE), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar raportimin e rregullt mbi konkluzionet që rrjedhin nga dialogu ekonomik dhe financiar ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, duke reflektuar zhvillimet makroekonomike dhe sektoriale përkatëse. Në këtë drejtim, bashkëpunimi

me Bankën Qendrore Evropiane (BQE), përmes takimeve e diskutimeve të strukturuar mbi stabilitetin financiar, mbikëqyrjen dhe rregullimin financiar, si dhe konkurrencën në treg, ka pasur rëndësi të veçantë. BQE ka ofruar mbështetje të vazhdueshme teknike dhe profesionale, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale të BQK-së dhe në përparimin drejt integritimit evropian.

Gjithashtu, BQK ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e Planit Kombëtar për Integritimin Evropian (PKIE), përmes raportimit për kapitujt relevantë dhe masat e ndërmarra për përmbushjen e reformave të kërkuara në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Krahas raportimeve të rregullta, në kuadër të përpjekjeve për avancimin e integritimit evropian, Guvernatori i BQK-së ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në Ministerialin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor mbi Zonën e Vetme të Pagesave (SEPA), si dhe në Ministerialin Vjetor të Këshillit Evropian për Politikë Ekonomike dhe Financiare (ECOFIN), duke kontribuar në forcimin e dialogut ndërinstytucional me Bashkimin Evropian (BE).

Në drejtim të avancimit të procesit të anëtarësimit të Kosovës në SEPA, delegacioni i BQK-së ka zhvilluar takime të nivelit të lartë me përfaqësues të Komisionit Evropian, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme për Stabilitet Financiar, Shërbime Financiare dhe Tregje të Kapitalit (DG FISMA). Gjatë këtyre takimeve është konfirmuar përfundimisht para-aplikimi për anëtarësim dhe janë përcaktuar hapat e më tutjeshëm teknikë dhe legjislativë. Në këtë kontekst, BQK ka përmblyllur para-aplikimin për SEPA përmes dorëzimit të aplikacionit të përditësuar në dhjetor 2024, të shoqëruar me rregullativën e re ligjore, në përputhje me kërkesat e BE-së.

Gjithashtu, Guvernatori Ismaili ka zhvilluar takime me drejtues të lartë të Këshillit Evropian të Pagesave (EPC), të Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësi dhe Zgjerim (DG NEAR), si dhe me guvernatorë të bankave qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe harmonizimin e politikave financiare me ato të BE-së.

Si pjesë e zgjerimit të bashkëpunimit me institucionet e BE-së, BQK ka pritur në vizitë edhe një anëtar të Bordit të Autoritetit të Përmblylljes së BE-së, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e krizave financiare dhe ndërtimin e mekanizmave në përputhje me praktikat e BE-së.

Këto zhvillime pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në procesin e integritimit evropian, përmes përmbushjes së standardeve të kërkuara dhe zgjerimit të bashkëpunimit me institucionet relevante të Bashkimit Evropian.

Përkushtimi i BQK-së ndaj reformave është reflektuar në vlerësimin pozitiv të Raportit për Kosovën 2024 të Komisionit Evropian. Në raport theksohet qëndrueshmëria dhe zgjerimi i sektorit bankar, me kapitalizim të lartë dhe rritje të kreditimit dhe depozitave, miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit, ndërsa rekomandohet vazhdimi i zbatimit të kornizës për kërkesat kapitale. Raporti njih progresin në forcimin e qeverisjes së BQK-së, pas emërimit të Guvernatorit dhe kompletimit të Bordit Ekzekutiv, si dhe rëndësinë e Planit të ri Strategjik pesëvjeçar, lansuar në fund të vitit 2023, për rritjen e efikasitetit operacional. Vlerësim të veçantë merr kontributi i BQK-së në luftën kundër pastrimit të parave, përmes një kornize mbikëqyrëse të bazuar në rrezik dhe bashkëpunimit me Njësinë e Inteligjencës Financiare, progresin në luftimin e falsifikimit të parasë, si dhe avancimet në përfshirjen financiare, përfshirë mundësimin e IBAN për IFJB-të dhe anëtarësimin e BQK-së në Rrjetin për Financa dhe Banking të Qëndrueshëm, në funksion të integritimit të parimeve të ESG në sektorin financiar.

8.3. Konferencat ndërkombëtare dhe rajonale

Më 15 nëntor 2024, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shënoi 25-vjetorin e themelimit me një Konferencë Ndërkombëtare të nivelit të lartë, të titulluar “Ndërtimi i urave

përtej kufijve, ndërtimi i ardhmërive: Integrimi në SEPA për gjithpërfshirje financiare – fuqizimi i rritjes dhe reziliencës”. Kjo ngjarje e rëndësishme mbledhi në Prishtinë udhëheqës të lartë të FMN dhe Grupit të Bankës Botërore, guvernatorë e drejtues të lartë të bankave qendrore nga rajoni dhe vendet evropiane si Austria, Islanda, Portugalia, Italia, Sllovenia, Kroacia, Lituania, Estonia, Anglia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Turqia dhe Mali i Zi, si dhe drejtues të institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare.

Për BQK-në, kjo konferencë ishte një mundësi strategjike për të forcuar dialogun me institucionet financiare ndërkombëtare, për të demonstruar progresin institucional dhe për të konsoliduar mbështetjen për agjendën reformuese të vendit në sektorin financiar. Pjesëmarrja e gjerë ndërkombëtare dhe niveli i lartë i diskutimeve kontribuuan në rritjen e besueshmërisë së BQK-së si institucion qendror financiar dhe partner i besueshëm në skenën rajonale dhe globale.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm ishte organizimi për herë të parë në Prishtinë i Konferencës Rajonale për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE ISI) si organizim i përbashkët në mes të BQK dhe CESEE ISI, me një pjesëmarrje të 11 vendeve nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor, konkretisht drejtues dhe zyrtarë të lartë të autoriteteve rregullative të sigurimeve dhe bankave qendrore nga Shqipëria, Austria, Republika Çeke, Sllovenia, Hungaria, Polonia, Sllovakia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë e Hercegovina.

Gjatë vitit 2024, Kosova u bë vendi mikpritës i Punëtorisë Rajonale të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) mbi Standardin e Veçantë të Pasqyrimit të të Dhënave (SDDS) – një ngjarje që shënon një moment historik në rrugëtimin e Republikës së Kosovës drejt përmirësimit të mëtejshëm të praktikave të raportimit dhe transparencës statistikore. Punëtorja pesëditore mbledhi përfaqësues nga Kosova, Mali i Zi, Shqipëria dhe Sllovenia, si dhe ekspertë të FMN-së, me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe përvojave për avancimin drejt përmbushjes së standardeve të SDDS. Kjo iniciativë u organizua nga FMN-ja, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), dhe me mbështetjen financiare të Qeverisë së Japonisë. Mbajtja e kësaj punëtorie në Prishtinë nënvizon angazhimin e përbashkët të BQK-së për forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e pasqyrimit dhe raportimit të të dhënave statistikore, në përputhje me praktikën dhe standardet ndërkombëtare të transparencës.

Një tjetër organizim i rëndësishëm në bashkëpunim me Departamentin për Evropë të FMN-së, ishte edhe konferenca ku u prezantua Raporti mbi Perspektivën Ekonomike Rajonale për Evropën (REO). Ngjarja mbledhi mbi 70 pjesëmarrës nga institucione publike, sektori financiar, akademia dhe organizata ndërkombëtare.

Krahas konferencave të organizuara në Kosovë, viti 2024 u karakterizua me pjesëmarrjen aktive të BQK-së, e përfaqësuar nga Guvernatori, në një sërë panelesh dhe ngjarjesh të nivelit të lartë ndërkombëtar, të organizuara nga banka qendrore dhe institucione të tjera rajonale e ndërkombëtare. Guvernatori ishte folës në panelin e Forumit Ndërkombëtar “Vienna Initiative” të mbajtur në Lituani, së bashku me guvernatorë të bankave qendrore dhe drejtues të institucioneve financiare ndërkombëtare. Po ashtu, ai prezantoi në panelin mbi politikën makroprudenciale në Konferencën Ekonomike të Rejkjavikut. Ndër pjesëmarrjet tjera të rëndësishme gjatë vitit ishin: Forumi i XI Rajonal i Ministrave të Financave, Guvernatorëve të Bankave Qendrore dhe Drejtorëve të Administratave Tatimore, i mbajtur në Beçiq; tryeza e nivelit të lartë e projektit “We Lead”, e financuar nga Bashkimi Evropian dhe organizuar nga Qendra e Ekselencës në Financa; konferenca e nivelit të lartë e organizuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Komitetin e Bretton Woods; si dhe Konferencën Vjetore me temë “Roli i bankës qendrore dhe sistemit bankar në rrugën drejt BE-së”, e organizuar në Tiranë nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave.

8.4. Anëtarësimet në organizata ndërkombëtare

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm gjatë vitit ishte anëtarësimi i BQK-së në Shoqatën Evropiane të Shtëpive të Kliringut të Pagesave (EACHA). Ky anëtarësim u formalizua në maj 2024 në kuadër të Takimeve Plenare të Forumit të Pagesave në Sofje, Bullgari. EACHA përfaqëson 29 shtëpi kliringu në 28 vende evropiane dhe luan një rol kyç në standardizimin dhe harmonizimin e infrastrukturës së pagesave. Pjesëmarrja e BQK-së në këtë organizatë përbën një hap strategjik drejt modernizimit të sistemit të pagesave në vend, rritjes së efikasitetit operacional dhe avancimit të ndërveprimit me sistemet evropiane, duke kontribuar kështu në përgatitjet për integrimin në zonën SEPA. Ky anëtarësim gjithashtu pritet të nxisë zhvillimin e mëtejshëm të tregut financiar vendor dhe të përmirësojë ofrimin e shërbimeve moderne të pagesave në Kosovë.

Në vitin 2024, Republika e Kosovës pranoi për herë të parë vlerësimin kreditor sovran nga agjencia ndërkombëtare “Fitch Ratings”, e cila e vlerësoi vendin me notën BB- me perspektivë të qëndrueshme. Një ndër shtyllat kryesore që ka kontribuar në këtë vlerësim është sektori bankar i Kosovës, i karakterizuar nga stabiliteti i lartë, likuiditeti i mjaftueshëm dhe kapitalizimi i mirë. Agjencia “Fitch” ka vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar edhe në periudha të pasigurisë globale, si dhe efikasitetin e mbikëqyrjes bankare, e cila është realizuar në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

8.5. Vizitat Bilaterale në institucionet homologe

Gjatë vitit raportues, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka realizuar një sërë vizitash bilaterale të nivelit të lartë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe shkëmbimin e përvojave profesionale në fusha me rëndësi për stabilitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar. Delegacione të BQK-së zhvilluan vizita zyrtare në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë, në Bankën Qendrore të Maltës dhe në Bankën Nacionale të Hungarisë. Bashkëpunimi me AMF-në u konkretizua me vizita të ndërsjella, ku përveç vizitës së delegacionit të BQK-së në Tiranë, edhe përfaqësues të lartë të AMF-së zhvilluan një vizitë zyrtare në Prishtinë.

Gjatë takimeve me AMF në Shqipëri dhe Kosovë u diskutuan zhvillimet rregulatore në tregun e sigurimeve dhe të kapitalit, zbatimin e standardeve ndërkombëtare si IFRS 17 dhe Solvenca II, si dhe avancimi i bashkëpunimit në fushën e edukimit financiar dhe integritetit të praktikave ESG. Vizita zyrtare në Bankën Qendrore të Maltës ofroi mundësi për shkëmbim përvojash në fushën e menaxhimit të rrezikut, sistemit të pagesave, përgatitjeve për anëtarësim në SEPA, administrimit të rezervave dhe masave për parandalimin e pastrimit të parave. Ndërsa vizita në Bankën Nacionale të Hungarisë u zhvillua me fokus në shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, ku delegacioni i BQK-së u njoh me modelet organizative dhe qasjet inovative të aplikuara nga ky institucion.

Në të njëjtën kohë, BQK mirëpriti në Prishtinë delegacionin e lartë të Bankës Popullore të Maqedonisë së Veriut, me të cilin u diskutua për bashkëpunimin rajonal në fushat e mbikëqyrjes financiare, politikës makroprudenciale, mbrojtjes së konsumatorëve dhe edukimit financiar. Kjo vizitë u kurorëzua me nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi për bashkëpunim të zgjeruar ndër-institucional. Këto vizita kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e kapaciteteve teknike dhe rregulatore të institucionit, duke përfunduar rolin e BQK-së si partnere e besueshme në rrjetin rajonal dhe evropian të bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse.

Bashkëpunime tjera bilaterale përfshijnë: Vizita e DMB në Bankën e Austrisë për Implementimin e SREP dhe ICAAP, Vizita e DSP në Bankën e Lituanisë për pjesëmarrjen e FINTECH në Sistemin e Pagesave, dhe vizita në Bankën e Italisë për Mbikëqyrjen e bazuar në Rrezik dhe PPP. Dy vizitat

e fundit, shënuan njëherit përmylljen e Projektit të “Mbështetjes së Integritimit Evropian të Kosovës” një projekt tre vjeçar i financuar nga ambasada Norvegjeze.

Këto angazhime e afirmuan BQK-në si një institucion kredibil dhe partner të besueshëm në sistemin financiar ndërkombëtar, si dhe përforcuan vizionin e saj për një sektor financiar të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare.

9. Qëndrueshmëria financiare

Gjatë vitit 2024 BQK ka vazhduar të forcojë qëndrueshmërinë financiare si pjesë e pavarësisë institucionale, duke arritur nivelet e kërkuara të rezervave sipas kërkesave të ligjit, krahas plotësimit të të gjitha nevojave financiare, dhe duke arritur të ndajë për të dytin vit radhazi pjesën e të ardhurat të ndashme në buxhetin e Republikës së Kosovës, të cilat do të transferohen në buxhetin shtetëror gjatë vitit 2025. Të ardhurat e ndashme që i përkasin vitit 2024 janë në vlerë prej 30.8 milionë eurove, prej të cilave 15.4 milionë euro janë kapitalizuar në kapitalin e BQK-së dhe 15.4 milionë euro tjera i transferohen buxhetit të Republikës së Kosovës.

Pasqyrat financiare të BQK-së për vitin 2024 janë audituar nga auditori i jashtëm i licencuar sipas kërkesave të legjislacionit të cilat kanë marrë opinion të pastër (të pamodifikuar), i cili së bashku me pasqyrat janë shpalosur në shtojcën nr. IV në vijim.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

IV. Pasqyrat Financiare

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
me Raportin e Auditorit të Pavarur

Përmbajtja	Page
Raporti i auditorit të pavarur	2
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	6
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	7
Shënime mbi pasqyrat financiare	8 - 58

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK" ose "Banka Qendrore"), të cilat përfshinë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, dhe shënimet për pasqyrat financiare duke përfshirë informacione materiale të politikave kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të BQK-së më 31 Dhjetor 2024, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga BQK-ja në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Brodit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të BQK-së më dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023 janë audituar nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra më 22 Maj 2024.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për një kontroll të brendshëm që menaxhmenti e përcakton se është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së BQK-së për të vazhduar vijimësinë, duke shpalosur, sipas rastit, çështjet që lidhen me vijimësinë dhe duke përdorur bazën e vijimësisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur menaxhmenti ka ndërmend të likuidojë BQK-në ose të pushojë operacionet, ose nuk ka alternativë realiste përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të BQK-së.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe marrin evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Kuptojmë kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin në mënyrë që të hartohen procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të BQK-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga menaxhmenti të bazës së vijimësisë të kontabilitetit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e BQK-së për të vazhduar si vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditorit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të bëjnë që BQK-ja të të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e BQK-së, ndër të tjera, në lidhje me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.



BDO
BDO Kosova L.L.C
audit, accounting and financial advisory
Prishtina, Kosova

Burim Cena,
Partner i angazhimit


BDO Kosova L.L.C.
Rr. Ukshin Hoti, Ob. C4/3, Hy. A, Kati II,
10 000 Prishtinë, Kosovë

4 Qershor 2025

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e pozicionit financiar
Më 31 Dhjetor 2024

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2024	2023
Pasuritë			
Pasuritë rrjedhëse			
Paraja e gatshme	7	77,017	101,932
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	147,633	426,077
Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione)	9	192,364	383,879
Plasmanet në tregun e parasë	10	506,806	205,252
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	154,934	153,831
Pasuritë tjera	14	2,673	2,476
Gjithsej pasuritë rrjedhëse		1,081,427	1,273,447
Pasuritë jo-rrjedhëse			
Letra me vlerë (Obligacione)	10	539,730	333,935
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	25,255	24,430
Prona dhe pajisjet	12	4,179	4,276
Pasuritë e paprekshme	13	836	896
Gjithsej pasuritë jo-rrjedhëse		570,000	363,537
Gjithsej pasuritë		1,651,427	1,636,984
Detyrimet			
Detyrimet rrjedhëse			
Detyrime ndaj bankave komerciale në vend	15	656,260	590,622
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	1,135	1,297
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	575,251	511,903
Detyrime ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	104,611	240,202
Huamarrja/et	19	228	222
Detyrime të tjera	20	2,042	8,362
Gjithsej detyrimet rrjedhëse		1,339,527	1,352,608
Detyrimet jo-rrjedhëse			
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	189,420	182,920
Huamarrja/et	19	1,256	1,440
Detyrime të tjera	20	827	860
Gjithsej detyrimet jo-rrjedhëse		191,503	185,220
Gjithsej detyrimet		1,531,030	1,537,828
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	21	30,000	30,000
Fondi i rezervave	21a	56,997	39,507
Rezerva nga rivlerësimi	21a, 29	1,783	2,018
Fitimet e mbajtura		31,617	27,631
Gjithsej kapitali dhe rezervat		120,397	99,156
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		1,651,427	1,636,984

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga organet vendimmarrëse¹ të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 24 Prill 2025 dhe është nënshkruar në emër të tyre nga:


 Ahmet Ismaili
 Guvernator


 Faton Ahmetaj
 Drejtor,
 Departamenti i Financave

Shënimet shoqëruesc nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

¹ Sipas nenit 34 dhe 59 të Ligjit Nr. 03/L –209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse
Më 31 Dhjetor 2024

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2024	2023
Të ardhurat nga interesi			
Të ardhurat nga interesi		45,149	34,526
Shpenzimet nga interesi		(17,922)	(9,350)
Të ardhurat neto nga interesi	22	27,227	25,176
Të ardhurat nga tarifatat dhe ndalesat			
Të ardhurat nga tarifatat dhe ndalesat		4,716	4,140
Shpenzimet nga tarifatat dhe ndalesat		(1,221)	(1,274)
Të ardhurat neto nga tarifatat dhe ndalesat	23	3,495	2,866
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ dhe të ardhurat tjera operative			
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ	24	8,722	7,849
Të ardhurat nga grantet	20, 25	50	81
Të ardhurat tjera operative	26	22	19
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit	29	783	(182)
Të hyrat operative		40,299	35,809
Shpenzimet administrative (operative)			
Shpenzimet personelit	27	(6,036)	(5,588)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12, 13	(890)	(840)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	28	(1,663)	(1,697)
Shpenzimet administrative (operative)		(8,589)	(8,125)
Rezultati financiar para pritjeve për fitimet / humbjet kreditorë			
		31,710	27,684
Provizioni për humbjet e pritura kreditorë	4	(93)	(53)
Fitimi i vitit		31,617	27,631
Të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse			
		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin			
		31,617	27,631

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

<i>Në mijë Euro</i>	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 Janar 2023	30,000	31,444	1,529	8,552	71,525
Transferimi në fondin rezervë	-	8,063	489	(8,552)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	8,063	489	(8,552)	-
Fitimi për vitin	-	-	-	27,631	27,631
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	27,631	27,631
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	30,000	39,507	2,018	27,631	99,156
Gjendja më 1 Janar 2024	30,000	39,507	2,018	27,631	99,156
Transferimi në fondin rezervë	-	17,490	(235)	(17,255)	-
Transferim në Thesar – Ministria e Financave	-	-	-	(10,376)	(10,376)
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	17,490	(235)	(27,631)	(10,376)
Fitimi për vitin	-	-	-	31,617	31,617
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	31,617	31,617
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	30,000	56,997	1,783	31,617	120,397

Shënimet shoqëruese nga I deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e rrjedhjes së parasë
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2024	2023
Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi vjetor		31,617	27,631
Rregullime për:			
Zhvlerësimin	12	632	555
Amortizimin	13	258	286
Të ardhurat nga grantet	25	(50)	(81)
Provizionet për humbjet e pritshme kreditore	4	93	53
Fitimi / humbja neto nga këmbimi valutor	29	(783)	182
Të ardhurat nga interesi	22	(45,149)	(34,526)
Shpenzimet nga interesi	22	17,922	9,350
		4,540	3,450
Ndryshime në bono thesari dhe obligacione qeveritare		(4,378)	(51,881)
Ndryshime në plasmanët në tregun e parasë		(201,000)	75,105
Ndryshime në pasuritë e ndërlidhura me FMN-në		(7,513)	131,205
Ndryshime në pasuritë tjera		(170)	240
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave komerciale		65,622	(3,659)
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në		937	(128,345)
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		62,926	(73,880)
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale		(135,587)	109,064
Ndryshime në detyrimet e tjera		(6,304)	6,813
		(220,927)	68,112
Interesa të marra		44,869	33,718
Interesa të paguara		(17,712)	(9,259)
Paraja neto e gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet operacionale		(193,770)	92,571
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve	12	(428)	(632)
Blerja e aseteve të paprekshme	13	(198)	(139)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(626)	(771)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Ripagesat për huamarrjet	19	(224)	(224)
Arkëtimet nga grantet	20	15	45
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		(209)	(179)
(Zbritja)/rritja neto në para dhe ekuivalentet e saj		(194,605)	91,621
Efekti i kursit të këmbimit (në para dhe ekuivalentet e saj)		1,392	(189)
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar		732,056	640,624
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 Dhjetor	30	538,843	732,056

Shënimet shoqëruesë nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

I. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK" ose "Banka Qendrore"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Banka vepron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 "Ligji mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" të cilit tash e tutje i referohemi si

("Ligji për BQK-në"). Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë dhe të mbajë një sistem të qëndrueshëm financiar, duke përfshirë një sistem të sigurt, të shëndetshëm dhe efikas të pagesave.
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve.
- të mbështes politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK vepron nga zyrat e saj që gjenden në Prishtinë. Adresa e regjistruar e zyrës së BQK-së është si më poshtë:
Rr. Garibaldi nr. 33
Prishtinë, Kosovë.

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori (organet vendimmarrëse)

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas nenit 34, paragrafit 2, si dhe dispozitës së përkohshme të nenit 79, paragraf 2, të Ligjit për BQK-në, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga **katër anëtar jo-ekzekutiv** dhe **Guvernatori** dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2024, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga këta anëtarë:

- Bashkim Nurboja – Kryetar i Bordit (anëtar jo-ekzekutiv)
- Ahmet Ismaili – Guvernator
- Nora Latifi Jashari – Anëtare (jo-ekzekutiv)
- Nexhat Kryeziu - Anëtar (jo-ekzekutiv)
- Arta Hoxha - Anëtar (jo-ekzekutiv)

Ndërsa, me 31 dhjetor 2023, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Bashkim Nurboja – Kryetar i Bordit (anëtar jo-ekzekutiv)
- Ahmet Ismaili – Guvernator
- Nora Latifi Jashari – Anëtare (jo-ekzekutiv)
- Nexhat Kryeziu - Anëtar (jo-ekzekutiv)
- Arta Hoxha - Anëtar (jo-ekzekutiv)

Nga data 05 shkurt 2023 Kryetar i Bordit është zgjedhur z. Bashkim Nurboja, pas skadimit të mandatit të z. Mrasori (ish kryetar i Bordit të BQK-së). Me datë 29 mars 2023 deri në muaj gusht 2023 Bordi i BQK-së bazuar në nenin 46-të të Ligjit për BQK-në ka marr kompetencat e Bordit Ekzekutiv sipas përkufizimeve të këtij neni. Në muaj gusht 2023, janë zgjedhë organet e reja të Bordit Ekzekutiv dhe anëtarët e Bordit të BQK-së janë ri-kthyer në emërimet përkatëse si anëtar Bordi të BQK-së. Nga muaji gusht 2023 konsiderohet së BQK ka pasur funksionale të dy organet vendimmarrëse.

1. Subjekti raportues (vazhdim)

Përkufizimet e nenit 46-të të Ligjit për BQK-në:

“Neni 46 - Mungesa apo pamundësia relativisht afatgjatë për të vepruar e Bordit Ekzekutiv:

1. Në rast rrethanash të jashtëzakonshme dhe nëse të gjithë anëtarët e Bordit Ekzekutiv mungojnë apo nuk janë në gjendje të veprojnë, posti i Guvernatorit do të merret përkohësisht nga Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore. Dy (2) anëtarët jo-ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore që janë më së gjati në post të tillë si dhe në dispozicion do të marrin përkohësisht postet e Zëvendësguvernatorëve.
2. Në rast se mungesa ose paaftësia për të vepruar e të gjithë anëtarëve të Bordit Ekzekutiv vazhdon për një periudhë prej tre (3) muaj, duhet të krijohen vendet e lira dhe do të zbatohen procedurat për emërim sipas nenit 38 të këtij ligji.”

Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për implementimin e politikave të BQK-së dhe të operacioneve të saj. Bordi Ekzekutiv me 31 dhjetor 2024 përbëhet nga Guvernatori, i cili është Kryesues dhe tre Zëvendësguvernator, ndërsa me 31 dhjetor 2023 Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Guvernatori dhe një Zëvendësguvernator (dy pozita të lira si zëvendësguvernator), ndërsa po ashtu me 01 janar 2023 Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Guvernatori dhe një u.d. Zëvendësguvernator.

2. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRI”). Zërat janë të rumbullakuar rreth vlerës së njëmishes (1000) se përafërt, në raste kjo mund të paraqet ndonjë mospërputhje (+/-) rreth asaj vlere si rezultat i këtij rumbullakimi të vlerave.

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuara nga SNRI-ja për secilin lloj të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë shpalosur më në detaje në politikat kontabël në shënimin 3 më poshtë.

c) Valuta funksionale dhe e prezentimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro (“EUR”), e cila është valuta funksionale e BQK-së, përveç nëse është specifikuar ndryshe në ndonjë shënim analitik. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është rumbullakësuar në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informatat në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe vendimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të konsiderueshëm në shumat e pranuar në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë në shënimin 5.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezentuara në këto pasqyra financiare.

e) Rrethanat mbi rrjedhën e aktiviteteve operative të Bankës Qendrore në 2024

Në vitin 2024, inflacioni mbetet një sfidë për shumicën e ekonomive globale, por tendenca e tij ka pasur një moderim në krahasim me vitin 2023, i cili karakterizohej nga rritje më të ndjeshme të çmimeve. Inflacioni gjatë vitit 2023 ishte rezultat i një kombinimi faktorësh të brendshëm dhe ndërkombëtarë, kryesisht nga ndikimet e vazhdueshme nga vazhdimi i luftës në Ukrainë, rritja e çmimeve të energjisë. Ndërkohe, në vitin 2024, inflacioni ka filluar të tregojë një tendencë stabilizimi, duke pasur një ndikim më të moderuar në ekonominë kryesore.

Përsa i përket aktivitetit operativ të Bankës Qendrore (BQK-së), ndikimi i inflacionit në vitin 2024 ka qenë relativisht i kufizuar. Megjithatë, nga ana tjetër, normat e interesit kanë pësuar një rritje të dukshme gjatë vitit 2024. Sidoqoftë, vlera e aseteve financiare të BQK-së nuk është prekur drejtpërdrejt nga rritja e normave të interesit, për shkak të natyrës së portfolios së instrumenteve financiar. Në vitin 2024, ndikimi i rritjes së normave të interesit dhe forcimit të valutës euro ka pasur një efekt pozitiv në të hyrat dhe shpenzimet e interesit, duke kontribuar në një rritje të zërit neto të të hyrave nga interesat. Ky trend ka ndihmuar në stabilizimin e zërave financiar të BQK-së dhe në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare.

Një tjetër faktor që ka qenë në fokus gjatë vitit 2024 ka qenë vlerësimi i ndikimeve të situatës globale, veçanërisht efekti i luftës në Ukrainë dhe tensioneve dhe luftat në Lindjen e Mesme, si dhe forcimi i sanksioneve ndërkombëtare kundër Federatës Ruse. Edhe pse këto konflikte janë ende aktive, gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndikime të mëdha në aktivitetet e BQK-së. Megjithatë, BQK vazhdon të monitorojë nga afër zhvillimet dhe të mbetet vigjilente ndaj efekteve të mundshme që këto ngjarje mund të kenë në stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit.

3. Politikat e rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj vlerësohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së transaksioneve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga valutat e huaja për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë rivlerësohen në monedhë funksionale në kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar ajo vlerë e drejtë. Diferencat nga valutat e huaja që rrjedhin nga rivlerësimi njihen si fitim ose humbje.

b) Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen si fitim apo humbje bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pasurisë ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të pasurisë ose detyrimit financiar. Norma e interesit efektiv përcaktohet në njohjen fillestare të pasurisë ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo kostot e transaksioneve të pranura dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejtë për blerjen, emetimin apo largimin e një pasurie apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje apo fitim përfshijnë interesat nga pasuritë ose detyrimet financiare me kosto të amortizuara mbi bazën e interesit efektiv.

c) Tarifat dhe komisionet

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një mjet apo detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të hyrat tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, tarifat e transferimit të fondeve dhe të licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to. Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitojnë.

d) Përfitimet e punonjësve

BQK aplikon kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, që përcaktohen si kontributet pensionale të punonjësve kur ata dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve të kontributit të përcaktuara, bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së ngarkohen si shpenzim në të ardhura në momentin kur ato ndodhin.

Po ashtu BQK ndan përfitime të punonjësve në baza jubilarë dhe në formë të shumës së paracaktuar në momentin e pensionimit. BQK njih këto shpenzime sipas ndodhjes së këtyre ngjarjeve sipas planeve për përfitime afatgjata.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e liruar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010. Shih shënimin 4 (f) se si BQK-ja alokon fitimin e saj.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare

Pasuritë financiare të BQK-së të përfshira në këto pasqyra financiare klasifikohen si instrumente financiare me kosto të amortizuara (modeli mbaj për të mbledhur) dhe përbëhen nga paraja dhe ekuivalentët e saj, letrat me vlerë, llogaritë e depozitave në bankat jorezidente, asetet e lidhura me FMN dhe pasuritë tjera.

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDFH (Vlera e drejtë përmes Humbjes së Fitimit):

- pasuria mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të specifikuara tek flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI) mbi shumën e mbetur të papaguar.

BQK-ja klasifikon të gjitha detyrimet e saj financiare të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të ardhurat nga interesi ose shpenzimet e interesit nga detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar, njihen në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare të matura me koston të amortizuar përfshijnë detyrimet ndaj bankave vendase, institucioneve qeveritare, subjekteve publike dhe tregtare, për shkak të FMN-së, huazimeve dhe detyrimeve të tjera financiare.

i. Njohja

Në njohjen fillestare, një pasuri financiare klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar (KA), vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDAGJ) ose vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Pasuria financiare apo detyrimi financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për zë jo me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

Siç u përmend më lartë, BQK-ja ka në librat e saj vetëm instrumente financiare me kosto të amortizuar, të cilat plotësojnë kriteret e modelit të mbajtjes për të mbledhur flukset monetare kontraktuale.

ii. Riklasifikimi

Pasuritë financiare të bankës varësisht nga rrethanat respektivisht ndryshimi i modelit të saj të biznesit për administrimin e pasurive financiare mund të ri-klasifikoj këto të fundit edhe pas njohjes fillestare të tyre.

Në qoftë se banka ri-klasifikon një pasuri financiare apo grup të pasurive financiare nga kategoria e matjes me koston e amortizuar tek kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë e tyre do të matet në datën e ri-klasifikimit. Çdo fitim ose humbje neto që rrjedh nga një diferencë midis koston së amortizuar dhe vlerës së drejtë të aktivit financiar njihet në fitim ose humbje.

iii. Ç'regjistrimi

BQK-ja ç'regjiston një pasuri financiare kur skadojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhat e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhat e parasë kontraktuale në një transaksion në të cilin në thelb janë transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare ose në të cilat BQK as nuk transferon dhe as mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e asetit financiar.

Për ç'regjistrimin e një pasurie financiare, diferencën midis vlerës kontabël të pasurisë (ose vlerës së mbartur të alokuar për pjesën e pasurisë së ç'regjistruar) dhe shumës së (i) vlerësimit të marrë (përfshirë çdo pasuri të re të marrë më pak çdo detyrim të ri supozuar) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që ishte njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) njihet në fitim ose humbje. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që është krijuar ose mbajtur nga BQK-ja njihet si pasuri ose detyrim i veçantë.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

BQK-ja hyn në transaksione me të cilat transferon asete të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurive të transferuara ose një pjesë të tyre. Në raste të tilla, pasuritë e transferuara nuk ç'regjistrohen. Shembuj të transaksioneve të tilla janë kreditimi i letrave me vlerë dhe transaksionet e shitjes dhe të riblerjes.

Në transaksionet në të cilat BQK as nuk mban dhe as transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një pasurie financiare dhe ai mban kontrollin mbi pasurinë, BQK vazhdon të njohë pasurinë në masën e përfshirjes së tij të vazhdueshme, të përcaktuar në masën tek e cila është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

BQK-ja ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale përfundohen ose anulohen, ose skadojnë.

iv. Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimeve financiare

Nëse kushtet e një pasurie financiare janë modifikuar, BQK vlerëson nëse flukset monetare të pasurisë së modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Nëse flukset e parave janë në thelb të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga pasuria financiare origjinale konsiderohen të kenë skaduar. Në këtë rast, pasuria fillestare financiare ç'regjistrohet (shiko (iii)) dhe një pasuri e re financiare njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset e parave të pasurisë së modifikuar të mbartura me kosto të amortizuara nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim të pasurisë financiare. Në këtë rast, BQK-ja rillogarit vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe një shumën që lind nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje e modifikimit në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ai paraqitet si të ardhura nga interesi.

BQK-ja ç'regjistron një detyrim financiar kur kushtet e saj modifikohen dhe flukset e parave të detyrimit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast, një detyrim i ri financiar bazuar në kushtet e modifikuara njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar të shuar dhe detyrimit të ri financiar me termat e modifikuar njihet në fitim ose humbje. Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si ç'regjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke zbritur flukset e modifikuara të parash me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

v. Netimi

Mjetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

vi. Matja e koston së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një mjeti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën mjeti ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

vii. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë (reale) është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një pasurie apo që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përfaqësojnë transaksionet që ndodhin aktualisht dhe rregullisht në treg në bazë të vullnetshme midis palëve.

Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit midis palëve të mirë informuara dhe në formë të vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e zbritjes së rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i mermin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vendosjen e çmimit të instrumenteve financiare. Të dhënat për teknikat vlerësuese paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritjet e tregut dhe masat e faktorëve të rrezikut që ekzistojnë në instrumentin financiar. BQK-ja kalibron teknikat vlerësuese dhe i teston ato për vlefshmërinë duke shfrytëzuar çmimet nga transaksionet aktuale të dallueshme të tregut në të njëjtin instrument apo në bazë të të dhënave tjera të dallueshme dhe të disponueshme në treg.

viii. Lejimet e humbjeve

BQK njih lejimet e humbjeve për humbjet e pritura kreditore "HPK" për pasuritë financiare që maten sipas kostos së amortizuar dhe nuk maten në VDFH. BQK-ja vlerëson lejimet e humbjes në një shumë të barabartë me HPK përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit, përveç rasteve të mëposhtme për të cilat ato maten si HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë të investimeve të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët kredie në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

BQK-ja e konsideron një letër me vlerë të borxhit me rrezik të ulët krediti kur vlerësimi i rrezikut të kredisë është ekuivalent me përkufizimin e kuptuar globalisht "shkallë e investimit". ECL 12-mujore janë pjesa e ECL që rezultojnë nga ngjarjet e mospagimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet një ECL 12-mujore referohen si instrumente financiare të Fazës 1.

HPK përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit financiar janë HPK që vijnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të paracaktuar gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet një HPK gjatë gjithë jetëgjatësisë, por që nuk janë të efektuar (dëmtuara) nga humbjet kreditore, klasifikohen të "Faza 2 - Nënperformuese e instrumenteve financiare".

Matja e HPK-së

Modeli i zhvlerësimit të HPK-së është një matje e bazuar në probabilitet dhe përfshin ndikimin e rezultateve të ndryshme të mundshme. Operacionalisht, kjo mund të jetë e vështirë për t'u zbatuar dhe zgjedhja e skenarëve përkatës ekonomik mund të jetë sfiduese.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)
f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

Për implemetimin e hollësishëm të HPK-së kemi përdorur metodën e thjeshtë që shfrytëzon mundësinë e parashikimit të qasjes së humbjes e cila është:

$$\text{Humbjet e pritura kreditore (HPK)} = \text{Vlera a ekspozuar (VE)} \times \text{Humbja e mundshme e pritur (HP)} \times \text{Probabiliteti i humbjes së mundshme të pritur (PHP)}.$$

VE – Vlera e ekspozuar, është vlera kontabël bruto e pasurive financiare që bien në model për t'u rivlerësuar.

HP – Humbja e mundshme e pritur, është pritshmëria se nga vlera e ekspozuar mund të mos kthehet nëse ndodh humbja. Ne jemi bazuar në gjykimin tonë të brendshëm dhe, gjithashtu jemi mbështetur në disa qasje ndaj rrezikut sipas përcaktimeve të Bazelit për vlerësimin e huamarrësve që dështojnë të mbyllin obligimet.

PHP – Probabiliteti i humbjes së mundshme së pritur, është variabla më e ndjeshme dhe paraqet gjasën e mos pagesës nga pala e tjetër për një periudhë të observuar (12 mujore apo gjate gjithë jetës së instrumentit).

Modeli humbjeve të pritura (HPK) është një vlerësim i ponderuar i humbjeve kreditore dhe vlerësohen si më poshtë:

- pasuritë financiare që janë korrigjuar në vlerë në datën e raportimit: si vlera aktuale e të gjitha pritjeve me pak të parasë së gatshme (d.m.th. ndryshimi midis rrjedhës së parave të gatshme ndaj BQK-së, në përputhje me kontratën dhe rrjedha e parave që BQK-ja pret të marrë);
- pasuritë financiare që janë vlerësuar sipas humbjeve kreditore të pritura në datën e raportimit: si ndryshim midis vlerës së tyre bruto dhe pritjes së humbjes kreditore për të njëjtat.

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat e gatshme, depozita me bankat dhe pasuri financiare shumë likuide me maturitet origjinal për më pak se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga BQK-ja në menaxhimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiare me kosto të amortizuar.

h) Letrat me vlerë të investimeve

Letrat me vlerë të investimeve, të përbëra nga bonot e thesarit dhe obligacionet, fillimisht maten me vlerën e drejtë plus shtesat për kostot e transaksionit direkt dhe më pas maten sipas koston të amortizuar (mbajtja e pasurive me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale) duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të gjitha blerjet dhe shitjet e letrave me vlerë të investimeve njihen në datën e shlyerjes, d.m.th. data kur pasuria është marrë, ose dorëzuar tek pala tjetër.

Kostoja e amortizuar/ mbajtja e pasurive me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale janë investime në pasuri jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturim fiks që BQK ka qëllimet pozitive dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë të caktuara në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

i) Depozitat dhe huamarrjet

Depozitat dhe huazimet fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit direkt shtesë, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j) Pasuritë dhe detyrimet e lidhura me FMN-në

Zërat e llogarive me FMN-në zakonisht paraqitet në zërat e Bankës Qendrore të anëtarit. Mjetet dhe detyrimet e lidhura me FMN-në fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar. Fitimet dhe humbjet nga rivlerësimi i kursit të këmbimit që lindin nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve të FMN-së njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

k) Prona dhe pajisjet

i. Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e mjetit. Kosto e mjeteve të ndërtuara nga vet BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejt, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e mjetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera që janë thelbësore (pjesë përbërëse) për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesor) të pronës dhe pajisjes.

ii. Kosto pasuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të pronës ose pajisjeve njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij mjete të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të përditshëm të pronës dhe pajisjes (pasurive afatgjata materiale) njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së secilës pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën aktuale dhe krahasues është si më poshtë:

	2024	2023
Investimet në objekte me qira	20 vite	20 vite
Pajisje	5 vite	5 vite
Kompjuterë	3 vite	3 vite
Automjete	5 vite	5 vite

Jetëgjatësia e pajisjeve tjera vlerësohet rast pas rasti. Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rihvlerësohen në datën e raportimit.

l) Asetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë, nëse ka.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij asemi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike bazohet në vlerësimin për shfrytëzimin e atij programi pa qenë nevoja për ndonjë përmirësim të madh, aktualisht nga 3 deri në 10 vite.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

m) Rënia në vlerë e pasurive jo-financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për ndryshim në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aseti/pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aseteve që gjeneron njëdhë të parasë që janë të pavarura nga mjetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësisë gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis aseteve të tjera të njësive (grupi të njësive) në baza proporcionale. Vlera e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë. Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më.

Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

n) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

o) Të ardhurat nga grantet

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një aseti njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të asetit.

p) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtar të caktuar dhe financiar për një afat të shkurtër nga organizatat ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtar. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në këto pasqyrat financiare.

q) Provizionet

Provizioni njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e zbritur rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga BQK-ja nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis koston së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njih çdo humbje nga rënia në vlerë e asetit të lidhur me atë kontratë.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

r) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet që janë tashmë në fuqi

Gjatë këtij viti, Banka Qendrore ka zbatuar një sërë ndryshimesh në Standardet e Raportimit Financiar Sipas SNRF, të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), të cilat janë bërë të detyrueshme për periudhat kontabël që fillojnë më 1 janar 2024 ose më pas.

- Përgjegjësia për qiranë në një marrëveshje shitjeje dhe qiradhënieje (Ndryshime në SNRF 16 Detyrimet e qirasë);
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (përfshirë shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi) (Ndryshime në SNA 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare);
- Detyrime afatgjata me kushte financiare (Ndryshime në SNA 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare);
- Marrëveshjet e financimit të furnitorëve (Ndryshime në SNA 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Zbulimet).

Ndryshimet e listuara më sipër nuk kanë pasur asnjë ndikim në shumat e njohura në periudhat e mëparshme dhe nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në periudhat aktuale ose të ardhshme.

s) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive

Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara që janë lëshuar, por ende nuk kanë hyrë në fuqi deri në datën e publikimit të pasqyrave financiare, janë zbuluar më poshtë. Banka Qendrore synon të miratojë këto standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara, nëse janë të zbatueshme, kur ato të bëhen efektive.

Ndryshimet e mëposhtme nuk janë në fuqi për periudhën që fillon më 1 janar 2024:

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshim në SNA 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor);
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 Instrumentet Financiare);
- Kontratat që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra (Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7);
- SNRF 18 Prezantimi dhe Zbulimi në Pasqyrat Financiare;
- SNRF 19 Degët pa Përgjegjësi Publike: Zbulimet.

Këto standarde, ndryshime ose interpretime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në Bankën Qendrore gjatë periudhave aktuale ose të ardhshme të raportimit dhe në transaksionet e parashikuashme në të ardhmen.

Banka Qendrore ka zgjedhur të mos aplikoj këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Banka Qendrore parashikon që aplikimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të ketë një ndikim më peshë në pasqyrat financiare të Bankës Qendrore. Ndërsa ndikimi i plotë i tyre do vlerësohet edhe një herë kur vendoset aplikimi i tyre.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

a) Hyrje dhe vështrim

BQK është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga zhvillimi i aktiviteteve të saj dhe po ashtu edhe nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku operacional
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme, objektivave, politikave dhe procedurave të BQK-së për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe administrimi aktiviteteve dhe po ashtu edhe të kapitalit nga BQK-ja. Shënime të tjera specifike si sasiore po ashtu edhe cilësore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Struktura e menaxhimit të rrezikut

Mbikëqyrja e administrimit të aktiviteteve të BQK-së (përfshirë edhe menaxhimin e rrezikut) është përgjegjësi e Bordit të Bankës Qendrore. Bordi Ekzekutiv ka përgjegjësinë t'i identifikojë dhe t'i vlerësojë rreziqet dhe të hartojë plane, që në rast të papriturash në të ardhmen, të sigurohen vazhdimësia e veprimtarive dhe siguria e Bankës Qendrore. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht (në baza tre-mujore) nëpërmjet Departamentit për Menaxhimin e Rrezikut dhe Bordit Ekzekutiv të BQK-së tek Bordi i BQK-së mbi praktikën e administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut. Bordi Ekzekutiv, Komiteti i Investimeve dhe Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut e kanë për detyrë në koordinim me njësitë organizative të bëjnë hartimin dhe monitorimin e politikave të administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika zbatohen më pas nga njësitë përkatëse organizative.

Politikat e administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballlet BQK-ja, si dhe të vendos kufizime dhe kontroll të duhur për rreziq, dhe të monitoroj rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e ofruara të tregut. BQK-ja, me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, synon të zhvilloj një mjedis kontrolli efektiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të BQK-së po ashtu është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet që përballlet BQK-ja. Komiteti i Auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Shefit të Auditimit të Brendshëm dhe Auditimi i Brendshëm (njësitë përkatëse). Auditimi i Brendshëm ndërmerr auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe të rastësishme (ad-hoc), rezultatet e të cilave raportohen përmes Shefit të Auditimit të Brendshëm tek Komiteti i Auditimit, pastaj te Bordi i BQK-së.

b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj, dhe mund të rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në instrumente financiar si: letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera. BQK për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut kreditor, BQK-ja konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut kreditor (siç është rreziku i ekspozimit kreditor nga: vonesa e përmbushjes së detyrimeve individuale, rreziku i vendit dhe sektorit).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut kreditor

i. Investimet dhe ekspozimi ndaj rrezikut kreditor në BQK

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra të lëshuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe korporata multinacionale dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të cilave i janë vlerësuar në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur parasysh vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

Menaxhimi i rrezikut bëhet përmes:

- Kufizimit të fushëveprimit dhe kohëzgjatjes së instrumenteve financiare,
- Kufizimit të emetuesve të palëve, me vlerësim të pranueshëm kredie për klasën e investimit dhe me lartë,
- Kufizimit të shumës dhe përqendrimit maksimal me palët.

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, paraqitet nga vlera e bartur e llogarive rrjedhëse me bankat e huaja, letrave me vlerë (Bono të Thesarit dhe Obligacione) dhe depozitave me bankat (përfshirë ato rezidente dhe jo rezidente). Për detaje mbi ekspozimin referohuni edhe të shënimeve 8, 9 dhe 10.

Vlerësimi kreditor për instrumentet financiare që BQK ka ekspozim për periudhën që përfundon më 31 dhjetor 2024 është prej AAA deri BB-/ Aaa deri Baa3/AAA deri BB-.

Tabela në vijim paraqet vlerat bartëse të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor të ndara sipas rangimit kreditor dhe të shprehura edhe pjesmarrja në përqindje me gjithsej.

Shpërndarja sipas llojit dhe vlerësimit kreditor

31 dhjetor 2024						
Rangimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	Plasmane t në tregun e parasë	Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	Llogaritë e ndërlidhur a me FMN (DVT dhe shfrytëzim i i fondeve)	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	104,510	271,246	176,138	-	551,894	35.20%
AA+/Aa1/AA+	-	-	137,974	-	137,974	8.81%
AA/Aa2/AA	374	20,231	-	-	20,605	1.32%
AA-/Aa3/AA-	10,170	-	163,465	-	173,635	11.08%
A+/A1/A+	2,928	120,530	-	-	123,458	7.88%
A/A2/A	7,221	25,043	15,507	-	47,771	3.05%
A-/A3/A-	21,460	50,373	29,989	-	101,822	6.49%
BBB-/Baa3/BBB-	1,012	-	36,700	-	37,712	2.41%
BB-/Baa3/BB-	-	19,479	172,789	-	192,268	12.26%
N/A (pa vlerësim – IFN/FMN)	-	-	-	180,189	180,189	11.50%
Gjithsej	147,675	506,902	732,562	180,189	1,567,328	100.00%

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Shprendarja sipas llojin dhe vlerësimit kreditor

31 dhjetor 2023						
Rangimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	Plasmanet në tregun e parasë	Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	Llogaritë e ndërlidhur a me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i i фондеве)	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	387,109	180,216	143,868	-	711,193	46.59%
AA+/Aa1/AA+	-	-	129,489	-	129,489	8.48%
AA-/Aa3/AA-	-	-	190,575	-	190,575	12.48%
A+/A1/A+	6,023	-	-	-	6,023	0.39%
A/A2/A	21,178	-	15,658	-	36,836	2.41%
A-/A3/A-	10,534	25,064	200,755	-	236,353	15.48%
BBB-/Baa3/BBB-	-	-	37,836	-	37,836	2.48%
N/A (pa vlerësim - IFN)	-	-	-	178,261	178,261	11.69%
Gjithsej	424,844	205,280	718,181	178,261	1,526,566	100.00%

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është në vonesë. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditor.

Kriteret themelore të përcaktimit të ekspozimit janë vlerësimi kreditor. Vlerësimi kreditor merret nga agjensitë për vlerësim kreditor. Klasifikimi kreditor minimal i lejuar për investim në afat të shkurtër është P-2 (Moody's) ose A-2 (Standard & Poor's), ndërsa në afat të gjatë është Baa3 (Moody's) ose BBB- (Standard & Poor's).

Ne rastet e jashtëzakonshme në pamundësi të realizimit të kthimeve pozitive, lejohet ekspozim i investimeve përmes klasifikimit afatshkurtër kreditor të emetuesit P-3 (Moody's) apo A-3 (Standard & Poor's) dhe klasifikimit afatgjatë kreditor të emetuesit Ba3 (Moody's) apo BB- (Standard & Poor's).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Modeli i dëmtimit të pasurive financiare në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut kreditor respektivisht ndryshimeve në rrezik kreditor që nga njohja fillestare e pasurive financiare përcakton tre faza në modelin e vlerësimit të humbjeve të pritshme kreditore. Këto faza mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Faza 1 (Performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - pasuritë financiare të cilat trajtohen si ekspozim me rrezik të ulët ose të mesëm përfshihen në këtë fazë në njohjen fillestare. Bazuar në procedurat tona të brendshme, nuk na lejohet të investojmë në ekspozime me rrezik të lartë kreditor. Bazuar në këtë, çdo investim në njohjen fillestare alokohet në Fazë 1 të ekspozimit.
2. Faza 2 (Nën-performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - nëse kemi një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare, pasuria financiare e cila ndodhet në shkallën 1, transferohet në fazën 2.
3. Faza 3 (Jo-performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - transferimi në fazën 3 bëhet vetëm atëherë kur ka evidenca objektive që klienti do të dështon në përmbushje të obligimeve.

Vlerësimi bëhet në njohjen fillestare dhe në datën e periudhës së raportimit. Modeli i përdorur për fazën 1 të shpërndarjes është baza 12 mujore e jetëgjatësisë, por mund të varret nga niveli i përbërës të ekspozimit të kredisë nëse kemi ndryshim të rëndësishëm në rritjen e rrezikut të kredisë dhe në kredinë e zhvlerësuar të portofolit të aktivitetit financiar.

Ndryshimi i ndjeshëm në rritjen e rrezikut të kredisë si kriter për të kaluar nga faza 1 në fazën 2, kur ai kalon nga klasa e investimit në klasën jo-investuese të vlerësimit të përbërës të kredisë së një portofoli.

Definicioni i dështimit:

Kriteret e dështimit duhet të bazohen në provat objektive të:

- Debitorëve, me vështirësi të konsiderueshme financiare,
- Kur është fjala për shkelje të detyrimeve kontraktuale, në lidhje me kryegjënë dhe interesin,
- Kur të ndodhë me ndonjë ristrukturim të kushteve ekzistuese të përmbushjeve të detyrimit nga një instrument financiar,
- Dëshmi/probabilitet i qartë që debitori po kalon në falimentim dhe/ose likudim,
- Shenjat e të qenit jo aktiv në tregtim (në tregjet financiare).

Në tabelën në vijim paraqiten vlerat e ekspozimit në nivel të fazave. Në datën e raportimit nuk kemi ndonjë ndryshim material në rrezik kreditor që nga njohja fillestare prandaj të gjitha pasuritë financiare janë në fazën 1.

	2024 ²			2023		
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	147,675	-	-	426,194	-	-
Lëtrat me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	732,562	-	-	718,181	-	-
Plasmanët në tregun e parasë	506,902	-	-	205,280	-	-
Vlera bartëse bruto	1,387,139	-	-	1,349,655	-	-
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(606)	-	-	(512)	-	-
Neto vlera bartëse	1,386,533	-	-	1,349,143	-	-

² Në vitin raportues (2024) dhe as në vitin krahasues nuk janë të përfshira instrumentet financiare për llogaritë e ndërlydhura me FMN (IMF), pasi vlerësimi/pritshmëria është se ky grup nuk është ekspozim që mbart në vete lejime për humbje të pritura kreditore (HPK).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja të ketë vështirësi në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve që rrjedhin nga detyrimet e saj financiare.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, që vazhdimisht të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së. BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jo-rezidente dhe duke mbajtur shuma të mjaftueshme të mjeteve monetare në kasafortat e saj. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të keqësuar BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj. Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testime të rregullta të likuiditetit kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit iu nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet mujore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i paraqiten rregullisht anëtarëve të Komitetit të Investimeve nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Maturiteti i mbetur kontraktual për pasuritë dhe detyrimet financiare, më përjashtim të pagesave të ardhshme të interesit:

31 Dhjetor 2024	Shënim	Neto vlera e bartur	zërat si pasuri rrjedhëse		zërat si pasuri jo-rrjedhëse		
			Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vit deri në 5 vite	mbi 5 vite
Pasuritë jo-derivative							
	7	77,017	77,017	-	-	-	-
	8	147,633	147,633	-	-	-	-
	9	732,562	-	68,521	124,312	533,085	6,644
	10	506,902	335,402	171,500	-	-	-
	11	179,206	153,951	-	-	-	25,255
		1,643,320	714,003	240,021	124,312	533,085	31,899
Detyrimet jo-derivative							
	15	(656,260)	(656,260)	-	-	-	-
	16	(168,887)	(68)	-	-	-	(168,819)
	17	(575,251)	(575,251)	-	-	-	-
	18	(104,611)	(104,611)	-	-	-	-
	19	(1,484)	-	(114)	(114)	(913)	(343)
	20	(760)	(760)	-	-	-	-
		(1,507,253)	(1,336,950)	(114)	(114)	(913)	(169,162)
		136,067	(622,947)	239,907	124,198	532,172	(137,263)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2023	Shënim	Neto vlera e bartur	zërat si pasuri rrjedhëse			zërat si pasuri jo-rrjedhëse	
			Më pak se 1 muaj	1 deri ne 3 muaj	3 muaj deri ne një vit	1-5 vite	mbi 5 vite
<i>Pasuritë jo-derivative</i>							
		101,932	101,932	-	-	-	-
	8	426,077	426,077	-	-	-	-
	9	717,814	42,170	74,273	267,436	333,935	-
	10	205,252	130,184	75,068	-	-	-
	11	177,049	152,619	-	-	-	24,430
		1,628,124	852,982	149,341	267,436	333,935	24,430
<i>Detyrimet jo-derivative</i>							
	15	(590,622)	(590,622)	-	-	-	-
	16	(163,808)	(6)	-	-	-	(163,802)
	17	(511,903)	(511,903)	-	-	-	-
	18	(240,202)	(240,202)	-	-	-	-
	19	(1,662)	-	(111)	(111)	(886)	(554)
	20	(758)	(758)	-	-	-	-
		(1,508,955)	(1,343,491)	(111)	(111)	(886)	(164,356)
		119,169	(490,509)	149,230	267,325	333,049	(139,926)

Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK-ja mban mjete likuide që përfshijnë para dhe ekuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

4. Menaxhim i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet që përhapen në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtur nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin e investimeve.

Menaxhimi i rreziqeve të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrihen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në atë masë që pasuritë dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Mjetet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e ri-çmimit të indekseve të shumëllojshme me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistent me strategjitë e veprimit të BQK-së. Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e rivlerësimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve.

Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portfolios jo të tregtueshme paraqitet tabelën e mëposhtme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

31 Dhjetor 2024	Shënim						
		Neto vlera e bartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vite
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	147,633	147,633	-	-	-	-
Letra me vlerë (obligacione dhe bono thesari)	9	732,562	9,583	-	4,781	652,294	65,904
Plasmanët në tregun e parasë	10	506,902	305,261	201,641	-	-	-
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	11	176,459	153,951	-	-	-	22,508
Gjithsej		1,563,556	616,428	201,641	4,781	652,294	88,412
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(656,260)	(656,260)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(168,887)	(68)	-	-	-	(168,819)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(575,251)	(575,251)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(104,611)	(104,611)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(1,484)	-	-	-	-	(1,484)
Detyrime të tjera vendase	20	(760)	(760)	-	-	-	-
Gjithsej		(1,507,253)	(1,336,950)	-	-	-	(170,303)
Ndryshimi		56,303	(720,522)	201,641	4,781	652,294	(81,891)

31 Dhjetor 2023	Shënim						
		Neto vlera e bartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vite
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	426,077	426,077	-	-	-	-
Letra me vlerë (obligacione dhe bono thesari)	9	717,814	116,443	103,538	163,899	333,934	-
Plasmanët në tregun e parasë	10	205,252	205,252	-	-	-	-
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	11	174,384	152,619	-	-	-	21,765
Gjithsej		1,523,527	900,391	103,538	163,899	333,934	21,765
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(590,622)	(590,622)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(163,808)	(6)	-	-	-	(163,802)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(511,903)	(511,903)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(240,202)	(240,202)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(1,662)	-	-	-	-	(1,662)
Detyrime të tjera vendase	20	(758)	(758)	-	-	-	-
Gjithsej		(1,508,955)	(1,343,491)	-	-	-	(165,464)
Ndryshimi		14,572	(443,100)	103,538	163,899	333,934	(143,699)

Pasuritë dhe detyrimet financiare që nuk bartin interes nuk janë të përfshira në tabelën më lartë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregtar i normave të interesit jo të tregtueshme menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të menaxhuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standard të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh bazë ("pb"). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbove të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

2024

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	563	(563)

2023

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	146	(146)

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutor të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj DVT-të lidhur me pasuritë dhe detyrimet e saj në FMN si dhe ndaj USD lidhur me pasuritë e saj në formën e llogarive rrjedhëse me bankat jo rezidente dhe investimet në letra me vlerë në dollar, të cilat i monitoron në vazhdimësi. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

2024	DVT		USD	
	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	(118)	118	209	(209)
2023				
	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	(75)	75	99	(99)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

	Euro	USD (Ekuivalent në Euro)	DVT (Ekuivalent në Euro)	Gjithsej neto vlera e bartur
31 Dhjetor 2024				
Pasuritë				
Paraja e gatshme	77,017	-	-	77,017
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	147,187	446	-	147,633
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	717,731	14,363	-	732,094
Plasmanët në tregun e parasë	462,327	44,479	-	506,806
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	983	-	179,206	180,189
Mjetet e tjera	2,673	-	-	2,673
Gjithsej	1,407,918	59,288	179,206	1,646,412
Detyrime				
Detyrime ndaj bankave vendase	656,260	-	-	656,260
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	1,067	-	189,488	190,555
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	536,845	38,406	-	575,251
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	104,611	-	-	104,611
Nga huamarrja /et	-	-	1,484	1,484
Detyrime të tjera vendore	2,869	-	-	2,869
Gjithsej	1,301,652	38,406	190,972	1,531,030
Pozicioni neto për valuta të huaja	106,266	20,882	(11,766)	115,382
	Euro	USD (Ekuivalent në Euro)	DVT (Ekuivalent në Euro)	Gjithsej neto vlera e bartur
31 Dhjetor 2023				
Pasuritë				
Paraja e gatshme	101,932	-	-	101,932
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	425,818	259	-	426,077
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	713,321	4,493	-	717,814
Plasmanët në tregun e parasë	200,094	5,158	-	205,252
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	1,212	-	177,049	178,261
Mjetet e tjera	2,476	-	-	2,476
Gjithsej	1,444,853	9,910	177,049	1,631,812
Detyrime				
Detyrime ndaj bankave vendase	590,622	-	-	590,622
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	1,291	-	182,926	184,217
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	511,903	-	-	511,903
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	240,202	-	-	240,202
Nga huamarrja /et	-	-	1,662	1,662
Detyrime të tjera vendore	9,222	-	-	9,222
Gjithsej	1,353,240	-	184,588	1,537,828
Pozicioni neto për valuta të huaja	91,613	9,910	(7,539)	93,984

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa monedhat e huaja/tjera të cilat BQK-ja ka në portfolio janë kryesisht "Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes" ("DVT") dhe Dollar Amerikan (USD). Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 ishin si vijon:

	2024	2023
	Euro	Euro
1 DVT	1.25482	1.21753
1 USD	0.96256	0.90498

DVT-të janë pasuri rezervë shtesë si mbështetje në këmbimin/transaksionet e jashtme që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vetë, ato përfaqësojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT-ve përcaktohet si mesatare e shportës së pesë valutave kryesore, euro, dollari amerikan, funta britanike, jeni japonez dhe renmindbi kinez.

USD-të janë mjete në llogari rrjedhëse dhe depozita të afatizuar me Federal Reserve New York.

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BQK-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përveç rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullative si dhe standardet e pranuar gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative.

Objekti i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional, si dhe dëshiron të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me menaxhimin e kostove efektive.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket çdo njësie organizative përmes stafit menaxhues të tyre. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha politikave, rregullave dhe procedurave të BQK-së për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për vlerësime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për menaxhimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve emergjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimin të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin, kur kjo është efektive.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Menaxhimi i kapitalit

Përshtatshmëria me standardet dhe korinizen raportuese për zërat financiar, BQK mbështetet politikat, rregullat dhe procedurat e brendshme dhe në bazë të të cilave pegatitet raportimi periodik. Pastaj këto janë të rishikuara prej Departamentit për menaxhimin e rrezikut dhe Auditimit të Brendshëm. Gjetjet e vlerësimeve si të Departamentit për menaxhimin e rrezikut ashtu edhe të Auditimit të Brendshëm diskutohen me menaxhimin e njësisë organizative me të cilën ato ndërlidhen, dhe po ashtu të njëjtat dorëzohen dhe diskutohen në Komitetin e Auditimit dhe të organet vendimmarrëse të BQK-së.

Në përputhje me Ligjin, BQK-ja krijon dhe mban një rezervë të përgjithshme. Rezerva e përgjithshme nuk mund të përdoret, përveç për qëllime të mbulimit të humbjeve që mund të rrjedhin nga aktiviteti i saj. Përveç kësaj, BQK-ja do të krijojë llogari të rezervës së rivlerësimit për akumulimin e fitimeve të përealizuara që rrjedhin nga fitimet dhe rrjedhimisht mbulimin e humbjeve të përealizuara për shkak të pozicioneve të saj me valuta të huaja, ari, instrumente financiare dhe aktive tjera.

Sipas Ligjit nr. 03/L-209, të ardhurat neto ose humbja neto e BQK-së llogariten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Fitimet në dispozicion për shpërndarje do të përcaktohen:

- duke zbritur nga fitimi neto, shumën totale të ardhurave të përealizuara të rivlerësimit, dhe duke ndarë një shumë ekuivalente në llogarinë përkatëse të përealizuara të rezervës së rivlerësimit, dhe
- duke zbritur nga llogaria e duhur e përealizuar e rezervës së rivlerësimit dhe duke shtuar në fitimet e shpërndara shumën e çfarëdo fitimi të përealizuar që është zbritur nga fitimi neto për një ose më shumë vitet e mëparshme dhe u realizuara gjatë vitit aktual financiar.

Humbjet e përealizuara nga rivlerësimi do të transferohen në llogaritë përkatëse rezervë të përealizuara të rivlerësimit deri në kohën kur këto llogari rezervë rivlerësimi kanë një bilanc zero, pasi që këto humbje do të mbulohen nga fitimi i vitit aktual, atëherë nga ana e rezervave të përgjithshme dhe më pas duke i autorizuar llogarisë kapitale.

Sipas nenit 56, paragrafi 1.1. të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbetet pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(f) Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)

Të ardhurat e ndashme		
Përshkrimi	2024	2023
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	31,617	27,631
Nga të cilat janë fitimet (fitimet) e perealizuara nga rivlerësimi (shënimi 29)	(783)	-
Nga të cilat janë humbjet e perealizuara të rivlerësimit të cilat janë realizuar në vitin aktual	-	-
Të ardhurat e ndashme	30,834	27,631
Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme		
	2024	2023
Kapitali	30,000	30,000
Rezervat e përgjithshme	56,997	39,507
Të ardhurat e ndashme	30,834	27,631
Gjithsej Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme	117,831	97,138
Gjithsej detyrimet monetare		
	2024	2023
Ndaj bankave komerciale vendore	656,127	590,505
Ndaj institucioneve qeveritare	574,631	511,705
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	189,488	182,925
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	104,576	240,163
Nga huamarrja/et	1,484	1,662
Ndaj detyrimeve tjera monetare	760	757
Gjithsej detyrimet monetare³	1,527,066	1,527,717
Raporti sipas nenit 56, paragrafi 1.1.	7.72%	6.36%
Kapitali dhe rezervat (neni 56, p.1.1.)	117,831	97,138
Kapitali dhe rezervat (neni 56, p.1.1.) - Limiti 5%	76,353	76,386
Të ardhura të ndashme mbi limit 5%	30,834	20,752
50% i të ardhurave të ndashme	15,417	10,376

(g) Menaxhimi i aseteve

Në pajtim me Ligjin 03/L-209 dhe Ligjin 03/L-048, BQK-së i është caktuar përgjegjësia për bërjen dhe menaxhimin e investimeve të autorizuara në emër të Ministrisë së Financave.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare përfshin përdorimin e vlerësimeve dhe supozimeve të pasigurta lidhur me ngjarjet e ardhshme që ndikojnë në shumat e njohura për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet. Menaxhmenti diskuton me Bordin e Bankës Qendrore zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmërinë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

³ Përfjashtuar akrualet.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Lejimet për humbjet kreditore

Pasuritë e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen në baza të vazhdueshme për të identifikuar rënien e mundshme në vlerë të pasurisë. Pasiguri në vlerësim të cilat mund të rezultojnë në një rregullim material në periudhë raportuese, paraqiten në rastin e: përcaktimit të të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen dhe supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e flukseve të rikuperueshme monetare.

Përbërësit specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të pasurive financiare të vlerësuara individualisht dhe bazohet në vlerësimin më të mirë të menaxhimit të vlerës aktuale të rrjedhjeve të pritshme të parasë që pritet të pranohen. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave, menaxhmenti gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali të vendosur.

Zhvillimet tjera globale dhe efektet e krizave të përgjithshme globale

Në pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe 2024 rezervat ndërkombëtare të bankës, të përbërë nga letra me vlerë dhe depozita bankare afatshkurtra (në valuten euro) të shaplosura në zërat përkatës, nuk janë ndikuar materialisht nga ngadalësimi ekonomik apo trendët e inflacionit në nivel si dhe dhe krizave tjera të këtyre viteve në nivel global apo tregjeve kur ne kemi ekspozimime e rezervave të jashtme. Si dhe po ashtu nuk vlerësojmë se do ketë ndikim edhe në vitin pasues pas vitit raportues.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i pasurive dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që pasuritë dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e pasurive financiare si të mbajtura për t'u arkëtuar rrjedhat e kontraktuara të parasë, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe afërsinë për t'i mbajtur mjetet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël.

Poashtu gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël, që kanë një ndikim domethënës në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë: përcaktimi i kriterëve për të vlerësuar nëse rreziku kreditor i një pasurie financiare është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, përcaktimi i metodologjisë për përfshirjen e informacionit mbi të ardhmen në matjen e humbjeve të Pritshme Kreditore (HPK) dhe përzgjedhja dhe miratimi i modeleve të përdorura për të matur HPK-të.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

6. Pasuritë dhe detyrimet financiare (klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të pasurive dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre. Të gjitha pasuritë financiare janë të mbajtura në koston e amortizuar (të mbajtura për të arkëtuar).

31 Dhjetor	Shënim	2024		2023	
		Kostoja e amortizuar	Vlera e drejtë	Kostoja e amortizuar	Vlera e drejtë
Paraja e gatshme	7	77,017	77,017	101,932	101,932
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	147,633	147,633	426,077	426,077
Leftrat me vlerë	9	732,094	724,185	717,814	705,860
Plasmanët në tregun e parasë	10	506,806	205,252	205,252	205,252
Pasuritë lidhur me FMN	11	180,189	178,261	178,261	178,261
Pasuritë tjera	14	2,673	145	145	145
		1,646,412	1,332,493	1,629,481	1,617,527
Detyrime ndaj bankave vendase	15	656,260	656,260	590,622	590,622
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	190,555	190,555	184,217	184,217
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	575,251	575,251	511,903	511,903
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	104,611	104,611	240,202	240,202
Nga huamarrja /et	19	1,484	1,484	1,662	1,662
Detyrime të tjera vendase	20	760	760	758	758
		1,528,921	1,528,921	1,529,364	1,529,364

7. Paraja e gatshme

Paraja e gatshme

	2024	2023
Paraja e gatshme	77,017	101,932
Gjithsej vlera	77,017	101,932

Saldot janë sipas trendit normal mbi menaxhimin e vlerës/sasisë së parasë se gatshme në pozicionet tona financiare për periudhat e raportimi me dhe për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor të viteve përkatëse në shpalosje sipas këtij shënimi!

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja

Këto llogari mbahen në bankat e mëposhtme:

	2024	2023
Deutsche Bundesbank	47,999	319,333
Raiffeisen Zentralbank	1,721	6,023
Deutsche Bank	1,166	10,534
Banque centrale du Luxembourg	55,761	67,529
Commerzbank AG	465	1,078
Bank of Lituania	6,026	20,101
Federal Reserve Bank (FED-NY)	327	246
DZ Bank AG	374	-
Hrvatska Narodna Banka	21,368	-
Erste Group Bank Ag	743	-
National Bank Of Belgium	10,145	-
Banca d'Italia	1,009	-
Gjithsej vlera bartese	147,104	424,844
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(42)	(117)
Gjithsej vlera neto	147,062	424,727

Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja
interesi aktual

	2024	2023
Deutsche Bundesbank	272	1,077
Raiffeisen Zentralbank	0.5	-
Banque Centrale du Luxembourg	152	209
Bank of Lituania	28	64
Hrvatska Narodna Banka	92	-
Erste Group Bank Ag	0.5	-
National Bank Of Belgium	24	-
Banca D'Italia	2	-
Llogaritë rrjedhëse me bankat – akrualet	571	1,350
Llogaritë rrjedhëse me bankat - Gjithsej	147,633	426,077

Norma e interesit për periudhën raportuese është ndërmjet 0.66% dhe 4.0%. Ndersa në periudhën krahasuese kanë qenë ndërmjet 0.9% dhe 4.0%. Duke treguar tendencë zogëlimi në tremuorijne tretë 2024 krahas vitit 2024 dhe vitit 2023 për rreth 84 deri në 100 pikë të përqindjes!

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja (vazhdim)

Lëvizjet e HPK përkatëse për llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja janë si më poshtë:

	2024			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK më 1 Janar 2024	117	-	-	117
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	(75)	-	-	(75)
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet e HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	42	-	-	42

	2023			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK më 1 Janar 2023	41	-	-	41
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	76	-	-	76
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet e HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2023	117	-	-	117

9. Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupimit janë letra të borxhit të lëshuara nga vendet e Bashkimit Evropian, Amerika dhe nga Kosova. Bonot e thesarit të shpalosura me poshtë kanë maturitet deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve deri në 7 vite. Norma e interesit efektiv në letra me vlerë variron ndërmjet -0.014% deri në 4.998% vjetore në vitin 2024 (2023: -0.014% deri në 5.104% vjetore).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse mik është theksuar ndryshe)

9. Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare) (vazhdim)

Shpalosje analitike e letrave me vlerë sipas llojit dhe sipas shteteve emetuese:

Sipas shteteve:

Shteti	2024			2023		
	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera
Gjermani	58,625	(34)	58,591	80,243	(32)	80,211
Francë	48,499	(30)	48,469	69,396	(33)	69,363
Holandë	73,606	(37)	73,569	49,337	(15)	49,322
Finlandë	67,759	(40)	67,719	60,578	(19)	60,559
Sloveni	29,989	(19)	29,970	20,695	(15)	20,680
Luksemburg	29,543	(4)	29,539	9,795	(2)	9,793
Belgjikë	69,117	(36)	69,081	89,857	(44)	89,813
Austri	70,216	(49)	70,167	68,911	(17)	68,894
Irlandë	45,849	(15)	45,834	31,322	(2)	31,320
Amerikë	14,364	(2)	14,362	4,493	(1)	4,492
Itali	36,700	(30)	36,670	37,836	(28)	37,808
Poloni	15,506	(38)	15,468	15,658	(28)	15,630
Kosovë	172,789	(134)	172,655	180,060	(131)	179,929
Gjithsej	732,562	(468)	732,094	718,181	(367)	717,814

Sipas llojit:

	2024			2023		
	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto Vlera	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto Vlera
Bono thesari	14,364	(2)	14,362	74,019	(20)	73,999
Obligacione	718,198	(466)	717,732	644,162	(347)	643,815
Gjithsej	732,562	(468)	732,094	718,181	(367)	717,814

Lëvizjet e HIPK përkatëse për letrat me vlerë të borxhit me kosto të amortizuar janë si më poshtë:

	2024			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK më 1 Janar 2024	367	-	-	367
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	101	-	-	101
Ndikimi në fund të vitit I HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç' regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	468	-	-	468

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

9. Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare) (vazhdim)
 Lëvizjet e HPK përkatëse për letrat me vlerë të borxhit me kosto të amortizuar (vazhdim)

	2023			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK më 1 Janar 2023	362	-	-	362
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	5	-	-	5
Ndikimi në fund të vitit I HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2023	367	-	-	367

Në tabelën në vijim paraqitet shpërndarja gjeografike e investimeve në letra me vlerë, duke përfshirë normën e interesit efektiv minimale, maksimale dhe mesatare. Po ashtu përqindjen e koncentrimit dhe maturitetet në nivel shteti.

Shteti	2024					
	Interesit efektiv minimal	Interesit efektiv maksimal	Interesi efektiv mesatar	Vlera e bartur	% e peshës në gjithsej	Maturiteti
Gjermani	0.49757%	3.03205%	2.10637%	58,625	8.00%	2025-2027
Francë	0.85635%	2.37200%	1.61417%	48,499	6.62%	2025-2027
Holandë	2.06588%	2.36018%	2.17894%	73,606	10.05%	2026-2028
Finlandë	0.85555%	3.05094%	2.20657%	67,759	9.25%	2025-2028
Sloveni	0.47233%	3.15152%	2.08428%	29,989	4.09%	2025-2028
Luksemburg	1.16414%	2.26451%	1.88860%	29,543	4.03%	2025-2026
Belgjike	0.22016%	2.63902%	1.72340%	69,117	9.44%	2025-2029
Austri	2.14269%	3.37129%	2.67847%	70,216	9.58%	2025-2029
Irlandë	2.17326%	3.31140%	2.62184%	45,849	6.26%	2025-2031
Amerikë	4.60941%	4.99778%	4.80360%	14,364	1.96%	2025
Itali	-0.01403%	0.05282%	0.01940%	36,700	5.01%	2026
Poloni	0.05768%	0.07231%	0.06645%	15,506	2.12%	2027-2028
Kosovë	0.98795%	3.69770%	2.17685%	172,789	23.59%	2025-2029
Gjithsej				732,562	100%	

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

9. Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet) (vazhdim)

Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet)

Shteti	2023			Vlera e bartur	% e peshës në gjithsej	Maturiteti
	Interesit efektiv minimal	Interesit efektiv maksimal	Interesi efektiv mesatar			
